

Gjykata Themelore e Prishtinës

Numri i lëndës PKR nr. 218/14

Data: 17 maj 2016

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut të Prishtinës, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek, si Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve Mariola Pasnik dhe N.S. Foniqi si anëtarë të trupit gjykues dhe Nuhi Shalës si procesmbajtës, në lëndën penale kundër:

E.S.

[në paraburgim që nga arrestimi i tij me 3 janar 2014]

I akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale PPS nr. 467/2009 të datës 24 prill 2014, e ndryshuar me 27 prill 2016, për pikat në vijim:

PIKA 1

Vepra penale *Nxitje për të kryer Vrasje të Rëndë* në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPK”),

PIKA 2

Vepra penale e *Detyrimit* në kundërshtim me nenin 267 (1) dhe (2) të KPK-së

PIKA 3

Vepra penale e *Dhunimit* në kundërshtim me nenin 193 (1) dhe (2) të KPK-së,

Pas mbajtjes së gjykimit publik me 30 prill 2014; 31 tetor 2014; 5, 6 10, 14, 19, 20, 21 nëntor 2014; 16 dhjetor 2014; 10, 13, 14, 22, 27, 28, 29 janar 2015; 11 dhe 12 shkurt 2015; 4 dhe 31

mars 2015; 27 dhe 30 prill 2015; 25, 28 dhe 29 maj 2015; 1, 2, 3, 15, 26 qershor 2015; 20, 21, 22 dhe 23 korrik 2015; 17, 18, 19, 20 dhe 21 gusht 2015; 1, 2, 5, 6, 29 dhe 30 tetor 2015; 2, 3, 4, 5, 6, 17, 18 dhe 30 nëntor 2015; 1, 2, 3 dhe 4 dhjetor 2015; 25 janar 2016; 2, 3, 7, 8 dhe 9 mars, 2016; 12, 13, 14, 19 dhe 29 prill 2016; 12 maj 2016.

me Andrew Carney që përfaqëson Prokurorinë Speciale të Kosovës, në prani të palëve të dëmtuara, avokatëve mbrojtës të E.S., K.K.t dhe B.P.s dhe më në fund të pandehurit E.S., të pranishëm gjatë gjithë seancave,

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur me 17 maj 2016 shpalli publikisht të mëposhtmin:

AKTGJYKIM

E.S., me detaje personale si më lart, në paraburgim që nga data 3 janar 2014 shpallet si vijon:

Në përputhje me nenin 365 (1) të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme “KPP”),

PIKA 1

FAJTOR për Nxitjen për të kryer Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPK”),

SEPSE

Më 30 gusht 2007, në Prishtinë në territorin e Kosovës, E.S. ka nxitur A.B. për të privuar nga jeta T.R i cili veproi kështu në bashkëkryerje me R.A., I.A.n dhe F.A.n në një mënyrë mizore dhe mashtruese dhe për shkak të hakmarrjes së paskrupullt apo ndonjë motiv tjetër bazë përkatësisht duke pasur hakmarrje personale kundër të përmendurit në fjalë T.R, një zyrtar në shërbim të policisë në Shërbimin Policor të Kosovës. Para vrasjes, grupi duke vepruar së bashku, ka ndjekur lëvizjet e T.R. në mënyrë që ta ndjek atë.

Me 30 gusht 2007, gjersa E.S., A.B., R.A. dhe I.A. ishin në kafenenë 'S.' në Bulevardin Bill Klinton, F.A., nëpërmjet telefonit të tij celular 044 XXXXX përfaqësisht rreth orës 14:06:58 i dërgoi një mesazh I.A.t në telefonin e tij celular 044 XXXXX duke deklaruar "*Fqinji ka veturën në vendparkimin e Grandit*", e cila i referohej T.R., apartamenti i të cilit ishte i vendosur në anën e kundërt të rrugës në S. Bar dhe i cili, në këtë kohë, ishte brenda në hotelin Grand, Prishtinë. Menjëherë pas marrjes së këtij mesazhi, A.B., R.A. dhe I.A., duke vozitur veturën e I.A.t, një Passat, shkuan në Bar Queen. Atje, A.B. hyri në bar i armatosur me një pistoletë 'Glock' me kalibër 9 x 19 mm me numrin serial FDR795 ndërsa dy të tjerët hynë në një kafene tjetër në mënyrë që të presin T.R i cili ishte një klient i rregullt në kafenenë AM / PM. Aty rreth orës 15:00, T.R hyri në kafenenë AM / PM. Posa T.R doli nga kafeneja AM / PM, ai u qëllua gjersa ai po ecte drejt automjetit të tij në një parking të veturave në vendin e quajtur Flamurtari në Dardani. A.B., i cili vrapoi në drejtim të tij, nga prapa gjuajti diku rreth njëmbëdhjetë plumba pa asnjë paralajmërim apo provokim, tre prej të cilëve e goditën T.R, duke e plagosur për vdekje. Vrasja ishte kryer në një mënyrë mizore dhe mashtruese pasi që ajo ishte e para-planifikuar dhe e ekzekutuar nga një grup kundër një viktime i cili ishte i pambrojtur dhe në të ishte shtënë nga prapa.

Vrasja u organizua dhe u koordinua nga një numër i individëve të cilët ishin anëtarë të grupit të ashtuquajtur 'Grupi S.', duke qenë lider i kësaj bande E.S.. T.R u vra sepse, në vitet që shpinin kah vrasja e tij, ai ishte bërë një shënjestër për hakmarrje. Në vitin 2004, i ndjeri u miqësua me dëshmitaren A.I..

Më tej, me 24.12.2005 në një klub nate të quajtur Swiss Casino, në Prishtinë, ndodhi një grindje e dhunshme brenda në lokal në mes të T.R. në njërin anë dhe bandës së E.S. gjatë së cilës pati të shtëna dhe individë të ndryshëm ishin plagosur. I pandehuri mori lëndime gjatë këtij incidenti, duke marr trajtim në spital si pasojë e incidentit të dhunshëm me të vdekurin. Ky incident, mes tjerash, shkaktoi që i pandehuri në mënyrë aktive të kërkojë hakmarrje kundër T.R..

Më tej, me 22.05. 2006, E.S. ishte i përfshirë në një incident të dhunshëm me pjesëtarët e Policisë së Kosovës në Ferizaj, një ngjarje për të cilën i pandehuri e fajësoi T.R duke besuar që ai në mënyrë aktive ka inkurajuar kolegët e tij policor të sulmojnë të pandehurin.

Duke kërkuar hakmarrje dhe i zemëruar nga veprimet e T.R., në periudhën që çon në vrasjen e tij, i pandehuri dhe banda e tij shpesh e ndoqën atë në makinat e tyre në një përpjekje për t'a frikësuar apo lënduar atë. Pretendohet se E.S. ka orkestruar vrasjen, duke organizuar anëtarët e tij të bandës për të gjurmuar T.R dhe nxitur A.B. i cili ishte një anëtar i besuar i grupit për të shtënë të shtëna vrasëse. T.R kurrë nuk kishte pasur personalisht ndonjë problem me A.B., vetëm me E.S..

PIKA 2

Vepra penale e *Detyrimit* në kundërshtim me nenin 267 (1) të KPK-së

Sepse

Nga fillimi i vitit 2003 deri në fund të 2004, i pandehuri ka zhvatur para në shuma të ndryshme dhe në raste të shumta nga pala e dëmtuar A.I.. Gjersa ajo jetonte në një apartament në zonën Dardania të Prishtinës, ka pasur raste kur i pandehuri, duke vepruar me grupin e tij, kërkonte dhe zhvaste para nga ajo. Në një rast të veçantë, ai e kërcënoi atë, duke përdorur fjalët "*hej vajzë e mirë, në bagazh ne mbajmë një karrige me rrota për vajzat e këqija; ne i marrim ato dhe i dërgojmë në Llukar dhe një herë kur unë ua bëj atë atyre dhe pastaj miqtë e mi ia bëjnë atë atyre, kështu që bëhu vajzë e mirë.*"

A.I. ishte një këngëtare e famshme dhe e njohur mirë në Kosovë në atë kohë për shfaqjet e saj të gjalla dhe paraqitjet në stacionet televizive dhe radiot lokale.

Për shkak të kërcënimeve të tilla që dëshmitarja i mori seriozisht duke pasur parasysh reputacionin e të pandehurit si udhëheqës i dhunshëm dhe i paskrupullt të bandës, ajo u ndje në frikë për sigurinë e saj dhe i dorëzoi E.S. shuma të ndryshme të tilla si 200 €, 500€, 1000€, 2000 €, 3000€, 4000€ deri në 9000 €. Ajo u detyrua që të lë paratë jashtë derës së apartamentit të saj ose nën fshirësen e xhamave të makinës apo nën automjetin e nënës së saj. Gjatë vitit 2004, dëshmitarja kaloi një kohë në Gjermani në cilësinë e saj si këngëtare që jepte koncerte. Me kthimin e saj në Prishtinë, i pandehuri i kërkoi dhe ajo i dha atij shumën prej 9.000 €. A.I. i

dorëzoi shuma të shumta personalisht atij apo bashkëpunëtorëve të tij për shembull në 'Gjambazet,' në hotelin Madrid në Prishtinë, në oborrin e shtëpisë së tij dhe tek Albi Commerce në Dardani. Kur ajo nuk pranoi që ta paguajë atë më tej, vetura e saj ishte vandalizuar dhe apartamenti i saj u sulmua. Pasi që ajo ka mbajtur koncerte edhe në të gjithë Kosovën dhe për këtë arsye nuk ka qenë në gjendje për të dorëzuar paratë e kërkuara prej saj, ajo mori kërcënime nga ai nëpërmjet telefonit, ku ai i tha asaj se bombat ishin vendosur në sallat e koncerteve, ku ajo kishte për të performuar, duke rezultuar në anulimin e një koncerti që duhej të mbahej në Graçanicë. Ajo u detyrua që të punësojë mbrojtje personale. Nëna e saj, M.I., gjithashtu ishte sulmuar dhe abuzuar verbalisht nga i pandehuri dhe grupi i tij, në mënyrë që ta detyrojë A.I. që t'i paguaj atij shuma të mëtejshme të parave. Situata vazhdoi derisa ajo u miqësua dhe u vu nën mbrojtjen e policit T.R, kur i pandehuri u ndal së thirruri atë edhe pse ajo vazhdoi të vuajë nga sjellja frikësuese e të pandehurit në rastet kur ajo ishte e shoqëruar nga T.R në fjalë.

PIKA 3

SEPSE

Ankuesja E.Z. e takoi së pari të pandehurin me 21.04.2004, kur ai e thirri me telefon ndërsa ajo po ngiste veturën e saj kur ai së pari hyri në bisedë me të. Më vonë atë ditë, pasi që ajo kishte përfunduar punën në vendin e saj të punës në Ferizaj, i pandehuri së bashku me një E.L. këmbëngulën që ata ta vozitin atë në shtëpinë e tij. Kur shkuan atje, ai filloi që ta puthë atë por ajo iu lut atij që të mos shkojë më tej pasi që ajo ishte e virgjër. Ai e lejoi atë që të braktisë ambientet e tij. Gjatë ditëve në vijim, ai e kontaktonte atë me telefon.

Më vonë me 19.10.2004, i pandehuri i telefonoi asaj dhe i kërkoi asaj të shkonte në shtëpinë e tij gjë të cilën ajo e bëri. Kur shkoi atje, ai u zemërua sepse ajo nuk i tregonte ku kishte qenë një natë më parë dhe e goditi atë. Ai pastaj i hoqi rrobat e tij dhe e urdhëroi atë që të bëjë të njëjtën gjë. Nga frika për të për shkak të reputacionit të tij dhe për shkak se ai sapo e kishte goditur me shuplakë, ajo iu bind. Pavarësisht asaj se ajo përsëri deklaroi se ishte e virgjër, ai e detyroi atë që

të ketë marrëdhënie seksuale me të pa pëlqimin e saj. Si rezultat i kësaj, ajo mbeti shtatzënë. Me 07.12.2004, ajo vizitoi një klinikë ku ajo abortoi.

Në bazë të nenit 364, 1.3 të KPP-së është shpallur i **PAFAJSHËM** për *Dhunim* në kundërshtim me nenin 193 (1) dhe (2) nën-paragrafin (2) të KPK-së pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën ai ishte akuzuar.

I pandehuri E.S.

Për veprën penale të përshkruar në pikën 1, bazuar në nenin 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 24 dhe nenin 147 (3) dhe (9) dhe 36 (1) dhe 37 (2) të Kodit Penal të Kosovës dënohet me burgim afatgjatë prej 37 (tridhjetë e shtatë) vjet;

Për veprën penale të përshkruar në pikën 2, bazuar në nenin 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 267 (1) të Kodit Penal të Kosovës me burgim prej 3 (tre) vjet;

Në bazë të nenit 71 (2) të Kodit Penal të Kosovës një dënim unik me burgim afatgjatë prej 37 (tridhjetë e shtatë) vjet i është shqiptuar të pandehurit E.S. për veprat penale të përshkruara në pikën 1 dhe 2 të dispozitivit.

Në bazë të nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 i KPP-së, koha të cilën i pandehuri E.S. e ka kaluar në paraburgim prej datës 03.01.2014 deri më 17 maj 2016- 2 (dy) vjet, 4 (katër) muaj e 14 (katërbëdhjetë) ditë do të llogaritet në dënim;

Në bazë të nenit 367 paragrafi 2 i KPP-së, paraburgimi kundër E.S. vazhdohet derisa aktgjykimi të merr formën e prerë;

Në pajtim me nenin 453 paragrafi 4 i KPP-së, i pandehurit E.S. do të lirohet plotësisht nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale.

Kryetari i trupit gjykues i EULEX-it Arkadiusz Sedek

Anëtarët e trupit gjykues

Gjyqtari i EULEX-it Mariola Pasnik

Gjyqtari vendor N.S. Foniqi

ARSYETIMI

A. Historiati procedural

1. Më 24 prill 2014, prokurori i PSRK-së ka ngritur aktakuzën PPS nr. 467/2009 e së njëjtës datë, ku i pandehuri është akuzuar për tri pika si më poshtë: *Nxitje për të kryer Vrasje të rëndë* në bazë të nenit 24 dhe 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës ("KPK"), *Detyrim* në bazë të nenit 267 (1) dhe (2) të KPK-së, *Dhunim* në bazë të nenit 193 (1) dhe (2) të KPK-së ..

2. Seanca fillestare dëgjimore ishte mbajtur më 30 prill 2014.

3. Në bazë të aktvendimit të nxjerrë nga Kryetari i trupit gjykues me datë 12 qershor 2014, Kërkesa e avokatit mbrojtës të të pandehurit E.S. për hedhjen e aktakuzës dhe për të shpallur provat si të papranueshme ishte refuzuar si e pabazuar.

Aktvendimi për refuzimin e kërkesës u kundërshtua nga avokatët mbrojtës për të pandehurin E.S.. Në një aktvendim të datës 7 gusht 2014, Gjykata e Apelit, ka vërtetuar aktvendimin e Kryetarit të trupit gjykues i cili u përmend më lart.

4. Një aktakuzë e ndryshuar ishte ngritur me 27 prill 2016 që kishte marrë parasysh kohën e korrigjuar të sms-ve.

5. Seancat e shqyrtimit gjyqësor ishin mbajtur më 30 prill 2014; 31 tetor 2014; 5, 6 10, 14, 19, 20, 21 nëntor 2014; 16 dhjetor 2014; 10, 13, 14, 22, 27, 28 29 janar 2015; 11 dhe 12 shkurt 2015; 4 dhe 31 mars 2015; 27 dhe 30 prill 2015; 25, 28 dhe 29 maj 2015; 1, 2, 3, 15, 26 qershor 2015; 20, 21, 22 dhe 23 korrik 2015; 17, 18, 19, 20 dhe 21 gusht 2015; 1, 2, 5, 6, 29 dhe 30 tetor 2015; 2, 3, 4, 5. 6, 17, 18 dhe 30 nëntor 2015; 1, 2, 3 dhe 4 dhjetor 2015; 25 janar 2016; 2, 3, 7, 8 dhe 9 mars 2016; 12, 13, 14, 19 dhe 29 prill 2016; 12 maj 2016.

Gjatë seancave të lartpërmendura janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

Nr.	Titulli i dokumentit/Dëshmitari	Data	Regjistratori	Fashikulli
1.	Procesverbali i dëgjimit fillestar	30/04/2014	Regjistratori A	Fashikulli A
2.	Fjalimet hyrëse	31/10/2014	Regjistratori A	Fashikulli B
3.	Dëshmitari S.R.	05/11/2014	Regjistratori A	Fashikulli C
4.	Dëshmitari V.R.	06/11/2014	Regjistratori A	Fashikulli D
5.	Dëshmitari S.K.	10/11/2014	Regjistratori A	Fashikulli E
6.	Dëshmitari S.H.	10/11/2014	Regjistratori A	Fashikulli E
7.	Dëshmitari F.S.	19/11/2014 20/11/2014	Regjistratori A Regjistratori A	Fashikulli G Fashikulli H
8.	Dëshmitari G.H.	20/11/2014	Regjistratori A	Fashikulli H
9.	Dëshmitari K.B.	21/11/2014	Regjistratori A	Fashikulli IJ
10.	Dëshmitarja E.Ze.	16/12/2014	Regjistratori A	Fashikulli K
11.	Dëshmitarja Z.I.	10/01/2015	Regjistratori B	Fashikulli A
12.	Dëshmitarja M.D.	13/01/2015	Regjistratori B	Fashikulli B
13.	Dëshmitari B.G.	13/01/2015	Regjistratori B	Fashikulli B
14.	Dëshmitari B.O.	13/01/2015	Regjistratori B	Fashikulli B
15.	Dëshmitari A	13/01 2015 14/01/2015	Regjistratori B Regjistratori B	Fashikulli B Fashikulli C
16.	Dëshmitari B.S.	22/01/2015	Regjistratori B	Fashikulli D
17.	Dëshmitarja M.I.	27/01/2015 28/01/2015	Regjistratori B Regjistratori B	Fashikulli E Fashikulli F
18.	Dëshmitari E.I.	28/01/2015 29/01/2015	Regjistratori B Regjistratori B	Fashikulli F Fashikulli G

19.	Dëshmitari R.J.	29/01/2015	Regjistratori B	Fashikulli G
20.	Dëshmitarja R.I.	11/02/2015	Regjistratori C	Fashikulli A
21.	Dëshmitari M.K.	12/02/2015	Regjistratori C	Fashikulli B
22.	Dëshmitarja B.M.	12/02/2015 31/03/2015	Regjistratori C Regjistratori C	Fashikulli B Fashikulli D
23.	Dëshmitarja A.I.	27/04/2015	Regjistratori C	Fashikulli E
24.	Dëshmitarja M.P.	30/04/2015	Regjistratori C	Fashikulli F
25.	Dëshmitarja L.I.	30/04/2015	Regjistratori C	Fashikulli F
26.	Dëshmitari B.H.	25/05/2015 28/05/2015 01/06/2015	Regjistratori C Regjistratori C Regjistratori D	Fashikulli G Fashikulli HI Fashikulli B
27.	Dëshmitari A.Be.	29/05/2015 02/12/2015	Regjistratori D Regjistratori G	Fashikulli A Fashikulli 11
28.	Dëshmitari D2	02/06/2015 18/11/2015	Regjistratori D Regjistratori G	Fashikulli C Fashikulli 8
29.	Dëshmitari S.Q.	03/06/2015 15/06/2015	Regjistratori D Regjistratori D	Fashikulli D Fashikulli E
30.	Dëshmitari B.G.	26/06/2015	Regjistratori D	Fashikulli F
31.	Dëshmitari O.M.	20/07/2015	Regjistratori D	Fashikulli G
32.	Dëshmitari F.G.	20/07/2015	Regjistratori D	Fashikulli G
33.	Dëshmitari L.M.	20/07/2015	Regjistratori D	Fashikulli G
34.	Dëshmitari S.L.	21/07/2015	Regjistratori D	Fashikulli H
35.	Dëshmitari F.Gu.	21/07/2015	Regjistratori D	Fashikulli G
36.	Dëshmitari N.S.	21/07/2015 22/07/2015 23/07/2015 17/08/2015	Regjistratori D Regjistratori E Regjistratori E Regjistratori E	Fashikulli H Fashikulli A Fashikulli B Fashikulli C

37.	Dëshmitari D.H.	17/08/2015	Regjistratori E	Fashikulli C
38.	Dëshmitari F.B.	18/08/2015 19/08/2015	Regjistratori E Regjistratori E	Fashikulli D Fashikulli E
39.	Dëshmitari A.E.	18/08/2015 19/08/2015	Regjistratori E Regjistratori E	Fashikulli D Fashikulli E
40.	Dëshmitarja R.I.	18/08/2015	Regjistratori E	Fashikulli D
41.	Dëshmitari L.K.	19/08/2015	Regjistratori E	Fashikulli E
42.	Dëshmitari M.K.	20/08/2015 21/08/2015 05/10/2015	Regjistratori E Regjistratori E	Fashikulli F Fashikulli G
43.	Dëshmitari B.Sp.	21/08/2015	Regjistratori E	Fashikulli G
44.	Dëshmitari D.Ha.	01/10/2015	Regjistratori F	Fashikulli 1
45.	Dëshmitari R.B.	01/10/2015	Regjistratori F	Fashikulli 1
46.	Dëshmitari A.D.	02/10/2015	Regjistratori F	Fashikulli 2
47.	Dëshmitarja F.M.	05/10/2015	Regjistratori F	Fashikulli 3
48.	Dëshmitari F.A.	06/10/2015	Regjistratori F	Fashikulli 4
49.	Dëshmitari A.B.	29/10/2015 30/10/2015 02/11/2015 19/04/2016	Regjistratori F Regjistratori F Regjistratori G Regjistratori H	Fashikulli 5 Fashikulli 6 Fashikulli 1 Fashikulli _
50.	Dëshmitarja L.Id.(K.)	02/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 1
51.	Dëshmitari K.M.	03/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 2
52.	Dëshmitari G.S.	03/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 2
53.	Dëshmitari F.L.	04/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 3
54.	Dëshmitari M.T.	04/11/2015 05/11/2015	Regjistratori G Regjistratori G	Fashikulli 3 Fashikulli 4

55.	Dëshmitarja V.S.	05/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 4
53.	Dëshmitari A.G.	06/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 5
56.	Dëshmitarja S.G.N.	06/11/2015 04/12/2015	Regjistratori G Regjistratori H	Fashikulli 5 Fashikulli _
57.	Dëshmitari B.Ma.	17/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 7
58.	Dëshmitari A.Gr.	17/11/2015 02/12/2015	Regjistratori G Regjistratori G	Fashikulli 7 Fashikulli 11
59.	Dëshmitari J.T.	30/11/2015	Regjistratori G	Fashikulli 9
60.	Dëshmitari A.H.	01/12/2015	Regjistratori G	Fashikulli 10
61.	Dëshmitari B.A	02/12/2015	Regjistratori G	Fashikulli 11
62.	Dëshmitari Q.Q.	03/12/2015	Regjistratori G	Fashikulli 12
63.	Dëshmitari L.L.	03/12/2015	Regjistratori G	Fashikulli 12
64.	Dëshmitari B.D.	03/12/2015	Regjistratori G	Fashikulli 12
65.	Dëshmitari N.Se.	14/04/2016	Regjistratori H	Fashikulli _
66.	Dëshmitarja M.S.	14/04/2016	Regjistratori H	Fashikulli _
67.	Dëshmitari H.S.	14/04/2016	Regjistratori H	Fashikulli _
68.	Dëshmitarja N.G.	19/04/2016	Regjistratori H	Fashikulli _

Në bazë të nenit 541 të KPP-së, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, gjykimi është zhvilluar në përputhje me dispozitat e Kodit të ri të Procedurës Penale.

Provat e motiveve të N.S. për të vrarë T.R.

a. Rasti Swiss Casino

Duhet të theksohet në mënyrë të qartë dhe vendimtare se në këtë gjykim prokuroria nuk ka paraqitur prova të drejtpërdrejta që vërtetojnë se E.S. në fakt ka vrarë T.R, por në fakt ka ofruar prova të mjaftueshme rrethanore dhe të pafundme se në fakt E.S. ka vepruar që vrasja e tij të ndodhë.

Termi ligjor provë rrethanore është kuptuar nga ky trup gjykues në këtë mënyrë:

a. përkufizimi nga law.com që thotë si në vijim: provë rrethanore në një gjykim që nuk është drejtpërdrejt nga një dëshmitar okular ose pjesëmarrës dhe që kërkon arsyetim për të vërtetuar një fakt. Përfundimi i mundshëm nga rrethanat mund të jetë aq i fortë sa mund të ketë pak dyshim për një fakt thelbësor ("përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", në një lëndë penale, dhe "mbizotërim i provave" në një lëndë civile). Veçanërisht në rastet penale, prova e tipit të "dëshmitarit okular" ("Unë e pashë Frankin duke shtënë në Johnnin") shpesh mungon dhe mund të jetë e pabesueshme, kështu që prova rrethanore bëhet e domosdoshme. Kërcënimet e mëparshme të viktimës, shenjat e gishtërinjve të gjetur në skenën e krimit, pronësia e armës vrasëse dhe i akuzuari që është parë në lagje, sigurisht që drejtojnë kah i dyshuari si vrasës, por secila pjesë e provave është rrethanore.

b. një tjetër përkufizim mund të gjendet në legal-dictionary.com që lexon si më poshtë: prova rrethanore në ligjin e provave, provë indirekte e një fakti në çështje. Një konkluzion i faktit në çështje mund të bëhet nga marrja parasyshe e një numri të fakteve të tjera. Nganjëherë flitet për të si një zinxhir por ndoshta më shumë konsiderohet si një kabëll: sa më shumë fije aq më e fortë, dhe mungesa e një prej fijeve nuk e ndërpret lidhjen. Personi laik shpesh e konsideron atë në një farë mënyre inferiore, por jo avokati, i cili i vlerëson vështirësitë si të pandashme në provat e drejtpërdrejta të dëshmitarit okularë. Megjithatë, kjo është vetëm aq e mirë sa edhe fijet që e përbëjnë atë. Këto ndoshta duhet të vlerësohen në të drejtën e tyre, përndryshe një konkluzion i shëndoshë ndoshta mund të bazohet në një premisë të mangët, si aty ku Othello, duke kërkuar prova për pabesinë e Desdemonës, ishte përgjigjur nga Iago: " Se s' eshte pune qe t' i shohsh me sy Dhe sikur t' ishin aq asgene sa cepinjte, Te ndezur sa majmunet, a si ujq te eger, Dhe aqe budallenj te tresh' e kokefyej Sa eshte dehja e bashkuar me padijen. Po une thom me mendjen

time se, ne qofte Qe jane mjaft per ju ca shenja e ca gjyrma Qe munt t' ju shpien drejt te der' e se vertetes, Ne doni prova te ketija, munt t' i gjeni. (* *shënim i përkthyesit –këta rreshta janë marrë nga përkthimi origjinal i veprës së Shekspirit-Otello*).

Është provë përmbajtësore se E.S. ka mbajtur prej kohe një urrejtje të thellë kundër T.R.. Kjo ka filluar rreth vitit 2000 deri në vitin 2001, shumë kohë para se T.R të vritej. Në vitin 2007, i pandehuri kishte vendosur që të përfundonte punën dhe të vriste policin për shkak të urrejtjes së gjatë. E.S. ka rrezikuar se ai do të shpëtonte nga vrasja e policit në mes të ditës sikurse që nuk i kishte ndodhur asgjë më parë me të vërtetë atij nga sanksionet penale; përveç dhunës në Ferizaj ai gjithmonë ia kishte dalë të shpëtonte nga ato. Në fund të fundit, nga rasti i Swiss Casinos nuk ka asgjë dhe ende nuk ka pasoja ligjore. A.B., një anëtar i ri dhe i panjohur i grupit i cili pa dyshim ishte i prirur që ta dëshmojë veten para shefit të tij siç është tipike në kulturën e bandës, do të ekzekutonte të shtënat dhe të merrte fajin. Pastaj, E.S. do të zhdukej për një kohë; në fund çështja do të zgjidhej, anëtarë të vogël të ndryshëm të bandës do të dilnin në gjykim dhe më vonë ai do të kthehej në qytet për të vazhduar si më parë dhe ndjenja e tij e deformuar e nderit do të shlyhej . Me pak fjalë, kjo është një mënyrë shumë e mundshme në të cilën E.S. e kishte vendosur që të vrasë armikun e tij më të urryer.

Frikësimi i T.R. ka filluar shumë herët kur T.R ndjekej pasi që kishte ndodhur një incident kur ai ishte kërcënuar me një granatë në një rreth-rrrotullim në Prishtinë. Pas kësaj, ai ishte ndjekur shpesh nga i pandehuri, miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij të tillë si R.A. dhe I.A.. Në lidhje me këto incidente kërcënuese T.R.i kishte biseduar me individë të shumtë disa nga të cilët kanë dhënë dëshmi. Përveç kësaj, këto akte të ngacmimit ishin konfirmuar nga vëllai i të ndjerit, V.R.. Dëshmia e tij është shumë e rëndësishme dhe përbëhet nga prova e drejtpërdrejtë e veprimeve të të pandehurit, jo thjesht përsëritje e thashethemeve të dorës së dytë. V.R. jo vetëm që i kishte treguar vëllai për kërcënimet e vazhdueshme por ai ka qenë fizikisht i pranishëm gjatë disa prej ndjekjeve të tyre. V.R.i ka deklaruar se ata të dy ishin të ndjekur vazhdimisht nga banda e të pandehurit të cilët kishin përdorur automjete të ndryshme për t'i ndjekur ata. Ai kujton incidente të tilla si kur ai dhe vëllai i tij T.R.i ishin ndjekur në Veternik në autostradën e Shkupit. V.R. tha: "E.S., ai kishte një veturë të blinduar, dhe zakonisht qëndronte në fund të skuadrës ndjekëse.¹" Ai e përshkruajti të pandehurin si person që shpesh voziste ngadalë në një veturë të gjelbër Grand

¹ Procesverbali i gjykimit të datës 06.11.2015

Cherokee. Ai ka përshkruar se ka parë të pandehurin dhe bashkëpunëtorët e tij çdo ditë. Kjo është provë e drejtpërdrejtë e përfshirjes personale së të pandehurit në ngacmimin dhe frikësimin e T.R.. E rëndësishme dhe si provë vërtetuese se banda e kanë ndjekur pas T.R.in në ditën e vrasjes së tij ishte se V.R.i ishte i pranishëm me T.R.in kur ata u vozitën së bashku në vendparkimin e Hotelit Grand në ditën e vrasjes në mënyrë që T.R.i të shpërndante disa prodhime të djathit. V.R. e kishte parë qartazi R.A. duke qëndruar jashtë hotelit, duke shikuar direkt në ta gjersa ishte duke folur në telefonin e tij celular, pa dyshim duke i ndjekur të dy vëllezërit për tu përgatitur për vrasjen e para-planifikuar që do të ndodhte më vonë atë pasdite. Deklarata e dëshmitarit V.R. u konsiderua si plotësisht e besueshme dhe e kuptueshme. Për më tepër, ajo vërtetohet me ankesat e shumta që ishin bërë në polici nga T.R dhe A.I. në lidhje me kërcënimet dhe aktet penale të kryera nga E.S. dhe grupi i tij.

Rastet në vijim ekzistojnë në procesverbalet e Policisë së Kosovës²

a) Lënda 2003 TA1- 618 – Kërcënim

Më 01.03.2003 rreth orës 21:25 në rrugën "Ilir Konushevci", në Prishtinë, T.R gjersa ishte duke e vozitur veturën e tij i ishte afruar në semafor një veturë VG pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Tre persona dolën nga kjo veturë, erdhën tek dritarja e veturës së tij dhe filluan ta kërcënojnë dhe ta fyejnë verbalisht. Gjersa ai po dilte nga vetura e tij ai e njohu njërin nga tre të dyshuarit si N.S., vëllai i E.S., një person të cilin e kishte arrestuar pak kohë më parë në ambientet e diskotekës "2000". Viktima deklaroi se sulmuesit i kishin thënë: "A e din se kush jemi ne?! Ne do ta q... familjen dhe do të të vrasim!" Të dyshuarit ishin identifikuar si N.S., D.S. dhe E.Si., anëtarë të njohur të Grupit S.! Në atë ditë, të dyshuarit e kishin ndjekur atë për rreth 1 km. Viktima gjithashtu deklaroi se konflikti mes tij dhe S. kishte filluar gjatë muajit mars të vitit 2001 gjersa ai ishte duke i kryer detyrat e tij zyrtare, kur E.S. dhe N.S. e kishin kërcënuar atë me një granatë dore. Si pasojë, ai kishte kërkuar që të zhvillohen hetime. Rasti është dërguar në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë. Gjykata Komunale në Prishtinë kishte urdhëruar pezullimin e çështjes kundër të dyshuarve të deklaruar.

² Pp. 1-134, Fashikujt I .1-1.6 , Regjistratori VI

b) Lënda 1827 AD 2004 - Sulm

Më 09.06.2004 rreth orës 12:40, në kafenenë "AM-PM" në Prishtinë, gjersa ishin duke pirë kafe, T.R dhe vëllai i tij V.R. ishin fyer dhe sulmuar fizikisht nga të dyshuarit S.S., U.D. dhe S.Se., të njohur në vend si njerëzit e S., të cilët i njohën vëllezërit R. dhe një tjetër polic si persona të cilët kishin arrestuar njërin prej tyre disa kohë më parë. Viktimat ishin të shoqëruar nga vajza tre vjeçare e V.R.it, A. dhe një miku të quajtur A.M.. V.R. kishte pësuar lëndime në fytyrë, pasi që ishte grushtuar në hundë. Thuhet se të dyshuarit S.Se. dhe S.S. ishin në posedim të armëve të zjarrit dhe thika të cilat ata i nxjerrën në drejtim të viktimave, i kërcënuan me vdekje vëllezërit R. dhe u larguan nga vendngjarja në këmbë. Rasti ishte referuar në Gjykatën për Kundërvajtje me 17.08.2004 kundër të dyshuarve S.S. dhe S.Se., për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Gjykata për Kundërvajtje në Prishtinë ka dënuar vetëm të dyshuarin S.S.n me një gjobë prej 130 euro për shkeljen e qetësisë dhe rendit publik, ndërsa i dyshuari i tretë nuk është përfshirë në kërkesën për fillimin e procedurave për kundërvajtje.

c) Lënda 2005 AD 3264 - Zjarrvënie

Më 13.10.2005 rreth orës 00:05 në bulevardin Bill Clinton në Prishtinë, persona të panjohur i vunë zjarrin veturës Landrover me numrin e regjistrimit 102 KS 855, pronë e T.R.. T.R ka deklaruar se ai dyshonte se disa prej personave nga Grupi S. ishin pas sulmit, në veçanti E.S., A.By., A.C. dhe R.A.. Për shkak të mungesës së provave të qarta lidhur me identitetin e të dyshuarve, rasti është hapur kundër personave të panjohur dhe ishte dorëzuar në prokurori me 13.04.2006.

d) Lënda 2005 AB 5113 – Vrasje në tentativë – Swiss Casino

Më 25.12.2005 në rrugën "Robert Doll" në Prishtinë, në ambientet e Swiss Casino është raportuar një incident i tentativës për vrasje. Viktimat ishin dy policë A.S. dhe T.R, të cilët nuk ishin në detyrë në atë kohë. Në këtë incident ka ndodhur një përleshje dhe shkëmbim i zjarrit duke i shkaktuar lëndime nga plumbat policit A.S., një nga të dyshuarit dhe një stafi të sigurisë së diskotekës. Sipas kallëzimit penal të përpiluar në këtë rast, të dyshuarit ishin E.S., A.By., A.C., R.A., S.Se., A.Se., K.Ki., F.M. dhe V.H., të gjithë anëtarë të njohur të grupit S.

e) Lënda 2006 AB 1458 dhe 2006, AB 1457 – Kërcënim / frikësim

Më 04.05.2006 rreth orës 16:30 minuta, në rrugën e Tiranës në Prishtinë, gjersa T.R ishte duke e vozitur veturën e tij LANDROVER me numër të regjistrimit XXX KS XXX, ishte ndjekur nga dy persona në motoçikleta dhe një veturë. Në mes të ngasësve të motoçikletës viktimja kishte identifikuar N.Se., ndërsa në veturën VW 3 me numër të regjistrimit XXX KS XXX ai kishte identifikuar A.By.n si shofer dhe E.S. në ulësen e pasagjerit. Siç raportohet, motoçikletat shkuan para veturës së viktimës, duke e bllokuar atë dhe duke e detyruar për të ndaluar, ndërsa vetura VW Golf kishte për qëllim që ta godiste vet viktimën. Në ankesën e tij në polici, T.R tha se E.S., A.By. dhe N.Se., me qëllim kanë dashur që ta godasin veturën e tij dhe ta lëndojnë atë. Edhe një rast i veçantë është hapur nga policia me nr. 2006 AB 1457 në lidhje me incidentin, ku E.S. e kishte akuzuar T.R dhe F.V. se e kishin kërcënuar atë. Për të dyja rastet janë kryer hetimet kundër të dyshuarve E.S., A.By., N.Se., T.R dhe F.V.. PK-ja arriti në përfundimin se incidenti kishte një lidhje shkakësore me rastin e tentim vrasjes që kishte ndodhur me 25.12.2005 në ambientet e Swiss Casino. Rasti i ishte referuar Prokurorisë së Qarkut të Prishtinës me 11.05.2006.

f) Lënda 2003 AB 1800 – Dëmi

Më 06.07.2003 rreth orës 3:35, T.R raportoi se përballë me mensën e studentëve në Prishtinë, persona të panjohur kanë shpuar gomat e automjetit të tij, një BMW e zezë me numrin e regjistrimit XXX KS XXX. Lënda ishte mbyll për shkak të mungesës së provave lidhur me identitetin e kryerësve.

g) Lënda 2005 AD 3132 - Vjedhje

Më 01.10.2005, në periudhën kohore midis orës 02:00 deri në ora 11:00, në zonën e parkimit në bulevardin Bill Klinton në Prishtinë, persona të panjohur vodhën një kasetofon, llamba dhe të dy tabelat e regjistrimit të automjetit nga një Landrover me targa të regjistrimit XXX KS XXX, pronë e T.R..

Rasti u mbyll për shkak të mungesës së provave lidhur me identitetin e kryerësve.

Është provë përmbajtësore se E.S. ka mbajtur prej kohe një urrejtje të thellë kundër T.R.. Shkaqet kryesore ishin të shumta dhe janë të dokumentuara mirë. Kjo ka filluar rreth vitit 2000

deri në vitin 2001, shumë kohë para se T.R të vritej dhe ka vazhduar të intensifikohet prej atëherë e tutje. Sidoqoftë, në vitin 2007, i pandehuri kishte vendosur që të përfundonte punën dhe të vriste policin. Ai ndjehej sikur të ishte i paprekshëm pa dyshim për shkak të lidhjeve të tij politike dhe policore. E.S. ka rrezikuar se ai do të shpëtonte me vrasjen e policit në mes të ditës sikurse që nuk i kishte ndodhur asgjë më parë me të vërtetë atij nga sanksionet penale; përveç dhunës në Ferizaj ai gjithmonë ia kishte dalë të shpëtonte nga ato. Në fund të fundit, rasti i Swiss Casinos nuk ka asgjë dhe ende nuk ka pasoja ligjore. A.B., një anëtar i ri dhe i panjohur i grupit i cili pa dyshim ishte i prirur që ta dëshmojë veten para shefit të tij siç është tipike në kulturën e bandës, do të ekzekutonte të shtënat dhe të merrte fajin. Pastaj, E.S. do të zhdukej për një kohë; në fund çështja do të zgjidhej, anëtarë të vogël të ndryshëm të bandës do të dilnin në gjyq dhe më vonë ai do të kthehej në qytet për të vazhduar si më parë dhe ndjenja e tij e deformuar e nderit do të shlyhej . Megjithatë, ai lozi keq. Ai nuk e kishte llogaritur se autoritetet do të reagonin në mënyrën në të cilën reagan apo, po aq e rëndësishme, se do ishte një protestë e tillë nga publiku i gjerë.

Rasti Swiss Casino

Një nga motivet që E.S. kishte vendosur që të vrasë T.R është rasti Swiss Casino, kur E.S. ishte lënduar dhe poshtëruar seriozisht.

Në lëndën penale PP 850-4 / 2005, prokurori nga Prokuroria e Qarkut Publik të Prishtinës lëshoi një aktvendim për fillimin e hetimeve me 28.12.2005, kundër të pandehurve A.By., E.S., S.Se. dhe R.A.t për veprat penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje në pajtim me nenin 147 paragrafi 4, në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës, mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafi 2 i KPK-së dhe kundër të pandehurve A.C., A.Se., K.Ki., F.M. dhe V.H. për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje sipas nenit 147 paragrafi 4 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së. Aktvendimi ishte bazuar mbi dyshimin e arsyeshem se më 25.12.2005, rreth orës 00:35 në diskotekën "Swiss Bar" në Prishtinë, të pandehurit A.By., E.S., S.Se. dhe R.A. kanë tentuar të vrasin A.S. dhe T.R, pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe gjithashtu me dëshirë kanë rrezikuar jetën e V.Ra., menaxher i sigurimit të Swiss Bar. Këta të pandehur ishin ndaluar për periudha që variojnë nga një deri në tre muaj duke filluar nga data 25.12.2005.

Gjatë procedurës paraprake është përcaktuar se një luftë e dhunshme ka ndodhur gjatë të cilës ishin shtënë plumba nga të pandehurit A.By. me një pistoletë të prodhimit Walther numri serik 185914 dhe, në vetëmbrojtje, nga pala e dëmtuar T.R duke përdorur armën e tij zyrtare të policisë. Në këtë dhunë T.R, E.S. dhe një palë e tretë V.Ra. kishin pësuar lëndime të rënda.

Të pandehurit A.C., A.Se., K.Ki., F.M. dhe V.H. dyshohen se kanë ndihmuar të pandehurit E.S., A.By., S.Se. dhe R.A. për të kryer veprat e cekura penale duke sjellë revole nga jashtë klubit në vendin e ngjarjes dhe duke ua dhënë të pandehurve të përmendur.

Më 16.05.2006, prokurori publik ka ngritur aktakuzë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër të pandehurve A.By., E.S., S.Se., R.A. dhe N.Se.. I pandehuri A.By. ishte akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në pajtim me nenin 147 paragrafi 11 në lidhje me nenin 20 KPK-së dhe mbajtje në pronësi, posedim, kontroll ose përdorim të armëve, në kundërshtim me nenin 328 paragrafi 2 të KPK-së. Të pandehurit E.S. dhe S.Se. u akuzuan për veprën penale të Pjesëmarrjes në një përleshje, në pajtim me nenin 155 paragrafin 1 të KPK-së ndërsa të pandehurit R.A. dhe N.Se. u akuzuan për veprën penale mbajtje në pronësi, posedim, kontroll ose përdorim të armëve, sipas nenit 328, paragrafi 2 i KPK-së.

Aktakuza pohoi se më 25.12.2005 rreth orës 00:35, në "Swiss Bar " e cila gjindet në rrugën "Mbreti Zogu I" në Prishtinë, Kosovë, i pandehuri A.By., me qëllim të privimit nga jeta të palëve të dëmtuara A.S. dhe T.R ka përdorur një armë në posedim të tij për të gjuajtur disa të shtëna në drejtim të tyre, duke goditur dhe plagosur A.S.n. Aktakuza pohoi se T.R dhe A.S. kanë hyrë në ambientet e klubit dhe, posa që ata arritën në korridorin e hyrjes, ata u takuan me A.By.n, E.S. dhe S.Se. që ishin duke dalë jashtë. E.S. e shtyri T.R në shpatull, ndërsa A.By. e grushtoi A.S.n. Pastaj të pandehurit menjëherë e rrethuan A.S. me dy persona të tjerë të pidentifikuar që filluar ta grushtojnë atë dhe T.R. Të dy burrat janë përgjigjur në vetëmbrojtje, duke i grushtuar prapa agresorët. Pas kësaj, i pandehuri A.By. nxorri një revole të markës Walther me kalibër 7,65 x 17 mm me numër serik 185914 dhe shtiu dy herë në drejtim të A.S., duke e goditur atë me një plumb në këmbën e tij dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda. Ai më pas e drejtoi armën drejt T.R. dhe e qëllloi dy herë. Duke vepruar në vetëmbrojtje, të dy T.R dhe A.S. nxorrën revolet e tyre zyrtare të policisë dhe shkrepën dy të shtëna në drejtim të A.By., duke e goditur atë në pjesë të ndryshme të trupit dhe duke i shkaktuar lëndime. Pastaj filloi një përleshje e madhe duke rezultuar në atë që T.R pësoi lëndim në dorën e djathtë dhe E.S. kishte pësuar lëndime në anën e

pasme të kokës së tij dhe dorës së djathtë. Persona të panjohur kishin shkrepur disa herë nga zona brenda klubit në drejtim të personave të lënduar dhe si rezultat, A.S. ishte qëlluar në gishtin e këmbës dhe V.Ra. ishte goditur nga pesë të shtëna në këmbën e tij të djathtë, duke pësuar lëndime të lehta trupore.

Dëshmitarët B.S., B.C., P.S., A.Sel., V.Ra., B.T., B.Mo., B.Z. kanë ofruar dëshmitë e tyre për incidentin që tregonin se E.S. dhe grupi i tij ka provokuar rrahjen pasi që ata u takuan në hyrje të korridorit në disko bar me atë të T.R., fillimisht duke e goditur T.R dhe menjëherë pastaj duke e rrahur kolegun e tij, A.S.. Të dy policët pastaj u përgjigjën në vetëmbrojtje në mënyrë që të parandalojnë sulmin fizik. Ata janë detyruar që të përdorin armët e tyre të zjarrit, sepse ata u qëlluan nga A.By.. I njëjti shpjegim i ngjarjeve ishte ofruar nga T.R dhe A.S..

T.R u intervistua me 26.12.2005 nga Policia e Kosovës dhe me 11.02.2006 dhe 03.05.2006 para prokurorit. Ai dha një shpjegim të ngjarjeve dhe për E.S. dhe grupin e tij deklaroi se ata persona ishin të dyshuar shumë të njohur për policinë, të cilët ai i kishte hasur më parë gjatë kryerjes së detyrave të tij zyrtare. Dyshohet se të dyshuarit ishin të njohur mirë edhe për kryerjen e veprave penale të rënda si vrasje, tentim vrasje, posedim të paautorizuar të armëve, detyrim dhe shantazh. Ai më tej theksoi se ai kishte qenë shpesh objektiv i veprimeve ndëshkuese për shkak se ata ishin të përfshirë në rastet që ai ishte duke i trajtuar. Si rezultat i kësaj, ai kishte kërkuar shtim të sigurisë për vetveten dhe të gjithë zyrtarët e Policisë së Kosovës që merreshin me ta. Ai shtoi se, në shtator të vitit 2005, Jeep i tij Land Rover me numër të regjistrimit XXX KS XXX ishte djegur gjersa kishte qenë i parkuar në Dardani dhe ai ka dyshuar se E.S. dhe grupi i tij ishin pas këtij akti duke i pasur parasysh thashethemet se ata ishin duke u përpjekur që ta lëndonin atë.

Për shkak të plagëve të marra gjatë incidentit A.By. iu nënshtrua operacionit për heqjen e veshkave. Ai ka deklaruar se ai e kishte humbur vetëdijen menjëherë pasi kishte vërejtur se T.R e kishte goditur E.S. në supë dhe pastaj kishin pasuar të shtënat.

Në deklaratën e tij, E.S. ka treguar, në kundërshtim me atë që palët e dëmtuara kishin deklaruar, se ai ishte i provokuar nga T.R dhe personat e tjerë, i cili e kishte sulmuar atë gjersa ai ishte duke u larguar nga klubi. Ai shtoi se policët kanë shtënë në drejtim të tij por kanë shkarë dhe se T.R e kishte goditur atë mbi kokë me qytën e pistoletës së tij derisa ai e kishte humbur vetëdijen. Ai shtoi se T.R e kishte zvarritur atë brenda në klub dhe e kishte ngritur kundër një shtylle dhe ka

filluar ta godasë atë ndërkohë që njerëz të tjerë të panjohur iu bashkuan dhe gjersa ai ishte i mbështetur për shtyllë e goditnin me shkop druri. Ai deklaroi se, sipas tij, motivi prapa sulmit të T.R. ishte fakti se E.S. e kishte pasur të dashur A.I.n, e cili më vonë u bë e dashura e T.R.it dhe përveç kësaj T.R. e kishte provokuar vëllain e tij N.S. në një çështje që lidhej me një veturë.

Gjatë dëshmisë së tij të dhënë në Prokurori më 28.03.2014, i pandehuri ishte pyetur në lidhje me këtë incident dhe në mënyrë të veçantë, cila ka qenë përfshirja e T.R.. I pandehuri tregoi se ai nuk e dinte se T.R.i ishte i përfshirë pasi që ai kishte rënë pa ndjenja. Ai tha se nuk kishte ndjerë asnjë hidhërim ndaj T.R.it pasi që sipas njohurisë së tij, T.R. nuk ishte agresor. Ai tha se lufta nuk kishte të bënte me argumentin lidhur me A.I.. E gjithë kjo është në kundërshtim të plotë me deklaratën që ai e kishte dhënë gjatë hetimit të Swiss Casino. Qëndrimi i prokurorit është se i pandehuri ishte duke u përpjekur për të fshirë faktin se ai kishte një motiv të fortë për të ngacmuar dhe lënduar T.R. si rezultat i shtrimit të tij në spital nga duart e T.R..

Përveç kësaj, kur kafeneja S. ishte kontrolluar më 30.08.2007, së bashku me sende të tjera, ishte konfiskuar një CD e listuar si provë materiale nr. 4 me numër serial: CDRUG80E031840101. Analiza mjeko-ligjore zbuloi se ajo përmbante video incizime të T.R. dhe një personi tjetër të paidentifikuar në atë çfarë duket të jenë ambientet e diskotekës Swiss Casino. Mënyra në të cilën është bërë incizimi si dhe prapavija dëgjuese sugjerojnë se regjistrimi është bërë nga incizimi origjinal i sigurimit dhe është luajtur në një ekran (një incizim i një incizimi). Është vërejtur se kur T.R. ecën në pamje në kamerë personat në prapavijë lëshojnë komentin "Ec ... Qitash!". Mbajtja e këtij materiali është dëshmi e qartë e mërisë së vazhdueshme dhe të thellë që i pandehuri ka pasur kundër T.R.. Kur u pyetën gjatë të njëjtës dëshmisë me 28.03.2014 pse ai duhet të mbante pamje të tilla të Swiss Casinos në ambientet e tij, ai deklaroi se ajo është "vendosur" nga policia, një sugjerim sinqerisht qesharak. Provat e tjera me fotografi dhe video të konfiskuara nga kafeneja S. tregojnë pamjet e T.R. të incizuara fshehurazi dhe i fotografuar nga anëtarët e grupit S..

I pandehuri S.Se. tregoi gjithashtu se T.R. gjoja e kishte provokuar E.S. për rrahje dhe se gjatë rrahjes kishte dëgjuar duke u përmendur emri i A. (I). R.A. ka deklaruar se e ka dëgjuar T.R. duke i thënë E.S. që A.I. ishte e tij dhe pas pak kohe ai kishte parë A.S. dhe T.R.in duke nxjerrë revolet e tyre dhe kishin filluar të gjuajnë.

Siç duket, A.I. ka qenë një mollë sherri në mes të dy burrave rival, E.S. ish i dashuri me sa duket nuk ka mund të përballet me faktin që A.I. kishte një partner të ri në jetën e saj.

Ky trup gjykues duhet të theksojë ndikimin që rasti Swiss Casino kishte mbi E.S., që e bëri edhe më të fuqishme urrejtjen e të pandehurit për T.R, sepse E.S. doli keq nga incidenti, duke u rrahur dhe poshtëruar në mënyrë të tmerrshme që ai si udhëheqës i lagjes lokale nuk mund ta durojë. Kaq serioze ishin pasojat e këtij konfrontimi të dhunshëm që menjëherë pas kësaj A.S., koleg dhe mik i T.R., u dashtë që si pasojë të ndërmarrë hapin shumë drastik që të ik nga Kosova me familjen e tij. Çështje e rëndësishme është efekti i rëndë mendor që kishte mbi E.S.. Ai dha një deklaratë gjatë rrjedhës së hetimeve për këtë incident, ku ai e dha versionin e tij të ngjarjeve. Gjatë intervistës më 28 mars 2014³, ai mohoi të ketë ndonjë njohuri se T.R ishte njëri nga ata që kanë qenë përgjegjës në ndonjë mënyrë për rrahjen e të pandehurit gjatë incidentit në Swiss Casino. Në fakt, ai ka mohuar se ka pasur ndonjë njohuri për T.R fare. Gjatë dëshmisë së tij në këtë gjykim, ai madje ka deklaruar se ishte vetëm A.S. ai i cili duhej të fajësohej. Në lidhje me T.R, ai kishte thënë: *"Dora e tij rrëshqiti nga shpatullat e mia dhe më goditi në fytyrë, jo shumë. Unë nuk e kam njohur ndonjëherë pas Swiss Casinos, e bile as nuk ka qenë ai që e ka nxitur atë.* "Ai madje në dëshmi ka pretenduar se sikur T.R.i të mos kishte qenë atje për ta mbrojtur atë, ai do të kishte pësuar një rrahje edhe më të keqe.

Ai u mor në pyetje në mënyrë të tërthortë lidhur me atë që ai i kishte thënë policisë dhe prokurorit gjatë hetimit për Swiss Casino; shkresat e lëndës tregojnë një situatë shumë ndryshe pasi që i pandehuri ka ndryshuar dëshminë e tij. Në deklaratën e vet të të pandehurit të datës 16.01.2006, ai deklaroi *"T.R.i dhe disa persona të tjerë më kanë sulmuar fizikisht. Unë nuk i kam njohur të tjerët përveç A.S. dhe T.R.it për të cilët po ashtu e dija se kanë qenë pjesëtarë të SHPK-së."*⁴ Më pas, ai deklaroi *"Unë u sulmova fizikisht nga T.R.i dhe ai më goditi me qytë të revoles nja 4-5 herë. "* Në faqen 41, *"T.R. më tërhoqi brenda në disko .. "Ai në fund për T.R.in tha " Mendoj se motivi që ata më sulmuan dhe më rrahën atë natë kritike është për shkak se unë dikur kam qenë në lidhje me A.I. dhe ajo më vonë ishte e dashura e T.R.. Përveç kësaj, para këtij incidenti, T.R. kishte provokuar vëllain tim në lidhje me veturën e tij "*. Shpjegimi i këtij ndryshimi të deklaratave është vetë-shpjegues; incidenti në Swiss Casino ishte pika kulminante e

³ Regjistratori XV, f. 19-97

⁴ Regjistratori X, f.40

dramës / përleshjes serioze në lidhje me armiqësinë për A.I.. Shtrohet pyetja pse T.R.i do të sulmonte të pandehurin kur A.I. ishte tanimë në lidhje me T.R., përgjigja është se ishte i pandehuri ai i cili ishte i mbushur me zemërim se ish-e dashura e tij tashmë ishte në lidhje me një polic, një tregues i mirë se E.S. e kishte provokuar këtë konfrontim. Kur ai shpjegoi se pse ai kishte fajësuar T.R.in në deklaratat e tij origjinale, ai dëshmoi se ka qenë një numër i gabimeve daktilografike dhe se ai kurrë nuk ka pasur për qëllim që ta përmende atë, por vetëm A.S.. Sipas mendimit, ky shpjegim është i nxituar dhe nuk mund të konsiderohet si i besueshëm.

Për fat të keq, ky trup gjykues nuk ka qenë në gjendje që të kthehet prapa në kohë, por ankthi mendor në të cilin T.R ishte ekspozuar menjëherë pas incidentit në Swiss Casino nuk mund të lihet pa u vënë re. Duke u marrë në pyetje T.R gjatë gjykimit pas incidentit Swiss Casino, ai tashmë ishte duke i shprehur shqetësimet e tij për sigurinë e tij, për shkak të veprimeve të E.S. dhe njerëzve të tij. Në një deklaratë të dëshmitarit të datës 26 dhjetor 2005⁵, T.R.i tha: *"Unë dyshoj se jam sulmuar nga i dyshuari i lartpërmendur [E.S.], sepse ata më njohin dhe për shkak se gjatë shërbimit tim në polici jam përballur me ta gjatë kryerjes së detyrave të mia. Këta të dyshuar janë të njohur mirë për policinë për kryerjen e të gjitha llojeve të veprave penale ... Dua të theksoj se unë shpesh kam qenë një objekt i (sulmimit) këtyre personave (kriminelë të njohur), gjersa unë isha duke i kryer detyrat zyrtare dhe ata ishin të dyshuar në rastet e mia. Unë kërkoj më shumë siguri, jo vetëm për mua, por për të gjithë pjesëtarët e PK-së.. "Ai shtoi:" ...Unë jam takuar me ta gjatë kryerjes së detyrave të mia, më është dashur që ti arrestoj disa prej tyre disa herë ". Në përgjigje të pyetjes nëse ai kishte qenë i kërcënuar më parë nga të dyshuarit: "Po, në shtator të këtij viti, vetura ime ishte djegur tërësisht dhe unë dyshoj se të dyshuarit e këtij rasti kanë qenë autorët e krimit. Kam dëgjuar thashetheme se ata do të përpiqen që të më lëndojnë disi, nuk e di si ". Ai kishte të drejtë në lidhje me atë, por e ardhmja e kishte dëshmuar se ai kishte tmerrësisht të drejtë. Për fat të keq, nuk ka qenë askush që ta ndihmojë për t'ia shpëtuar jetën. Kjo deklaratë tregon qartë gjendjen mendore të viktimës pas Swiss Casinos. Kjo është dëshmi e qartë se polici ishte shumë i shqetësuar për sjelljen e dhunshme të të pandehurit dhe bandës së tij dhe se ata do të përpiqeshin që ta lëndonin atë.*

Nuk ka qenë vetëm T.R ai i cili ka qenë shumë i shqetësuar për pasojat e incidentit Swiss Casino, ka qenë edhe një polic, miku dhe kolegu i T.R. - A.S. i cili u largua nga Kosova. Edhe pse asnjë

⁵ Regjistratori XIII, f. 104-122

palë nuk ka arritur të sjellë A.S.n në gjykatë për të dëshmuar, zyrtari B.S. ka deklaruar se ai ishte kontaktuar nga A.S. dhe se A.S. i kishte thënë atij.. *"Unë jam larguar nga Kosova pasi që kam qenë i kërcënuar prej tyre."*⁶

b. Rasti i Ferizajt, maj 2006.

Megjithatë, një tjetër arsye pse T.R u vra brutalisht, për të mos thënë ishte ekzekutuar publikisht, në mes të ditës në një vend publik ka qenë incidenti i Ferizajt i cili kishte ndodhur në maj të vitit 2006.

Të dhënat zyrtare të këtij rasti deklarojnë si në vijim.

Në vendimin P 461/2006, P 497/2006 e 27.10.2006, Gjykata e Qarkut të Prishtinës shpalli fajtor dhe dënoi me dënimet që variojnë në mes të një (1) dhe tre (3) vjet burgim të akuzuarit E.S., X.D., B.Mi. dhe A.By. për kryerjen e veprave penale të Kanosjes, në shkelje të nenit 161, paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPP); Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në shkelje të nenit 316, Paragrafët 1 dhe 3 të KPP-së, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPP-së. Vendimi i Gjykatës së Qarkut u vërtetua dhe mori formë të prerë me anë të një vendimi të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. AP 127/2007 e datës 27.12.2007. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut të Prishtinës ka konstatuar se me datë 22.05.2006 rreth orës 14:30, në afërsi të restorantit "Dani" në Ferizaj, Kosovë, policët e Policisë së Kosovës B.Su., B.H. dhe J.B. kanë pësuar lëndime trupore, gjersa kanë qenë duke i kryer detyrat e tyre zyrtare. Pala e dëmtuar A.A. kishte raportuar në polici se i akuzuari E.S. e kishte kërcënuar atë me vdekje nëpërmjet telefonit dhe kishte kërkuar që ajo të vinte në vendin e deklaruar. Kur policët e lartpërmendur vizituan vendin e ngjarjes, në mënyrë që ta kapnin të akuzuarin, ata gjetën një VW Golf 3 me numrin e regjistrimit XXX -KS- XXX, me tre udhëtarë dhe ata e urdhëruan shoferin, E.S., që të hapte derën e veturës, përndryshe ata do të duhet të përdornin forcën. Pas dy ose tre minutave i akuzuari E.S. hapi derën e veturës dhe në momentin që ai doli jashtë, ai e goditi policin B.Su. në anën e djathtë të trupit, në mes të brinjëve dhe në stomak dhe e goditi në krahun e djathtë, ndërsa i akuzuari X.D. kapi duart e policit B.H.t dhe e kafshoi dy ose tre herë në krahun e djathtë dhe i akuzuarit B.Mi. e goditi policin J.B. në gjurin e tij të djathtë dhe me dorë

⁶ Procesverbali i gjykimit të datës 22.01.2015, f. 11

ia kapi qafën duke i shkaktuar atij lëndime trupore. Policët arritën të tërhiqen nga sulmi, goditën të akuzuarit në kundërpërgjigje, i prangosën dhe i shoqëruan në stacionin policor të Ferizajit. Pas kontrollimit të veturës, ishte gjetur një revole dhe municion, e cila i përkiste X.D.t pa leje ligjore. Policët kanë deklaruar se të akuzuarit i kishin rezistuar arrestimit dhe kanë vepruar me dhunë.

Në kundërshtim me këtë, E.S. ka deklaruar se ai ka qenë ai i cili ka qenë i viktimizuar nga policët dhe ai i kishte mohuar plotësisht akuzat kundër tij. Ai ka deklaruar se nuk i ka rezistuar arrestimit dhe kur e ka hapur derën e veturës ai ishte hedhur për tokë dhe, gjersa ka qenë duke u prangosur, ai ishte rrahur nga policia, duke e shkëmbuar, goditur dhe duke ia mbajtur një këmbë në kokë, në këtë mënyrë duke i shkaktuar atij lëndime në fytyrë dhe në anën e djathtë. Për më tepër ai ishte rrahur në stacionin e policisë në Ferizaj nga anëtarët e njësisë speciale të SHPK-së, duke pësuar lëndime trupore në shpinë dhe supe, në këmbën e majtë, në bërrylin e dorës së majtë dhe i kishte të dy sytë e mavijosur, gjë e cila e kishte bërë të shtrihet në spital për dy ditë.

I akuzuari B.Mi. kishte deklaruar se në momentin që ishin hapur dyert e veturës, një nga policët e kishte nxjerrë jashtë dhe e kishte goditur në nofull dhe gjatë prangosjes së tij ai kishte thënë " cili është E.S., q... nënën". Kur E.S. ishte prezantuar policët gjoja i kishin thënë "ju keni pasur probleme me T.R.in, ai është miku ynë, dhe ju jeni një spiun" dhe gjersa ata ishin duke e prangosur ata vazhduan që të rrihnin , duke e goditur kryesisht në kokë dhe duke e lënduar në syrin e djathtë, në ballë dhe brinjë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli E.S. fajtor për kryerjen e veprave penale të kanosjes dhe pengimit të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Ai u dënua me një dënim unik prej dy (2) vjet burg, nga të cilat koha e kaluar në paraburgim (22.05.2006 deri 27.10.2006) u zbrit. Policët e plagosur janë anëtarë të së njëjtës njësi të policisë si të asaj të T.R..

Kjo gjykatë ka pasur mundësi që të dëgjoj dëshmi të detajuara për rrethanat që e rrethonin këtë incident kur i pandehuri ishte arrestuar nga dëshmitarët B.H. dhe S.Q. dhe dëshmitarët e tjerë. I pandehuri ishte arrestuar pasi që kishte ndodhur një përleshje e dhunshme. Ai pohoi se ai ishte rrahur nga policët që e kishin arrestuar si dhe se policët, kishin shkuar shumë larg, sa ia kishin montuar një revole. S.Q. tha se edhe ai kishte dëgjuar se kështu ka qenë rasti. Sipas mendimit të këtij trupi , nuk ka asnjë arsye për të mos i besuar S.Q.t. Në këtë rast ai ka pasur guximin të jetë i sinqertë pasi që ai e di se me këtë dëshmi ai as nuk fiton asgjë e as nuk humb asgjë. Nderi i mikut të tij të ndjerë T.R nuk është në rrezik pasi që R. nuk kishte kërkuar nga ata që ta

vendosnin revolen dhe nuk e kishin orkestruar këtë veprim policor kundër E.S.. Për shkak të arsyeve për të cilat vetëm S.Q. dhe B.H. janë të vetëdijshëm dhe duke e ndjekur kodin e tyre të çuditshëm të nderit ata vendosën që ta fajësojnë E.S., kjo ka qenë ide e planifikuar dhe e ekzekutuar. Ky incident fatkeq, i cili siç duket është planifikuar për të heshtur S. dhe në këtë mënyrë të ndihmohet T.R, nuk ka funksionuar. Përkundrazi, E.S. u bë edhe më paranoik në lidhje me T.R. Çfarëdo që ka qenë ajo që i ka ndodhur E.S. gjatë dhe pas arrestimit të tij në Ferizaj, ai fajësoi një person, T.R, edhe pse T.R nuk ka qenë i pranishëm në Ferizaj dhe nuk kishte asgjë të bëjë me këtë rast. E.S. më vonë i tha S.Q.t në dy raste kur ata u takuan se arrestimi ishte e gjitha vepër e T.R.it. I pandehuri së pari herë i tha S.Q. në Stacionin e Policisë në Ferizaj dhe më vonë kur i pandehuri e ftoi S.Q.n tek kafeneja e tij për një bisedë. I pandehuri i tha S.Q.t (f.14), *"..për këta qentë e tjerë të rrugës unë do të kujdesem."* Kjo ishte në lidhje me T.R dhe policët e tjerë. Prandaj çështja penale ndaj të pandehurit që rrjedh nga Ferizaji u bë edhe një shkak më shumë që i pandehuri do ta ruante kundër T.R. përveç A.I. dhe Swiss Casinos. Përveç asaj që S.Q. dëshmoi në lidhje me Ferizajin, ai ishte gjithashtu në gjendje që të jap dëshmi të drejtpërdrejtë se të dy T.R dhe A.I. i kishin treguar atij personalisht për kërcënimet e shumta të vazhdueshme dhe problemet që i kishin pasur nga E.S. dhe banda e tij dhe për aktivitetet e tyre të tjera kriminale. Ai gjithashtu dëshmoi se në arrestimin e të pandehurit në Ferizaj, ai kishte në posedim të tij fotografi të qarta të A.I., edhe pse ata nuk ishin në lidhje në këtë fazë. Kjo ishte vërtetuar nga një polic i cili dha një raport të policisë të datës 23.06.2015 me kërkesë të gjykatës në të cilën ai tha se kur i pandehuri ishte duke u transferuar nga burgu i Gjilanit në burgun e Prishtinës, fotografi personale të një natyre lakuriqe që ishin sekuestruar nga ai gjatë arrestimit i ishin kthyer më vonë të pandehurit. S.Q. foli edhe për demonstratën e madhe publike që ndodhi pas vrasjes, se si qytetarë të zakonshëm reagues ndaj aktivitetëve të kriminelëve të cilët tani po vepronin pa u ndëshkuar nga zyrtarët e thjeshtë për zbatim të ligjit. Ai kritikoi pretendimin e A.B. se B. e kishte "e vrava T.R, sepse ai më goditi mua në fytyrë", dhe ai e përshkroi A.B. si "vetëm një xhelat i zakonshëm."

Dëshmia e S.Q.t ishte konsideruar nga ky trup gjykues si dëshmi e besueshme. Ai haptazi kishte pranuar se arma ishte montuar në mënyrë që të fajësohet E.S.. Ky dëshmitar nuk ka arsye personale për të dëshmuar në favor të të pandehurit ose kundër tij, pavarësisht urrejtjeve të vjetra të tij kundër E.S. për vrasjen e kolegut të tij T.R.. Sa i përket dëshmitarëve S.Q. dhe B.Ha., gjykata është e vetëdijshme se ata të dy ishin të dënuar për bombardimin e kafenesë S. që kishte

ndodhur në shtator të vitit 2007 dhe për të cilat ata të dy janë duke e vuajtur dënimin me burgim afatgjatë. Veprimet e tyre ishin të neveritshme. Megjithatë, ata deklaruan se motivi i tyre nuk ishte për të vrarë civilë të pafajshëm, por që ti dërgonin një mesazh E.S. nga policia dhe si hakmarrje për vrasjen e kolegut të tyre. Këta dy ish-policë e dinin fare mirë se kolegu i tyre ishte vrarë dhe se ishte i pandehuri ai i cili e kishte urdhëruar vrasjen.

Pretendimi lidhur me paratë

1. Gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokuroria argumentoi në bazë të parashtrësave për prova të reja se një kompensim financiar i ishte paguar të akuzuarit A.B. nga E.S. për vrasjen e T.R..

2. Më 12 janar 2015, prokurori kishte autorizuar⁷ policë të Kosovës nga Departamenti për Krime të Rënda për të identifikuar "R." nga Western Union Kosova, për të marrë dokumentacionin përkatës nga Western Union dhe për të mbledhur informacion në lidhje me gjendjen e përgjithshme financiare të A.B..

3. Policia ka dorëzuar raportin e tyre nr. 06-01-35 / 15 të datës 21 janar 2015. Ata zbuluan se familja B. përbëhej nga babai A.Be., i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, nëna F.B. (e papunë) dhe fëmijët G.B. (i papunë), A.Ber. (e papunë), Ar.B. (duke punuar në Gjermani), dhe A.B. i cili ishte duke vuajtur dënimin në burgun e Gërdocit. Familja i tha policisë se shtëpia e tyre ishte ndërtuar para 6-7 viteve dhe ishte ende e papërfunduar.

4. Gjatë hetimit i ishte bërë një ekspertizë telefonit celular Nokia E50, IMEI 351892/01/496234/9 e paraqitur si Prova materiale # 1, e cila ishte marrë gjatë kontrollit në kafenenë S.. Ekspertët e TI⁸ gjetën se më 30 gusht 2007, ditën kur u vra T.R, ishin dërguar dy mesazhe nga numri i telefonit 044 XXXXX i cili shfrytëzohet nga N.S. në numrin e telefonit 044 XXXXX të të akuzuarit E.S., me këtë përmbajtje: "*Dej pi mush kto fletat*) dhe "*(R. i vesterit i pruni Qato)*".

5. Më 12 janar 2015 policia e identifikoi "R.n" si R.I. i lindur më 14 qershor 1974.

⁷ Regjistratori i shqyrtimit gjyqësor 2, fashikulli 19

⁸ Raporti i Policisë së UNMIK-ut, mbi ekzaminimin nga eksperti i TI 25.09.2007, regjistratori i prokurorisë IX, fashikulli 10, faqe 313 dhe raporti i mjekësisë ligjore të TI, ITF-2014-14 të datës 11.04.2014, regjistratori i Prokurorisë VIII fashikulli 1, faqe 1-3;

6. Më 26 janar prokurori paraqiti një Kërkesë në përputhje me nenet 329 (3), (4) dhe 299 (5) të KPP-së që kërkonte nga Gjykata që të mbledhë prova të reja, përkatësisht, dëshminë e R.I.t, informacionin përkatës financiar nga kompania Unioni Financiar Prishtinë, pasardhës i Western Unionit, si dhe të dhënat në lidhje me pronën e patundshme të A.B. dhe familjes së tij të ngushtë.

Transfertet në Western Union

7. Më 18 shkurt 2015, Gjykata urdhëroi Unionin Financiar Prishtinë që të zbulojë informacionin financiar që tregon transferimet me para të gatshme që kanë ndodhur në mes të datës 28 dhe 30 gusht 2007.

8. Sipas të dhënave të Western Unionit, shuma të barabarta prej 3,000 Euro janë dërguar nga dërgues të ndryshëm në Spanjë më 28 gusht 2007 tek N.Se., N.S., H.S., D.S., E.S., A.Sek.; dhe më 30 gusht 2007 te G.A., F.A., A.P., S.Ru., A.By., A.Byt., A.Em., P.P., R.A., A.E., B.Abd., E.Si., X.D., A.Ab. dhe I.A. , siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

9. R.I. dha dëshminë e tij si dëshmitar para gjykatës më 11 shkurt 2015. Ai deklaroi se në gusht të vitit 2007 ai kishte në pronësi dhe menaxhonte kompaninë private "IRS International". Agjencia i ofronte Western Unionit shërbime të transferimit të parave dhe gjendej në Prishtinë në Bulevardin Bill Clinton. Transfertet hyrëse të të hollave që vinin nga Spanja ishin të kufizuara nga rregulloret financiare lokale në një maksimum prej 3,000 Euro për transaksion. Kur shuma më të larta të parave pranoheshin për klientë të caktuar, ai personalisht ia jepte të hollat klientit në dorë, për më shumë siguri.

10. Në lidhje me transaksionet e datës 28 dhe 30 gusht 2007, R.I. ka deklaruar⁹ se ai ishte i njohur me pseudonimin "R." dhe se ai e njihte E.S. nga qyteti. Në dëshminë e tij ky dëshmitar ka treguar se vëllai i N.S., E.S., erdhi në agjencinë e tij dhe e pyeti në lidhje me procedurën për të pranuar një shumë të të hollave më shumë se 3,000 euro. Për shkak se një person nuk lejohet që të tërheqë më shumë se 3000 euro brenda një dite R.I. e kishte këshilluar atë që mundën të përdoren emra të ndryshëm të personave për transfere më të mëdha. Nga familja S. ai e njihte E.S.in, kështu që çdo herë që diçka kishte të bënte me ta, ai e identifikonte E.S.in dhe kështu perceptimi i tij ishte se paratë ishin për E.S.in, edhe pse ishin për vëllain e tij. Shuma e madhe e

⁹ Proceverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 5 (versioni në gjuhën angleze);

parave në mes të 40-100 mijë euro është marrë përmes disa transaksioneve të njëpasnjëshme me nga 3,000 euro secila. E gjithë shuma e parave është dorëzuar në të njëjtën ditë nga R.I. personalisht në kafenenë S.. Ai ia dorëzoi paratë E.S.it apo N.S.it në kafene rreth orës 10 apo 11 të mëngjesit të datës 30 gusht të vitit 2007. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që dëshmitari ofroi një shërbim të transaksionit të tillë.¹⁰ Dëshmitari ishte i sigurt për datën, sepse ai e kishte lidhur me vrasjen e T.R.¹¹. Transaksionet që arritën shumën e parave që ishin dorëzuar te S. kishin lidhje për shkak se ato të gjitha vinin nga Barcelona, Spanjë. Për çdo transaksion ai kishte marrë paraprakisht informatat e letërnjoftimit të marrësve të ndryshëm.

11. Gjatë seancës së njëjtë të gjykimit, i akuzuari E.S. ka deklaruar se paratë e sjella nga R.I. i përkisnin familjes së tij dhe ishin pranuar nga vëllai i tij N.S.. Në atë kohë ai ishte në shtëpinë e tij në Vranjevc për drekë.¹² Paratë kishin mbetur në kafenenë S. derisa ato më vonë gjatë ditës ishin vjedhur nga policia gjatë ndërhyrjes së tyre brutale në lokal.¹³ Paratë ishin më shumë se 40.000 €. Vjedhja e këtyre parave nuk ishte raportuar në polici për shkak se i akuzuari nuk ka qenë në gjendje për ta bërë këtë dhe vëllai i tij N.S. u arrestua për shtatë apo tetë muaj. Anëtarët e tjerë të familjes së tij nuk kanë mund ta bëjnë këtë për shkak se ata nuk kanë qenë në lokal dhe nuk e kanë ditur për këto para.

12. Paratë ishin menduar që të përdoren për interesin e tij, për të zgjeruar biznesin e tij ose për të ndërmarrë transaksione tregtare me prona të pasurive të patundshme ose të ndërtonin një shtëpi tjetër për fitim. Tre apo katër vjet më parë vëllai i tij N.S. ia kishte huazuar këtë shumë të të hollave një personi i cili kishte një biznes për importim të qeramikës nga Spanja. Pseudonimi i tij ishte K. dhe ai ishte një fqinj.¹⁴ K. me siguri i është dashur që të gjej miq të ndryshëm për të dërguar para në transaksione të njëpasnjëshme në emrat e tyre, pasi që ai nuk ishte lejuar që të dërgojë më shumë se 3000 euro për një herë.

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 9 (versioni në gjuhën angleze);

¹¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 12 (versioni në gjuhën angleze);

¹² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 19 (versioni në gjuhën angleze);

¹³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 19 dhe 24 (versioni në gjuhën angleze);

¹⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 21-22 (versioni në gjuhën angleze);

13. E.S. gjithashtu e pranoi se N.S.i i kishte pranuar paratë nga R.I. dhe pas kësaj ai ia kishte dërguar një mesazh me tekst për t'ia konfirmuar këtë.¹⁵

14. N.S. ka deklaruar se R.I. kishte ardhur në kafenenë S. në datën përkatëse rreth orës 13:00 ose 14:00 dhe kishte sjellë paratë në fjalë, në vlerë prej 42,000 eurove.¹⁶ Ai ia kishte dërguar, në të njëjtën datë, një mesazh vëllait të tij, E.S., që e informonte atë se R. i kishte plotësuar letrat dhe i kishte dorëzuar paratë. Ai nuk ia kishte përmendur këtë fakt policisë në dëshmitë e tij të mëparshme për shkak se ai kishte qenë i traumatizuar nga ana e tyre.¹⁷ Paratë ia kishte borxh atij N.S. K. i cili e menaxhonte një biznes që importonte qeramikë nga Spanja. Ai ishte një fqinj i F.A. i cili ishte i afërm i tij, përkatësisht djali i tezes/hallës së tij. K. i kishte huazuar këto të holla në fund të vitit 2006, kur ata u takuan në shtëpinë e F.A.. Ai kishte nevojë për të holla për shkak se ai ishte ngushtuar financiarisht në biznesin e tij.

15. Nga shuma e përgjithshme prej 42.000 eurove, A.E. kishte kontribuar me 30.000 euro dhe N.S. kishte kontribuar me pjesën e mbetur prej 12.000 euro. Kredia nuk ishte konfirmuar me shkrim. Paratë duhej të ktheheshin brenda një muaji; megjithatë në fakt ato ishin kthyer pas 10 muajsh. Pas diskutimit me K. me telefon për mënyrën e kthimit të këtij borxhi, ai ia kishte dërguar paratë nga Spanja nëpërmjet Western Unionit. N.S. kishte pranuar paratë nga duart e R.I.t "R." sepse ai personalisht e njihte atë. Në mënyrë që ta bënte këtë ai ia kishte dhënë R. 14 letërnjoftime të personave për të vepruar si marrës.¹⁸

16. Paratë, si dhe një sasi e kafesë ishte vjedhur nga policia gjatë kontrollit në kafenenë S..¹⁹ Ai shkoi për t'u ankuar për paratë e vjedhura dhe që ishte rrahur nga policia, por atij nuk i u dha mundësia që ta bënte këtë²⁰.

17. Për të qartësuar faktet e transmetuara nga R.I. dhe N.S., mbrojtja kishte ftuar A.E.n. Ai e dha dëshminë më 18 dhe 19 gusht 2015. Ai deklaroi se N.S. K. ishte fqinji i tij. Ai importonte pllaka qeramike nga Spanja. Biznesi i tij ishte ballafaquar me probleme financiare dhe A.E. ishte

¹⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 23 (versioni në gjuhën angleze); *'Nuk ka asnjë koment lidhur me atë që N.S.i i ka marrë paratë, ai me dërgoi një mesazh duke më thënë që R. i kishte sjellë paratë, do të kishte qenë më mirë sikur unë të kisha qenë atje për ti marrë paratë dhe unë do ti dërgoja ato para në shtëpi'*.

¹⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 16, 18 (versioni në gjuhën angleze);

¹⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 shkurt 2015, faqe 17 (versioni në gjuhën angleze);

¹⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 23 korrik 2015, faqe 22-25 (versioni në gjuhën angleze);

¹⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 23 korrik 2015, faqe 23-24 (versioni në gjuhën angleze);

²⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 23 korrik 2015, faqe 29, 30 (versioni në gjuhën angleze);

pajtuar që ta ndihmonte atë duke i dhënë një kredi prej 60,000-70,000 euro. Paratë ishin paguar me këste. A.E. ishte i interesuar në këtë marrëveshje për shkak se ai shpresonte që ta blej shtëpinë e K. e cila ishte afër shtëpisë së tij, në rast se K. do të dështonte ta kthente kredinë. Asnjë kontratë me shkrim nuk ishte lidhur.²¹ A.E. kishte ofruar të paguajë 107,000 euro për shtëpinë e K. por ky i fundit e ndryshoi mendjen në lidhje me shitjen e saj.²²

18. Në lidhje me kthimin e parave, A.E. ka deklaruar se të gjitha paratë, që e arrinin shumën mbi 60.000 euro, ishin kthyer me anë të Western Unionit. Nga kjo shumë, 42,000 euro i ishin kthyer pas më pak se një vit N.S..²³ N.S. kishte marrë paratë për shkak se ai personalisht kishte kontribuar me 12.000 euro për këtë shumë. Dëshmitari nuk e ka marrë pjesën e tij të këtyre parave, sepse, sipas N.S., policia i kishte vjedhur paratë nga kafeneja e tij.²⁴ Edhe pse 30,000 euro nga paratë e vjedhura i përkisnin atij, ai nuk ka bërë ankesë në lidhje me këtë, sepse ai nuk ka qenë në kafene kur kjo ka ndodhur, sepse paratë ishin marrë nga N.S. e jo nga ai dhe për shkak se ai e kishte kuptuar për këtë nga N.S. rreth një vit më vonë, kur ai ishte liruar nga paraburgimi.²⁵

19. Kur paratë ishin pranuar, të dy A.E. dhe N.S. kishin paraqitur disa letërnjoftime që do të paraqiteshin si marrës në Western Union. Pronarët e këtyre letërnjoftimeve ishin pajtuar që letërnjoftimet e tyre të përdreshin. Ai kishte komunikuar me telefon me dërguesin-N.S. K.. Dëshmitarit nuk i kujtohet data e transferimit të parave. Në atë datë, N.S. i kishte thënë atij se paratë ishin sjellë në kafene. N.S. e njëhte personin që punonte në Western Union. Ai i kishte thënë N.S. që të mbante 42,000 euro, pasi që ai duhej të shkonte vet në Western Union dhe të merrte disa para, sepse ai kishte disa letërnjoftime dhe ai do të vinte më pas për të marrë [pjesën e tij] paratë.²⁶ Ai pastaj personalisht kishte marrë nga Western Union një shumë [të dytë] prej më pak se 18.000 euro e cila ishte dërguar shtesë nga K. në shumën fillestare prej 42.000 euro. Ai

²¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 7-10 (versioni në gjuhën angleze);

²² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 26, 28 (versioni në gjuhën angleze);

²³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 10-11 (versioni në gjuhën angleze);

²⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 12 (versioni në gjuhën angleze);

²⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 42, 43 (versioni në gjuhën angleze);

²⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 14 (versioni në gjuhën angleze);

përdori letërnjoftimin e tij, si dhe ato të vëllait të tij A.Em., A.By.t, P.P., A.Byt., B.Abd.t, dhe të tjerëve. Ai ia kishte komunikuar K. informatat e këtyre letërnjoftimeve me mesazh teksti/sms.²⁷

20. K. e dinte se A.E. kishte marrë një pjesë të parave nga N.S. dhe kështu kishte rënë dakord që t'ia kthente paratë N.S.. N.S. kishte marrë paratë nga Western Unioni në të njëjtën ditë që policia kishte ardhur në kafene rreth orës 16:00. N.S. foli me R.n nga Western Unioni dhe i tha se paratë do të dërgohen atje.²⁸

21. Dëshmitari refuzoi të përgjigjej ose iu shmang një sërë pyetjeve në lidhje me dënimin e tij penal në rastin e vrasjes së T.R. dhe në lidhje me të ardhurat e tij financiare, edhe pse ka ishte paralajmëruar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata.²⁹

22. Kur N.S. K. e kishte ndryshuar mendjen e tij në lidhje me shitjen e shtëpisë, babai i A.E.t kishte vendosur që t'ia kthente atij shtëpinë dhe të pranojë që ti kthente paratë që ai i kishte huazuar. Dy ose tre muaj më vonë ai i kishte marrë paratë në fjalë. Vendimi për të transmetuar tërë shumën brenda një dite ishte marrë nga N.S. K..³⁰ Emri aktual i N.S. K. ishte ndoshta N.S. A..

23. R.I. ishte ri-marrë në pyetje më 18 gusht 2015. Ai kishte sqaruar se në rastin e dorëzimit të parave tek S., ata e njihnin dhe i besonin atij që t'i merrte dhe tua sillte atyre gjithë shumën. Emri i A.E.t nuk i kujtonte atij asgjë, pasi që ai nuk ishte një person i njohur. Ai në mënyrë të vendosur ka mohuar të ketë biseduar me A.E.n në atë kohë.³¹ Kjo gjendje e fakteve iu kishte paraqitur dëshmitarit A.E.t gjatë seancës gjyqësore të datës 19 gusht 2015. Përballë kësaj, A.E. kishte qëndruar pranë versionit të tij se ai i kishte marrë paratë personalisht nga R.I. në Western Union, më 30 gusht 2007 në ora 16:00.³² Dy ditë para kësaj ai kishte shkuar në Western Union së bashku me N.S.. N.S. kishte hyrë në zyrën e Western Union , ndërsa ai kishte qëndruar në veturë. Ata kishin sjellë letërnjoftimet të cilët iu paraqitën R.I.t "R.t". Dy ditë më vonë ai u kthye vetëm dhe R.I. ia kishte dhënë atij paratë, rreth 15.000 euro.³³ Ai pranoi se e kishte ndihmuar dorëzimin

²⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 39 (versioni në gjuhën angleze);

²⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 16-17 (versioni në gjuhën angleze);

²⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 21 (versioni në gjuhën angleze);

³⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 32 (versioni në gjuhën angleze);

³¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 51, 52 (versioni në gjuhën angleze);

³² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 gusht 2015, faqe 4 (versioni në gjuhën angleze);

³³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 19 gusht 2015, faqe 11,12 (versioni në gjuhën angleze);

e A.B.. Ky i fundit kishte ardhur tek ai dhe kishte kërkuar ndihmë. Ai kishte frikë se policia do ta vriste atë. Ky trup gjykues kishte konsideruar dëshminë e R.I.t si plotësisht të besueshme. Ai kishte treguar ngjarjet që lidhen me transfertet e parave në detaje dhe në mënyrë të qartë. Ai pranoi se e kishte ndërmarrë hapin e jashtëzakonshëm dhe i kishte dorëzuar personalisht paratë në kafenenë S., hap që mund të merret parasysh, dhe që është marrë parasysh gjatë fazës së procedurës paraprake, për sa i përket përgjegjësisë penale, si ndihmë në kryerjen e një vepre penale. Duhet të theksohet se E.S. ka konfirmuar se paratë ishin dorëzuar nga R.I. në kafenenë e tij. Ky dëshmitar kishte paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë, të saktë dhe të plotë shpjegime të ngjarjeve që lidhen me transferimin e parave.

24. Në fillim të seancës gjyqësore të datës 20 gusht 2015 i akuzuari E.S. njohu në një numër të fotografive të paraqitura nga Gjykata shtëpinë e kushëririt të tij A.E. dhe atë të N.S. K. e cila gjendet në afërsi. Ai ka deklaruar se A.E. e kishte blerë shtëpinë në fjalë duke paguar 60.000 euro nga çmimi i përgjithshëm prej 107,000 euro. Megjithatë, shitësi ndryshoi mendjen e tij dhe ia ktheu paratë A.E.. Sidoqoftë, do të kishte qenë e vështirë për të transferuar të drejtat pronësore mbi shtëpinë për shkak të çështjeve të vazhdueshme të privatizimit me pronarin fillestar, ndërmarrjen shoqërore "Vocar".³⁴

25. Duke marrur parasysh deklaratat e dëshmitarit A.E., ky trup gjykues erdhi në përfundim se ato nuk janë të besueshme. Ky dëshmitar ishte propozuar nga mbrojtja në pretendimin e prokurorit që kompensimi financiar i ishte paguar A.B. nga i akuzuari E.S. për vrasjen e T.R. Rizës. Dëshmitë e tij duken të jenë të fabrikuara me qëllim të qartë për të mbrojtur E.S. S. dhe për t'i ofruar atij një alibi. Është e palogjikshme që dëshmitari ka humbur një sasi të konsiderueshme të parave - 30.000 Euro dhe ai nuk ka kërkuar asnjë kompensim. Ky dëshmitar nuk e ka raportuar këtë fakt në polici apo prokurori menjëherë pasi që kjo humbje kishte ndodhur. Ky trup gjykues është i mendimit se 30.000 Euro janë një sasi e konsiderueshme parash dhe çdo person përgjegjës do të merrte masa të menjëhershme për ti rimarrë atë duke përdorur të gjitha mjetet e mundshme. Ky dëshmitar në fakt nuk kishte marrë asnjë masa për të rimarrë paratë e tij dhe ishte sjellë sikur mos të brengosej fare për 30.000 euro. Dëshmia e këtij dëshmitari duket të jetë e palogjikshme dhe të jetë zhvilluar nga nxitja e momentit nga ana e një personi që dëshpërimisht dëshiron të ndihmojë duke siguruar një alibi, por që nuk kujdeset për

³⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20 gusht 2015, faqe 4 (versioni në gjuhën angleze);

paraqitjen e rrjedhës së ngjarjeve në mënyrë të qartë, logjike dhe materiale. Përveç kësaj duhet të theksohet se dëshmia e A.E. para Gjykatës ishte kontradiktore me vetveten dhe me dëshminë e ofruar nga R.I.. Lidhja familjare e A.E. me të pandehurin, punësimi në të kaluarën në kafenenë S., roli i tij i drejtpërdrejtë në dorëzimin e A.B. dhe dënimi penal në rastin e vrasjes së T.R. kanë hedhur dyshim të konsiderueshëm në kredibilitetin dhe besueshmërinë e tij.

Shtëpia e familjes B.

26. Pas një vlerësimi të kujdesshëm, ky trup gjykues ka vendosur që ex officio të mbledhë prova shtesë me qëllim të qartë për të shqyrtuar pretendimet e prokurorisë dhe për të verifikuar vijën e mbrojtjes të paraqitur nga avokatët mbrojtës. Gjykata ka lëshuar një urdhër që iu kishte drejtuar hetuesve të policisë së Kosovës për të mbledhur informacion për statusin financiar të familjes B., duke përfshirë pronësinë e pronave të patundshme.

27. Sipas informatave të mbledhura nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe degës së saj në Prishtinë, anëtarët e familjes B. e kanë të regjistruar vetëm pronën e tokës që gjendet në Prishtinë, rr. Adem Keqekolla nr. 9, me numër kadastral 3281-0. Që para vitit 1999 parcela i përkiste H.H.B.. Sipas Drejtorisë së Urbanizmit, A.Be. paraqiti një kërkesë më 19 shkurt 2015 për të regjistruar / legalizuar një shtëpi në të njëjtën adresë. Kjo ndodhi pas verifikimeve në vend të kryera nga policia.

28. Sipas raportit të policisë,³⁵ A.B. dhe G.B. ishin anëtarët e vetëm të familjes së tyre, të cilët kishin në pronësi vetura, përkatësisht Golf (mes vitit 2002 dhe 2003) dhe një Audi (që nga 2014). Sipas Agjencisë për Regjistrim të Biznesit asnjë nga anëtarët e familjes B. nuk kishin aksione në ndonjë subjekt të biznesit. Administrata Tatimore e Kosovës ka raportuar se, nga anëtarët e kësaj familjeje vetëm A.Be. ishte i regjistruar me të ardhura nga paga, që rezultojnë nga punësimi i tij në Kompaninë Energjetike të Kosovës ("KEK"). Kompania Energjetike e Kosovës ka raportuar³⁶ se i punësuar A.Be. ka marrë një pagë neto vjetore prej 3,973.05 euro në vitin 2005; 4,067.02 Euro në vitin 2006; 4,070.09 Euro në vitin 2007; 4,674.49 Euro në vitin 2008; 5,425.37 Euro në vitin 2009; 5,630.36 Euro në vitin 2010; 6,011.48 Euro në vitin 2011 dhe 5,838.74 Euro në vitin 2012.

³⁵Regjistratori i shqyrtimit gjyqësor 2, fashikulli 31;

³⁶ Regjistratori i shqyrtimit gjyqësor 4, fashikulli P

29. Në situatën që pasoi ky trup gjykues vendosi ex officio që të pranojë dëshminë e A.Be.. Ky dëshmitar e dha dëshminë e tij më 29 maj 2015. Ai deklaroi se e kishte ndërtuar shtëpinë e tij familjare në prill të vitit 2011 por ajo ishte ende e papërfunduar. Deri në momentin e dëshmisë së tij, ai ka investuar rreth 17.000 euro në ndërtimin e shtëpisë. Paratë kanë ardhur kryesisht nga paga që ai i kishte marrë nga "KEK-u". Të ardhurat e tij vjetore ishin rreth 8,000 euro. Në këtë shtëpi kishin kontribuar edhe bijtë dhe vajza e tij. A.B. menaxhonte një shitore të kompjuterëve para se ai të arrestohej në vitin 2007. Djali i tij i dytë po ashtu ka punuar si një tregtar i veturave. Burime të tjera financiare kishin ardhur nga dy kredi që ai i kishte kontraktuar me Raiffeisen Bank nga 5,000 euro secila. Kredia e parë ishte kontraktuar në vitin 2009 dhe ishte paguar plotësisht. Kredia e dytë ishte ende duke u paguar nga rroga e tij. Kredia e fundit ishte kontraktuar në mënyrë që të përfundoheshin punët e brendshme të ndërtesës. Disa nga punimet e ndërtimit ishin kryer falas nga të afërmit e tij, të tilla si instalimet elektrike të cilat ishin kryer nga vëllai i tij dhe punimet hidraulike nga dhëndërrin e tij.

30. Ky dëshmitar tregoi se shtëpia e mëparshme u dashtë që të rrënohej në vitin 2011 për t'i lëshuar vend ndërtimit të ri i cili ishte nisur në të njëjtin vend. Shtëpia e mëparshme ishte ndërtuar para vitit 1962 kur familja B. ishte zhvendosur atje. Ajo kishte një kat dhe katër dhoma. Edhe pse ishin kryer punë të vogla për mirëmbajtje u dashtë që të ndërtohej një shtëpi e re në mënyrë që të akomodoheshin nevojat e banimit për familjen B. që po rritej. Edhe pse e papërshtatshme, shtëpia u dashtë që të rindërtohej vonë në vitin 2011 për shkak të angazhimeve të ndryshme financiare që dëshmitari i kishte brenda familjes së tij.

31. Dëshmitari nuk mund të specifikojë emrin e kompanisë që ka kryer shembjen dhe punimet e ndërtimit, apo emrat e punëtorëve. Ai ka deklaruar se ata ishin nga rajoni i Drenicës dhe personi përgjegjës kishte qenë një person me emrin D.. Asnjë kontratë nuk ishte nënshkruar për kryerjen e punëve të ndërtimit apo rrënimit.

32. Pas shqyrtimit të kujdesshëm, trupi gjykues vendosi më 17 shtator 2015 të emërojë një ekip ekspertësh të përbërë nga: M.T. (ekspert financiar) dhe V.S. (eksperte e ndërtimit/arkitekturës), për të përcaktuar vlerën financiare të ndërtimit që ishte në pronësi të A.Be. në Prishtinë në rr. Adem Keqekolla nr 9.

33. Ekspertët paraqitën gjetjet e tyre në një raport të shkruar. Ata gjithashtu dëshmuan në gjykatë më 04 dhe 05 nëntor 2015. Ata konstatuan se vlera e ndërtimit ishte 34,591.36 euro. Llogaritja ishte bërë duke u bazuar në çmimet mesatare të tregut në nivel të vitit 2011, pa përfshirë vlerën e tokës dhe orenditë e brendshme. Asnjë faturë apo dokumente të tjera nuk ishin paraqitur nga pronari i shtëpisë në raport me shpenzimet me materialet ose punimet e ndërtimit. Vlera e punës që është bërë është përafëruar në deri në një të tretën e vlerës së përgjithshme të shtëpisë. Shtëpia është ndërtuar pa leje ose autorizim.

34. Më 03 nëntor 2015, Gjykata urdhëroi mbledhjen e informacionit financiar dhe bankar të A.Be. nga një numër i institucioneve bankare. Raiffeisen Bank në Kosovë ka raportuar se A.Be. ishte titullar i llogarisë bankare nr. 1501001004787430 e hapur me 16 qershor 2005. Ai kishte marrur tri kredi si në vijim: më 25 korrik 2007, në vlerë prej 2,830.00 euro, më 23 prill 2009, në vlerë prej 5,000.00 euro dhe më 15 maj 2012 në vlerë prej 5,100.00 euro.

35. A.Be. u thirr për të dëshmuar më 02 dhjetor 2015. Ai ka deklaruar se shuma prej 17.000 euro të cilat ai i kishte përmendur më parë ishte shpenzuar vetëm për ndërtimin e jashtëm të shtëpisë. Edhe 7.000 euro të tjera ishin investuar në enterier. Disa prej shpenzimeve të brendshme janë mbuluar nga fëmijët e tij. Kjo e lejoi atë që të mbledhë kursimet për ndërtimin e shtëpisë. I pyetur në lidhje me kredinë prej 2830 euro e cila ishte kontraktuar në vitin 2007, të cilën ai nuk e kishte përmendur në dëshminë e tij e mëparshme, dëshmitari tha se ai i kishte përdorur paratë në fjalë për tarifat e avokatit.³⁷ Shuma prej 5,000 euro e cila ishte huazuar në vitin 2009 ishte përdorur për të paguar dyert dhe dritaret e shtëpisë para se ndërtimi i shtëpisë të kishte filluar. Kredia e dytë ishte kontraktuar në maj të vitit 2012. Gjysma e këtyre parave minus shuma prej 100 euro të sigurimit ishin përdorur për të paguar borxhet e mbetura nga kredia e parë. Shuma e mbetur prej 2700 euro ishte shpenzuar në çati, trarë prej druri, pllaka dhe letër. Të kthehemi te shuma prej 2,830 euro që i ishin atribuar më parë për tarifat e avokatit, dëshmitari kishte dhënë një arsye tjetër, duke treguar se ato janë përdorur vetëm për nevoja personale. Edhe pse ishte pyetur në mënyrë të përsëritur, ai nuk pranoi që të specifikojë se cili ka qenë qëllimi i saktë i këtyre parave. Megjithatë, rreth 3.000 euro janë paguar duke filluar nga viti 2007 për tarifa ligjore për gjykimin e djalit të tij A.B.. Avokati ishte paguar në këste.

³⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 2 dhjetor 2015, faqe 4 (versioni në gjuhën angleze)

36. A.B. kishte deklaruar³⁸ se në vitin 2007, statusi i tij financiar ishte i varfër. Ai merrej me vetura dhe nuk e kishte në pronësi asnjë kompani. Në një kohë më të hershme ai kishte punuar në një auto larje dhe shiste duhan në treg. Kur familja e tij filloi ndërtimin e shtëpisë në vitin 2011 ai nuk mundi të kontribuojë për shkak se ishte në burg.

37. Në lidhje me gjendjen fizike të shtëpisë së A.B., Gjykata dëgjoi dëshmitarin M.K., një oficer i PK-së në krye të hetimit të vrasjes së T.R.. Ai deklaroi se³⁹ në kohën kur hetimi ka filluar, shtëpia e A.B. ka qenë shumë e vjetër. Ndërtimi që ekziston sot është ngritur në të njëjtin vend në oborr. M.K. hodhi poshtë pretendimin se 40,000 euro ishin vjedhur nga policia në kafenenë S. dhe pohoi se asnjë ankesë nuk është bërë ndonjëherë në lidhje me këtë. Gjatë seancës së njëjtë të gjyqimit, i pandehuri E.S. ka deklaruar se policia jo vetëm që vodhi paratë e përmendura, por kishte vjedhur edhe një sasi prej 600 kilogram kafe.

38. Dëshmitari S.Q. ka deklaruar se⁴⁰, si oficer i inteligjencës së PK-së i ishte dhënë detyra për të mbledhur informacion në lidhje me A.B.. Statusi i tij financiar ishte drejt varfërisë së thellë. Ai ka marrë para për të vrarë T.R.. A.B. ishte shumë i varfër, "pothuajse në skaj të varfërisë". S.Q. e kishte konstatuar këtë në bazë të verifikimeve që ai i kishte ndërmarrë si polic për statusin financiar të A.B. dhe anëtarëve të tij të familjes si dhe nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë në vend të shtëpisë ku ata jetonin.

39. B.H. ka deklaruar⁴¹ se ai kishte qenë anëtar i një ekipi të policisë që e kishte kontrolluar shtëpinë e A.B.. Bazuar në vëzhgimet e tij, kushtet e jetesës së A.B. dhe familjes së tij ishin katastrofike. Ai ishte shumë i varfër. Ai ishte i shtyrë nga E.S. për të kryer vrasjen në këmbim të parave.

40. Dëshmitari F.S. ka deklaruar se⁴² E.S. kishte dhënë para dhe kishte ndërtuar shtëpi për shumë njerëz në Vranjevc. Kushdo që ka kërkuar mbështetje financiare dhe që ka qenë nga Vranjevci i është dhënë përkrahja financiare.

³⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 29 tetor 2015, faqe 11 (versioni në gjuhën angleze);

³⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 12 shkurt 2015, faqe 7;

⁴⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 15 qershor 2015, faqe 17-18, 36;

⁴¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 28 maj 2015, faqe 2;

⁴² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 2 dhjetor 2015, faqe 4 (versioni në gjuhën angleze)

41. Në bazë të provave të paraqitura para Gjykatës është konstatuar se në gusht të vitit 2007 N.S. e kishte kontaktuar R.I.n gjithashtu i njohur si "R.", menaxheri i IRS International - një operator i shërbimeve Western Union në Prishtinë. N.S. ka treguar se ai donte që të merrte një sasi të madhe parash prej më shumë se 3.000 euro nëpërmjet Western Union. R.I. e kishte informuar atë se paratë do të duhej të ndaheshin dhe të transferoheshin në shuma të barabartë prej më së shumti 3.000 euro. Një kufizim i tillë ishte i diktuar nga politikat zyrtare. N.S. ia paraqiti R.I.t informatat e 21 letënjoftimeve të personave si përfitues të parave.

42. Më 30 gusht 2007, R.I. pranoi përmes Western Unionit dhe ia dorëzoi N.S. në kafenenë S. vlerën e shumës prej 63,000.00 euro. Paratë kishin ardhur nga Spanja në 21 operacione të transferimit në shuma të barabarta prej 3,000 euro. Marrësit ishin 21 persona informatat e letërnjoftimit të të cilëve ishin paraqitur.

43. R.I. e njihnte E.S. nga qyteti. Për shkak se shuma e parave ishte e madhe R.I. i kishte dorëzuar personalisht në kafenenë S. në mëngjesin e 30 gushtit të vitit 2007 rreth orës 10-11. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që ai kishte kryer një transaksion për S..

44. Në të njëjtën ditë, N.S. nga numri i telefonit 044 XXXXX ia dërgoi dy mesazhe të njëpasnjëshme E.S. në numrin e telefonit 044 XXXXX duke e informuar atë për përgatitjet dhe për marrjen e parave nga R.: (*"Dej pi mush kto fletat"*) dhe më vonë (*"R. i vesterit i pruni qato"*).

45. Ka elemente të mjaftueshme për të marrë parasysh 21 transfertet e parave si pjesë përbërëse të operacionit të njëjtë. Së pari, transaksionet janë të njëpasnjëshme dhe janë regjistruar nga sistemi i Western Unionit: gjashtë transfere më 28 gusht dhe pesëmbëdhjetë më 30 gusht 2007. Ato para u dërguan të gjitha nga Spanja për marrësit të cilët janë anëtarë të familjes së S., përfshirë E.S. dhe N.S.. Dërguesi i çdo transaksioni mbeti i paidentifikuar dhe nuk është konstatuar asnjë lidhje në mes tyre dhe marrësve. R.I. në dëshminë e tij pohoi se ai personalisht i kishte dorëzuar paratë në kafenenë S., në mes të 40 deri në 100 mijë euro.

46. Gjykata nuk i gjen të besueshme sqarimet e dhëna në lidhje me këto para nga të akuzuarit dhe nga dëshmitarët e mbrojtjes ,N.S. dhe A.E.. Vjedhja e dyshuar e parave nga policia gjatë kontrollit kurrë nuk iu kishte raportuar autoriteteve. Marrëveshja e kredisë me N.S. "K." A. ka mbetur e pabazuar. Asnjë kontratë apo provë tjetër nuk ishte paraqitur për kredinë, për dhënien aktuale të parave, blerjen e shtëpisë, për identitetin e K. ose biznesin e tij të qeramikës në

Prishtinë. Nuk ka prova që e lidhin N.S. "K." A. me transfertet e Western Unionit. Emri i tillë nuk shfaqet në mesin e atyre që janë shënuar si dërgues të parave. Faktikisht "K." ka mbetur i paidentifikuar dhe mbrojtja dështoi që ta paraqesë atë para Gjykatës në mënyrë që të konfirmojë versionin e saj të rrëfimit. Gjithashtu ishte konstatuar se gjendja financiare e A.B. në kohën e vrasjes së T.R. ishte shumë e varfër. Ai ishte i papunë dhe merrte vetëm të ardhura duke u marrë me vetura. Shtëpia ku ai jetonte me familjen e tij, që ndodhet në Prishtinë, lagjja Vranjevc, rr. Adem Keqekolla nr. 9, ishte në kushte shumë të këqija dhe të pamjaftueshme për të akomoduar nevojat e familjes. Në ose rreth prillit të vitit 2011 shtëpia e shfrytëzuar nga familja e A.B. ishte shkatërruar dhe kishte filluar ndërtimi i shtëpisë së re.

47. Vlera e ndërtimit të ri ishte përcaktuar nga ekspertët e emëruar nga Gjykata në 34,591 euro. Burimet e të ardhurave të paraqitura nga A.B. janë të pamjaftueshme për financimin e ndërtimit. A.Be. ishte i vetmi anëtar i familjes i cili merrte të ardhura të paqëndrueshme nga pagat. Të ardhurat e tij totale neto në KEK ishin afërsisht 5000 euro në vit.⁴³ Shuma maksimale e ndarë për ndërtim nga kreditë e Raiffeisen mund të arrijnë vetëm deri 7,700 euro përafërsisht. Kontributet nga anëtarët e tjerë të familjes ishin të vogla.

48. Gjykata i dha vetëm besim të pjesshëm dëshmisë së A.Be.. Trupi gjykues e kishte konsideruar si të besueshme dëshminë e tij për ndërtimin e shtëpisë. Pjesa e mbetur e dëshmisë së tij lidhur me origjinën e mjeteve financiare të përdorura për të ndërtuar një shtëpi të re ishte konsideruar si e pabesueshme. Edhe pse ai kishte pohuar se kishte qenë në gjendje vetëm me mbështetje të vogël nga familja të përballonte koston e ndërtimit, ai nuk arriti të paraqes ndonjë dokument justifikues. Identifikimi i kompanisë dhe / apo punëtorëve që kishin kryer shembjen, punët e ndërtimit dhe instalimit mbetën të panjohura. Asnjë faturë apo dokumentacion tjetër nuk u paraqit në Gjykatë apo nga ekspertët në lidhje me shpenzimet. Dëshmia e tij në lidhje me tarifatat ligjore që ishin paguar për përfaqësimin e djalit të tij A.B. ishin kontradiktore. Vlerësimi i tij i pagës së tij vjetore është në kundërshtim me informacionin zyrtar të dhënë nga KEK-u. Shpjegimi i tij në lidhje me vlerën e përgjithshme të investimit të tij ishte kontradiktor.

49. Ky trup gjykues kishte pranuar prova të reja në mënyrë që të largoj të gjitha dyshimet në lidhje me burimin e financave të marra për ndërtimin e shtëpisë së re. Krahasimi i të ardhurave

⁴³ Të llogaritura në bazë të informatave të pranuar nga Kompanie Energjetike e Kosovës për periudhën në mes të viteve 2005-2012;

që familja B. ishte në gjendje të mbledhë me koston reale të ndërtimit çon në përfundimin e qartë se kjo familje nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të ndërtuar një shtëpi të re. Familja B. u dashtë që të shfrytëzoj dhe në fakt shfrytëzoi para shtesë për të financuar ndërtimin e shtëpisë. Përfundimi i vetëm i mundshëm është, se paratë e kishin origjinën nga E.S..

50. Në bazë të analizës së provave në tërësi të paraqitura në gjykatë, është konstatuar përtej çfarëdo dyshim të arsyeshëm se shuma prej 63,000 Euro është pranuar përmes Western Union nga N.S., në koordinim dhe në dispozicion të të akuzuarit E.S.. Paratë i janë dhënë në pjesë ose në tërësi A.B., si nxitje ose si shpërblim për vrasjen e T.R.. Këto para janë shfrytëzuar nga familja B., si shtesë e burimeve të tyre financiare, për ta rindërtuar dhe rregulluar shtëpinë familjare.

Pika 2 dhe 1 deklaratat e A.I.

51. Te pika 2 e aktakuzës prokurori i shtetit pretendoi se nga fillimi i vitit 2003 deri kah fundit i vitit 2004, i pandehuri zhvati para në shuma të ndryshme dhe në raste të ndryshme nga e dëmtuara A.I., e cila në atë kohë ishte këngëtare e famshme, e njohur mirë nëpër tërë Kosovën. Është pretenduar se i pandehuri, duke vepruar me grupin e tij, përmes kërcënimeve dhe duke u mbështetur në reputacionin e tij si udhëheqës i dhunshëm dhe i paskrupull i grupit, kërkoi dhe mori nga e dëmtuara shuma të ndryshme si, 200, 500, 1000, 2000, 3000, 4000 deri në 9000 Euro. Paratë janë dhënë nga e dëmtuara, personalisht në lokacione të ndryshme si te Gjambazet,' te hoteli Madrid në Prishtinë, në oborrin e shtëpisë së tij dhe nën Albi Commerce në Dardani. Ndonjëherë i ka lënë paratë jashtë derës së banesës së saj ose nën fshesa të xhamit të përparmë ose nën veturën e nënës së saj. Kur paratë nuk janë paguar, e dëmtuara ka pësuar shpagim, sikurse vandalizma të veturës së saj, sulme të banesës së saj, sulme të rreme bombe që çonin në anulimin e përformimeve të saja drejtpërdrejtë, si dhe sulme fizike dhe verbale kundër nënës së saj M.I..

A.I.

52. Gjykata pati vështirësi të posaçme në vërtetimin e fakteve të cekura lidhur me pikën 2. Kur u zhvillua shqyrtimi gjyqësor, e dëmtuara dhe dëshmitarja kyçe A.I. ishte larguar nga Kosova dhe po jetonte në Zvicër. Pas ftesës së saj në Kosovë, pa rezultat, gjykata u mundua ta zhvilloi marrjen e saj në pyetje përmes video-lidhjes me një gjykatë kompetente të Zvicrës. Kërkesa

formale për ndihmë ligjore ndërkombëtare, megjithatë është refuzuar nga autoritetet zvicerane, në çështje procedurale. Një thirrje e mëvonshme është pranuar përfundimisht nga A.I. dhe ajo e dha dëshminë e saj pranë gjykatës në Prishtinë, më 27 prill 2015.

53. Në dëshminë e saj, dëshmitarja duke folur gjerësisht u largua nga faktet të cilat ajo fillimisht i kishte deklaruar para policisë dhe prokurorisë gjatë fazës së hetimeve në procedurë paraprake.

54. Gjatë dëshmisë në shqyrtim gjyqësor, dëshmitarja tha se ajo nuk kishte asnjë problem apo shqetësime rreth sigurisë së saj gjatë kohës relevante. Ajo kishte punësuar mbrojtje të afërt që nga viti 2000. T.R. kishte ardhur te shtëpia e saj për t'i ofruar mbrojtje duke pasur në mendje nivelet e përgjithshme të kriminalitetit në lagje. Problemet e saj ishin në përgjithësi nga fansat, ose probleme politike apo tjera. Ajo nuk kishte pasur asnjëherë probleme personalisht me E.S.⁴⁴. Vetura e saj ishte dëmtuar dhe ajo e raportoi në polici por që hetimet nuk i atribuohen veprimit të E.S.. Një pjesë e parave që ai i fitoi nga performimet e saj të muzikës drejtpërdrejtë, në fakt janë mbajtur nga organizatorët nën pretekstin se e kanë paguar S.. Ajo supozoi se organizatorët “përfituan nga fenomeni S.” që ishte në media në atë kohë, me qëllim që t'i vjedhin paratë për vete⁴⁵. Është e vërtetë se kërcënimet me bombë janë raportuar lidhur me performimet e saja në diskoteka. Për shkak të legjendës që ishte krijuar për S., ajo e besoi atë. A.I. e konsideroi këtë të jetë një “detyrim indirekte” gjoja i kryer nga punëdhënësit e saj në Gjermani dhe Zvicër. Të cilët më vonë refuzuan të dëshmojnë për këtë⁴⁶.

55. Gjykata e konstaton dëshminë e re të dëshmitarit si shumë të dyshimtë. Identiteti i organizuesve të pretenduar nuk është shfaqur dhe mashtrimi i tyre është treguar më parë. Nuk do të kishte asnjë arsyetim për dëshmitaren që ka paguar para nga detyrimi për shkak të frikës së pavend ose në lajthim, të cilën ajo kurrë nuk e ka provuar apo hetuar. Ajo ka pohuar se asnjë presion direkt nuk i është bërë nga S., megjithatë ajo i është bindur kërkesave të tyre dhe i është dorëzuar detyrimit të pretenduar të organizuar nga menaxherët e saj mashtrues në Gjermani dhe Zvicër, thjesht për shkak të reputacionit të keq që kishte S. në Dardani, në Prishtinë. A.I. duket që përpiqet ta koordinojë dëshminë në procedurë paraprake me faktet e saja të reja të ndryshuara në mënyrë radikale. Shpjegimi i saj është dukshëm i pamundshëm dhe nuk mund të pranohet.

⁴⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 6 (versioni në anglisht);

⁴⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 12 (versioni në anglisht);

⁴⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqet 18, 19 (versioni në anglisht);

56. Dëshmitarja gjithashtu ia linte fajin dallimit në mes të dëshmisë në procedurë paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor për shkak të faktit se ajo [në fakt e tërë familja e saj] ishin nën qetësues⁴⁷ menjëherë pas vrasjes së T.R., dhe më vonë, ajo ishte nën ndikim të psikoterapisë, dhe të barnave shumë të forta për dy vite. Kjo me gjasë i ka penguar në kapacitetin e saj për t'i kujtuar faktet. Asaj nuk i kujtohet se çfarë ka thënë para prokurorit Millaku lidhur me detyrimin në deklaratën e saj të datës 25 tetor 2007. Është e mundur që fjalët e shkruara në këtë deklaratë të kenë qenë fjalët e saj. Ajo nuk e përjashton këtë si mundësi duke ditur se ajo ishte e ndikuar nga kjo tragjedi dhe dëshironte hakmarrje për vrasjen e T.R.. Ajo ishte në ndikim të shokut, stresit, traumave dhe qetësuesve dhe e kishte një dëshirë ekstreme për hakmarrje. Prandaj, është e mundur që i ka thënë ato fjalë nën ndikimin e atyre që u përmenden më lartë, apo nuk i ka thënë ato fare. Ato nuk janë të gjitha fjalët e saj, dhe asaj nuk i kujtohet t'i ketë thënë në mënyrë se si i ka regjistruar procesmbajtësi. Ajo e mohon të ketë dhënë deklaratë të rreme, përkundër dëshirës së saj për hakmarrje. Ky shpjegim gjithashtu u konsideruar si i pabesueshëm. Së pari, kur dëshmitarja e ka dhënë dëshminë e saj te prokurori i shtetit, ajo nuk e ka përmendur se ajo ishte nën ndikimin e barnave dhe po trajtohej me psikoterapi. Së dyti, mënyra se si dëshmitarja fillimisht i ka treguar faktet gjatë dëshmisë së saj në procedurë paraprake, faktet mbështetëse në detaje të mëdha dhe në renditje logjike; e diferencojnë atë nga një person tipik nën qetësues të rëndë. Së fundi, vet dëshmitarja e pranoi se prokurori është sjellë me profesionalizëm dhe e ka hedhur poshtë mundësinë se dëshmia e saj ka mundur të jetë ndryshuar nga ai, apo nga stafi i prokurorisë. Ajo e njohu nënshkrimin e saj në dokument. Ajo iu referua shmangies nga dëshmia e saj në procedurë paraprake si “gabime” ose deklarime të bëra “për shkak të emocioneve”⁴⁸. Ajo nxori në përfundim, të kundërtën e asaj që në përgjithësi ishte e pranueshme, që kujtesa e saj në fakt ishte më e freskët në kohën kur e kishte dhënë dëshminë e saj në gjykim, d.m.th. tetë vite pasi që kanë ndodhur ngjarjet, se sa që e kishte dhënë në vitin 2007, disa javë më pas. Mohimi i dëshmisë së saj të mëparshme bazohej në një “kujtesë të mjegullt për shkak të qetësuesve”, apo sepse ajo ishte e prekur nga tragjedia⁴⁹ apo për shkak të dëshirës së fortë për hakmarrje⁵⁰. Ajo gjithashtu ia linte fajin urrejtjes që kishte ndaj S., gjithashtu edhe presionit të mediave dhe magjisë së

⁴⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqet 19, 20 (versioni në anglisht);

⁴⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 21 (versioni në anglisht);

⁴⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 23 (versioni në anglisht);

⁵⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqet 25, 27 (versioni në anglisht);

shtrigave⁵¹. Dëshmitarja e pranoi se e njihte E.S., por e mohoi të ketë pasur ndonjë marrëdhënie me të. Ajo gjithashtu ka thënë se e njihte “L.” dhe “S.”. I vetmi dëm që ajo kishte ishte ai emocional dhe profesional⁵².

57. Në lidhje me deklaratën e dhënë në polici (regjistratori i dëshmitares nr. 7, f. 307, 311, 312): më 9 dhe 10 shtator 2007, ajo deklaroi si në vijim: Deklarata është dhënë dhjetë ditë pas vrasjes së T.R. Ajo ka shkuar nga spitali në polici. Ajo ishte në ndikim të qetësuesve dhe nuk i kujtohet shumë. Është e mundur të ketë folur në afekt, por ajo nuk e di. Është shumë e mundur që deklarata është regjistruar siç duhet. Tani kur ajo e kujton pas 7 viteve, gjithçka që është thënë atëherë, është thënë në afekt, pa menduar. Ishte deklaratë e momentit. – Ata nuk kanë pasur probleme me grupin S. dhe ajo nuk ka bërë raport në polici vetëm lidhur me grupin S.. Ajo donte që E.S. të futej në burg. Në momentin e vrasjes së T.R.it, secili në spital, ku ajo ndodhej në atë kohë, ka thënë se S. ishte prapa kësaj vrasjeje.

Kjo deklaratë lidhur me arsyet e ndryshimit të dëshmisë nuk u konstatua si e besueshme për arsyet e përmendura në paragrafin 56. Për më tepër, kjo dëshmitare nuk e ka argumentuar se dëshmia e dhënë ishte detyrim nga ana e oficerëve të policisë të cilët e kanë marr në pyetje. Mund të nxirret në konkluzion se oficerët e policisë janë sjellë në mënyrë profesionale, prandaj papranueshmëria e kësaj deklarate është jashtë opsionit.

58. Pas ballafaqimit me dëshminë tjetër të saj dhe dëshminë e saj të dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake:

p. 314: Në lidhje me pjesën e parë të raportit, ajo deklaroi si në vijim: jo e tëra është e saktë. Ekzistojnë të vërteta, por ka shumë tjera gjëra që ajo nuk ishte në gjendje t’i thoshte. Është e vërtetë që T.R. i kishte thënë asaj se kur ai ishte bërë oficer i policisë e kishte ndaluar E.S. dhe që ata ia kishin vrarë qenin e tij. Gjithashtu edhe që ai ishte ndjekur dhe kërcënuar. Në një rast, ajo ishte me të kur ai po përcillej, por ajo nuk i kishte parë ata, pasi ai i kishte thënë “mos u kthe mbrapa, mos provoko”. Ajo nuk i njeh të gjithë ata persona me emra. Incidenti rrugës për në Gërmi që është raportuar më 24 gusht 2007, është i vërtetë. – Ajo asnjëherë në jetën e saj nuk e kishte parë një kamionçinë të kuqe të “B. Café”. Ajo dëgjoi për herë të parë për të në gjykim.

⁵¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 28 (versioni në anglisht);

⁵² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqet 40, 41 (versioni në anglisht);

p. 316: Ajo nuk ishte atje që ta shihte atë, por duke marrë parasysh sa shumë gjëra nëna e saj i ka treguar, ajo nuk e përjashton atë. Lidhur me paragrafin e fundit në deklaratën e saj në faqe 316 ajo nuk e ka thënë apo shkruar atë. Ajo ishte e pakënaqur me mënyrën sesi autoritetet janë marrë me ankesat e saj rreth E.S. dhe të grupit të tij, të cilat ajo dhe T.R.i i kanë bërë. Ajo e përsëriti këtë haptazi në disa intervista dhe programe. Siç mund ta sheh ajo, dikush e ka dëgjuar deklaratën e saj publike dhe pastaj e ka shkruar deklaratën e saj. Për të e gjithë kjo është e trilluar. Është qesharake nëse nëna e saj ishte dhunuar. Ajo asnjëherë nuk e ka parë A.B. në shoqërim me E.S. ajo e ka parë atë për herë të parë në jetën e saj kur ai është sjellë në pranga në gjykimin lidhur me T.R.

Regjistratori i dëshmitares nr. 6, fashik. 9, f. 156 A : Ajo nuk është e sigurt nëse ka bërë ankesë në Policinë e Kosovës, më 2 shkurt 2005. Asaj nuk i kujtohet ta ketë bërë atë ankesë.

Regjistratori i dëshmitares nr. 6, fashik. 11, f. 221 A dhe 222 A: E përballur me dokumentin e datës 22 qershor 2005 (një raport i policisë) ajo tha se ajo e kishte bërë një ankesë për shkak të një kërcënimi verbal. Asaj i ka ndodhur të jetë kërcënuar nga tre persona të “Princi i Arberit”. Ajo personalisht nuk është e sigurt nëse ishte grupi S. apo jo, pasi ata asnjëherë nuk kanë guxuar ta kërcënojnë. Megjithatë, ishte gjatë natës dhe ishte ashtu se si u prezantuan ata.

59. Kjo dëshmitare ofroi disa fakte lidhur me marrëdhënien e saj me T.R. Ajo tha se për herë të parë e kishte njohur T.R. në vitin 2006. Ai ka ardhur në shtëpinë e saj dhe e kishte prezantuar veten si mik i familjes. Ai pyeti nëse kishin ndonjë problem sikurse të tjerët në lagje. Ajo kishte probleme me fansat e saj në atë kohë. Ka ndodhur që fansat e saj e kanë kërcënuar dhe po ashtu kishte raste kur ajo ishte kërcënuar për shkak të preferencave politike. Ajo i kishte paraqitur ata në polici kurdo që ajo kishte pasur mundësi ta bënte. Ajo personalisht nuk kishte pasur probleme me E.S. apo me ndonjë nga bashkëpunëtorët e tij edhe në kohën kur ajo u takua me T.R. Ajo asnjëherë nuk i kërkoi T.R. për ndonjë ndihmë, asistencë apo mbrojtje nga E.S.. Ajo e kishte sigurimin saj personal të angazhuar qysh nga viti 2000 në Kosovë.

Ata si familje kishin probleme vazhdimisht. Shumë prej koncerteve të saja në atë kohë ishin anuluar. Kjo ndodhi për shkaqe të ndryshme. Në atë kohë ajo besonte se anulimi i koncerteve të saja kishte të bënte diçka me E.S. ose dikë nga bashkëpunëtorët e tij. Ajo besonte se ai ishte përgjegjës për disa nga anulimet e koncerteve të saj për shkak të faktit se legjenda S. ishte krijuar

në atë kohë në lagjen Dardania. Dy prej personave kyç që i mbanin frenat e biznesit shqiptar në Evropë i kanë thënë saj se ata frikësoheshin të punonin me të, pasi që ajo po përgojohet. Ata jetonin në Zvicër dhe Gjermani, dhe kishin dëgjuar thashetheme se kishte probleme në Kosovë. Ajo raportoi në polici se biznesi i saj po shkatërrohet dhe ju ofroi emrat e personave, që ja kishin thënë këtë asaj, por ata persona nuk janë marrë në pyetje nga policia dhe as policia nuk i ka treguar asaj për një gjë të tillë. (Punëdhënësit i kanë thënë asaj se po i epnin para njerëzve të S. dhe policia nuk guxoi t'i marrë në pyetje ata. Policia i tha asaj se nuk i kishin marrë në pyetje personat nga Zvicra dhe Gjermania, pasi ata ishin nën juridiksion tjetër/ nuk ishin nën juridiksionin e tyre). Organizuesit e koncertit i thanë asaj se ata nuk mund të paguanin koncertet siç duhet për të sepse ata ishin shantazhuar. Duke folur për Gjermaninë dhe Zvicrën, për shembull nëse çmimi i saj për koncert ishte dhjetë mijë euro, ajo do të merrte vetëm një mijë, pasi ata kishin thënë se pjesa tjera ishte marrë nga S.. Më vonë, organizatorët e koncertit nuk ka dashur të dëshmojnë për këtë. Paratë janë dhënë për të mbajtur koncerte përndryshe kishte kërcënime me bomba. Ajo asnjëherë nuk ishte shantazhuar apo detyruar drejtpërdrejtë nga E.S.

57. Analiza e dëshmisë nën betim e A.I.t nxjerr në pah jo vetëm tërheqje të rëndësishme nga dëshmia në procedurë paraprake por gjithashtu edhe mospërputhje dhe kundërthënie të dukshme dhe të shpeshta.

58. Në lidhje me problemet e mundshme me E.S., dëshmitarja në fillim e ka hedhur poshtë kompletë një mundësi të tillë: *“E.S. nuk ka pasur shans të kishte probleme me mua sepse unë e kisha sigurimin personal”*. Sidoqoftë, më vonë gjatë dëshmisë, ajo e pranon se në më shumë se pesë raste, gjatë vozitjes, ajo dhe T.R.i ishin ndjekur nga njerëzit e E.S.⁵³. Fillimisht ajo shfaqet e paqartë në identifikimin e kryerësve: *“në rastin tim është e vështirë të përcaktohen nëse ishte ndonjë fans përndjekës i çmendur, ndonjë kundërshtar apo dikush nga grupi S., duke mos qenë në gjendje t'i njoh të gjithë ata fizikisht, dhe ta dijë se sa krijesa merrnin pjesë në këtë grup”*⁵⁴. Kjo është në kontrast të zyrtë me faktet e detajuara që ajo i tregoi gjatë dëshmisë së saj në procedurë paraprake, ku automjete dhe persona përmenden në detaje të mëdha. Më vonë në dëshminë e saj, A.I. e pranon se pesë deri në dhjetë herë T.R i ka thënë asaj se personat që po i përcillnin ata ishin të S. dhe i tha asaj *“mos u kthe mbrapa, mos provoko, jemi duke u*

⁵³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 51 (versioni në anglisht);

⁵⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe14 (versioni në anglisht);

*përcjellë*⁵⁵”. Pa dyshim, incidenti i datës 24 gusht 2007, ku A.I. dhe T.R. po përcilleshin me vetura në drejtim të Rrugës së Gërmisë, në fakt ishte raportuar në polici⁵⁶. Megjithatë, në dëshminë e saj para gjykatës, dëshmitarja qëllimisht i dha pak rëndësi incidentit: “*unë personalisht nuk ndjeva ndonjë rrezik nga përcjellja*”⁵⁷.

Dëshmitarja e pranoi se ishte ankuar në polici për S., vetëm pasi iu tregua përmbajtja e tyre. Ajo e pranoi nënshkrimin në këto ankesa por prapë se prapë e mohoi, përmbajtjen e deklarimeve që i kishte bërë, dhe në mbështetje i mendoi ato si “*surrealiste*”⁵⁸.

59. Gjykata me kujdes e ekzaminoi sjelljen dhe qëndrimin e dëshmitares kur e peshoi dëshminë e saj. A.I. insistoi se seanca gjyqësore të mbyllej për publikun dhe se ajo të dëshmoi vetëm në mungesë të të pandehurit. Në një korrespondencë me shkrim të paraqitur në gjykatë para paraqitjes së saj, A.I. paralajmëroi se ajo do të refuzojë të dëshmojë nëse i pandehuri është i pranishëm. Gjykata konsideroi si të domosdoshme të merr dëshminë nga kjo dëshmitare e rëndësishme lidhur me pretendimet në Pikën 1 dhe 2 të aktakuzës në një mënyrë të pakufizuar dhe të përshtatshme, ndërsa në të njëjtën kohë duke respektuar të drejtën e mbrojtjes për ta marrë në pyetje të tërthortë pas konsultimit me klientin e tyre. Prandaj, kërkesa e dëshmitares është miratuar⁵⁹ dhe shqyrtimi gjyqësor ishte i mbyllur për publikun dhe u zhvillua në mungesë të të pandehurit.

60. E pyetur më tej rreth kërkesës së saj për ta përjashtuar publikun dhe të pandehurin nga seanca, dëshmitarja tha se ajo e kishte një neveri dhe urrejtje të thellë ndaj të pandehurit. Për shkak të ndjenjave të saja negative dhe barrës emocionale⁶⁰, A.I. theksoi se ajo e preferon t’i referohet atij apo edhe bashkëpunëtorëve të tij si “*krijesa*⁶¹” ose “*gremlina*⁶²”. Ajo e mohon se kishte ndonjë arsye të frikësohej apo të ndihej në rrezik për shkak të E.S.⁶³.

61. Duke pas parasysh rrethanat e rastit dhe konotacionin e rolit emocional dhe personal të A.I. në veprat penale të pretenduara në pikat 1 dhe 2, gjykata konsideron si të papranueshme

⁵⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 16 (versioni në anglisht);

⁵⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 35 (versioni në anglisht);

⁵⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 39 (versioni në anglisht);

⁵⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 32 (versioni në anglisht);

⁵⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 3 (versioni në anglisht);

⁶⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 18 (versioni në anglisht);

⁶¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 12 (versioni në anglisht);

⁶² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 13 (versioni në anglisht);

⁶³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 44 (versioni në anglisht);

shpjegimet e dhëna nga dëshmitarja për urrejtjen e saj ndaj të pandehurit. A.I. tha se arsyeja e urrejtjes personale të saj ishte dëmi që i pandehuri i ka shkaktuar kombi të saj si bashkëpunëtor i regjimit serb⁶⁴.

62. Shqetësimi emocional i dëshmitares gjatë dëshmisë së saj është i dukshëm nga përgjigjet e saj. Në përpjekje për t'u marr me fakte, ajo u mbështet në dëshminë e saj në procedurë paraprake, ajo i mori pyetjet me tallje: p.sh. kur është pyetur nëse ajo ndonjëherë është detyruar apo shantazhuar nga S., ajo u përgjigj *“Po mundohem mos me qesh”*⁶⁵; ajo iu shmang përgjigjeve duke ia vënë fajin kujtesës së saj, kalimit të kohës, apo shpalosjen e madhe të ngjarjeve: kur është pyetur nëse ajo ndonjëherë kishte bërë ankesë për shkak të detyrimit apo shantazhuar, ajo përgjigjet: *“nuk më kujtohet, ndoshta po, ndoshta jo, ishin kohëra të çmendura”*⁶⁶. Ajo tregonte mburrje të shtirur dhe sarkazëm: *“ata njerëz nuk mund të kenë probleme me mua”*⁶⁷, *“asnjë kriminel, qoftë ai kryeministër i një vendi, nuk mund të merr para nga unë”*⁶⁸. Më vonë gjatë dëshmisë ajo nënkuptoi se asnjëherë nuk është ndje në rrezik nga E.S.. Ajo e mbështeti të vërtetën në misterin apo pasigurinë, edhe kur faktet duhet të jenë shumë të qarta: mbeti mister nëse problemet në mes të R. dhe S. ishin në ndonjë mënyrë të ndërlidhura me të; ishte e mundur që ajo ka mund ta ketë raportuar S. në polici.⁶⁹ Ajo e pranoi rraskapitjen fizike të saj: *“nuk kam fjetur këto 24 orët e fundit”*⁷⁰.

63. Ajo filloi të takohej me T.R. më 27 shtator 2005. T.R. i ka thënë asaj se ai kishte probleme me E.S. dhe se ai ishte një kriminel. Ai i ka thënë asaj gjithashtu se ish e dashura e tij kishte probleme me E.S. apo me grupin S.. T. R. Nuk ishte lloji i njeriut i cili do të diskutonte problemet me të. Ai i diskutoi me të problemet e tij me S. por ishin diskutime të kota, përfshirë sharjet etj. Nga perspektiva e sodit ajo mund të thotë se T.R.i kishte diskutuar me të vetëm gjëra sipërfaqësore. Ajo e kishte ndjesinë sikur po përcillej. Në rastin e saj ishte e vështirë të përcaktohet nëse ishte një fans i çmendur që e përcillte, një kundërshtar apo dikush nga grupi S.. Ajo i raportoi të gjitha këto përcjellje në polici brenda mundësisë. Në një rast ka ndodhur që ajo ishte përcjellë ndërsa ishte në veturë në lëvizje bashkë me T.R. Ka ndodhur kur T.R.i po e çonte

⁶⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqet 52, 53 (versioni në anglisht);

⁶⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 13 (versioni në anglisht);

⁶⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 13 (versioni në anglisht);

⁶⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 17 (versioni në anglisht);

⁶⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 22 (versioni në anglisht);

⁶⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 17 (versioni në anglisht);

⁷⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, faqe 11 (versioni në anglisht);

për në vizitë te shtëpia e gjyshes së saj. Në një moment, T.R.i i tha, “mos u kthe mbrapa, mos provoko, i kemi mbrapa nesh duke na përcjellë”. Ai tha se ishte grupi S., ishin duke i përcjellë. Ka ndodhur në më shumë se një rast që T.R.i në shoqëri me të është ankuara se ata të dy po përcilleshin nga E.S. Është tepër vështirë të kujtohen të gjitha ato. Ka ndodhur njëherë te lagjja e T.R.it, që quhet “Qafa”. Ishte gjithmonë e njëjtë, “mos u kthe mbrapa, mos provoko, po na përcjellin”. Mund të thuhet se incidenti ka ndodhur pesë deri në dhjetë herë. Ajo personalisht, nuk ka ndier asnjë rrezik nga përcjellja. Gjatë jetës në Kosovë, ajo asnjëherë nuk e është ndier që po i kërcënohej jeta nga ndonjë veturë që po e përcillte. Në ato raste kur ajo ishte në veturë me T.R.in, ajo asnjëherë nuk e ka parë E.S. me sytë e saj në veturë apo një veturë që gjoja po e përcillte.

Për aq sa është dijëni, T.R.i kishte probleme me këtë grupin. Ajo dinë aq sa T.R.i i ka treguar. E vetmja gjë që T.R.i e ka ndërlidhur me të ishin problemet që ai kishte me E.S. nga viti 1999. Ajo nuk ishte arsyeja se pse grupi S. i përcillte. Çfarëdo problemi që T.R. ka mundur ta ketë pasur me E.S. ishte në mes tyre dhe nuk kishte të bënte asgjë me të. Ajo ishte në New York, natën e ngjarjes në “Swiss Casino”. Kur kanë folur në telefon, ai shkurtimisht i ka thënë asaj, “patëm probleme me ata qenë”. T.R.i e minimizoi incidentin kur po fliste me të në telefon. Ajo beson se ai e ka bërë me qëllim që të shmangte ndonjë brengosje, pasi ajo ishte një kontinent larg në kohën kur ka ndodhur. Ajo nuk mund t’i referohet këtij incidenti si përleshje pasi që ajo e mori vesh se kishte pasur të shtëna me armë dhe përballje me armë. Ajo nuk ia lejoi T.R.it të zgjerohej rreth atij incidenti, sepse ajo e mori vesh përmes mediave se nuk ishte një përleshje e thjeshtë po kishte të shtëna me armë zjarri. Pas këtij incidenti, T.R. u bë tepër mbrojtës; e tërë lidhja e tyre ishte “shiko, ki kujdes, shko ka kjo rrugë”.

Për aq sa i kujtohet, motra e saj dhe nëna e saj kishin një marrëveshje verbale me dikë nga grupi S..

Ajo i njeh disa fytyra që shquheshin grupi S., por jo emrat. Emrat lidhur me grupin S. ishin emra të ndryshëm dhe zakonisht ishin fjalë të këqija. E pyetur nëse mund t’i ndërlidh emrat me fytyrat e tyre, ajo u përgjigj: “L., nuk ia di emrin e tij, por në shoqërinë time ata e quanin [L. e S.]”

Tema e grupit S. u shfaq pas publikimit të një interviste në gazetën, Gazeta Express. Përveç dëmit emocional, këta persona (që i takonin këtij grupi) nuk i shkaktuan ndonjë dëm apo cenim asaj.

E pyetur për ta vlerësuar T.R si person, ajo tha si vijon: Ishte i kujdesshëm, temperament dhe i drejtë. I dilte në ndihmë asaj në çdo aspekt për aq sa mundte. Ishte i sinqertë dhe njeri i mirë ndaj saj.

M.I.

64. Dëshmitarja M.I., nëna e A.I.t gjithashtu më masë të madh e distancoi vetën nga dëshmia e saj fillestare në procedurë paraprake. Ajo tha⁷¹ se T.R dhe A.S. i ofruan mbrojtje nga E.S.. Gjithashtu, ajo e vërtetoi se A.I. dhe E.S. kishin qenë në një lidhje. Kjo deklaratë është në kundërtënie evidente me atë se çfarë vajza e saj tregoi për këto çështje, duke provuar medoemos ta bind gjykatën se ajo as nuk ishte në lidhje me E.S. e as me T.R, dhe se ajo asnjëherë nuk ishte e rrezikuar nga i pari dhe në fakt ajo nuk kishte nevojë për ndonjë lloj ndihme apo mbrojtje nga E.S.. Dëshmitarja M.I. e dha dëshminë e saj gjithashtu edhe në procedurë paraprake. Deklarata e saj është e datës 08.01.2008. Ajo e përmendi se ajo ishte në dijeni që vajza e saj kishte qenë në lidhje me E.S. dhe se A.I. frikësohej nga ai. Ajo e kujtoi se në vitin 2003 ose 2004, pas largimit nga një studio muzikore, ata i kanë gjetur gomat e veturës së një muzikanti tjetër të prera. Ata i kishin vërejtur më parë grupin S. te veturat e tyre. Ajo gjithashtu ka thënë se ajo dhe vajza tjetër e saj, E.I. ishin sulmuar jashtë Zyrës së Postes nga S.Se.. Asaj gjithashtu i ishte hedhur baltë dhe ishte sharë verbalisht nga dy individë në vitin 2004, të cilët po e vozisnin një veturë tërësisht të zezë, VW Golf III. Të dyja këto incidente ishin raportuar në polici. Gjithashtu gjatë dhënies së dëshmisë në shqyrtim gjyqësor ajo i konfirmoi këto fakte. Sipas kësaj dëshmitare problemet me grupin S. filluan kur F.S. e njoftoi A.I. me E.S. në vitin 2002. Dëshmitarja tha se në vitin 2003 apo 2004, A.I. i kërkoi asaj para në disa raste sepse ishte e obliguar t'ia jepte E.S.. Asaj i kujtohet që A.I. i ka raportuar disa raste të tilla të ngacmimeve në polici.

Në thelb, deklaratat e kësaj dëshmitare janë konsideruar nga gjykata si të besueshme pasi ato janë të kuptueshme, e qëndrueshme, eksplicite, të dorës së parë. M.I. ishte në qendër të ngjarjeve si nënë e kujdesshme dhe e dashur e A.I.t, e cila shqetësohej për vajzën e saj.

⁷¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 28 janar 2015;

E.I.

65. Ajo është motra e A.I. dhe vajza e M.I.. E.I. tha se ajo ishte kundër që motra e saj A.I. të kishte një lidhje me të pandehurin për shkak të kaluarës së tij kriminale dhe gjithashtu edhe sepse E.S. e kishte fyer atë dhe nënën e saj në telefon. Ajo e ka dhënë dëshminë se T.R. ka ardhur në sallonin e saj të ondulimit para se ajo ta njihnte T.R.in dhe ajo e kishte pyetur atë, nëse ata kishin *“pasur probleme me E.S.”*. Marrëdhënia e A.I. me E.S. paraqiti tension tek të gjithë anëtarët e familjes I., duke konsideruar se kjo familje kryesohej vetëm nga M.I., e pa shoqëruar nga bashkëshorti i saj. Dëshmitarja e konfirmoi se kishte ngacmime nga grupi S. ndaj saj, nënës së saj dhe motrës, duke ju shkaktuar shqetësime emocionale. Kërcënime me bomba janë bërë së paku në dy raste, duke shkaktuar anulimin e paraqitjeve të drejtpërdrejta të A.I.t. Ajo gjithashtu e konfirmoi se gomat e veturës së saj janë shfryrë në vitin 2003, ndërsa ajo ishte në pushim në Ulqin, dhe se ajo besonte se ishte veprim i shokëve të të pandehurit. Ajo gjithashtu e vërtetoi se A.I. i kishte thënë asaj rreth tentim pritës afër fshatit Stagovë që ka ndodhur dhe që A.I. ishte shumë e brengosur. Edhe pse dëshmitarja nuk ka qëndruar plotësisht mbrapa dëshmisë në procedurë paraprake, ajo nuk tregoi se ishte në presion, ose që ndryshime të dëshmisë së saj fillestare janë bërë nga prokurori i shteti apo nga policia. Kur është përballur me procesverbalin e gjyqimit të A.B. ajo e pranoi se ishte e saktë se T.R.i i kishte thënë asaj se ai po përcillej nga dikush me veturë nga Grupi S. (p. 52). Ajo e vërtetoi pjesën e deklaratës së saj para prokurorit ku ajo kishte raportuar se ajo dhe familja e saj ishin frikësuar nga S. dhe grupi i tij përfshirë të pandehurin që kanë ardhur jashtë banesë së tyre natën me të tjerë në pesë apo gjashtë vetura dhe duke bërë me buria vazhdimisht për të frikësuar familjen. Ajo gjithashtu e konfirmoi se A.I. i ka thënë asaj rreth një prite në tentativë afër Stagovës dhe se A.I. ishte shumë e brengosur (p. 34). Në asnjë fazë gjatë dëshmisë, dëshmitarja nuk ka thënë as që prokurori apo policia e kanë shtyrë që ta nënshkruaj deklaratën.

Në deklaratën para prokurorit special, ajo tha se e njohu T.R. vetëm pas një dite kur ai kishte shkuar për ta vizituar atë dhe kishte thënë se ai mund t'i ndihmonte lidhur me grupin S.. Më pas, T.R.i dhe shoku i tij A.S. po e vizitonin A.I. në banesën e saj, përpara, pas disa muajve, një lidhje serioze filloi në mes të A.I. dhe T.R.it. Ajo tha se nuk ishte frikësuar vetëm A.I., nga E.S., por edhe e gjithë familja I.. Ajo tha se ajo personalisht është telefonuar rregullisht nga E.S. apo pjesëtarët e grupit të tij, kur e shanin verbalisht atë. Para vrasjes, A.I. i kishte thënë asaj se T.R.

dhe A.I. po përcilleshin nga E.S. dhe grupi i tij gjatë tërë kohës. Asaj i ishte treguar rreth bllokimit të rrugës në fshatin Stagove. Ajo i tha me emra disa persona që ajo pretendonte se ishin pjesë e grupit S., por kur u pyet për A.B., ajo nuk kishte dëgjuar kurrë për të.

Trupi gjykues i konsideroi deklaratat e kësaj dëshmitare si të besueshme. Ajo tregoi gjallërisht dhe në detaje marrëdhënien e motrës së saj A.I. me E.S. dhe më pas me T.R. Këto janë të dhëna të dëshmitares okulare të ofruara nga një person që ishte në qendër të ngjarjeve të cilat çuan në vdekjen e T.R.. Trupi gjykues kishte përshtypjen, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor, që E.I. është person me vetëbesim e cila nuk ka paraqitur asnjë dobësi nga ngacmimet e pjesëtarëve të grupit të E.S.. Ajo e paraqiti këndvështrimin e saj në një mënyrë të qëndrueshme, si motër e A.I., duke thënë se ajo është kundër një lidhjeje të A.I. me E.S., për shkak të kaluarës së tij kriminale dhe për shkak të fyerjeve që ajo dhe nëna e saj i kanë pësuar nga S.. Sjellja e sa e pa-kompromis tregon se ajo nuk ka fshehur asnjë nga faktet dhe është munduar të jap një dëshmi më të mirë të mundshme. E.I. vërtetoi në mënyrë të vendosur se A.I. ka një marrëdhënie me E.S., i cili më vonë, i shkaktoi kërcënime të rrezikshme ish të dashurës së tij dhe familjes së saj. Në bazë të këtyre fakteve, deklarata e E.I. është në kundërshtim me dëshminë e motrës së saj A.I. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. E.I. nuk kishte asnjë arsye personale të dëshmojë kundër motrës së saj lidhur me këto elemente të rëndësishme të rrjedhës së ngjarjeve. Duhet të nënvizohet se përkundër lidhjes së ngushtë familjare me A.I.n, ajo vendosi ta shkel atë dhe ta tregojë të vërtetën dhe kjo e bën dëshminë e saj përmbajtjesore dhe të paanshme.

Z.I.

66. Ajo tha se ajo e dinte që motra e saj A.I. e njihte T.R. Sipas dëshmitares, kjo ka ndodhur kur T.R dhe A.S. kanë ofruar ndihmën e tyre familjes së saj duke e dikur që ato po ngacmoheshin nga grupi S.. Më tutje kjo dëshmitare tha se ajo personalisht nuk kishte pasur asnjë problem me grupin por e dinte që A.I., M.I. dhe E.I. i kanë raportuar shumë probleme që kanë pasur në polici. Gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor, Z.I. e vërtetoi përsëri deklaratën e saj në polici sipas së cilës A.I. ka pasur kërcënime të ndryshme nga E.S. dhe njerëzit e tij. Gjatë dëshmisë së saj në gjykim ajo tregoi se ajo kishte dëshmuar kështu pasi ajo ndoshta e kishte dëgjuar A.I. që e ka përmendur këtë⁷². Në vazhdim kjo dëshmitare e vërtetoi se T.R dhe E.S. ishin armiq. Ajo e

⁷² Procesverbali i gjykimit, 10.01.2015, faqe 24, (versioni në anglisht);

vërtetoi kur u përballë me deklaratën e saj të datës 08.02.2008, se A.I. kishte probleme me të pandehurin. Ajo gjithashtu e vërtetoi se e kishte përdorur shprehjen grupi S. në deklaratën e saj disa herë dhe se ajo ishte në dijeni rreth ekzistimit të këtij grupi (f. 18-19). Ajo e vërtetoi se ajo ndoshta ka thënë në deklaratën e saj “A.I. kishte pasur kërcënime të ndryshme nga E.S. dhe njerëzit e tij.” Ajo e vërtetoi pjesën e deklaratës së saj ku ajo kishte thënë “nuk e njihja A. por F.S. më ka thënë se A.B. ishte pjesëtar i ‘Grupit S.’ dhe ai është shoqëruar më së shumti me L..” Në dëshminë e saj para gjykatës, ajo është pyetur nëse L. ishte pjesëtar i grupit S. dhe ajo u përgjigj “me siguri po.”

67. Edhe pse dëshmia e kësaj dëshmitare nuk ishte aq e qëndrueshme dhe e guximshme si dëshmia e E.I., ky trup gjykues e konsideron si të besueshme. Z.I. duket të jetë më e rezervuar sesa motra e saj E.I. dhe nuk ka guxuar të ndërhyjë në jetën personale të A.I.t që takohej me E.S., pro në fakt ajo vërtetoi dëshminë e M.I. dhe E.I.. Kjo dëshmi është vërtetuar me dëshminë e E.I. dhe provat tjera objektive duke i përmendur vetëm ankesat në polici.

B.H.

68. Një dëshmi e rëndësishme është dhënë nga dëshmitari B.H., një ish oficer i PK-së, i cili ishte shok i T.R. dhe A.I.t. B.H. i dinë shumë fakte rreth punëve të T.R. me E.S.. B.H. e kishte kuptuar këtë personalisht nga T.R dhe A.I.. Ky dëshmitar i kujtoi shumë realisht të gjitha situatat problematike që T.R dhe A.I. i kishin me E.S.. Ky dëshmitar e dha një deklaratë të rëndësishme që i ndihmoi gjykatës për vërtetimin e fakteve që çuan në vdekjen tragjike të T.R.. Trupi gjykues vendosi t’i përmbledh deklaratat e tij në një mënyrë gjithëpërfshirëse që ndihmuan në të kuptuarit e rrjedhës së ngjarjeve tragjike.

Dëshmitari iu bashkua Policisë së Kosovës në vitin 2000. Ai punoi në njësinë e patrullimit, njësinë e komunikacionit dhe gjithashtu në njësinë speciale siç është ROSU dhe FIT deri më 21 janar 2008, kur ai është arrestuar. Ai e njihje T.R shumë mirë si koleg dhe si shok. Ata u takuan gjatë trajnimit në Vushtrri, në vitin 2000, atje T.R.i punoi si instruktor. Ata filluar si kolegë e pastaj si shokë.

T.R.i ishte një person i qetë, shumë i respektueshëm ndaj kolegëve të tij si dhe qytetarëve dhe në shoqërinë që ai kishte, ai gëzonte respekt lartë. Ai ishte një oficer i policisë shumë i ndershëm dhe shumë profesional. Ai ishte një oficer i policisë shumë trim dhe shumë i drejtë në

respektimin e rregullave. Ai ishte trajner dhe instruktor për tërë shërbimin policor të Kosovës. Ai asnjëherë nuk kishte konflikt fizik apo grindje me askënd. Ai ishte i respektuar dhe e kishte guximin që t'i vinte stop E.S..

Ai nuk u takua personalisht me E.S. deri kur ndodhi incidenti në Ferizaj, më 22 maj 2006. Deri në atë kohë ai personalisht nuk kishte kontakt me E.S.. Në atë ditë, E.S. ishte arrestuar nga njësia e ROSU në Ferizaj. Incidenti ndodhi jashtë restorantit “Dani” në Ferizaj. Stacioni policor në Ferizaj është njoftuar rreth një kërcënimi dhe njësia ROSU ishte angazhuar sepse në këtë rast konkret, ishte një person i profilit të lartë kriminal, E.S.. (Në bazë të dëshmitarëve është thënë se kërcënimi ka ndodhur në restorantin “Dani”. Ata i morën udhëzimet dhe shkuan atje. Ai ishte personalisht i përfshirë në atë arrestim. Në atë kohë ai ishte pjesëtar i ROSU.) Ata e arrestuan E.S. dhe dy persona tjerë – një prej tyre nga Vitia, dhe tjetri nga Prishtina. Pas arrestimit në Ferizaj ai duhej të paraqitej në gjykatë si dëshmitar. Pas marrjes së vendimit përfundimtar për E.S., dhe ndërsa po largohej nga salla e gjyqimit, E.S. e kërcënoi atë dhe kolegët e tij, të cilët, sikurse ai, ishin pjesë e sigurimit atje. E.S. tha, “do t’ju vrasë një nga një”. T.R nuk ishte i përfshirë në këtë arrestim që ka ndodhur më 22 maj 2006.

Pas incidentit në Ferizaj, T.R i tha atij se ata po e përcillnin atë rregullisht. Ai i ka thënë atij se e kishte raportuar rregullisht në stacion policor. Ai gjithashtu i kishte thënë se i ishte përgatitur një pritë në fshatin Stagove. Disa ditë para se të vritej T.R.i, atij i ishte përgatitur një pritë në fshatin Stagova, për arsye të sigurisë T.R.i ishte i detyruar të largohej nga Prishtina dhe të shkonte të jetonte në Stagove. T.R.i u detyrua ta ndërronte vendbanimin kohë pas kohe. Në hyrje të fshatit Stagovë, ata kishin vënë copa druri dhe gurë para tij. Për fat të mirë, në atë kohë ai po voziste një SUV dhe pati mundësi ta kalonte këtë barrierë që ia kishin vendosur atje dhe ai voziti shpejt. Ai i mësoi të gjitha këto personalisht nga T.R.i.

Arsyeja se pse T.R.i e zgjodhi të largohet nga Prishtina në fshat ishte për shkak të kërcënimeve të vazhdueshme dhe përpjekjeve për ta vrarë, nga E.S. dhe grupi i tij. T.R.i asnjëherë nuk ka pasur ndonjë problem personal me askënd gjithë jetën e tij, as edhe me E.S., por E.S.i e kishte kthyer këtë në çështje personale. Ai e mori këtë çështje si personale dhe e bëri me secilin person. Për të kjo ishte diçka e rregullt.

T.R.i thoshte se F.S. regjistronte secilën lëvizje të tij dhe e raportonte E.S.. Ai gjithashtu e përmendi emrin e A., R. dhe L., si ata që ishin të përfshirë në këtë lloj aktiviteti. T.R.i shpesh fliste me të dhe kolegët në përgjithësi sepse për të kjo u bë një lloj shqetësimi. Ai ia përmendi atij se po ngacmohej, dhe kishte një vëmendje të padëshiruar nga E.S. dhe të tjerët. Ai i mori ato incidente si shumë serioze dhe ishte i shqetësuar për sigurinë e tij. Për këtë arsye ai e ndryshoi vendbanimin e tij.

Shqetësimet e T.R. lidhur me E.S. ishin të shumta dhe shpesh ai fliste me ta si kolegë dhe shokë se ai ndihej i rrezikuar nga E.S. T.R.i frikësohej se E.S. do ta vriste. Dhe në fakt ai e vrau atë sepse T.R.i nuk kishte asnjë problem apo çështje me askënd. Nuk kishte asnjë problem fare në mes të T.R.it dhe A.B.. A.B. ishte paguar nga E.S.. T.R.i nuk e njohte A.B.. Ata e njohën se kush ishte A.B., vetëm pas vrasjes së T.R.. Ai asnjëherë nuk kishte dëgjuar personalisht për A.B. dhe askush asnjëherë nuk e ka përmendur emrin e tij. Dhe ai nuk ishte në dijeni për veprimet e tij përveç faktit se ai e dinte se A.B. ishte një njeri i varfër sepse e kishte parë këtë me sytë e tij kur kishte marrë pjesë në bastisjen e shtëpisë së A.B.. Kushtet e tij jetësore ishin të mjerueshme. E.S. është kryerësi i kësaj vrasje. A.B. e ka tërhequr këmbëzën por E.S. ishte truri, organizatori i atij krimi. Askush nuk ka mundur të priste se E.S. do të shkonte ta vriste T.R., sepse nuk është ai lloj personi. E.S. tëra ishte përgatitur nga E.S.. T.R.i asnjëherë nuk ka pasur ndonjë konflikt me askënd apo mosmarrëveshje, përveç me E.S..

T.R.i nuk ka pasur asnjë problem me askënd përveç me E.S. Problemet me E.S. filluan kur ai e kishte ndaluar atë diku në Vranjevc. Kjo ka ndodhur në 2000-2002, kur T.R.i ishte polic patrulle. E.S. e mori atë personale dhe në mënyrë shumë ofenduese. T.R.i i ndje shumë i kërcënuar dhe për shkak të këtyre arsyeve ai i bëri raportet, por problemet u rriten më shumë sepse asgjë nuk i është marrë E.S nga policia, prokuroria apo gjyqësori. T.R.i ishte absolutisht i pakënaqur me mënyrën se si janë trajtuar shqetësimet e tij nga autoritetet. Policia nuk kishte ndërmarr masat e duhura kur ishte fjala për T.R.in. Ai kishte bërë një numër ankesash dhe raportesh rreth asaj që i ka ndodhur. Ai ishte i pakënaqur sepse shumë pak veprime ishin ndërmarr kundër E.S.. T.R.i ishte plotësisht i pakënaqur me D.T. dhe disa oficerëve të lartë të policisë si M.K. dhe A.K..

Pas incidentit të T.R.it, me ndalesën e E.S. situata në mes të T.R.it dhe E.S.it u përkeqësua. Më vonë, vetura e T.R.it u dogj nga E.S.i. T.R.i e pati një ballafaqim fizik me E.S. në “Swiss Casino”, ku pati një shkëmbim të shtënash dhe fatkeqësisht një oficer i policisë është plagosur

dhe një person tjetër i quajtur A. nga grupi S. është plagosur. Ai e mori vesh për djegien e veturës, nga T.R. T.R. po përcillej gjatë gjithë kohës deri kur ai u vra. Në një rast T.R.i dhe A.I. ishin përcjellë nga E.S.i bashkë me R. dhe L., kah rrugët e lagjes dhe T.R.i duhej ta dërgonte A.I. në shtëpi sa më shpejt që ishte e mundur.

Ai nuk ishte fizikisht i pranishëm në “Swiss Casino” kur ndodhi incidenti, por ai e di rreth rrjedhës së ngjarjeve në kazino dhe se si E.S. ka arritur të sjellë armë brenda në kazino. Ishte A.S., ai i cili e njoftoi për atë incident. Ata gjithashtu u njoftuan përmes raporteve zyrtare sepse gjatë raportimit të gjitha incidentet janë përmendur. Ai e di se E.S. e ka shtyrë T.R.in për krahu dhe kështu filloi e tëra. A.I. ishte një nga arsyet se pse T.R. u bë më i inatosur me E.S.. Ajo pretendohet se ishte në lidhje me E.S.i, me vullnetin e saj apo për shkak se ishte e shantazhuar. Ata i kanë gjetur disa fotografi të A.I. gjatë bastisjes në Ferizaj, dhe në posedim të E.S., i cili i kishte përdorur ato fotografi për ta shantazhuar atë. Madje edhe vet A.I. i kishte thënë se po shantazhohej dhe kërcënohej në të gjitha format. Në momentin kur A.I. filloi një lidhje me T.R., E.S.i filloi ta urrente më së shumti, sepse pastaj ai nuk mund ta shantazhonte më A.I., pasi ajo ndihej e sigurt duke qenë me T.R..

Ai e njihte A.I. më përpara, sepse vëllai i tij punon në biznes muzikor në Gjermani dhe ai ishte personi që ishte në kontakt me këngëtarët për të angazhuar koncerte atje. Ai nuk e dinë se sa serioze ishte lidhja në mes të A.I. dhe E.S.. Ajo i kishte thënë atij personalisht se ajo gjithmonë ndihej e kërcënuar dhe e shantazhuar kur ishte me E.S.. Ajo gjithashtu ishte detyruar t’i jepte para E.S.. Kur ai e pyeti A.I. nëse ajo i kishte raportuar këto incidente, ajo u përgjigj se do të ishte e kotë, sikurse me i raportuar ato te E.S., dhe do të ishte dënimi i saj. Dhe në fakt, ishte mjaft e besueshme, sepse T.R.i i kishte raport shumë raste në stacion policor dhe askush nuk i kishte trajtuar ato.

Ai nuk e dinë se si T.R.i dhe A.I. janë bërë bashkë, por T.R.i ishte i pashëm dhe ajo e donte një trim afër vetës. Ajo e pëlqente T.R.in dhe T.R.i e pëlqente atë gjithashtu dhe ajo ndihej e sigurt me të afër. Kjo është informatë që ai e mori nga bisedimet me A.I. dhe T.R.in.

T.R.i ishte arsyeja që E.S. filloi ta humbte fuqinë dhe ndikimin. Grupi S. ishte një grup shumë i rrezikshëm që merrej me shantazh dhe kësi lloj aktivitete. Kjo vërehet gjithashtu zyrtarisht nga dokumentet e policisë. E.S. ishte bosi i bandës kriminale. Si oficer i policisë ai kishte njohuri

rreth njerëzve të E.S.. E dashura e L. ishte dërguar në spital ditën e vdekjes së T.R. për ta vërtetuar vdekjen e tij. Ai e kishte vërejtur atë atje. Ajo erdhi te oborri i spitalit edhe pse ajo nuk ishte motër atje sepse ata e kishin dërguar atë të merrte vesh nëse T.R.i kishte vdekur apo ishte ende gjallë. Ata frikësoheshin nëse T.R.i nuk kishte vdekur. Kur është vrarë T.R.i askush nuk është lejuar të futej në oborr por ajo kishte arritur të futej gjithsesi.

Ai ishte shumë i afërt me A.I.. Ajo i kishte thënë atij se e kishte bërë një deklaratë në polici dhe në prokurori. Pas vdekjes së T.R., ajo u takua me të disa herë. Ajo ishte kërcënuar si dhe ishte shantazhuar pas vdekjes së T.R.it. Ata vazhduan me kërcënime dhe shantazhe sepse menduan që nuk ishte mjaft. Ata u munduan ta frikësojnë në mënyrë që ajo të mos flas. Ata i thanë që ta këqyr punën e saj, dhe kjo ndodhi përmes F.S.t. E.S.i kishte foto pornografike të A.I. që tregojnë pjesën e përparme të tij së bashku me A.I.. A.I. i kishte thënë atij pas vdekjes së T.R.it se ajo ishte kërcënuar dhe shantazhuar për këto foto. A.I. e kishte thirrur disa herë duke qarë dhe këto janë incizime zyrtare dhe jo private. Ai e kishte këshilluar të shkonte te prokurori dhe ai i kishte ofruar mbështetje morale, pasi ata donin që ajo të mos dëshmonte në asnjë mënyrë, përmes shantazheve të ndryshme siç i përmendi më parë.

Ai vet kishte pasur kërcënime pas vdekjes së T.R.. Ai ishte thirrur në telefon nga shtabi, që ishin A.J., toger dhe A.R., rreshter. Ata e thirrën në telefon urgjentisht kur u takua me ta, ata ja sollën një jelek anti-plumb dhe zyrtarisht e njoftuan se E.S. e kishte bërë një marrëveshje me dikë që ta vret atë, dhe ai ishte L.T.. Ata ja ofruan një veturë të blinduar dhe gjithashtu donin t'i ofronin oficerë për mbrojtje të afërt por ai nuk pranoi.

Ai ishte një nga oficerët të cilët e bastisën shtëpinë e A.B. në lagjen Kodra e Trimave. Ai ishte pjesëtar i njësisë FIT në atë kohë dhe shkuan atje zyrtarisht pas kërkesës së prokurorisë. Kushtet e jetesës së A.B. ishin shumë të liga dhe shumë të dobëta.

Incidenti në “Swiss Casino” ishte në mes të oficerëve të policisë dhe grupit kriminal të E.S.. Oficeri i policisë, A.S. ishte plagosur atje dhe ishte fat që askush nuk është vrarë aty. Këto ngjarje janë inskenuar nga E.S.. Ai e provokoi T.R.in duke e ja prekur krahun. “Swiss Casino” ishte një bar i hapur dhe E.S. e dinte që oficerët e policisë ndodheshin atje. Gjithçka është përgatitur nga E.S. dhe revolet janë sjellë atje nga F.M.. Pas vrasjes/vdekjes së T.R., ajo i kishte thënë atij se ajo e kishte sjellë revolen brenda kafenesë. Ndërsa E.S. ishte në arrati ajo i kishte

kërkuar të vinte dhe ta takonte në mënyrë të fshehur, ashtu që grupi S. nuk do ta merrte vesh. Ajo madje ja solli një CD të video-incizimit të festës së ditëlindjes së E.S.. Ishin dy raste kur ata e kishin diskutuar çështjen e revoles dhe “Swiss Casino” dhe në të dyja rastet ajo ishte me nënën e saj. Ishte çështje biznesi sepse nëna e saj ishte e interesuar të gjente punë për F., pasi F. po mundohej të bëhej këngëtare. Ai nuk e bëri asnjë raport rreth kësaj çështje, por ka mundësi që ndonjë koleg tjetër e ka bërë.

F.M. e përshkruan E.S. si person të rrezikshëm. T.R nuk është vrarë vetëm për arsye të incidentit “Swiss Casino”, por për dobësimin e imazhit të S. si njeri i fortë, dhe ky ishte njëri prej motiveve. F.M. dëshironte të ofronte një imazh pozitiv të vetës së saj dhe donte të arsyetohej se pse rrinte me grupin kriminal. Ajo tha se e kishte një vajzë dhe po shantazhohej, por ai asnjëherë nuk e besoi këtë. F.M. dukej bukur nga pamja dhe gjithmonë është përdorur për shantazh duke e sjellë një biznesmen për shantazh.

Lidhja në mes të E.S. dhe A.I. ishte ndryshe nga lidhja që ajo kishte me T.R. A.I. tha vet se ajo ishte shantazhuar dhe kishte presion nga E.S., ndërsa lidhja me T.R ishte normale dhe serioze. Gjatë arrestimit të E.S. në vitin 2006, oficerët e policisë i gjetën disa fotografi të një natyre delikate që ishin bërë gjatë marrëdhënies në mes të E.S. dhe A.I.. Ai i pa këto fotografi (2-3 fotografi) dhe ato ishin dorëzuar në Stacionin Policor të Ferizajit.

Ai kishte ndenjtur me A.I. dhe T.R.in në disa raste. A e njihte A.I. qysh kur ajo kishte filluar të këndonte. Ai nuk e di se pse A.I. tha/deklaroi ndryshe gjatë shqyrtimit gjyqësor para gjykatës. Për shembull ata ishin në Prizren bashkë me T.R.in dhe V.R. Rizën. Ata i blenë dy këlysh Sharri në Prizren. Ata ishin bashkë te parku në Ferizaj, “Natyral”, në afërsi të Prishtinës, Stagove dhe te shtëpia e T.R.it.

A.I. kishte kërcënime të vazhdueshme dhe ai i tha asaj se ajo mund ta thërriste atë në çdo kohë dhe ai do ta mbështeste për ta zbardhur krimin. Kjo bisedë u bë pasi që është vrarë T.R.i. Ai i kishte thënë asaj të shkonte te prokurori i cili po e ndiqte penalisht rastin, nëse policia nuk do të ndërmerre ndonjë masë. Ai nuk ishte i autorizuar të merrte deklarata në emër të A.I..

Njësia e tij është caktuar të merret me incidentin në Ferizaj në vitin 2006, me vendim të shefit të operacioneve, F.K.. Ai shkoi te vendi i incidenti si pjesëtar i njësisë së quajtur ROSU. E tërë ROSU ishte e angazhuar në këtë operacion. Komandanti ishte L.Q.. Ata fillimisht janë informuar

se ishin kërcënuar dy persona. Emrat e dy femrave të cilat shkuan në stacionin policor në Ferizaj dhe e raportuan rastin e kërcënimit ishin Muzi dhe A.A.. Ai dilte me ankuesen A.A. pas rastit të Ferizajit në vitin 2006. Operacioni në Ferizaj nuk ishte kurth për E.S.. S.Q. nuk ishte pjesëtar i njësisë, ai punonte në një njësi tjetër. Ai nuk di asgjë se çfarë S.Q. ka thënë në deklaratën e tij rreth rastit të Ferizajit. Ai ishte marrë në pyetje lidhur me S.Q.n nga hetuesit ndërkombëtar, por ai e mohon të ketë qasje në deklaratën e dhënë nga S.Q.. Hetuesit ndërkombëtar bënë pyetje lidhur me S.Q.n, por ai nuk e ka parë dhe nuk e ka lexuar deklaratën e S.Q.t. – Nuk kishte asnjë lidhje në mes të T.R. dhe rastit në Ferizaj. Ai nuk merrte pjesë në këtë operacion dhe as nuk ishte në stacion policor. Ai ka dëgjuar se një armë dhe disa fotografi janë gjetur në veturën e të dyshuarit; megjithatë, ai vet nuk ishte i përfshirë në këtë bastisje. Policia i gjeti këto fotografi në veturën e E.S. gjatë bastisjes. Ai i pa këto fotografi, por nuk i kujtohet se cili oficer i policisë ja ka treguar ato. Ai nuk i kishte kushtuar aq vëmendje fotografive; ai vetëm e pa fytyrën e A.I.. Komandanti i departamentit për krime të rënda, M.J. i kishte ato fotografi me vete. Ai nuk e di se sa fotografi ishin aty, dhe as nuk është i sigurt nëse i ka parë dy apo tri fotografi të A.I.. Ai nuk e kishte kontrolluar tërë albumin: ai vetëm i ka parë disa fotografi. Ai nuk ia kishte kurdisur E.S. duke ia vendosur një armë në veturë. Ai nuk kishte qasje në veturë, përveç personit i cili ishte i përfshirë në këtë rast.

Ai qëndron prapa intervistës që e ka dhënë te prokurori më 30 tetor 2007. Në deklaratën tij ai e përmendi se kishte folur me B.B.. Ndërsa po fliste me B.B., kjo kishte ndodhur në një kafé bar, një turmë e madhe ishte aty. Kur ai doli jashtë për ta thirrur policinë, B.B. e shfrytëzoi një hyrje tjetër dhe u largua. Pas kësaj ai e thirri atë në telefon dhe i përsëriti kërcënimet. Pastaj ai e raportoi rastin në stacion policor në Ferizaj. Për aq sa i kujtohet policia i ndërmori disa hapa por nuk e dinë saktësisht se çfarë hapash. B.B.n e njihnin në polici.

Ai nuk ishte në dijeni për faktin se T.R ishte suspenduar për një kohë nga detyra për shkak të dhunës së pretenduar të detyrës së policit dhe përdorimit të tepërt të dhunës.

E.S. ishte kryesues i grupit që merreshin me haraç, dhënie të huas me fajde dhe shantazh. Ai nuk e di se prej sa pjesëtarëve përbëhej grupi apo emrat e të gjithë pjesëtarëve të tij. Kishte shumë pjesëtarë, ata ishin nëpër tërë Kosovën. L., R., D. dhe vëllai i tij H., R., I. ishin dorë e djathtë e E.S..

Në marrje në pyetje indirekte, është kërkuar nga dëshmitari ta shpjegojë një bisedë të supozuar telefonike që e kishte pasur nga burgu me X.I., hallën e A.I. lidhur me dëshminë e të fundit para gjykatës. Dëshmitari refuzoi të komentojë⁷³.

69. Trupi gjykues e mori në konsideratë që ky dëshmitar së bashku me B.Be. ishin të akuzuar në një lëndë tjetër të ashtuquajtur shpërthimi Bill Clinton, për vendosjen e bombës në lokalin S. si një vepër hakmarrjeje për vdekjen e T.R., duke e vlerësuar kredibilitetin e tij. Duhet të nënvizohet se kjo vepër penale është subjekt i një hetimi tjetër në vazhdim dhe nuk ka efekt negativ në kredibilitetin e B.Be. dhe S.Q.t si dëshmitarë. Të dy dëshmitarët kanë dëshmuar rreth fakteve që i kanë marr vesh nga T.R dhe A.I., pra ata janë dëshmitarë të dorës së dytë. Dëshmitë e tyre në këtë rast nuk kanë ndikimin ne situatën procedurale të tyre në lëndën e shpërthimit në rrugën Bill Clinton.

S.Q.

70. Dëshmitari deklaroi se, sipas T.R., E.S. mendonte për vete si i paprekshëm nga policia. Urrejtja e tij ndaj T.R. u rrit kur A.I. u bë e dashura e T.R. dhe e pati kulmin në incidentin Swiss Casino. Në atë rast E.S., në parim është hakmarrë për shkak të A.I., jo sepse ai ishte ndaluar në komunikacion⁷⁴.

Para vrasjes së T.R. ndërsa po shoqërohej me të dhe L.Q.n, ata u morën vesh që A.I. të këndonte të kompania e quajtur X. e L.Z. në Ferizaj. Një kërcënim me bombë ishte bërë natën e parë kur A.I. filloi të përformonte atje dhe ajo e fajësoi S. për atë, duke thënë se ai po e shantazhonte, duke kërkuar para prej saj. Ajo e tha këtë në zyrën e menaxherit duke quajtur, në prani të T.R., L.Q. B. dhe dëshmitarit. Ajo pretendohet se e vërtetoi se S. nuk po e lejonte atë që të këndonte më, duke bërë alarme të rreme bombe, që bënë policinë të ndërhyjë, ta ndalojë muzikën dhe ta lirojë objektin. T.R.i e përmendi se ata e kishin raportuar rastin në polici por nuk u bë asgjë⁷⁵.

Trupi gjykues e mori në konsideratë që ky dëshmitar bashkë me, ishte akuzuar në një lëndë tjetër të ashtuquajtur shpërthimi në Bill Clinton, për montimin e bombës në barin S. në një akt të hakmarrjes për vdekjen e T.R., duke vlerësuar kredibilitetin e tij.

⁷³ Procesverabli i gjykimit 01 qershor 2015, faqet 7, 8

⁷⁴ Procesverabli i gjykimit 03 qershor 2015, faqe 7;

⁷⁵ Procesverbali i gjykimit 03 qershor 2015, faqe 8;

F.S.

71. F.S. ishte një dëshmitar i rëndësishëm i cili dha dëshmi për ekzistimin e grupit S..⁷⁶ F.S. ishte një nga të brendshmit i cili takohej me njerëzit e S.. Duhet vërejtur se gjatë dhënies së dëshmisë ai ishte shumë nervoz dhe ishte shumë e dukshme se ai frikësohej nga i pandehuri. Dëshmitari është ballafaquar me dëshminë e tij të mëparshme të cilën e ka dhënë më 28.11.2007^{77 78} dhe të cilën e ai e vërtetoi si korrekte. Në këtë dëshmi ai thotë se në vitin 2003, ai është futur me dhunë në veturë nga A.By. dhe pastaj është dërguar në një shtëpi në Vranjevc dhe ishte rrahur me një shkop bejsbolli dhe i ishte thënë “që të shkruaj çfarëdo që dinë për E.S..” F.S. pastaj është arrestuar nga oficerët e PK-së dhe më pas është intervistuar si i dyshuar para gjyqtarit të cilin F.S. e njihte si bashkëpunëtor të S. (“jam intervistuar nga një gjyqtare femër e cila është shoqe e A. dhe djali i saj është gjithashtu shok i mirë i S.Se. dhe i të gjithë pjesëtarëve të Grupit S...që nga ai rast, e kam humbur besimin në gjykatë dhe në polici”). Ai e vërtetoi në dëshminë e tij se kjo pjesë e asaj deklarate ishte e vërtetë. Kjo dëshmi është shumë e rëndësishme pasi që tregon se sa i gjerë ishte ndikimi i E.S. dhe grupit të tij në mes të agjencive të sundimit të ligjit për të siguruar që ai asnjëherë mos të ndiqet penalisht dhe se ai mund të vazhdoj të veproj duke mos u ndëshkuar. Kjo gjithashtu tregon se E.S. ka përdorur dhunë të tepërt dhe frikësim, duke komanduar pionët si A.By.n për të zbatuar dëshirën e tij, sikurse A.B. do bënte kur ishte rasti i ekzekutimit të T.R.. Asgjë nuk ndodhi pa dhënien e urdhrin të të pandehurit; ata i frikësoheshin dhe ishin plotësisht të varur nga ai për statusin e tyre dhe pasurinë. Gjatë dëshmisë së tij, F.S. provoi ta përshkruaj të pandehurin në një këndvështrim pozitiv, si hero lokal të Vranjevc. F.S. ka bërë një numër të pranimeve shumë domethënëse që ky trup gjykues i konsideroi si të rëndësishme. Ai tha se A.B. “gjatë gjithë kohës takohej me L..” Ai tutje tha “..A.B. nuk ishte person i rëndësishëm në Vranjevc, e kam parë disa herë në shoqëri me L. dhe gjithashtu ndonjëherë edhe me E.S.in. E kam parë njëherë me E.S.in...E kam parë në atë kafene që ai vinte dhe rrinte. Ai njihej si njeriu i L. (f. 11)⁷⁹” Ai është ballafaquar me deklaratën që e ka dhënë para prokurorit më 30.10.2007⁸⁰ dhe e konfirmoi se ishte e saktë dhe e dhënë me vullnet të

⁷⁶ Procesverbali i gjykimit , 19-20.11.2015

⁷⁷ Regjistratori VII f171-172

⁷⁹ Procesverbali i gjykimit, p.131, 19.11.2015

⁸⁰ Regjistratori VII, pp.152-156

lirë (f. 15). Në atë deklaratë, ai tha “e njoh të pandehurin A.B., e kam parë në kafenenë S., ku e kam parë në shoqëri me E.S.in, N.S., I.A.n, me të cilët është shoqëruar non-stop....Ai [A.B.] vazhdimisht ishte në kafenenë S. por nuk e di nëse ka punuar atje.” Në mënyrë domethënëse, në dëshminë para kësaj gjykate kur është pyetur rreth problemeve që T.R i kishte me të pandehurin, ai tha se T.R, përveç me të pandehurin, “ai gjithashtu kishte probleme edhe me A.Seks.n, ai kishte probleme edhe me N.S.. I tërë Vranjevci erdhi në qytet dhe bëri probleme, prandaj ai ishte oficeri i policisë i cili në fakt po e kundërshtonte këtë grup”⁸¹ (f. 17-18). Kur është pyetur nëse ky grup kishte udhëheqës, ai u përgjigj, “nuk mund të them se kishte një udhëheqës *por një idhull, E.S.*” (f. 18). Më vonë ai tha “T.R.i është munduar të mbaj rregull në Vranjevc” (p. 22). Në vazhdim, ai tha ”Vranjevci është komplet, Vranjevci dhe grupi S. janë këta: L., R., pesë apo gjashtë persona të afërt” (f. 24). Kur i është kërkuar të identifikojë të gjithë pjesëtarët e grupit ai u përgjigj “N.S.i, N., K., F., ata njiheshin në qytet, që ishin në Prishtinë, që ishin personat më të besueshëm për të, për E.S..” Në përgjigje të pyetjes së kryetarit të trupit gjykuese “.a ishin këta pesë apo gjashtë persona, i ashtuquajtur grupi S.?” F.S. u përgjigj, “po, ata të cilët ishin më të besueshmit për të.” Kur është pyetur nëse A.B. ishte gjithashtu pjesëtar i grupit, siç kishte thënë në deklaratën e datës 10.09.2007⁸², ai deklaroi “A.B. ishte gjithmonë me L.” (p. 24). Ai vazhdoi dhe kur iu përmend se në këtë deklaratë, ai ka thënë se A.B. ishte identifikuar si pjesëtar i grupit S., ai u përgjigj “ajo çfarë deklarova këtu është e saktë.” Ai tutje deklaroi kur u përballë me deklaratën e tij me shkrim se pas vrasjes, atij i ishte thënë nga A.I. që ajo i kishte thënë atij “ma vranë burrin...Ajo pretendohet se po i referohej T.R.it (f.25-26).” Kur është pyetur se a ishte dikush mbi E.S., ai u përgjigj “nuk besoj. Nuk ishte askush mbi E.S. (f. 27-28).” Kur është pyetur nëse A.B. kishte transportuar kafe për E.S. duke përdorur kamionçinën e kuqe B. Café, ai tha “ndoshta e ka vozitur veturën, ai ka mundur ta voziste veturën por ai nuk ishte punëtor i tij... shumë rrallë, e kam parë, një herë ose dy [që merrej me kafe]” (f. 32). Ai tha se i pandehuri i kishte ndihmuar një numri të njerëzve me ndërtimin e shtëpive të tyre përfshirë L. dhe R.. Atij iu përmend se në gjykimin e mëparshëm të A.B. ai kishte thënë “E.S. po i ndihmonte të gjithëve dhe mendoj që ai po i ndihmonte edhe A.B..⁸³” Në vazhdim atij iu përmend ajo çfarë kishte thënë gjatë gjykimin të mëparshëm dhe e pranoi se ishte e vërtetë se A.I. i kishte thënë atij se kur i janë shfryrë gomat dhe kur i ishte gërvishtur vetura “ajo kishte dyshuar se ishte rrethi i E.S.it.”

⁸¹ Procesverbali i gjykimin, 19.11.2015

⁸² Regjistratori VII, f. 139-151

⁸³ Regjistratori XIV,f.74

Ai gjithashtu ka thënë në gjykimin e mëparshëm nën betim, “të gjithë pjesëtarët e grupit S., emrin që e përmenda më herët kanë pasur urrejtje ndaj T.R.. Të gjithë personat që ishin ulur me E.S. janë pjesëtarë të grupit të tij sipas meje, mund të jetë edhe A.B.. Në secilin rast të hyrjes në restorantin S., grupi gjithmonë ka folur rreth urrejtjes ndaj T.R.it.” Në dëshminë e tij, ai tha “A.I. thoshte se [T.R.] ishte vlarë nga djemtë e Vranjevcit dhe E.S.i e kishte vlarë atë të saj.”

Deklaratat e këtij dëshmitari janë të rëndësishme kyçe pasi ato i ndihmuan trupit gjykues të vërtetojë se kush e kishte krijuar grupin S., që A.B. ishte pjesë e grupit, që të gjithë pjesëtarët e Grupit S. e urrenin T.R, që T.R.i kishte pasur një numër të shumtë të konflikteve me grupin, dhe që A.I. ishte ankuar te F.S. rreth asaj që po ndodhte dhe për ngacmimet e vazhdueshme nga grupi. F.S. gjithashtu e kishte thënë para atij trupi gjykues se ai ishte i frikësuar të përgjigjej në pyetjet për shkak të grupit të E.S.. Qëndrimi i këtij dëshmitari është mjaft i kuptueshëm, por duhet të nënvizoj se F.S. e vërtetoi atë që e kishte referuar më parë në hetime dhe në gjykime tjera.

Linja e mbrojtjes e paraqitur nga i pandehuri që përshkruan F.S.n si dikush që ishte i distancuar nga ai nuk mund të konsiderohet si e besueshme. Në mes të provave materiale, është një provë fotografike (p. m # 6, figura 0121), ku mund të shihen të dytë bashkë. Nuk i ka ikur vëmendjes së këtij trupi gjykues se në fakt F.S. është munduar ta ndihmojë të pandehurin duke e paralajmëruar ta ndryshoj numrin e tij të telefonit, kur E.S. ishte në arrati. Konkluzioni i vetëm logjik që mund të nxirret nga e gjithë kjo është se F.S. e njihte të pandehurin dhe përshkrimi i tij i grupit është i besueshëm.

35. Përkundër faktit se një numër i dëshmitarëve vetëm pjesërisht dëshmoi në përputhje me deklaratat e tyre të mëparshme të detajuara dhe konsistente, nga dëshmitë e tjera të paraqitura, është kryesisht rasti që E.S. ishte udhëheqës i një grupi të dhunshëm dhe të paligjshëm të individëve të cilët i kanë veçuar T.R dhe A.I., si pjesë e një fushate të egër dhe të qëndrueshme të ngacmimit dhe frikësimit. Megjithatë, gjykata jo vetëm që i ka dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur por, edhe një numër të madh të provave tjera, shumë prej tyre teknike, që qartë e dëshmojnë pa asnjë dyshim se i pandehuri e ka orkestruar fushatën e tij të urrejtjes dhe që përfundimisht e urdhëroi dhe e nxiti vrasjen e T.R. nga njëri prej djemve të tij të besueshëm, A.B., një njeri vështirë i njohur nga policia apo T.R.

Ankesat në polici

Gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit paraqiti një numër të kallëzimeve penale të hapura në policinë e Kosovës para vrasjes së T.R.. Këto ankesa zyrtare janë prova goditëse se dëshmia fillestare e A.I. gjatë procedurës paraprake nuk është asgjë tjetër përveç se e vërteta.

Ishte një ankesë e bërë më 21.02.2005, nga B.Nr., pastruese e A.I., e cila raportoi se asaj i është afruar M.Dr., i cili e kërcënoi duke i thënë “a e di se kush jam unë, unë jam S. dhe të rrah, a e di se çfarë lidhje kam me E.S.”⁸⁴ Vet A.I. e ka bërë një ankesë të nënshkruar ku ka thënë se ajo po përcillej nga ky personi i njëjtë (i cili kishte thënë se kishte lidhje me të pandehurin) të cilin ajo e raportoi, priti jashtë banesës së saj, pastaj e bëri një telefonatë dhe pas disa minutave, A.I. e pa se po përcillej nga një veturë dhe se kjo po ndodhte për 8-9 muaj⁸⁵.

Ishte gjithashtu një ankesë në detaje që A.I. e kishte bërë më 02.05.2005 duke përmendur E.S. si agresor⁸⁶. Ajo e raportoi këtë pasi ajo kur po kthehej në banesë pas mesnate dhe po shkonte mbrapa me qëllim që të parkohej, një xhip me targa XXX-KS-XXX, erdhi te ajo [shënim: kjo ishte e njëjta veturë xhip Cherokee e gjelbër e gjetur jashtë kafenesë S., pas vrasjes dhe e cila shfaqet në disa nga fotografit e nxjerra nga kamera Samsung si prova 6)]. Xhipi voziti drejt saj dhe ajo u detyrua të largohej para se ai ta godiste pjesën e përparme të veturës së saj; ajo vazhdoi të largohej. Ajo e raportoi këtë, se ajo e njihte që E.S. ishte vozitëse dhe se ai bëri gjeste të rrezikshme me duart e tij që nënkuptonte se do t’ia priste kokën asaj. Kjo e bëri atë të ikte. Këto ankesa ishin prova shumë të forta që i pandehuri personalisht po drejtonte një fushatë të urrejtjes së lig ndaj A.I..

Ishte incidenti tjetër në ora 15:30, më 12.05.2005, kur E.I. dhe M.I. ishin në Dardani, ku ato u kërcënuan dhe u fyen nga S.Se.⁸⁷. Në vazhdim, më 22.06.2005, A.I. e bëri një ankesë në polici se ajo ishte kërcënuar nga tre persona ndërsa ishte në rrugë, te Princi i Arberit. Ajo kishte raportuar se ‘ata ishin në grupin e E.S.’⁸⁸.

Trupi gjykues nuk sheh asnjë arsye tjetër që këto ankesa të trajtohen; A.I. ishte thjesht e frikësuar nga S. dhe grupi i tij.

⁸⁴ Regjistratori VII, f.143A-143

⁸⁵ Regjistratori VII, f. 144a-153

⁸⁶ Regjistratori VII, f. 154-157

⁸⁷ Regjistratori VII, f. 159a-159

⁸⁸ Regjistratori VII f. 221A-221

Rastet e përmendura më sipër as nuk janë dhe as të izoluar. Rastet në vijim janë gjetur në të dhënat e Policisë së Kosovës, lidhur me ankesat e formuluar nga A.I.:

a) Rasti 2005 TA3 0935 – Zjarrvënie

Më 21.06.2005 në ora 01:00, përgjatë rrugës Sali Mani në Prishtinë, a VW 3, me targa të regjistrimit XXX KS XXX, pronë e H.I., dajës së A.I., është djegur nga sulmues të paidentifikuar. Një hetim është hapur nga Njësia Regjionale e PK-së në Prishtinë më 22.06.2005, dhe një kallëzim penal është bërë kundër personave të panjohur dhe është referuar te prokurori komunal në Prishtinë më 07.10.2005. Është dyshuar se sulmi është kryer nga pjesëtarë të Grupit S. me qëllim që ta frikësojnë A.I.n për shkak të lidhjes së saj me T.R.

b) Rasti 2005 TA3 937 – Kërcënim

Më 22.06.2005, në ora 02:00, në rrugën Asllan Pireva, në afërsi të Hotelit Princi i Arbrit në Prishtinë, A.I. ka raportuar se ajo ishte kërcënuar nga tre kryerës të panjohur të dyshuar që ishin bashkëpunëtorë të Grupit S.. Në konsultime me prokurorin komunal në Prishtinë, rasti është mbyllur për shkak të mungesës së provave. Është dyshuar se ky akt është bërë nga pjesëtarë të Grupit S. për hakmarrje ndaj A.I. ilit, për shkak të lidhjes së saj me T.R.

c) Rasti 2005 AD 1416 – Mosbindje ndaj urdhrave të policisë, sulm ndaj personave zyrtarë

Më 12.05.2005, në ora 15:30, në rrugën “28 nëntori” në Prishtinë, ndërsa oficerët e policisë ishin në pikën e kontrollit, një veturë Peugeot, me tabela të regjistrimit XXX KS XXX, nuk ndaloi tek pika e kontrollit të policisë. Policia e ndoqi veturën dhe arriti që ta ndalojë. Ata e identifikuan E.S. si vozitës, i cili ishte i shoqëruar nga R.A.. Ata i kërcënuan oficerët e policisë të cilët i ndaluan. E.S. i kontaktoi me telefon të dyshuarit e tjerë dhe për një kohë të shkurtër, N.Se., S.Se. dhe I.A. erdhën në vendin e ngjarjes dhe i kërcënuan dhe i penguan oficerët e policisë. Të gjithë të dyshuarit, E.S., I.A., R.A., N.Se. dhe S.Se. janë mbajtur për shkak të pengimit të oficerëve të policisë ndërsa ishin duke e kryer detyrën zyrtare dhe i kërcënuan. Rasti është referuar tek prokurori komunal më 13.05.2005 dhe iu bashkua rasteve tjera që kanë të bëjnë me kërcënimet ndaj familjes I..

d) 2005 AD 447 – Kërcënim

Më 21.02.2005, rreth orës 15:30, në lagjen Dardania, një incident është raportuar, ku viktimja B.Nd., e punësuar për punë të shtëpisë në banesën e A.I.t, ishte kërcënuar nga i dyshuari i quajtur M.Dr., i lindur më 05.05.1886, i cili supozohet se tha “pse po mi ngul sytë, a nuk e dinë se unë jam një nga ata të S., do të rrah, a e di që E.S. është kushëri i imi”. Ankuesja A.I. tha se i dyshuari M.Dr. e kishte përcjellë, duke vëzhguar se kur ajo po hynte ose po dilte nga banesa e saj dhe secilën lëvizje të saj. I njëjti ka raportuar për të gjitha lëvizjet e saj tek një person i padëklaruar përmes telefonit. PK-ja dyshoi se i dyshuari ishte urdhëruar që ta ndiqte A.I., nga E.S., për shkak të lidhjes së saj të fundit me T.R.

e) 2005 AD 1281 – Kërcënim

Më 02.05.2005, rreth orës 00:15, në lagjen Dardania, afër "Fellini" në Prishtinë, A.I. ishte kërcënuar ndërsa ajo po kthehej në banesën e saj. Pas hyrjes në hapësirën e parkingut, ajo e pa një veturë xhip me tabela të regjistrimit XXX KS XXX, e cila e kishte bllokuar hyrjen për në hapësirën e parkingut. Kur është ndezur ndrita në veturën e dyshuar, viktimja e ka njohur E.S.. Pasi ajo shkante mbrapa me veturë, xhipi lëvizi shpejt drejt saj dhe e bllokoi veturën e viktimës nga para. Xhipi eventualisht erdhi paralelisht me veturën e saj, dhe ndërsa kaloi, ajo e pa E.S. që bënte gjeste me dorë kah ajo, që në përgjithësi nënkuptojnë: “do ta pres fytyrën”.

Në vazhdim I.A., R.A., N.Se. dhe S.Se. janë regjistruar si të dyshuar në këtë rast, së bashku me E.S..

Lënda i është referuar prokurorit komunal më 13.05.2005, së bashku me dy raste tjera të Sulmit ndaj një Oficeri të Policisë dhe Kërcënim ndaj motrës së A.I., E.I.t dhe nënës së tyre, M.I.. Policia e Kosovës konstatoi se i dyshuari kryesor E.S. ishte i motivuar nga hakmarrja dhe fyerja dhe ndaj A.I. dhe dëshironte ta frikësonte atë për shkak se ajo kishte filluar një lidhje me oficerin e policisë, T.R. Një përmbledhje e shkurtër dhe analizë e rasteve penale të regjistruara në Policinë e Kosovës siç përmenden më sipër janë dhënë në raportin e PK-së 2007-AD-02397 të datës 09.01.2008 dhe tutje në një raport 06/1-01-SA-023/2014⁸⁹ të datës 25.03.2014. Hetuesit e PK-së gjithashtu e intervistuan Tog. B.By., i cili ishte përgjegjës për njësinë e PK-së në të cilën

⁸⁹ F,1-222, fashik. 1.1-1.11 , regjistratori VI

ishite i caktuar T.R. T.R kishte kërkuar nga zëvendësi i Komisionarit të Policisë për rritje të personelit të sigurisë, pra një armë M5 dhe një veturë të blinduar, pasi frikësohej për jetën e tij për shkak të E.S.. Dhe në vend të kësaj T.R. i është ofruar mbrojtje e afërt, gjë që ai e refuzoi duke thënë se ai ishte pjesëtar i atij ekipi që merrej me detyra të tilla.

Përkundër faktit se një numër i dëshmitarëve vetëm pjesërisht dëshmoi në përputhje me deklaratat e tyre të mëparshme të detajuara dhe konsistente, nga dëshmitë e tjera të paraqitura është kryesisht fakti se E.S. ishte udhëheqës i një grupi të dhunshëm dhe të paligjshëm të individëve të cilët i kanë veçuar T.R dhe A.I., si pjesë e një fushate të egër dhe të qëndrueshme të ngacmimit dhe frikësimit. Megjithatë, gjykata jo vetëm që i ka dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur por, edhe një numër të madh të provave tjera, shumë prej tyre teknike, që qartë e dëshmojnë pa asnjë dyshim se i pandehuri e ka orkestruar fushatën e tij të urrejtjes dhe që përfundimisht e urdhëroi dhe e nxiti vrasjen e T.R. nga njëri prej djemve të tij të besueshëm, A.B., një njeri vështirë i njohur nga policia apo T.R.

Provat materiale të sekuestruara në kafenenë S.

Pranueshmëria e provave.

Menjëherë pas vrasjes së T.R., Policia e Kosovës ndërmori një numër të kontrolleve të objekteve të dyshuara që janë të ndërlidhura me kryerësit.

Në ora 19:15, më 30.08.2007, Policia e Kosovës hyri dhe kontrollloi lokalin e njohur si Café Bar ‘S.’ që ndodhet në bulevardin Bill Klinton, në Prishtinë⁹⁰. Përveç sendeve të sekuestruara ishin tridhjetë e shtatë kompakt disqe, dy kasete të video kamerës, një aparat digjital, pesëdhjetë e pesë fotografi, dy jelek anti-plumb, një kompjuter PC, një kamerë dhe gjashtë telefona mobil të markës NOKIA. Në atë rast, PK-ja i arrestoi në atë objekt, N.S. (vëllai i të pandehurit), S.Ga. dhe tani të dënuarin F.A.. Raporti i kontrollit është përpiluar gjithashtu nga hetuesi i PK-së, B.G.⁹¹. Mes sendeve të gjetura ishte një numër i CD-ve të cilat janë të rëndësishme për prova në këtë lëndë, pasi ato tregojnë se A.B. ishte një vartës i të pandehurit dhe e dyta se i pandehuri kishte një interesim të fortë në përcjelljen e lëvizjeve të T.R..

⁹⁰ Faqet 112-124, fashik. 8 regjistratori I, f. 182-184, regjistratori I

⁹¹ F. 5-13, fashik. 4 regjistratori II

Mbrojtja nxori një argument se të gjitha provat e grumbulluara gjatë kontrollit të lokalit Bar S., duhet të hidhen poshtë dhe provat të konsiderohen si të papranueshme pasi kontrolli është kryer pa urdhër verbal nga gjyqtari i procedurës paraprake në këtë lëndë.

Dispozitat relevante të Kushtetutës së Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

Dispozita përkatëse e Kushtetutës së Kosovës, thotë si në vijim:

Neni 36, E drejta e privatësisë

1. [...]
2. *Kontrollet e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimin, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.*

Dispozitat zbatuese të KPPK-së që rregullojnë kontrollin dhe sekuestrimin janë të përcaktuara në kapitullin XXVIII: VEPRIMET HETIMORE, Seksioni 5. Kontrolli dhe konfiskimi i përkohshëm, nenet 240-253.

Analiza

Duke marrë parasysh bazën ligjore për kontroll, KPPK parasheh dy baza ligjore:

a) Neni 201

Dispozitat e nenit 201 (1) dhe (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të cilat përcaktojnë në pjesë përkatëse, si më poshtë:

(1) Kur ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës, policia detyrohet qoftë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit publik, të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose

ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të gjejë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.

(2) Për të kryer detyrat nga paragrafi 1 i këtij neni policia ka autorizim: ...

6) Të kontrollojë në praninë e personit përgjegjës objektet e veçanta dhe lokalet e organeve publike dhe të shqyrtojë dokumentet e veçanta që u përkasin atyre;

7) Të konfiskojë sendet të cilat duhet të merren sipas Kodit të Përkohshëm Penal, ose që mund të shërbejnë si prova në procedurë penale

Duhet të thuhet se neni 201 është i pavarur, dhe nuk është i modifikuar apo i kufizuar nga dispozita e nenit 240 dhe në vijim. Me fjalë tjera, policia ka autoritetin për të kontrolluar lokalet dhe sekuestruar sende pavarësisht nga dispozitat e veçanta që rregullojnë kontrollin dhe sekuestrimin, por në rrethana të caktuara. Duhet të theksohet se paragrafi 6 i referohet objekteve dhe lokaleve të organeve publike. Kafeneja S. ishte një lokal komercial privat, dhe jo organ publik, kështu që në bazë të kushteve të saj, nuk zbatohet paragrafi 6. Fakti që kafeneja ka ofruar shërbime publike duke shërbyer kafe dhe pije tjera për klientët nuk nënkupton se të gjithë kishin të drejtë për qasje të lirë dhe të pakufizuar; dhe nuk e ka ndryshuar subjektin e vet juridik nga privat në institucion publik.

b) Neni 245,

Dikush mund të paraqet një argument të bazuar në nenin 245, i cili përcakton përjashtimet e kushteve për një urdhër të kontrollit:

(1) Kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:

1) Personi përkatës me dije dhe me vullnet pajtohet me kontrollin;

2) Personi thërret për ndihmë;

3) Kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes;

4) Arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë ose

5) Personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera..

Dispozitat e vetme të nenit 245 (1) të cilat mund të justifikojnë një kontroll pa urdhër për kontroll në këtë rast janë nën-paragrafët 1 (pëlqimi), 3 (kryerësi i kapur në flagrancë), dhe 4 (siguria e njerëzve).

Megjithatë nuk ka asnjë pretendim praktik se kjo ishte një kontroll me pëlqim. Ka prova se pjesëtarët e grupit S. ishin të pranishëm në kafene, por rrethanat mohojnë ndonjë kërkesë për pëlqim.

As nuk ka një pretendim të qëndrueshme që ka pasur një kryerës të kapur në flagrancë i cili duhej arrestuar pas ndjekjes. Ndërkohë që policia mund të ketë dyshuar apo shpresuar se ata mund të kapin dikë në kafene, ky nuk ishte rasti, si dhe në asnjë rast nuk pati ndjekje. Ekziston pretendimi se E.S. ka mundur të ketë ikur nga kafeneja në një moment dhe të mos pres për policinë që të vijë dhe ta arrestojë atë në vend.

Pretendimi më i arsyeshëm është se kontrolli është kryer për shkak të shqetësimit për sigurinë e personave. Faktet relevante tregojnë se kryerësit e këtij krimi ishin të armatosur dhe po shkaktonin kërcënim ndaj sigurisë së klientëve të kafenesë S., të cilët mund të kenë qenë apo jo në dijeni se policia është në kërkim të vrasësve të T.R.. Kjo ishte mundësi e rëndësishme që vrasësit e armatosur mund të jenë në kafenenë S. që kërkuan veprimin e menjëhershëm të policisë.

Siç u përmend më lart, neni 245, paragrafi (1), nën-paragrafi 4, i lejon policisë të hyjë në objekte pa një urdhër gjyqësor të çfarëdo lloji “kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme” nëse “arsyet për mbrojtjen e njerëzve...e kërkojnë.”

Megjithatë, paragrafi 3 i të njëjtit nen 245 trajton një situatë të ngjashme:

Përfundimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, policia gjyqësore mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Neni 245 (1), paragrafi 4, dhe neni 245 (3) e trajtojnë praktikisht të njëjtin shqetësim: sigurinë e njerëzve, dhe rrezikun ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve. Njëri i lejon hyrjen pa një urdhër;

tjetri kërkon një urdhër verbal. Prandaj, është e nevojshme të provohet bashkërendimi i këtyre dispozitave.

Paragrafi 1 i nenit 245 duhet të interpretohet për t'i trajtuar situatat unike që po ndodhin në moment-përveç shqetësimeve të sigurisë; ai gjithashtu përfshinë thirrjet për ndihmë, ndjekje të shpejt, dhe nevojën për të hyrë për të bërë arrestim. Me fjalë tjera, situata që kërkojnë veprime të menjëhershme. Këto situata duhet të jenë në kontrast me situata të mundshme të sigurisë që nuk kërkojnë intervenime të menjëhershme. Me fjalë tjera, mund të ketë shkallë të ndryshme të urgjencës që përfshijnë dispozita të ndryshme të 245. E gjitha varet prej fakteve të rasteve të veçanta.

Situata bie në kategorinë e dytë--neni 245 (3). Vetë policia nuk e ka parë nevojën për të hyrë menjëherë në kafenenë S., dhe ndërmoi disa hapa para ndërhyrjes aktuale. Në fakt policia dyshoi se E.S. mund të jetë një vrasës i mundshëm pasi ai ishte në konflikt me T.R, një fakt për të cilin policia ishte në dijeni. Aksioni i policisë është organizuar dhe prokurori O.M. ishte i pranishëm, i cili ishte kryesues i hetimit në këtë rast.

Duke pasur parasysh këtë rrjedhë të ngjarjeve, është e qartë se këto nuk ishin rrethana që do të shmangnin kërkesat e marrjes së lejes gojore nga gjyqtari i procedurës paraprake. Trupi gjykues vëren se situata u shpалos gjatë disa orëve gjatë ditës së punës kështu që nuk duhet të ketë qenë asnjë shqetësim për të qenë në gjendje për të gjetur një gjyqtar. Në fakt, prokurorët ishin në të njëjtën ndërtesë, dhe përveç kësaj ata ishin në dijeni rreth numrave të telefonit të gjyqtarëve kujdestar. Kështu, është konkluzion i trupit gjykues se nuk ekziston asnjë arsye legjitime për mos marrjen e të paktit një urdhri gojor për kontroll nga një gjyqtar. Ky trup gjykues vendosi, ex officio, të marrë në pyetje dëshmitarë shtesë në mënyrë që të vendos nëse sistemi i kujdestarisë ishte në fuqi më 30 gusht 2007.

Dëshmitari F.B. më 18 dhe 19.08.2015 (regjistratori E fashik. D dhe E), në atë kohë administrator i gjykatës e konfirmoi se sistemi i kujdestarisë ishte në fuqi në gusht 2007, dhe në detaje ai e përshkroi se si ishte i organizuar. Ky dëshmitar e konfirmoi se gjyqtarja D.H. ishte kujdestare në atë ditë kritike. Dëshmia e dëshmitarit F.B., administrator i gjykatës është konsideruar si plotësisht e besueshme pasi ai i ndërliđhi faktet në detaje dhe si punëtor publik që

mban pozitë të rëndësishme për shumë vite ai gëzon reputacion të mirë si shërbyes i përkushtuar dhe profesional i sistemit gjyqësor.

Dëshmia e tij është e vërtetuar me deklaratën e ish gjyqtares D.H.. (Dëshmia e datës 17.08 2015 regjistratori E, fashik. C). D.H. konfirmoi se ishte gjyqtare e procedurës paraprake më 30 gusht 2007. Për sa i përket kujtimit të fakteve, kjo dëshmitare shpjegoi lidhur me kërkesën për lejen gojore:” Jo, nuk më kujtohet. Nuk mund të them diçka që nuk më kujtohet. Shtatë vite kanë kaluar qysh atëherë.” Kur kjo dëshmitare është përballur me aktvendimin për mbajtje në paraburgim në këtë lëndë, e vetmja gjë që mund ta konfirmonte ishte nënshkrimi i saj.

Sipas mendimit të trupit gjykues, kjo është normale që kujtesa e njeriut është e shkurtër dhe ne jemi të prirë të mbajmë mend më shumë, menjëherë pas ngjarjes se sa pas një periudhe të caktuar kohore. Trupi gjykues nuk ishte i habitur me një deklaratë të tillë por nuk do të thotë se D.H. nuk e ka dhënë lejen gojore për kontroll të objektit në fjalë. Lëshimi i urdhrave gojor nuk ishte koncept ligjor i prezantuar rishtazi në kornizën ligjore dhe si gjyqtarët, prokurorët dhe policia ishin në dijeni për një mundësi të tillë. Në situatën në vijim, nuk ka arsye të përjashtohet se gjyqtarja e procedurës paraprake në atë kohë D.H., në fakt lëshoi një urdhër të tillë gojor duke lejuar policinë të vazhdojë në ndjekjen e provave. Duhet të theksohet se D.H. asnjëherë në dëshminë e saj nuk e mohoi se urdhri i tillë gojor është lëshuar përmes telefonit. Në krye të kësaj, dëshmitari F.G., një oficer i policisë i marrë në pyetje më 20 korrik 2015 (regjistratori D, fashik. G) tha: “ ne vazhdimisht u përpoqëm ta kontaktojmë gjyqtarin e procedurës paraprake për të marrë urdhrin gojor, për të ndërmarrë veprimet e mëtejme... dhe unë e thirra togerin F.G., i cili është mbikëqyrësi im për ta kontaktuar gjyqtarin e procedurës paraprake dhe për të marrë urdhrin gojor. ... E mora një njoftim nga togeri se është pranuar urdhri gojor përkatësisht njoftimi i gjyqtares së procedurës paraprake, e quajtur D.H.”. I marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, L.M., drejtor për hetime të krimeve të rënda, dëshmoi (më 20 korrik 2015, regjistratori D, fashik. G): në këtë rast unë e kontraktova gjyqtaren ... ia kërkova asaj urdhrin gojor për të kryer kontrollin, ajo e miratoi atë“. Deklaratat e këtyre dëshmitarëve, F.G., L.M., ky trup gjykues i konsideroi si plotësisht të besueshme pasi që deklaratat e tyre janë gjithëpërfshirëse, të detajuara dhe të sakta. Këta oficerë të policisë ishin në dijeni se nevojitet një urdhër gojor për të kryer kontroll ligjor. Fakti se dëshmitares D.H. nuk iu kujtua që e ka dhënë një urdhër të tillë, nuk i bënë deklarata e tyre kontradiktore dhe kështu jo të besueshme.

Trupi gjykues është gjithashtu i mendimit se situata në kafene bie direkt nën fushëveprimin e nenit 243 (2), i cili thotë:

Gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur si dëshmitarë. Para fillimit të kontrollit, dëshmitarët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë, për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit para se të nënshkruhet.

Siç u përmend më lart, është e qartë se dy persona ishin të pranishëm si dëshmitarë të kontrollit, përkatësisht S.L. dhe F.Gu.. Të dy janë marrë në pyetje, S.L. më 20.07.2015 regjistratori D , fashik. H dhe F.Gu. më 21.07.2015, regjistratori D, fashik. G. Këto deklarata të këtyre dy dëshmitarëve nuk sollën asnjë përparim në mbështetje të teorisë së Mbrojtjes që sugjerojnë se provat materiale të sekuestruara në kafene janë montuar nga policia.

Provat e sekuestruara gjatë bastisjes do të shpalleshin si të papranueshme sipas nenit 246, KPPK-së, i cili thotë:

Provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse

1) Kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;

5) Personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit (neni 243, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi).

Ekziston gjithashtu një kërkesë nën nenin 245, paragrafi 6, për paraqitjen e një raporti për kontroll nëse kontrolli është kryer pa urdhër me shkrim:

Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor ajo brenda aftit prej dymbëdhjetë orësh lidhur me këtë i dërgon raport prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar i procedurës paraprake.

Duket se asnjë raport nuk është dërguar tek prokurori publik dhe as te gjyqtarja e procedurës paraprake që plotëson kërkesat e 243 (7). **Megjithatë, mungesa e një raporti të kontrollit nuk është bazë për papranueshmëri sipas nenit 246 të KPPK-së.**

Ky trup gjykues mori gjithashtu parasysh kundërshtimet e ngritura nga mbrojtja lidhur me kohën se kur filloi kontrolli, 19:15 dhe përfundoi 19:45, sipas ekipit të oficerëve të policisë (regjistratori I , f. 112-123) ndërsa koha e treguar nga ekipi i forenzikës është 18:50 si pikë e fillimit të aktiviteteve të tyre. Ky ndryshim mund të shpjegohet në një mënyrë të thjeshtë, përkatësisht ekipi i forenzikës erdhi më herët në ora 18:50 dhe thjesht priti derisa u krye kontrolli. Trupi gjykues është i mendimit të qëndrueshëm se dallimi në kohë nuk mund të rezultojë në papranueshmërinë e provave.

Provat materiale të sekuestruara nga kafeneja S.

Shumë prova materiale të nxjerra në mënyrë të ligjshme nga kafeneja S. janë të një rëndësie të skajshme provuese. Këto prova, e dëmtuan vijën e mbrojtjes të këtij të pandehuri që bazohet në mohimin e përgjegjësisë për vrasjen. Mbrojtja u përpoq mjaft për ta dëshmuar se E.S. nuk e ka njohur dhe nuk e ka punësuar A.B., i cili vendosi ta vrasë T.R për arsyet e njohura vetëm nga ai, dhe se E.S. nuk ishte fare në dijeni rreth planeve të Berishës.

Disa prova materiale të mbledhura gjatë kontrollit e zbulojnë të pandehurin në veçanti kur bëhet fjalë për kontaktin e tij me A.B., një marrëdhënie të cilën i pandehuri gjithmonë e përshkroi si jo-ekzistuese. Provat zbuluan se linja e mbrojtjes nuk ishte e besueshme.

Prova materiale # 1 përbëhet nga një numër i CD-ve, disa nga të cilat janë konstatuar si relevante. P.m # 1.1 është një CD e cila është e ndarë në shtatëmbëdhjetë klipe. Ato tregojnë se i pandehuri i kishte marrë video incizimet e sigurimit nga Swiss Casino. Mbrojtja natyrisht që u përpoq të argumentojë se kjo ishte edhe një kurdisje tjetër e policisë që tregon se pamjet janë sekuestruar nga policia dhe ishin ata që i kishin ato, dhe ishin ata që pastaj i kishin montuar në kafene. Disa nga pamjet e kamerave të sigurimit nga prova materiale # 1.1 është përfshirja e drejtpërdrejt e Swiss Casino, por pjesët tjera përbëhen nga incizime të marra me gjasë me telefon celular nga incizimet e kamerave të sigurimit dhe kanë orë dhe datë pas incidentit. Në një klip (‘Lila’), T.R shihet duke hyrë në Swiss Casino; në incizimin e telefonit celular, duket një dorë kah ekrani dhe e tregon atë. Ai qartazi po përcillej dhe ishte në shënjestër. Në një klip tjetër (‘policia’), T.R është i incizuar përsëri. Madje ekziston edhe një klip i quajtur ‘T.R.’ që e incizon atë duke ecur shkallëve të Swiss Casino. Pretendimi i të pandehurit se ai asnjëherë nuk ishte i interesuar në T.R, është minuar nga kjo pamje, titulli i tij dhe fakti se është nxjerr nga kafeneja e

tij. Kjo është provë shtesë e mërisë së hidhur që i pandehuri e kishte ndaj T.R. pas dhunës në Swiss Casino, fakti se ai kishte mbajtur kopje të pamjeve dhe fakti se CD fokusohet në T.R.

P.m. # 1.7 është një CD e cila ka një numër të shumtë të fotografive që tregojnë të pandehurin dhe bashkëpunëtorët e tij të tjerë. Sidomos, fotografia 0152 është shumë e rëndësishme pasi ajo e tregon A.B. më kafenenë S. në shoqërim shumë relaksues të R. R. dhe I. (L.) A. dhe gjithashtu të A.By. (S.). Fotografia është bërë gjatë kohës së ngrohtë duke marrë parasysh rrobat e holla të cilat të gjitha ata i kishin veshur. Kalendari në mur pas tyre tregonte se ishte viti 2007. Është shumë e qartë se kjo fotografi është bërë brenda disa javëve kur kishte ndodhur vrasja. Fotografia 0162 e tregon kamionçinën e kuqe B. Café. Fotografitë tjera në disk kanë të bëjnë me E.S.. Nuk ka mundur kurrë të vendosen nga policia sepse shumë nga të shtënat janë të shtëna të drejtuara. Duket e pamundur për policinë t'i kenë bërë ato fotografi pasi që ato janë bërë nga persona të cilët ishin të pranishëm në ato raste.

Prova materiale # 6 është përmbajtja e një aparati digjital Samsung nga i cili ishin nxjerrë 213 fotografi. Ato kryesisht paraqesin të pandehurin dhe anëtarët e tjerë të familjes dhe miqtë si dhe foto personale të të pandehurit sikur që është ajo ku ai është duke u rruar në kopsht afër një pishine dhe ajo ku shihet ai duke pirë me njerëz të ndryshëm. Ai qartazi është subjekti kryesor në këtë koleksion të fotove. Fotoja 0010 paraqet kopshtin e shtëpisë së tij me një pishinë në të cilën shihet xhipi Cherokee i gjelbër në prapavijë. Ky është automjeti i njëjtë i cili përmendet shpesh si njëri nga automjetet i cili merrete pjesë shpesh në ndjekjen e A.I. dhe T.R.. Gjithashtu është i njëjti automjet dhe regjistrimi i njëjtë që A.I. e ka përmendur në raportin policor të datës 02.05.2005. Fotot më të rëndësishme janë 0163 dhe 0164. Në foton 0163, A.B. shihet duke pirë disa birra me I.A. dhe të tjerët në kafenenë S.. Fotografia tjetër 0164 është shumë e rëndësishme. Fotografia e paraqet E.S. si pjesë të të njëjtit grup duke u relaksuar në kafenenë e tij nën shoqërimin e A.B.. Fotoja i paraqet që të gjithë ata si të afërt dhe miqësorë. Nga të gjitha këto foto që paraqesin A.B. në kafenenë S., A.B. duket qartë si në shtëpinë e tij. Këto nuk janë fotografitë e personave të cilët ishin takuar rastësisht.

Gjatë dëshmisë së tij, i pandehuri ishte këmbëngulës se ai nuk ishte shoqëruar me djemtë më të ri si L. dhe R.. Kur dëshmia e tij u ballafaqua me fotot e tjera që ishin në kuadër të asaj prove materiale, nuk i iku vëmendjes së trupit gjykues se ai ishte shoqëruar nga afër me ta, gjë që paraqitet veçanërisht në fotot 0025, 0026, 0027, 0044, 0098, 0189, 0190, 1212 dhe 0213). Këto

prova hedhin poshtë linjën mbrojtëse që E.S. kishte aplikuar për ta mbrojtur vetën nga përgjegjësia penale.

Provat e spikatura që tregojnë se sa afër shoqërohej i pandehuri me A.B. dhe sa e kishte kontrolluar atë është Prova Materiale # 3 dhe kjo e paraqet situatën shumë saktë. Me kamerë është kapur një moment i jetës së përditshme. Përmbajtja e video kasetës Sony është ndarë në gjashtë pjesë dhe paraqet një aheng që ndodh në kopshtin e të pandehurit. Përsëri, i pandehuri është në qendër të vëmendjes dhe është i ulur dhe i rrethuar nga shumica mysafirë të gjinisë mashkullore dhe muzikantë. A.B. është gjithashtu aty. Ai futet në kuadër të kamerës në disa raste. Pjesët më të rëndësishme janë Pjesa 2 në sekondën 22 kur D.S. shihet i ulur në shkallë, dhe në sekondën 01:01 kur A.B. shihet gjersa i afrohet të pandehurit. Në Pjesën 4 në sekondën 07:00, A.B. shihet duke kaluar pranë dhe në sekondën 32:49 i pandehuri ia bënë me dorë atij duke e ftuar për të ardhur dhe pastaj i jep udhëzime. A.B. nuk thotë asgjë por tërhiqet pasi që udhëzohet nga E.S.. Në Pjesën 6 në sekondën 2:18, A.B. dhe D.S. janë ulur në shkallë. A.B. dëshmoi mbi këtë kur ishte ballafaquar me këtë video incizim për të cilën tha se ai ishte mysafir dasme por se shumë pak e njihte të pandehurin. Ai tha se ai ishte ulur në tavolinë me D.S. (juve do ju kujtohet se ai ishte dëshmitar i propozuar nga mbrojtja mirëpo ai kishte refuzuar të paraqitej në gjykatë për ‘arsye personale’) duke e shijuar ‘martesën.’ Tavolina e tij nuk shihet, nuk shihen mysafirët e martesës, dhe askush nuk është i veshur për dasmë. A.B. mundohej me çdo kusht të fshihte arsyen e vërtetë të prezencës së tij në këtë tubim. Duket shumë qartë se ai nuk ishte mysafir. Ai ishte shërbyes apo punëtor i E.S., nuk ekziston asnjë shpjegim tjetër logjik. Në pjesët 2 dhe 4, ai i afrohet të pandehurit duke treguar respekt ndaj tij pasi ishte thirrur aty nga ai. Ai merr udhëzime verbale. Pastaj ai kthehet në vendin e tij të punës i cili mund të shihet në pjesën 6, ku ai qëndron i ulur në shkallë duke mbikëqyrur hyrjen dhe veturat e parkuara të mysafirëve.

Kjo video e përshkruan saktësisht marrëdhënien në mes të të pandehurit dhe A.B.. A.B. vjen kur ai thirret dhe ai i bindet urdhrave të të pandehurit. Modeli i njëjtë përsëritet kur E.S. e kishte armatosur A.B. me Glock dhe kur ai e kishte nxitur atë të qëllonte T.R. T.R. i nuk kishte reaguar ndaj A.B. sepse ai nuk e kishte njohur atë. Ai ishte ushtar i E.S. dhe i panjohur për T.R.in.

Kur i pandehuri ishte marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë lidhur me këtë incizim, ai kishte dhënë një shpjegim të paqartë lidhur me atë se i kujt ishte ahengu dhe për arsyen për mbajtjen e këtij ahengu. Ndryshe nga A.B., ai tha se nuk ishte dasmë. Kjo dëshmi duket të jetë e besueshme

pasi që në incizim nuk janë kapur elemente tipike të pritjes në një martesë tradicionale. Kur ishte pyetur se përse A.B. ishte aty dhe se cili ishte roli i tij, përsëri i pandehuri pati telashe ta sqaronte. Ai edhe sugjeroj se ai mund të shihej duke i dhënë udhëzime D.S. për t'i sjell pijet e mysafirëve, gjë që mund të jetë e saktë por kjo vetëm e dëshmon edhe më shumë se A.B. dhe D.S. ishin aty, jo si mysafir të rastit, por si shërbyes të E.S.. Kjo provë përsëri e lidh A.B. me E.S. si persona të cilët kishin marrëdhënien punëtor / komandant – E.S. dhe punëtor / vartës A.B..

Një tjetër provë e rëndësishme është etiketuar Prova Materiale # 4 dhe janë dy mbështjellës rrethor të negativit të filmit që ishin vendosur brenda një CD-je. Nga gjashtëdhjetë e shtatë fotografi, disa janë të rëndësishme. 10006-ta është një 'selfie' e bërë nga i pandehuri e cila paraqet se ai me shumë gjasë kishte në posedim filmin dhe rrjedhimisht ai nuk ka mundur kursesi t'i montohej. 10014-ta dhe 10015-ta paraqesin R.A., ndërsa 10037-ta dhe 10038-ta paraqesin F.S.n. Krejt në fund artikujt 10047 dhe 10048 paraqesin foto eksplicite të një gruaje. Prokuroria thekson se kjo është njëra nga palët e dëmtuara. Fotot e këtij lloji më vonë janë përmendur në SMS-a dhe ishin për tu përdorur për ta shantazhuar atë në rast se ajo bashkëpunonte me prokurorinë. SMS-ët vijues tregojnë se i pandehuri pas vrasjes kishte bërë përpjekje për të mbledhur fotografi inkriminuese të A.I. dhe për t'i përdorur ato për ta shantazhuar atë në rast se ajo bashkëpunonte me policinë. SMS-ët vijues pjesërisht shpjegojnë se përse kishte ndodhur kjo.

11.10.2007

044 XXXXX

044 XXXXX

Hej, shko te Kryeziu dhe gjej disa foto të asaj bushtrës që t'ia dërgojmë K. dhe ai do t'i qet ato në internet, nëse unë dhe R. kemi foto të mira, ti mund gjithashtu t'i dërgosh disa. ok.

17:30

E.S.

A.Ab.

<u>11.10.2007</u>	044 XXXXX	044 XXXXX	<i>Dërgoja K. të gjitha</i>
17:34	E.S.	A.Ab.	<i>fotografitë me A. 3-4 dhe të mirat që i ke ti nëse ke ndonjë.</i>

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbrojtja u përmbajt nga komentimi për sa i përket identitetit të personave të paraqitur, megjithatë theksoj se femra në njëren nga fotot ishte afërsisht 45 vjeç dhe bionde prandaj nuk ka mundur të jetë A.I.. I pandehuri e pranoi se fotografitë e cekura e paraqesin atë duke kryer marrëdhënie seksuale me dy femra në dy raste të ndryshme, njëra bionde dhe tjetra është zeshkane. Ato kishin dhënë miratimin e tyre për bërjen e fotove. I pandehuri nuk deshi të zbulonte identitetin e dy femrave të cilën ai e konsideroi informacion intim; megjithatë ai theksoi se asnjëra nga to nuk ishte A.I.. Ai shtoi se negativat e fotografive ishin sekuestruar nga policia nga raftet pa miratimin e tij. Ai asnjëherë nuk kishte synuar që t'i keqpërdorte ato apo t'i shantazhonte dy femrat të cilat kanë familje.

Prokuroria gjithashtu pohoi se mesazhet e lartpërmendura paraqesin veprimet e ndërmarra nga i pandehuri, pasi që kishte ndodhur vrasja, për të mbledhur fotografi inkriminuese të A.I. dhe për t'i shfrytëzuar ato për ta shantazhuar atë në rast se ajo bashkëpunonte me policinë. Sigurisht, pas bashkëpunimit në fillim me hetuesit, ajo tërhoqi mbështetjen e saj dhe u bë dëshmitare jo-bashkëpunuese për rastin e prokurorisë.

Nga vlerësimi i dëshmive gjatë gjykimit të A.I., trupi gjykues vëren se dëshmitarja qëllimisht është munduar të ndryshoj përmbajtjen e dëshmive të saj të dhëna më herët në formën që favorizonte të pandehurin qoftë duke mohuar veprimin e tij kriminal siç pretendohet më herët ose duke zbutur apo minimizuar përgjegjësinë e tij. Kur ishte ballafaquar me dallime të habitshme në mes të dëshmive të saj të dhëna gjatë gjykimit dhe dëshmisë së saj të dhënë gjatë procedurës paraprake kjo dëshmitare kishte thënë se shkaktarë për këto dallime janë qetësuesit, terapia psikologjike, stresi, presioni i medias, dhe urrejtja ndaj të pandehurit, humbja e kujtesës, emocionet dhe gjërat e tjera.

Megjithatë, faktet burojnë nga provat e tjera vërtetuese, përfshirë dëshmitë dhe provat materiale, që rezultojnë në vërtetimin përtej dyshimit të arsyeshem se i pandehuri vërtetë ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar në Pikën 2 të Aktakuzës.

Pavarësisht nga dëshmitë dukshëm kundërthënëse dhe jo të besueshme të A.I. gjatë gjykimit, gjykata nuk ka mundur të qëndroj indiferente për sa i përket tërësisë së provave, siç ishin prezantuar ato, dhe të cilat shpijnë pa asnjë dyshim në konstatimin e cekur.

Vepra penale e detyrimit kërkon përdorimin e forcës apo kërcënimit serioz për të detyruar një person tjetër për të bërë një akt në dëm të pronës së saj me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të jashtëligjshme. Ankesat e bëra në polici para vrasjes së T.R. kundër E.S. dhe anëtarëve të tjerë të grupit vërtetojnë se i pandehuri dhe/ose bashkëpunëtorët e tij kishin ushtruar trysni të konsiderueshme kundër palës së dëmtuar dhe të dashurit të saj T.R.. Një trysni e tillë ishte konkretizuar përmes kërcënime serioze dhe akteve të dhunshme në formë të përcjelljes me vetura, ofendimeve të bëra me telefon siç ishin ato kundër familjes I., njollosjes së M.I., kërcënimeve false me bombë në koncertet e drejtpërdrejta ku performonte A.I. dhe akte të tjera. Këto akte ishin kryer nga i pandehuri qoftë për të zhvatur para nga A.I. të cilat ajo i kishte përfituar nga karriera e saj artistike ose pas pagesës së këtyre parave nga ana e saj, për ta detyruar atë për të vazhduar të njëjtën gjë, e sidomos pasi ajo kishte filluar një lidhje me T.R. Edhe pse pala e dëmtuar ishte kontradiktore për mënyrën se si e kishte krijuar atë, ajo kishte pohuar se ishte dëmtuar materialisht (financiarisht) në mënyrë të konsiderueshme.

Lloji i mbrojtjes që aplikon Mbrojtja e S. nuk e shfajëson atë. Fakti që i pandehuri ishte vërtetë në marrëdhënie me palën e dëmtuar, A.I.n, ose që vërtetë ai i kishte dhënë asaj dhuratatë të shtrenjta, nuk përbën arsye për të hequr përgjegjësinë e tij. Çfarëdo që i pandehuri i kishte dhënë A.I. si dhuratë, kishte qenë akt i vullnetit të tij të lirë, ndryshe nga pozita e ish të dashurës së tij e cila ishte detyruar t'ia jepte atij paratë.

Fakti që i pandehuri mbante fotografi kompromentuese të I. dhe ishte përpjekur t'i përdorte ato kundër asaj vetëm përkeqëson dhe vërteton qëllimet e tij keqdashëse. Është e panevojshme të thuhet, se A.I. nuk kishte dashur të jepte dëshminë e saj në gjykatë përkundër shumë përpjekjeve për ta thirrur atë. Më në fund, ajo vendosi të paraqitej dhe ofroi dëshminë që ishte në kundërshtim me dëshmitë e saja të dhëna gjatë procedurës paraprake. Trupi gjykues nuk kishte dyshime se sjellja e saj kishte treguar se nga çfarë kishte frikë dëshmitarja A.I., deri në atë masë që ajo të ndryshoi dëshminë e saj në gjykatë. Ishte e qartë për trupin gjykues se fotografitë kompromentuese ishin shkaktari kryesor për sjelljen e saj. A.I. thjeshtë ishte e frikësuar se fotografitë mund të bëheshin publike dhe ajo mund të humbaste kredibilitetin si figurë publike.

Ky trup gjykues erdhi në përfundimin se frika e saj ishte e arsyeshme pasi që i pandehuri pohoi se, disa fotografi kompromentuese që paraqisnin marrëdhënie seksuale dhe disa zonja të paidentifikuara, në fakt ishin bërë nga ai. A.I. si ish e dashura e tij sigurisht ishte në dijeni për këtë lloj sjelljeje dhe pasi që ishte detyruar të paraqitej në gjykatë, ajo vendosi të gjejë një mënyrë të lehtë për t'iu shmangur problemit, domethënë ajo ndryshoi dëshminë e saj të gjykimit. Duke pasur parasysh deklaratat e dëshmitares A.I. në të gjitha sjelljet e saj, ky trup gjykues arriti në konstatimin se vetëm deklaratimet e saj të ofruara gjatë procedurës paraprake duhet të konsiderohen si të besueshme.

Gjykata prandaj konstaton se elementet që përbëjnë aktin material (*actus reus*), si dhe faktori i dashjes (*mens rea*), që kërkohen për veprën penale të detyrimit, janë të pranishëm dhe mbështetën me prova të pranueshme.

E.S.

Në mbrojtjen e tij, E.S. theksoi se marrëdhënia e tij me A.I.n ishte normale dhe e këndshme dhe kishte zgjatur gati dy vite. Ai prezantoi disa fotografi që e paraqisnin atë së bashku me palën e dëmtuar në poza familjare. Ai e pranoi se ai e thërriste A.I. me pseudonimin "A.". Ai tërësisht mohoi ndonjë përfshirje në incidentin e veturave ose në incidentet e tjerë të raportuar nga A.I. apo familja e saj në polici. E.S. e pranoi se ai kishte bërë fotografitë e dy grave në pozita kompromentuese, megjithatë ai e mohoi të ketë pasur ndonjë dashje për t'i përdorur ato për të shkaktuar ndonjë dëm dhe gjithashtu theksoi se asnjëra nga to nuk e paraqesin A.I. Duke e konsideruar këtë çështje personale, ai refuzoi të zbuloi identitetin e dy femrave. Ai gjithashtu e mohoi se kishte qenë pjesë e komunikimit me SMS për sa i takon përdorimit të fotografive për shantazhim.

Dëshmitari D-2

Njëri nga dëshmitarët më të rëndësishëm në këtë rast ishte dëshmitari anonim i quajtur D-2. Ky status i veçantë i ishte dhënë atij për shkak të arsyeve të sigurisë pas mbajtjes së një seance të mbyllur. Gjatë seancës, ky dëshmitar zbuloi shqetësimin për sigurinë e tij në rast se ai do duhej të jepte dëshminë e tij në seancë publike. Frika dhe shqetësimet e tij u konsideruan si të natyrës serioze dhe kërkesa e tij ishte miratuar. Dëshmia e tij është shpallur e pranueshme dhe është në përputhje të plotë me KPPK-në.

Ai kishte dhënë dëshmi të drejtpërdrejtë se i pandehuri kishte urdhëruar vrasjen e T.R., duke e dëgjuar atë pa dashje në ditën e vrasjes duke folur me anëtarët e tjerë të bandës. Ai i njihte anëtarët e ndryshëm të Grupit S.. Më e rëndësishmja, ai ishte i pranishëm në kafe në ditën e vrasjes dhe prandaj ishte në gjendje të jepte dëshmi të drejtpërdrejtë lidhur me takimin e bandës, për pjesë të bisedës që ata kishin në mes tyre kur përgatiteshin për të kryer ekzekutimin, për nisjen e tyre të armatosur me armë të gjata, për kthimin e tyre gjithashtu duke mbartur armë me vete, dhe “shprehjes së gëzimit për fitoren dhe hakmarrjen” e tyre. Nuk ka ndonjë arsye që ky dëshmitar të gënjente apo të vendoste veten në atë rrezik kaq serioz kur kishte pranuar të dëshmonte. Menjëherë pas vrasjes ai kishte folur me policinë dhe atëherë kishte dhënë një deklaratë me shkrim më 19.09.2007⁹². Për sa i përket ditës së vrasjes, ai deklaroi gjatë dëshmisë së tij se ai kishte parë E.S. fillimisht rreth orës 08:00 (f. 4). Në deklaratën e tij me shkrim, ai ka thënë se ishte afërsisht ora 7.00. Kjo ishte kontestuar nga mbrojtja për arsyen se ai nuk ka mundur ta shihte të pandehurin atje kaq herët sepse kafeneja nuk ishte hapur deri më vonë në mëngjes dhe vetë i pandehuri ka theksuar “kafeneja ime asnjëherë nuk ishte hapur në 7 ose 8 të mëngjesit” (f. 43). I pandehuri e kishte fjalën për ditët e zakonshme, por kjo ishte një ditë e jashtëzakonshme. Fakti që dëshmitarit i kujtohet i pandehuri që kishte qenë në kafene herët atë mëngjes, tërësisht vërtetohet me të dhënat trekëndore që tregojnë se i pandehuri kishte përdorur telefonin e tij (nr. 044XXXXXX) nga ora 06:36:55 të mëngjesit në zonën e kafenesë. Kjo është një provë shumë bindëse që e bën deklaratën e dëshmitarit D-2 më të besueshme.

Dëshmitarit D2 iu kujtua që fillimisht kishte parë të pandehurin dhe më vonë derisa D2 ishte i pranishëm në kafene. R.R., L. (I.), A., N.S.i dhe F. ishin atje. Përsëri, kjo vërtetohet me dëshmitë e vet N.S. dhe A.B., që të dy këta pranuan se ishin në kafene atë ditë. Derisa ishte aty, D2 tha se ai i kishte parë të gjithë ata të futeshin në zyrën e E.S.it dhe ai “pa që diçka po përgatitej” (f. 6) me çka ai e kishte fjalën për vrasjen. Ai u larguar sepse ai i tha vetes se “diçka po shkonte lëmshë” (f. 9). Ata ishin të armatosur. Çka është shume e rëndësishme dhe duke ofruar dëshmi të drejtpërdrejtë për atë që i pandehuri duke qenë në pozitë komanduese për planin për të kryer vrasjen, D2 i dëgjoji fjalët e thëna nga i pandehuri “kjo punë duhet të kryhet sot” (f. 37). Ai tha se kur të gjithë ata ishin larguar nga kafeneja, ata kishin armë të gjata me vete në çanta. Ai e kishte parë këtë nga jashtë derisa ishte i ulur në veturën e tij. Ai tha “unë isha në veturë në parking dhe i

⁹² Regjistratori XXII, pp.107-110

pash ata duke dal jashtë për tu nisur në aksion” (f.10). Kur ata ishin nisur në drejtim të veturës, ai besoi se ora ishte diku rreth 15:00. Ai sqaroi se kur ata kishin dal nga kafeneja, ata ishin të armatosur, L., A. dhe R.. Përsëri, fakti që këta persona të caktuar ishin nisur së bashku vërtetohet nga dëshmia e A.B. i cili më në fund e pranoi në dëshminë e tij para kësaj gjykate se ai ishte larguar nga kafeneja në pasdite i shoqëruar nga këta të dy. Si ka mundur ta dinte këtë detaj D2 përveç nëse ka qenë në fakt i pranishëm afër kafenesë për të qenë dëshmuar i saj. Armët që ata po mbartnin drejt veturës para se të niseshin me vetura dilnin nga çantat dhe ata vozitën tutje me “xhipin e tyre, të gjelbër” (f. 11). A.B. ishte me ta. D2-s pastaj iu kujtua L., R.R. dhe N.S.i kur u kthyen dhe se ata bërtisnin diçka për hakmarrjen. Çka është me rëndësi, D2-s nuk iu kujtua A.B. të kishte qenë me ta kur ishin kthyer. Sigurisht, A.B. nuk do të kishte qenë aty me ta pas kthimit pasi që ai në këtë moment ai ishte në arrati dhe fshihej pasi që sapo e kishte vrarë T.R. . D2-s iu kujtua që pas kthimit, “ata ishin ngjitur shkallëve lartë, nuk kishin qëndruar aq gjatë atje dhe përsëri zbritën poshtë, u futën nëpër vetura dhe u shpërndanë” (f. 13).

Mbrojtja prezantoi argumentin që D2 është dëshmitar jo i besueshëm pasi që ata nuk mund ta dinin se kush ishte ai dhe prandaj e kundërshtojnë atë dhe së dyti, për shkak se disa momente kohore që ai kishte dhënë dallonin nga ato të dhëna në deklaratën e tij. Ky trup gjykues nuk e ndan këtë këndvështrim. Mbrojtja kishte dy rastet për të marrë në pyetje këtë dëshmitar përmes video-konferencës nga një lokacion i sigurt. Të drejtat themelore për marrje në pyetje dhe marrje të tërthortë në pyetje ishin dhënë. Kryetari i trupit gjykues ndërhyri vetëm në disa raste kur përgjigja në pyetje drejtpërdrejtë do të shpinte në zbulimin e identitetit të dëshmitarit.

Për sa i përket dallimeve kohore, kjo mund të shpjegohet për shkak të kalimit të kohës. Kryetari i trupit gjykues e kishte marrë në pyetje këtë dëshmitar në mënyrë të hollësishme për të kontrolluar besueshmërinë e tij dhe gjithashtu për të parë nëse D2 kishte ndonjë motiv të mundshëm kundër të pandehurit apo ndonjë nxitje për të falsifikuar provat apo për të gënjyer. Kryetari i trupit gjykues kishte ardhur në përfundimin se deklarata e dëshmitarit D2 është tërësisht e besueshme, jo e motivuar personalisht dhe dëshmitari ishte pajtuar të dëshmonte përkundër rrezikut të madh për veten dhe nuk kishte asnjë motiv tjetër përveç që ta bënte gjënë e duhur. Provë e besueshmërisë së tij është fakti se pjesa më e madhe e asaj që ai kishte deklaruar mund të vihet në ndërlidhje me provat e tjera që e vërtetojnë atë. Për sa i përket A.B., D2 i tha gjykatës se B. ishte i pranishëm në kafene çdo ditë. Kjo vërtetohet nga dëshmitarët e tjerë dhe gjithashtu nga

provat materiale PM# 1.7 dhe PM # 6, fotografitë që paraqesin marrëdhënien e lirshme dhe të qetë që B. kishte me të pandehurin, R.R., L. dhe të tjerët në kafene. Kur ishte pyetur për marrëdhënien në mes të A.B. dhe E.S., ai theksoi *“kam parë se E.S.i i jepte atij urdhër dhe ai [A.] e zbatonte, E.S.i i thoshte atij ta bënte këtë apo atë dhe ai do e bënte”* (f. 14). Ai theksoi *“Ai urdhronte në mënyrë të atillë që të gjitha punët që ai donte t’i kryente, ai i urdhëronte të tjerët për t’i bërë në mënyrë që ato të kryheshin”* (f. 18). Përsëri, kjo marrëdhënie padron/punëdhënës dhe shërbyes/punëtor tërësisht vërtetohet me incizimin e bërë të ahengut në kopsht (PM # 3) ku i pandehuri shihet duke i dhënë udhëzime të nënshtruarit A.B.. D2 gjithashtu theksoi se i pandehuri merrej me detyrim dhe fajde (f. 15). Kjo vërtetohet me dëshminë që ka të bëjë me detyrimin e A.I.. Edhe më domethënëse në kuptim të vërtetimit është fakti që D2 e dinte se i pandehuri njihnte persona nga jashtë *“domethënë Barcelona”* (f. 15). Të gjitha transferet e parave që ishin bërë përmes Western Union për S. para vrasjes vinin nga Spanja. Ngjashëm me këtë, të dhënat e regjistruara tregojnë se N.S. rregullisht kontaktonte numra që kishin kodin shtetëror të Spanjës deri në ditën e vrasjes, madje edhe në ditën e vrasjes. D2 madje ishte i pranishëm në kafene kur bashkëpunëtorët e tjerë i kishin sjellë E.S. *“një çantë me para”* (f. 16) si pjesë të kësaj sipërmarrjeje. Gjykata ka dëgjuar dëshmi të tjera të rëndësishme për paratë që i ishin dorëzuar të pandehurit dhe/ose vëllait të tij N.S.it në ditën e vrasjes. D2 kishte dhënë dëshmi të drejtpërdrejtë se kishte parë dhe dëgjuar shpesh të pandehurin duke qenë në kafenenë e tij, duke parë nga dritarja në drejtim të banesës së T.R. dhe duke thënë në disa raste duke e pasur fjalën për T.R.in *“tash ky qeni po del nga banesa e tij”* dhe *“ja ku është ky idioti, ky qeni po del tani jashtë”* (f. 40).

Trupi gjykues i kishte dhënë mbrojtjes një mundësi tjetër për ta marrë në pyetje D2 në mënyrë të tërthortë, për tu siguruar që mbrojtja ka pasur mundësi të mjaftueshme që të shterroj të gjitha çështjet. Gjatë kësaj seance, D2 kishte ofruar të njëjtën deklaratë dhe kishte dhënë edhe më shumë detaje që shërbejnë për të dëshmuar se sa i besueshëm ai është. Për shembull, ai tha se E.S. kishte dal nga kafeneja e tij, kishte kaluar afër dy bastoreve në rrugë (Toto Sport dhe Luka) dhe se i pandehuri pastaj kishte ndaluar te zyra e MCM-it. Ai gjithashtu tha se A.B. kishte dërguar kafe në emër të të pandehurit në Toto si dhe në lokalet e tjera. Ai ishte shumë i qartë: *“unë isha në kafene dhe dola dhe ndalova veturën në parking dhe dola nga parkingu deri te vetura dhe pastaj pash. Unë qëndrova në veturë dhe vëzhgova se çfarë po mbartnin ata, dhe pashë se po mbartnin armë të gjata, i pash tytat që kishin dal jashtë”* (f. 8)... *“Kishte rreth 10*

deri në 15 minuta [që ai ishte në veturën e tij para se ai të shihte personat që mbartnin armë të gjata]. Vetëm pash se diçka po ndodhte, një rrëmujë e vërtetë ...A., L., R., ishin që të tre ...N.S.in nuk e kam parë duke mbartur armë por ai ishte me ta” (f. 10). Kjo dëshmi tërësisht i demanton gënjeshttrat e thëna nga A.B. kur ai të kishte thënë se rastësisht ishte përplasur me T.R në parkingun e veturave në Flamutaria.

Trupi gjykues është i mendimit se kjo deklaratë është tërësisht e besueshme pasi që ajo është gjithëpërfshirëse, e vërtetë dhe dhënë nga dëshmitari okular. Pas marrjes së saj parasysht në të gjitha pikat, trupi gjykues erdhi në konstatimin se D-2 është karakter i vërtetë, person i cili tregoi me hollësi atë çfarë kishte parë dhe përjetuar, ai nuk është dëshmitar i rremë i caktuar nga policia për ta vënë në kurth E.S.. Nëse ai do të ishte dëshmitar i rremë, në mungesë të dëshmisë së drejtpërdrejte kundër E.S., ai do të zgjidhte E.S. në mesin e A., L., R. si personi i cili ka mbartur armë dhe i cili kishte shkuar në vendin e krimit duke ofruar kështu një deklaratë të drejtpërdrejtë nga dëshmitari kundër E.S..

Vlera provuese e deklaratave të dhëna nga dëshmitari D-2 është tepër e çmueshme pasi që ai, së bashku me dëshmitarët e tjerë kanë paraqitur dëshmi të qarta lidhur me prapaskenën e grupit. D2 gjithashtu përshkruajti se çfarë kishte ndodhur në Kafenenë S. më 30.08.2007 para dhe pas vrasjes. Duhet të theksohet me vendosmëri se ky dëshmitar është dëshmitari kryesor i cili ndihmoi këtë trup gjykues që t’i rikrijoj ngjarjet e kësaj dite kritike, por për sa i përket përfshirjes së E.S. në kryerjen e kësaj vepre penale, trupi gjykues konsideroi se të gjitha të dhënat relevante të regjistruara dhe të përgjuara ofrojnë prova shumë të rëndësishme lidhur me kontrollin që i pandehuri kishte ushtruar mbi R., I. dhe A., dhe tregon lidhjen në mes tyre.

Ky trup gjykues analizoi një sasi të bollshme të të dhënave të mbledhura gjatë përgjimit, regjistrimit dhe trekëndëzimit. Analiza prodhoi rezultatin përfundimtar.

Analiza e telefonave mobil dhe SIM kartelave

Telefonat mobil dhe SIM kartelat e sekuestruara nga Policia e Kosovës gjatë kontrollave të kryera më 30.08.2007 si në vijim:

Prova materiale nr.	Artikulli	Lokacioni
1	Një (1) telefon NOKIA E50 IMEI: 351892/01/496234/9	Kafeneja "S."
1.1	Një (1) SIM kartelë VALA 900 S/N: 8937701010002499529	
2	Një (1) telefon NOKIA 1600 IMEI: 35426/01/592398/6	
2.1	Një (1) SIM kartelë Vala 900 S/N: 8937701010009604584	
3	Një (1) telefon NOKIA 2610 IMEI: 353968/01/333964/4	
3.1	Një (1) SIM kartelë Vala 900 S/N: 8937701010006424242	
4	Një (1) telefon NOKIA 1110i IMEI: 354572/01/5757602/2	
5	Një (1) telefon NOKIA 1112 IMEI: 354801/01/481471/2	
5.1	Një (1) SIM kartelë Vala 900 S/N: 8937701010007504810	
6	Një (1) telefon NOKIA 6310i IMEI: 351457/20/019686/0	
NS#1	Një (1) telefon Nokia 3100	

	<p>IMEI 356214007280818 me</p> <p>Një (1) SIM kartelë Vala 900</p> <p>S/N: 8937701010000551800;</p> <p>Një (1) telefon Nokia 2100 me</p> <p>IMEI 351522001240264</p> <p>Një (1) SIM kartelë Vala 900</p> <p>S/N: 8937701010000695362.</p>	<p>E.S., në posedim të H.S. dhe F.A.</p>
E#4	<p>Një (1) telefon Nokia 3330</p> <p>IMEI: 350609804381568 me</p> <p>Një (1) SIM kartelë Vala 900</p> <p>S/N: 89377010100006585984;</p> <p>Një (1) telefon Nokia 6230i</p> <p>IMEI: 353233013831755 me</p> <p>Një (1) SIM kartelë Vala 900</p> <p>S/N: 89377010100007301993 dhe</p> <p>Një micro SD card 32 MB S/N: 0631150.</p>	<p>Banesën e I.A.</p>
#2	<p>Një (1) telefon Nokia 2100</p> <p>IMEI: 351522007712209 me</p> <p>Një (1) SIM kartelë Vala 900</p> <p>S/N: 8937701010000;</p>	<p>Banesën e A.B.</p>

- a. Prova materiale 1: Telefoni NOKIA E50 IMEI: 351892/01/496234/9 i sekuestruar nga Kafeneja S. përmban:

Dy mesazhe SMS të dërguara më 30.08.2007 në numrin 044 XXXXXX, të cilat përmendin një person me emrin R. nga Western Union. Personi me emrin R. është gjithashtu kontakt i ruajtur në këtë telefon, me numrin 044 XXXXXX;

- Dy fotografi të emëruara “E.S. 1” dhe “E.S. 2” që paraqesin E.S. në shoqëri të personave të tjerë të panjohur.

b. Prova materiale 1.1.: SIM kartela VALA 900 S/N: 8937701010002499529 e sekuestruar nga Kafeneja S. përmban:

- Numrat kontaktues të “K.” (044 XXXXXX), “P.” (044 XXXXXX) dhe “A.” (044 XXXXXX). N.Se. dhe A.S. gjithashtu njihen si “K.” dhe “P.” përkatësisht “P.”.
- Një SMS mesazh hyrës i datës 31.08.2006, 20:42, me të cilën dërguesi i panjohur i drejtohet marrësit si “N.”.

c. Prova materiale 3.: Telefoni NOKIA 2610 IMEI: 353968/01/333964/4 i sekuestruar nga Kafeneja S. përmban:

- Kontaktin me emrin “E.S. S.” i cili i bashkëngjitet numrit 044 XXXXXX.

d. Prova materiale 3.1.: SIM kartela Vala 900 S/N: 8937701010006424242 e sekuestruar nga Kafeneja S. përmban:

- Kontaktin me emrin “E.S. S.” i cili i bashkëngjitet numrit 044 XXXXXX.

e. Prova materiale 5.1.: SIM kartela Vala 900 S/N: 8937701010007504810 e sekuestruar nga Kafeneja S. përmban:

- Kontaktin me emrin “N.S.” me numrin 044 XXXXXX.

f. Prova materiale 6.: Telefoni NOKIA 6310i IMEI: 351457/20/019686/0 i sekuestruar nga kafeneja S. përmban:

- Numrat kontaktues të: “P.” (038 XXXXXX), “En S.” (044 XXXXXX), “S.” (038 XXXXXX), “Q.” (044 XXXXXX), “K.” (044 XXXXXX), “S.” (044 XXXXXX). (D.S. / A.S., E.Si., A.By., G. “Q.”, N.Se., F.S.);

- Një thirrje dalëse më 06.01.2002 në ora 01:27 në numrin 044 XXXXXXX;
- Një thirrje dalëse (data e panjohur) në numrin 044 XXXXXXX të A.By.;
- Një thirrje dalëse (data e panjohur) në numrin 044 XXXXXXX të R.A..

g. Prova materiale NS#1: Telefoni NOKIA 3100 IMEI 356214007280818, i sekuestruar nga H.S. përmban:

- Kontaktin me emrin “F.A.” me numrin 044 XXXXXXX;
- Kontaktin me emrin “E.S.” me numrin 044 XXXXXXX,;
- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXXX,;
- Kontaktin me emrin “N.S.” me numrin 044 XXXXXXX,;
- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXXX, (E.L.)
- Kontaktin me emrin “G.” me numrin 044 XXXXXXX.

h. Prova materiale NS#1: SIM kartela Vala 900 S/N: 8937701010000551800, e sekuestruar nga H.S. përmban:

- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXXX, (E.L.);
- Kontaktin me emrin “G.” me numrin 044 XXXXXXX;
- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXXX.

i. Prova materiale NS#1: Telefoni NOKIA 2100 IMEI 351522001240264, i sekuestruar nga F.A. përmban:

- Kontaktin me emrin “A.S.” me numrin 044 XXXXXXX, i cili hetuesia e zbuloi se i përkiste A.By.;
- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXXX, i cili hetuesia ia atribuon I.A.;
- Kontaktin me emrin “N.S.” me numrin 044 XXXXXXX, që i takonte N.S.;

- Kontaktin me emrin “Q.” me numrin 044 XXXXXX, i cili hetuesia e zbuloi se i përkiste E.S.,
- Kontaktin me emrin “R.” me numrin 044 XXXXXX, i cili hetuesia e zbuloi se i përkiste R.A.;
- Kontaktin me emrin “K.” me numrin 044 XXXXXX i cili i takonte N.Se..

j. Prova materiale E#4: Telefoni NOKIA 6230i IMEI: 353233013831755, i sekuestruar nga I.A. përmban:

- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXX të cilin hetuesia e zbuloi se ishte përdorur nga I.A.;
- Kontaktin me emrin “Rrumqi” me numrin 044 XXXXXX, të cilin hetuesia e zbuloi se i përkiste R.A.;
- Kontaktin me emrin “N.S.” me numrin 044 XXXXXX, i cili i përkiste N.S.;
- Një thirrje të humbur më 02.08.2007 në ora 16:34 nga një kontakt me emrin “F.S.” me numrin e telefonit 044 XXXXXX, të cilin hetuesia ia atribuoi F.S.;
- Një thirrje e humbur më 23.09.2007 në ora 12:31 nga një kontakt me emrin “E.Si.” me numrin 044 XXXXXX, E.Si.;
- Thirrjet e humbura nga kontaktet me emrat “L.D.” (044 XXXXXX, më 30.08.2007) dhe “K.” (044 XXXXXX, më 23.08.2007);
- Thirrjet hyrëse nga numrat 044 XXXXXX (më 28.08.2007 në ora 11:50) dhe 044 XXXXXX (më 29.08.2007 në ora 00:06) të cilat hetuesia ia ka atribuuar A.B. dhe A.By.t, respektivisht;
- Dy mesazhe SMS të pranuar më 17.09.2007 nga numri 044 XXXXXX, të cilat hetimi ia ka atribuuar K.B.;
- Fotografitë e një personi, të quajtura ”Image 013”, ”Image 014”, ”L. 000” dhe ”L. 001”

k. Prova materiale E#4: SIM kartela Vala 900 S/N: 89377010100007301993 e sekuestruar nga I.A. përmban:

- Kontaktin me emrin “L.” me numrin 044 XXXXXX, i cili hetuesia e gjeti se ishte përdorur nga I.A.;
- Kontaktin me emrin “R.” me numrin 044 XXXXXX, i cili hetimi e gjeti se është i R.A.;
- Kontakti me emrin “N.S.” me numrin 044 XXXXXX i cili i përkiste N.S..

l. Prova materiale E#4: Micro SD card 32 MB S/N: 0631150 e sekuestruar nga I.A. përmban:

Dy fotografi të një personi, me emrin “L. 000” dhe “L. 002”.

m. Prova materiale Nr. #2: SIM kartela Vala 900 S/N: 89377010100005944901 e sekuestruar nga A.B. përmban:

- Kontaktin me emrin “A.” me numrin 044 XXXXXX, i cili i përkiste A.B..

Regjistrimi dhe përmbajtja relevante e SMS-ve

Minutazha e të gjitha SMS-ve është përshtatur për të pasqyruar kohën e saktë

Data/Koha	Thirrësi	I thirruri	Kohëzgjatja	Antena	Përmbajtja
<u>01.08.2007</u> 12:56:30 ⁹³	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX A.By.			<i>Qopa më thirri, do të pres ty te Sharbant.888831</i>
<u>03.08.2007</u> 21:31:48 ⁹⁴	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX			<i>Thuaj atij që të shkoj në kafene. Jam pak larg me E.S.in dhe L..</i>
<u>13.08.2007</u>	044 XXXXXX	044 XXXXXX			<i>Ai dëshiron të takohemi në ora një për bishtin e</i>

⁹³ Faqet 257-257A, Regjistratori XII;

⁹⁴ Faqet 260-260A, Regjistratori XII;

12:05:00 ⁹⁵	E.S.	P.G.			<i>sëpatës. A po vjen, merre atë në veturën tënde.</i>
<u>23.08.2007</u> 19:03:00 ⁹⁶	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX F.S.			<i>A do të vije filania për të kënduar për AKR-në në Vranjevc, B.Pa. ka një koktej me qytetarët e Vranjevcit.</i>
<u>23.08.2007</u> 19:16 ⁹⁷	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX E.S.			<i>E mërkurë 29, nuk ka shans për të kënduar të mërkurave. Hajde këtu për pak kohë t q n</i>
<u>23.08.2007</u> 19:27 ⁹⁸	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX F.S.			<i>Në rregull, vëlla, ne i paguajmë ato pasi që kanë për të kënduar dy këngë secila. E., Y., K., F.M. do të jenë të pranishme hahah. Kryeje këtë</i>
<u>23.08.2007</u> 12:46 ⁹⁹	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX			<i>Përgatitmi 10 vizitë kartela me mbishkrimin "Café Bar S." për t'i ekspozuar në këmisha sikur distinktivët e ministrave</i>
<u>23.08.2007</u> 13:42 ¹⁰⁰	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX			<i>Shtype B. Café Bar S., Bulevardi Bill Clinton. Bëje mirë.</i>

⁹⁵ Faqet 3-3A, Regjistratori XII;

⁹⁶ Faqet 32-32A, Regjistratori XII;

⁹⁷ Faqet 32-32A, Regjistratori XII;

⁹⁸ Faqet 32-32A, Regjistratori XII;

⁹⁹ Faqet 31-31A, Regjistratori XII;

¹⁰⁰ Faqet 31-31A, Regjistratori XII;

<u>23.08.2007</u> 13:50 ¹⁰¹	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX F.M.			<i>Kur të bëjë me E. disa afishe, ti do të këndosh me dikë tjetër në hotel Apollonia më 29th në një koktej.</i>
<u>24.08.2007</u> 15:21:06 ¹⁰²	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX K.B.			<i>Në rregull, e dashur ti dil jashtë dhe thirre A. pasi që unë nuk jam këtu për momentin. Rreth orës 6 ose 7 do të vij në qytet</i>
<u>24.08.2007</u> 17:09:56 ¹⁰³	044 XXXXXX K.B.	044 XXXXXX A.B.			<i>Ku je ti, B., a ke pak kohë për një kafe me mua dhe Shkurtën, nëse po, më trego dhe ne do të vijmë atje poshtë ku ulemi zakonisht, në rregull më trego</i>
<u>24.08.2007</u> 17:20:56 ¹⁰⁴	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX A.B.			<i>Pasha familjen nuk jam në Prishtinë, jam me L. dhe G.Q., pak largë. Rri atje me ta dhe pyete S. dhe unë do të vij për një orë.</i>
<u>25.08.2007</u> 22:40 ¹⁰⁵	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX R.Pa.			<i>Afishet janë shpërndarë në të gjithë Pr, por shumica prej tyre do të jenë në Vranjevc, Azizi nuk është përgjigjur. Shihemi. Do të jenë</i>

¹⁰¹ Faqet 31-31A, Regjistratori XII;

¹⁰² Faqet 281-281A, Regjistratori XII;

¹⁰³ Faqet 17-17A, Regjistratori XII;

¹⁰⁴ Faqet 281-281A, Regjistratori XII;

¹⁰⁵ Faqet 35-35A, Regjistratori XII;

					<i>1000 njerëz. Hajdutët do të çmenden.</i>
<u>26.08.2007</u> 20:04 ¹⁰⁶	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX I.A.			<i>Atë që ia ke shitur V. a ka pasur TT rezervë.</i>
<u>26.08.2007</u> 20:07 ¹⁰⁷	044 XXXXXX F.A.	044 XXXXXX R.A.			<i>Lëje në shtëpinë time unë do të paguaj për të. (ja morav viq/e pakuptueshme) Ku je ti, a je me bushtrën e vogël</i>
<u>26.08.2007</u> 23:10:35 ¹⁰⁸	044 XXXXXX F.A.	044 XXXXXX R.A.			<i>Hej axhë/dajë nuk mund të qëndroi në zonën e dikujt tjetër i vetmuar këtu. Pyete atë nëse dëshiron të vije ose jo</i>
<u>27.08.2007</u> 14:04:48 ¹⁰⁹	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX I.A.			<i>A duhet të rri këtu edhe për një orë e gjysmë apo duhet të vijë</i>
<u>27.08.2007</u> 14:07:06 ¹¹⁰ ,	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX I.A.			<i>Ku je ti dhe me kënd</i>
<u>27.08.2007</u> 18:23:12 ¹¹¹	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX I.A.			<i>Q. na thirri ai tha hajde të vrapojmë unë jam në shtëpi çfarë të bëjmë</i>
<u>27.08.2007</u> 18:31:02hr ¹¹² ,	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX E.S.			<i>A duhet të nisem në drejtim të kafenesë apo vendit</i>

¹⁰⁶ Faqet 36-36A, Regjistratori XII;

¹⁰⁷ Faqet 36-36A, Regjistratori XII;

¹⁰⁸ Faqet 1-1A, Regjistratori XII;

¹⁰⁹ Faqet 284-284A, Regjistratori XII;

¹¹⁰ Faqet 284-284A, Regjistratori XII;

¹¹¹ Faqet 284-284A, Regjistratori XII;

¹¹² Faqet 284-284A, Regjistratori XII;

<u>27.08.2007</u> 20:08:56 ¹¹³ ,	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX R.A.			<i>Unë jam në AM/PM duke u sjell vërdallë me B. duke e lypur atë shokun. A është Q. atje lartë?</i>
<u>27.08.2007</u> 20:53:12 ¹¹⁴	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX G. "Q."			<i>Një tip po i garanton një 15 sikur ajo që e ke blerë nga Q.. 500 Euro a do ta marrësh për mua dhe pastaj më vonë barazohemi, i dashur shok G., dhe unë ta q-j nënën</i>
<u>27.08.2007</u> 00:01:45 ¹¹⁵	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX E.S.			<i>Pasha zotin e kam pasur të kyçur gjatë gjithë kohës, me R. ne ecëm vërdallë por nuk pat asgjë. Do të kryhet, do të kryhet, do ta shohësh</i>
<u>27.08.2007</u> 22:53:22 ¹¹⁶	044 XXXXXX L.	044 XXXXXX E.S.			<i>Përshëndetje E.S., çka po bon, a je mirë, dhe a ka ndonjë të re te ti? Këtu jam shëndosh e mirë, i ulur në burgun e Dubravës, më ra ndër mend tani që të përshëndes. Mirupafshim, nga L.</i>

¹¹³ Faqet 23-23A, Regjistratori XII;

¹¹⁴ Faqet 23-23A, Regjistratori XII;

¹¹⁵ Faqet 21-21A, Regjistratori XII;

¹¹⁶ Faqet 54-54A, Regjistratori XII;

<u>28.08.2007</u> 11:33:01 ¹¹⁷	044 XXXXXXX N.S.	+3463 XXXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:30 (30 sek)		
<u>28.08.2007</u> 12:22:59 ¹¹⁸	044 XXXXXXX N.S.	+346 XXXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:13 (13 sek)		
<u>28.08.2007</u> 13:02:52 ¹¹⁹	044 XXXXXXX N.S.	+346 XXXXXXX Nr. i Spanjës	00:02:06 (2 minuta dhe 06 sekonda)		
<u>29.08.2007</u> 15:02:53 ¹²⁰	044 XXXXXXX N.S.	+346 XXXXXXX Nr. i Spanjës	00:01:37 (1 minutë e 37 sekonda)	m_dardania2	
<u>29.08.2007</u> 20:02:24 ¹²¹	044 XXXXXXX	044 XXXXXXX E.S.		kastrioti1_1	<i>Hej, E.S., dërgo dikë ta merr B. (B.Ah.)</i>
<u>29.08.2007</u> 20:02:24 ¹²²	044 XXXXXXX A.B.	044 XXXXXXX			<i>Atje s'ka asgjë sonte shokut</i>
<u>29.08.2007</u> 21:17 ¹²³	044 XXXXXXX I.A.	044 XXXXXXX A.B.		(I.) k_trimave2_3 (A.) lakrishtja_1	<i>B., merre R. dhe hajde këtu lart ulu me filanen nga Suhareka, mashtroje disi, sepse Q. i ka dy tash, q. tha</i>

¹¹⁷ Faqet 97, Regjistratori X;

¹¹⁸ Faqet 97, Regjistratori X;

¹¹⁹ Faqet 97, Regjistratori X;

¹²⁰ Faqja 98, Regjistratori X;

¹²¹ Faqet 59-59A, Regjistratori XII;

¹²² Faqet 59-59A, Regjistratori XII;

¹²³ Faqet 18-18A, Regjistratori XII;

<u>30.08.2007</u> 00:13:45 ¹²⁴	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX I.A.		(I.) bardhoshi_3	<i>Q. po me thotë me të pyet ku je, çfarë t'i them.</i>
<u>30.08.2007</u> 00:16:38 ¹²⁵	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX I.A.		(I.) kastrioti1_3	<i>Unë jam me të, ne po shkojmë te B. kovaqi, ku t'i them se je</i>
<u>30.08.2007</u> 00:19:41	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		k_trimave2_1	
<u>30.08.2007</u> 06:36:55	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX		m-dardania2	<i>Flej flej</i>
<u>30.08.2007</u> 12:15:08 ¹²⁶	044 XXXXXX N.S.	+346 XXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:39 (39 sek.)	lakrishtja_1	
<u>30.08.2007</u> 12:51:31 ¹²⁷	044 XXXXXX N.S.	+346 XXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:43 (43 sek.)	lakrishtja_1	
<u>30.08.2007</u> 13:07:10 ¹²⁸	044 XXXXXX N.S.	044 XXXXXX E.S.		lakrishtja_1	<i>Derisa ai t'i plotëson dokumentet</i>
<u>30.08.2007</u> 13:54:53 ¹²⁹	044 XXXXXX N.S.	+346 XXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:12 (12 sek.)	lakrishtja_1	
<u>30.08.2007</u>	044 XXXXXX	044 XXXXXX		(F.)	<i>Vetura e kojshive është</i>

¹²⁴ Faqet 287-287A, Regjistratori XII;

¹²⁵ Faqet 287-287A, Regjistratori XII;

¹²⁶ Faqe 99, Regjistratori X;

¹²⁷ Faqe 99, Regjistratori X;

¹²⁸ Faqe 62, Regjistratori XII;

¹²⁹ Faqe 100, Regjistratori X;

14:06:58 ¹³⁰	F.A.	I.A.		rilindja1_1 (I.) lakrishtja_1	<i>në parkingun e Grandit</i>
<u>30.08.2007</u> 14:06:08	044 XXXXXX T.R.	044 XXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		art_foto_3	
<u>30.08.2007</u> 14:15:27 ¹³¹	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX F.A.	00:00:26 (26 sek.)	(I.) rilindja1_2	
<u>30.08.2007</u> 14:16:26	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		lakrishtja_3	
<u>30.08.2007</u> 14:17:14	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX		lakrishtja_1	<i>Eh shkëlqyeshëm. Kalofsh mirë</i>
<u>30.08.2007</u> 14:20:28 ¹³²	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX R.A.	00:00:30 (30 sek.)	(I.) rilindja1_1	
<u>30.08.2007</u> 14:21:48 ¹³³	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX K.B.			<i>Në rregull, zemër, jam i zënë, të dua</i>
<u>30.08.2007</u> 14:24:17	044 XXXXXX	044 XXXXXX E.S.		rilindja1_2	<i>Po, i ftuar por nuk isha aspak gati, ti më the vetëm një ditë përpara dhe atë natë unë shkova te b., nëse do më kishe treguar më herët do të</i>

¹³⁰ Faqet 1-2A, Regjistratori XII;

¹³¹ Faqe 100, Regjistratori X;

¹³² Faqe 100, Regjistratori X;

¹³³ Faqet 288-288A, Regjistratori XII;

					<i>kishte qenë ndryshe, sepse isha duke ngrënë dhe nuk kam mundur të përgjigjem</i>
<u>30.08.2007</u> 14:25:33 ¹³⁴	044 XXXXXXX I.A.	044 XXXXXXX R.A.	00:00:09 (9 sek.)	(I.) art_foto_3	
<u>30.08.2007</u> 14:26:31 ¹³⁵	044 XXXXXXX E.S.	044 XXXXXXX I.A.	00:00:22 (22 sek.)	(I.) radio_3 (E.S.) art_foto_3	
<u>30.08.2007</u> 14:28:27	044 XXXXXXX I.A.	044 XXXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		radio_2	
<u>30.08.2007</u> 14:28:31	044 XXXXXXX E.S.	044 XXXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		radio_2	
<u>30.08.2007</u> 14:54:52	044 XXXXXXX T.R	044 XXXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		menza_3	
<u>30.08.2007</u> 14:55:30 ¹³⁶	044 XXXXXXX N.S.	+346 XXXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:37 (37 sek.)	lakrishtja_1	
<u>30.08.2007</u>	044 XXXXXXX	044 XXXXXXX	00:00:28	menza_3	

¹³⁴ Faqe 100, Regjistratori X;

¹³⁵ Faqe 100, Regjistratori X;

¹³⁶ Faqe 100, Regjistratori X;

15:00:03		E.S.	(28 sek.)		
<u>30.08.2007</u> 15:09:55	038 XXXXXX	044 XXXXXX T.R	00:00:35 (35 sek.)	ulpiana2_2	
<u>30.08.2007</u> 15:10 ¹³⁷	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX A.B.	00:00:09 (9 sek.)	(A.) ulpiana2_2	
<u>30.08.2007</u> 15:13:12 ¹³⁸	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX I.A.		(I.) cannon_2	<i>Ta pimë një aty ku kemi pirë lëngun e manaferrave atë ditë</i>
<u>30.08.2007</u> 15:20:53	044 XXXXXX	044 XXXXXX I.A.	00:01:15 (1 minuta dhe 15 sek.)	(I.) ptk2_2	
<u>30.08.2007</u> 15:24:53 ¹³⁹	044 XXXXXX N.S.	+346 XXXXXX Nr. i Spanjës	00:01:53 (1 minutë e 53 sekonda)	lakrishtja_1	
<u>30.08.2007</u> 15:27:18 ¹⁴⁰	044 XXXXXX N.S.	+346 XXXXXX Nr. i Spanjës	00:00:33 (33 sek.)	lakrishtja_1	
<u>30.08.2007</u> 15:28:03	044 XXXXXX	044 XXXXXX E.S.	00:00:58 (58 sek.)	lakrishtja_3	
<u>30.08.2007</u> 15:28:04	044 XXXXXX T.R	044 XXXXXX	00:00:56 (56 sek.)	ulpiana2_2	

¹³⁷ Faqe 176, Regjistratori X;

¹³⁸ Faqet 288-288A, Regjistratori XII;

¹³⁹ Faqe 100, Regjistratori X;

¹⁴⁰ Faqe 100, Regjistratori X;

<u>30.08.2007</u> 15:36:25	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		euromedi_2	
<u>30.08.2007</u> 15:37:21	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX R.A.	00:00:04 (4 sek.)	cannon_2	
<u>30.08.2007</u> 15:39:11	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX E.S.		(I.)victoria_1 (E.S.) grandstore_3	<i>Hajde drejt shtëpisë</i>
<u>30.08.2007</u> 15:39:25	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX Kontrollim i kreditit / Mbushje elektronike		grandstore_3	
<u>30.08.2007</u> 15:58:12 ¹⁴¹	044 XXXXXX N.S.	044 XXXXXX E.S.		(N.S.) lakrishtja_1 (E.S.) f_kosova_3	<i>R. nga perëndimi i ka sjell ato</i>
<u>30.08.2007</u> 16:04hrs ¹⁴²	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX A.B.	00:00:18 (18 sek.)	(A.) emshiri_3	
<u>30.08.2007</u> 16:05:00 ¹⁴³	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX A.B.		(A.) lakrishtja_3	<i>Qëndro aty ku je, hyr brenda, do të të thërras më vonë</i>

¹⁴¹ Faqet 63-63A, Regjistratori XII;

¹⁴² Faqe 176, Regjistratori X;

¹⁴³ Faqet 288-288A, Regjistratori XII;

<u>30.08.2007</u> 17:49:35 ¹⁴⁴	044 XXXXXX K.B.	044 XXXXXX R.A.			<i>Zemër, kush e ka vrarë T.R.</i>
<u>30.08.2007</u> 17:56 ¹⁴⁵	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX K.B.			<i>Kjo nuk është puna jote, shikoj punët e tua, ok</i>
<u>30.08.2007</u> 17:57:39 ¹⁴⁶	044 XXXXXX K.B.	044 XXXXXX R.A.			<i>Po, është, është, ti mund të jesh i lidhur me ta dhe të futesh në burg, çfarë bëjë unë pa ty</i>
<u>30.08.2007</u> 18:00:58 ¹⁴⁷	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX K.B.			<i>Zemër, të thash se isha duke fjetur dhe më lerë të qetë a dëgjon</i>
<u>30.08.2007</u> 18:02:21 ¹⁴⁸	044 XXXXXX K.B.	044 XXXXXX R.A.			<i>Më fal zemër, kjo është vetëm për shkak se unë frikësohem</i>
<u>30.08.2007</u> 22:28:08 ¹⁴⁹	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX A.B.	00:00:50 (50 sek.)	(A.) lakrishtja_3	
Thirrja e fundit në të cilën ishte përgjigjur A.B. (044 XXXXXX) ishte bërë nga K.B. (044 XXXXXX) më 30/08/2007 në ora 22:46:07. Sipas regjistrimit të thirrjeve për A.B., telefoni i tij kishte pranuar thirrje të pa-përgjigjura deri me datën 02/09/2007 në ora 23:05:45 pas së cilës kohë as thirrje dhe as SMS-a nuk janë bërë apo pranuar nga ky numër.					
<u>01.09.2007</u> 01:06 ¹⁵⁰	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.			<i>Nuk mund ta paramendosh se sa të tërbuar janë njerëzit në</i>

¹⁴⁴ Faqet 255-255A, Regjistratori XII;

¹⁴⁵ Faqet 288-288A, Regjistratori XII;

¹⁴⁶ Faqet 255-255A, Regjistratori XII;

¹⁴⁷ Faqet 288-288A, Regjistratori XII;

¹⁴⁸ Faqet 255-255A, Regjistratori XII;

¹⁴⁹ Faqja 176, Regjistratori X;

¹⁵⁰ Faqet 10-10A, Regjistratori XII;

					<i>atë maskara</i>
<u>01.09.2007</u> 13:02 ¹⁵¹	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.			<i>Oh Zot, ai është vrarë nga qyqari më i madh.</i>
<u>01.09.2007</u> 13:04 ¹⁵²	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.			<i>Ai i cili ka ndenjur me L. gjatë gjithë kohës dhe ka vozitur kamionçinën e B. Cafë</i>
<u>01.09.2007</u> 13:08 ¹⁵³	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.			<i>Ai e shoqëronte L., ai shtirej se ishte truproja e L.</i>
<u>01.09.2007</u> 13:17 ¹⁵⁴	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.			<i>Z., çfarë budallai është A., nts nts ntss!</i>
<u>01.09.2007</u> 13:56 ¹⁵⁵	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX A.C.			<i>Ti e din kush e ka vra atë, një far A. që e shoqëronte L.</i>
<u>01.09.2007</u> 13:59 ¹⁵⁶	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX A.C.			<i>Po, thonë se ai ishte arrestuar. E.S.i është në arrati</i>
<u>01.09.2007</u> 14:01 ¹⁵⁷	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX A.C.			<i>Policia thotë se do të ketë edhe më shumë arrestime</i>
<u>01.09.2007</u> 14:03 ¹⁵⁸	044 XXXXXX A.C.	044 XXXXXX F.S.			<i>Pra është A. i cili e kishte shoqëruar L., kështu po thonë, ajo që</i>

¹⁵¹ Faqet 10-10A, Regjistratori XII;

¹⁵² Faqet 10-10A, Regjistratori XII;

¹⁵³ Faqet 10-10A, Regjistratori XII;

¹⁵⁴ Faqet 10-10A, Regjistratori XII;

¹⁵⁵ Faqet 9-9A, Regjistratori XII;

¹⁵⁶ Faqet 9-9A, Regjistratori XII;

¹⁵⁷ Faqet 9-9A, Dosje XII;

					<i>po flitet, ku je ti, çfarë të bëjmë, bir, puna mundet me u bë mut</i>
<u>01.09.2007</u> 14:06 ¹⁵⁹	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX A.C.			<i>Po, ai i cili e kishte shoqëruar L. L., R., E.S., K. janë në kërkim, po shkruan një gazetë</i>
<u>07.10.2007</u> 17:05 ¹⁶⁰	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX E.S.			<i>Ndërroje telefonin dhe këtë numër urgjentisht, blej një telefon të ri, leje këtë urgjentisht</i>
<u>07.10.2007</u> 17:16 ¹⁶¹	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX E.S.			<i>Unë jam në Pejton, do të të tregoj të gjitha, por duhet ta ndryshosh tani, urgjentisht telefonin dhe numrin. Do bëjë çdo gjë, mos u brengos</i>
<u>11.10.2007</u> 17:30 ¹⁶²	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX A.Ab.			<i>Hej shko te Kryeziu dhe gjej disa foto të asaj bushtre që t'ia dërgojmë K. dhe ai do t'i qes ato në internet, nëse unë dhe R. kemi fotografi të mira, ju mund t'i dërgoni gjithashtu disa. Në rregull</i>
<u>11.10.2007</u> 17:34 ¹⁶³	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX A.Ab.			<i>Dërgoja K. të gjitha fotot me A. 3-4 dhe gjithashtu ndonjë të</i>

¹⁵⁸ Faqet 13-13A, Regjistratori XII;

¹⁵⁹ Faqet 9-9A, Regjistratori XII;

¹⁶⁰ Faqet 7-7A, Regjistratori XII;

¹⁶¹ Faqet 7-7A, Regjistratori XII;

¹⁶² Faqet 88, 67, Regjistratori XII;

					<i>mirë tänden nëse ke</i>
<u>25.10.2007</u> 21:57 ¹⁶⁴	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX B.M.			<i>Z nuk është në rregull të flasësh, ti po pësjtjellon, në rregull vetëm vazhdo ti, të thash të mos pësjtjellësh dhe ti the jo. A e din se cilës familje i takon ? mos u bë mjet i dikujt tjetër</i>
<u>25.10.2007</u> 21:59 ¹⁶⁵	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX B.M.			<i>Thuaj B. se ma hanë k-- --. Vetëm thuaj ti këtë. Në rregull</i>
<u>25.10.2007</u> 22:01 ¹⁶⁶	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX B.M.			<i>Z, a do t'i thash, thuaji atij. Thuaj atij se ai ma han k---., ai është vetëm hajdut, një kriminel që punon me hajdutë. Asgjë më shumë</i>
<u>26.10.2007</u> 00:07 ¹⁶⁷	044 XXXXXX E.S.	044 XXXXXX B.M.			<i>Leje punën dhe gjithë të tjerat, Z, dhe ne do martohemi menjëherë, le të kërcënon ty policia ...</i>

Ky trup gjykues nuk ka asnjë dyshim se E.S. kishte përdorur numrin e mobilit 044 XXXXXX. Provat e prezantuara nga mbrojtja domethënë deklarata e dëshmitarit N.Se. ishte konsideruar si jo e besueshme. Dëshmitari i cekur kishte dhënë dëshmi ku sugjeronte se ai kishte qenë i vetmi

¹⁶³ Faqet 88, 67, Regjistratori XII;

¹⁶⁴ Faqet 136, 118, Regjistratori XII;

¹⁶⁵ Faqet 136, 118, Regjistratori XII;

¹⁶⁶ Faqet 136, 118, Regjistratori XII;

¹⁶⁷ Faqet 137, 119, Regjistratori XII;

person që e kishte përdorur numrin 044 XXXXXX. Ai madje kishte shkuar aq larg në përpjekjen e tij për t'i gjetur një alibi E.S., saqë kishte pretenduar se ai ishte Q. dhe se i pandehuri nuk kishte përdorur ndonjë numër të caktuar. Analiza vendimtare e mesazheve tekstuale të pranuar dhe të dërguara në numrin 044 XXXXXX tregon se vetëm E.S. e kishte përdorur këtë telefon. R.A. kishte përdorur numrin 044 XXXXXX, I.A. kishte përdorur numrin 044 XXXXXX, A.B. kishte përdorur numrin 044 XXXXXX dhe N.S. përdorte 044 XXXXXX.

Kur këta artikuj ishin analizuar, ishin identifikuar emra të ndryshëm kontakti dhe numrat e tyre që japin një tregues të qartë se kush përdorte cilin numër dhe se cilët ishin pseudonimet e tyre. PM # 3 dhe # 3.1 të dyja përmbajnë kontaktin “E.S. S.” afër numrit 044 XXXXXX ndërsa PM #NS#1, një telefon mobil Nokia, përmban numrin e njëjtë dhe emrin “E.S.” Gjithashtu, i pandehuri kishte nënshkruar një marrëveshje për të hapur një llogari bankare me datën 07.05.2007 me emrin e klientit që është E.S. dhe numrin e telefonit mobil 044 XXXXXX. N.S. e kishte pohuar gjatë dëshmisë së tij se E.S. “kishte në posedim numrin 044 XXXXXX dhe asnjë numër tjetër¹⁶⁸”. Një tjetër telefon mobil Nokia PM #NS1 gjithashtu kishte emra dhe numra. Shumica nga ta ishin emra dhe pseudonime të njohura siç është A. (A.By. ose S.), L. (I.), R. (R.), N.S.i dhe K. (N.Se.). Megjithatë, me rëndësi të madhe është kontakti nën numrin e të pandehurit 044 XXXXXX. Ishte Q. Kjo është shkurtesë për pseudonimin Q.. I pandehuri gjithashtu i kishte pranuar dy SMS-a nga N.S.i në pasditen e vrasjes që e kishin informuar atë që R.I. kishte dërguar paratë: në ora 13:07:10 dhe në 15:58:12, që është edhe një dëshmi më shumë se kishte qenë i pandehuri ai i cili kishte qenë në posedim të këtij numri të telefonit gjatë gjithë kësaj kohe. Kjo provë në mënyrë të qartë dhe pa asnjë dyshim dëshmon se deklarata e N.Se. nuk është asgjë më shumë se një gënjeshtër e montuar për të cilën ai duhet të ndiqet penalisht.

Nevojiten komente shtesë për sa i përket regjistrimit dhe përgjimeve për të dëshmuar se E.S. në ditët para vrasjes i kishte dhënë urdhra I.it, R.A.t dhe A.B.. E para nga një seri mesazhesh është:

<u>01.08.2007</u>	044 XXXXXX	044 XXXXXX	<i>Qopa më thirri, do të pres ty te Sharbant.888831</i>
12:56:30	R.A.	A.By.	

¹⁶⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 23.07.2015, f. 15

Kjo e paraqet R.A. duke ia përcjell A.By.t faktin se i pandehuri – Q. po jepte urdhra nga lartë. Numri i cekur 888831 është i rëndësishëm pasi që ky është numri mobil i A.B..

Edhe një tjetër shkëmbim kishte ndodhur më 23.08.2007, dërguar nga E.S. për të tjerët që do merreshin me organizimin e ahengut. Nga këto mesazhe tekstuale, E.S. paraqitet si ai i cili jep urdhra dhe në fakt është kryesori. Këto mesazhe tekstuale janë të rëndësishme pasi që së bashku me dëshmitë e tjera objektive, ato paraqesin rolin e këtij të pandehuri që luan rolin më të rëndësishëm në këtë rreth të njerëzve.

Më 27.08.2007 kishte pasur një shkëmbim të mesazheve tekstuale në mes të I., R. dhe E.S., është fjala për grafikun e mësipërm. Këto mesazhe janë të rëndësishme së madhe pasi që ato qartazi tregojnë se ky grup me herët kishte planifikuar për ta varur T.R..

R. kishte diskutuar me I. duke e pyetur atë se ku duhej të shkonte ai. Disa minuta më vonë, i pandehuri e kishte kontaktuar atë dhe donte të dinte se ku është ai dhe me kënd. E.S. qartazi ishte kryesori dhe i udhëhiqte I. dhe R.. Disa orë më vonë, R. kishte komunikuar me I. duke i thënë atij se “Q.” pseudonim ky i E.S., i kishte thënë atyre të vinin duke vrapuar. Ata ishin të shqetësuar dhe nuk dinin çfarë të bënin. Disa minuta më vonë, R. kishte vënë kontakt me të pandehurin duke e pyetur nëse ai duhej të shkonte drejt kafes apo te vendi. Më vonë, pasi që kishte shkuar te lokacioni ku ishte udhëzuar nga i pandehuri, I. kishte kontaktuar me R., duke dashur të dinte se ku ishte i pandehuri dhe duke i thënë R. se çfarë bënin ai dhe A.B. (“unë jam në AM/PM duke u sjell vërdallë me B., pseudonimi i A.B., duke e kërkuar atë shokun, a është Q. atje lartë?”). Domethënia e këtij mesazhi është më se e qartë. Pa asnjë dyshim, I. ishte me A.B. në të njëjtën kafene që pas katër ditësh do të ishte T.R., para se të qëllohej jashtë tij në parkingun e veturave. Nuk ka asnjë dyshim se ai shoku është T.R. Mesazhi i fundit ishte nga I. për të pandehurin. Ai qartazi tingëllonte i shqetësuar gjersa shpjegoi se si ai dhe R. ishin sjell vërdallë dhe nuk kishin mundur ta gjenin T.R. Por ata i premtuan të pandehurit, **“do të kryhet, do ta shohësh se do të kryhet.”** Atë natë, të gjithë ishin munduar ta gjenin T.R. por nuk e kishin gjetur. Ata i raportuan shefit të tyre, Q., E.S., dhe i kishin thënë se T.R nuk ishte kapur këtë herë. Kjo sekuencë e mesazheve tekstuale qartazi tregon se ata kishin dashur ta kapnin T.R por kjo kishte dështuar sepse ata nuk kishin mundur ta gjenin vendndodhjen e tij as në kafenenë në të cilën T.R.i zakonisht shkonte. I pandehuri drejtpërdrejtë është i lidhur me këtë seri të mesazheve shumë të qarta. “Ushtarët” e tij raportuan problemin që ata hasën por ata premtuan se do ta bënin

atë që pritej nga ta. Të gjitha këto komunikime të rëndësishme vërtetohen nga provat e tjera se i pandehuri ishte në pozitë komanduese, se kishte urrejtje ndaj T.R., se A.B. ishte anëtar i bandës siç tregohet nga dëshmia e dhënë, dhe gjithashtu me fotot dhe videon e tij se punonte drejtpërdrejtë për E.S. si punëtor dhe vartës i tij i bindur.

Një pjesë e rëndësishme e këtij mozaiku janë dy mesazhe të tjera që qartë demonstrojnë pa asnjë fije dyshime se Q. ishte i pandehuri, që B./B. ishte A.B. dhe se Q. i jepte urdhra të gjithë atyre dhe se ai vazhdimisht donte të dinte se ku ishin të gjithë ata dhe çfarë bënin.

<u>29.08.2007</u> 21:17	044 XXXXXX I.A.	044 XXXXXX A.B.	(I.) k_trimave2_3 (A.) lakrishnja_1	<i>B., merre R. dhe hajde lart ulu me filanen nga Suhareka, mashtroje, sepse Q. i ka dy tani, tha Q.</i>
<u>30.08.2007</u> 00:13:45	044 XXXXXX R.A.	044 XXXXXX I.A.	(I.) bardhoshi_3	<i>Q. dëshiron që ta dijë unë se ku je, çfarë t'i them atij</i>

Ekziston edhe një provë tjetër që e lidh A.B. me E.S.. Prova e qartë që A.B. në të vërtetë e kishte vozitur furgonin për S. mund të gjendet në mesazhet tekstuale:

<u>01.09.2007</u> 13:02	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.	<i>Oh Zot, ai është vrarë nga qyqari më i madh.</i>
<u>01.09.2007</u> 13:04	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.	<i>Ai i cili ka ndenjur me L. gjatë gjithë kohës <u>dhe ka vozitur kamioncinën e B. Cafë</u></i>
<u>01.09.2007</u> 13:08	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.	<i>Ai e shoqëronte L., ai shtrej se ishte truproja e L.</i>
<u>01.09.2007</u> 13:17	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX Z.I.	<i>Z., çfarë budallai është A., nts nts ntss!</i>
<u>01.09.2007</u>	044 XXXXXX	044 XXXXXX	<i>Ti e din kush e ka vra atë, <u>njëfarë A. që e shoqëronte L.</u></i>

13:56	F.S.	A.C.	
<u>01.09.2007</u> 13:59	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX A.C.	Po, ata thonë se ai ishte arrestuar. E.S.i është në arrati
<u>01.09.2007</u> 14:03	044 XXXXXX A.C.	044 XXXXXX F.S.	Pra është A. i cili e kishte shoqëruar L., kështu po thonë, ajo që po flitet, ku je ti, çfarë të bëjmë, bir, puna mundet me u bë mut
<u>01.09.2007</u> 14:06	044 XXXXXX F.S.	044 XXXXXX A.C.	Po, ai i cili e kishte shoqëruar L., L., R., E.S.i, K. janë në kërkim, po shkruan një gazetë

Këto mesazhe tekstuale janë dërguar nga F.S., një dëshmitar që ishte i afërt me E.S. dhe grupin e tij, i cili rrinte me ta dhe dinte shumë se kush ishin anëtarët e grupit S. dhe dinte për aktivitetet e tyre. Këto SMS-a ishin dërguar ditën e nesërme pas vrasjes në mënyrë shumë spontane, siç duket F.S. ishte ende nën emocione dhe dëshironte ta ndante këtë informacion në mënyrë të sinqertë me Z.I.. Sidoqoftë, A.B. e pranoi se ai ka vrasë T.R, por thelbi i këtij komunikimi është se çfarë ka thënë F.S. për A.B.. Ai e ka përshkruar atë si: **”Ai i cili ka ndenjur me Lizën gjatë gjithë kohës dhe që ka vozitur kamionçinën e B. Café”**. Fakti që A.B. ka vozitur kamionçinën e B. Café ishte një fakt i rëndësishëm për të vërtetuar gjendjen faktike dhe përgjegjësinë e të pandehurit, pasi që A.B. gjatë punës së tij për S. ishte konsideruar si njëri nga njerëzit e tyre besnik i cili, siç e dëshmoi e ardhmja, kishte vrasë T.R pa ndonjë arsye personale por duke e realizuar dëshirën e E.S..

Njëra nga provat më të rëndësishme të mbledhura në këtë gjykim ishte trekëndëzimi (gjurmimi i telefonave mobil) që e ka ndihmuar këtë gjykatë përmes një rikrijimi të saktë të rrjedhjes së ngjarjeve në këtë ditë kritike. Gjithashtu ishte provë kyçe shqyrtimi i deklaratave të të pandehurit dhe verifikimi nëse qasja e tij mbrojtëse do konsiderohej si e besueshme apo si përpjekje për t’iu shmangur përgjegjësisë penale.

Trupi gjykues vendosi ex officio të pranoi një provë të re të trekëndëzimit (gjurmimi i telefonave mobil) në përputhje me nenin 329.4 të KPP-së që parasheh me sa vijon:” Përveç provave të propozuara nga palët dhe i dëmtuari, trupi gjykues ka të drejtë të shqyrtojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale.”.

Duhet të theksohet me vendosmëri se trupi gjykues është plotësisht në dijeni për kufizimet kohore që parashihen me Ligjin nr. 04/L-109 mbi komunikimet elektronike por megjithatë kufizimet kohore nuk aplikohen në këtë çështje.

Problemi me mungesën e definicionit të duhur të përgjimit të ligjshëm të telekomunikimeve në Kosovë është se ai krijon vështirësi në aplikimin e ligjit në mënyrën e duhur. Definicioni i shprehjes së përgjimit të telekomunikimeve përshkruhet në nenin 87.5 të KPP-së si në vijim:” *Shprehja përgjim i telekomunikimeve do të thotë përgjim i komunikimeve zanore, komunikimeve tekstuale ose komunikimeve tjera përmes rrjeteve të telefonive fikse apo mobile. Kjo përfshinë çfarëdo mjeti apo sistemi tjetër të ngjashëm teknologjik që bartë të dhëna që kryesisht kanë për qëllim të jenë private.*”. Ky trup gjykues ishte i mendimit se vetëm përmbajtja e përgjimit të telekomunikimeve siç përshkruhet më lartë është e mbrojtur me kufizimet kohore.

Ky definicion nuk përfshinë Meta-të dhënat në kuptim të të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me komunikimet që janë subjekt i urdhrimit të ligjshëm për përgjim, përfshirë, *inter alia*, kohën, kohëzgjatjen, origjinën, destinimin, lokacionin dhe llojin e pajisjes apo mjetit të përfshirë në komunikime, por duke përjashtuar përmbajtjen e komunikimit, sipas nenit 3 të Ligjit nr.05/L-030 mbi përgjimin e komunikimeve elektronike. Këto Meta-të dhëna nuk mbrohen nga kufizimet kohore të ligjit mbi komunikimet elektronike.

Trekëndëzimi ishte me rëndësi të madhe për këtë trup gjykues për të vërtetuar vijën e mbrojtjes të paraqitur nga E.S. pasi që mbetet në kundërshtim me dëshminë e tij lidhur me ditën kritike. E.S. ka ofruar informata të detajuara kur ai ishte paraqitur në kafene, cilat ishin aktivitetet e tij gjatë asaj dite.

Ky trup gjykues ka vendosur të përdorë të gjitha deklaratat e tij të ofruara nga i pandehuri, në përputhje me nenin 123 paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale që ofron si vijon: ***”Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit.”***

Gjatë hetimit kur është pyetur në lidhje me lëvizjet e tij në ditën e vrasjes, ai tha: "**Kjo ka qenë 7/8 vjet më parë. Nuk e mbaj mend.**" Ai pastaj vazhdoi duke thënë se e kishte kaluar mëngjesin në kafenenë e tij para se të kthehej në shtëpi në Vranjevc, ku ishte babai i tij dhe kunata e tij. Kur ai dëgjoi se policia kishte bastisur shtëpinë e N.S.it, ai u largua nga prona e tij dhe eci përgjatë rrugës Prishtinë-Podujevë, afër Albi Commerce. Ai pretendoi se policia ia kishte rrahur të atin dhe e kishte kërcënuar nënën e tij. Ai më vonë shkoi në shtëpinë e motrës së tij, M.A. tek Hani i Dilit ku qëndroi për disa ditë. Ai mohoi të ketë pasur ndonjë kontakt në mëngjesin e datës 30.07.2007 me I.in, R.A. apo A.B..

Deklarata e tij e procedurës paraprake mbetet në kundërshtim me deklaratën e tij për ditën e vrasjes që ai e kishte dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ai dëshmoi si në vijim:

Në ditën kritike ai shkoi në kafene si çdo ditë ose si shumicën e ditëve. Ai nuk kishte parë asgjë të dyshimtë kur shkoi në kafene dhe qëndroi atje deri në mesditë përafërsisht deri në ora 13:00. Ai qëndroi atje me personin e quajtur Y. me të cilin ai ishte ulur në të njëjtën tryezë. Ata diskutuan në lidhje me një ngastër që ai e kishte në mend t'ia shesë atij. Pastaj ai u largua nga kafeneja, mori veturën Golf III dhe filloi të shkojë në drejtim të shtëpisë së tij në Vranjevc; së bashku me Y. i cili u largua nga kafeneja së bashku me të. Ai u nda me Y. në skaj të lokaleve afariste tek semaforët. Më pas, krejt i vetëm, vazhdoi më tej në shtëpinë e tij në Vranjevc. Atje në shtëpi, ai gjeti vetëm bashkëshortin e vëllait. Ai u ul dhe qëndroi në shtëpi gjersa ajo ishte duke e përgatitur drekën. Babai i tij u kthye në shtëpi 10 minuta pas orës 16:00; kjo ishte zakonisht koha kur ai kthehej nga puna. Dhe kur kishte trafik të dyndur atëherë ai arrinte rreth 20 minuta pas orës katër. Bashkëshortja e vëllait e shërbeu drekën, ata hëngrën drekë, pinë çaj dhe u ulën atje si zakonisht dhe biseduan për pak kohë. Pak më vonë, nëna e tij u kthye nga dajhtë e tij, vëllezërit e saj; dhe pas pak kohe e ëma i tha se policia i kishte hyrë atje. Ata i ofenduan ata dhe u sjellën shumë keq dhe i thyen dritaret dhe dyert. Pas një farë kohe, ai doli në rrugë ku u takua me N.Se., djalin e axhës së tij. Ai nuk tha asgjë të veçantë apo të çuditshme, ai nuk kishte asnjë ide. Dhe me siguri ai ishte larguar nga kafeneja më herët sesa që policia kishte arritur atje rreth orës 17:30. Ai e mban mend se N. kishte për të shkuar në Gjermani tek motra e tij, dhe nëse ai nuk e kishte gabim ai kishte udhëtuar për në Shkup atë natë. Dhe ai e di me siguri se ai kishte qëndruar atje një muaj apo një muaj e gjysmë dhe ishte kthyer.

Menjëherë pasi u nda nga N., disa vetura të policisë erdhën atje dhe e rrethuan lagjen. Ai nuk e dinte se ku shkuan, sepse nga pamja e rrugës nuk mund të shihej hyrja e shtëpisë së tij. Ai qëndroi në anën e kundërt të shtëpisë së tij, përballë rrugës në pjesën e sipërme, derisa policia u largua, dhe më pas u kthye në shtëpi. Atje, ai mori vesh se ata kishin qenë në shtëpinë e tij, e kishin rrahur babain e tij dhe e kishin kërcënuar nënën e tij, duke i thënë asaj se ata do ta vrisnin djalin e saj, E.S..

Ky trup gjykues duhet të theksoj se çuditërisht E.S. e kishte një kthim të papritur prapa gjatë shqyrtimit gjyqësor në vitin 2016 dhe iu kujtuan të gjitha faktet e rëndësishme në kundërshtim me mungesën e kujtimeve themelore lidhur me itinerarin e tij në fazën e procedurës paraprake. Trupi gjykues është i mendimit se ky i pandehur e kishte miratuar vijën e tij të mbrojtjes në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor dhe provave të administruara, në përpjekje të kotë për të vërtetuar alibinë e tij. Provat objektive, domethënë të dhënat trekëndëzuese e zbehin plotësisht vijën e fabrikuar të mbrojtjes të këtij të pandehuri.

Numri mobil që ishte përdorur nga i pandehuri ishte 044728485. Në ora 00:19:41 menjëherë pas mesnate në ditën e vrasjes, është përdorur në antenën k_trimave2_1. Prej atëherë e tutje deri në orët e para të mëngjesit deri në ora 05:48:58, ai numër ishte i regjistruar në antenat k_trimave2_1 dhe shkolla_1. Këto antena janë të vendosura në veri të qytetit në zonën e Vranjevcit. Herën e fundit që ky numër ishte përdorur në zonën e Vranjevcit ishte në ora 05:48:58 në mëngjes herët në antenën k_trimave2_1. Duke filluar nga ora 06:36:55, ai kishte shfrytëzuar antenën m-dardania2 dhe prej atëherë e tutje, ajo ishte në përdorim të shpeshtë në qendër të qytetit kryesisht duke shfrytëzuar antenën m-dardania dhe lakrishtja_1. Të dy këto antena BTS mbulojnë zonën afër kafenesë S.. Nga të dhënat, nuk ekziston asnjë dyshim se i pandehuri u largua nga shtëpia e tij në Vranjevc herët që në mëngjes dhe ishte në ose në afërsi të kafenesë së tij nga ora 06:36:55 e mëngjesit e tutje. Kjo provë vërtetohet me deklaratën e dëshmitarit D2, kur ai deklaroi se ai e kishte parë E.S. rreth orës 08:00 në kafene.

Nga trekëndëzimi i të dhënave të numrit celular 044 XXXXX të E.S. mund të shihet se ky numër ka qenë vazhdimisht në përdorim gjatë gjithë ditës nga ora 06:36:55 e tutje në zonën e antenës së lakrishtes dhe antenës së stacionit bazë të Dardanisë (në ose pranë kafenesë S.), derisa aktiviteti i fundit ishte regjistruar në antenën m_dardania2 në ora 14:16:26, dhe në antenën lakrishtja_3 në ora 15:28:03. Asnjë aktivitet nga ky numër nuk ishte regjistruar në ndonjërin nga antenat që

mbulojnë zonën e Vranjevcit pas orës 05:48:58 të mëngjesit ose gjithë pjesës tjetër të ditës që dëshmon se i pandehuri nuk ishte kthyer në shtëpi për drekë dhe të qëndronte në shtëpi. Rreth të njëjtës kohë që kishte ndodhur vrasja, ky numër fillimisht mund të gjurmohet duke lëvizur në jug të qytetit nëpërmjet Grandstore / Fushë Kosovë. E.S. nuk ishte kthyer në shtëpi fare atë ditë, pasi që kishte ardhur që në mëngjes në kafene. Ky ishte një rrëfim që ai na kishte dhënë neve që ta mbulonte atë që ai në të vërtetë ka qenë duke e bërë. Arsyeja për atë është se E.S. dëshiron dëshpërimisht që ti shmanget përgjegjësisë penale për veprën penale me të cilën ai ishte akuzuar. Mund të shihet se në ora 15:36:25, numri i tij celular ishte regjistruar duke u përdorur në antenën euromedi_2 në Fushë Kosovë dhe tre minuta më vonë në ora 15:39:25, ai ishte duke e përdorur telefonin e tij në zonën e antenës grandstore_3 celular. Në të vërtetë në të njëjtën kohë që kishte ndodhur vrasja, ose sapo që kishte ndodhur, ai ishte duke u larguar nga qyteti (T.R bëri thirrjen e tij të fundit në ora 15:28:04 duke e përdorur numrin celular 044 XXXXX i cili është regjistruar në antenën ulpiana2_2 do të thotë se ai ishte ende gjallë në atë kohë). Sikur të mos kishte qenë i përfshirë, i pandehuri nuk mund të ketë pasur njohuri rreth vrasjes aq herët. Ka vetëm një arsye që mund të shpjegojë se pse ai ishte duke vrapuar gjersa vrasja ishte duke u kryer. Vetëm për shkak se E.S. i dinte të gjitha për vrasjen dhe ishte duke vepruar në bazë të planit të tij, ai u arratis nga qyteti. Nga Fushë Kosova, numri i tij celular ishte kap më pas nga antenat rreth zonës Shkabaj, Kastriotit dhe Bardhoshit. Edhe pse, sinjali i celularit të tij tani kërcente në zona më të mëdha të vendit ndërmjet antenave të ndryshme BTS, të dhënat tregojnë në mënyrë të besueshme se ai tash ishte jashtë qytetit. Ai qartazi ishte duke udhëtuar me veturë në jug dhe pastaj në përfundim të qytetit. Ai nuk ishte parë më deri në dorëzimin e tij në vitin 2012.

Trekëndëzimi është gjithashtu provë e rëndësishme që dëshmon se E.S. dhe grupi i tij kishin planifikuar dhe ekzekutuar T.R.

Të dy, A.B. dhe N.S. kanë deklaruar se A., I. dhe R. kanë dalë nga kafeneja S. së bashku pasdite herët. V.R. ka dëshmuar se ai dhe vëllai i tij T.R.i shkuan në Hotelin Grand në mënyrë që të bëjnë një dërgesë të djathit. V.R.i përshkruajti se si, gjersa ata ishin duke u larguar nga parkingu i veturave në Hotelin Grand, ai kishte parë R.A. që ishte duke qëndruar afër jashtë në rrugë duke i shikuar ata dhe duke folur me telefon. Siç ishte dëshmuar, vëllezërit R. në mënyrë të qartë ishin duke u ndjekur. Përveç R., edhe një tjetër anëtar i bandës, F.A., gjithashtu i kishte sytë në veturën me të cilën T.R.i dhe V.R. ishin duke udhëtuar. F.A. e kontaktoi I.A. në ora 14:06:58 duke e

dërguar atë SMS shumë të rëndësishëm që ishte duke e ndjekur T.R që më në fund përfundoi në vrasjen e tij.

<u>30.08.2007</u> 14:06:58	044 XXXX F.A.	044 XXXX I.A.	(F.) rilindja1_1 (I.) lakrishtja_1	<i>Vetura e fqinjit është në parkingun e Grandit</i>
-------------------------------	------------------	------------------	---	--

Sipas të dhënave trekëndëzuese, kur F.A. e kishte dërguar këtë mesazh, SMS ishte regjistruar me antenën rilindja1_1. Kjo antenë ishte e vendosur në lokacionin e ndërtesës së zyrës së qeverisë, në afërsi të Hotelit Grand. Të dhënat trekëndëzuese për numrin celular të T.R. 044XXXXX tregojnë se në të njëjtën kohë, T.R. ishte në zonën e Hotelit Grand për shkak se telefoni i tij celular ishte regjistruar në antenën art_foto_3 në ora 14:06:08. Ky trup gjykues e kuptoi këtë SMS se fqinji ishte T.R, për shkak se ai ka jetuar në anën tjetër të Bulevardit Bill Klinton nga kafeneja S.. Kur I.A. e kishte marrë SMS, ai ishte regjistruar me antenën lakrishtja_1 e cila është zonë e kafenesë S.. Pra, F.A. dhe T.R.i ishin në ose në afërsi të Hotelit Grand. Efekti i këtij SMS ishte i menjëhershëm. Ai ka prodhuar lëvizje të papritur nga anëtarët e tjerë të bandës të cilët me shpejtësi kanë lënë afërsinë e kafenesë S. dhe janë zhvendosur në drejtim të zonës së antenave tek rilindja dhe art foto. E.S. i cili kishte qenë në zonën e kafenesë S. në ora 14:17:14 ishte regjistruar gati menjëherë në rilindja_2 në ora 14:24:17.

Të dhënat trekëndëzuese për I.A.n (numri i telefonit 044XXXX) tregon se me marrjen e atij mesazhi të rëndësishëm nga F.A. në ora 14:06, edhe ai u zhvendos nga të qenit i regjistruar në antenën lakrishtja_1 në ora 14:07:50 (zona e kafenesë S.) në zonën ku kishte qenë F.A. dhe T.R. Ka shumë të ngjarë që A.B. ishte me I.in, pasi që të dy B. dhe edhe N.S.i thanë se A.B., I. dhe R. u larguan së bashku nga kafeneja. I.A. bëri thirrje të shkurtra, kur ai ishte tek rilindja1_2 (14:15:27 për 26 sekonda) duke e thirrur F.A., kur ai ishte në rilindja1_1 (14:20:28 për 30 sekonda) duke e thirrur R. dhe kur ai ishte në art_foto_3 (zona e Hotel Grandit në ora 14:25:33 për 9 sekonda) duke e thirrur R..

Në ora 14:26:31, edhe E.S.i kishte lëvizur në zonën e saktë të Grand Hotelit duke qenë në zonën e art_foto_3 pasi që ai e thirri I.A.n për 22 sekonda, i cili tani ishte në zonën radio_3. Krahasimi i këtyre pjesëve të informacionit çon në një përfundim logjik dhe tregon se pas marrjes së mesazhit të F. në ora 14:06:58, I., R. dhe E.S. ishin në kontakt me njëri-tjetrin menjëherë dhe se

I.A. dhe E.S. lëvizën drejt te zona e Grand Hotelit. Prej orës 14:25 deri 14:26, të dy, I.A. dhe E.S. tani ishin duke i përdorur celularët e tyre brenda zonës së vogël të art_foto_3 në Hotelin Grand, ku F.A. kishte parë veturën e T.R. në ora 14:06:58 dhe nga ku mobili i T.R. ishte regjistruar të jetë përdorur në ora 14:06:08. Kjo provë tregon qartë se këta individë kishin qenë duke e vëzhguar nga afër T.R, shkëmbyen informacione mbi vendndodhjen e tij dhe shkuan në lokacionin ku T.R qëndronte për të ekzekutuar planin e tyre vdekjeprurës për të vrarë atë.

Në ora 14:28:31, E.S. kishte qenë në zonën radio_2. I.A. ishte gjithashtu saktësisht në të njëjtën zonë të antenave në të njëjtën kohë, telefoni i tij celular u regjistrua atje në ora 14:28:27 duke e bërë shumë të mundshme që i pandehuri E.S. dhe I. ishin së bashku, ose shumë afër me njëri-tjetrin në rrugën kryesore në mes të Grand Hotelit dhe katedrales. Vendndodhja e R.A. nuk mund të përcaktohet nga të dhënat trekëndëzuese sepse ky material tani më nuk është në dispozicion. Megjithatë, regjistrimi tregon qartë se R. ishte në kontakt të shpeshtë me I.A. dhe I. ka qenë në kontakt me E.S..

Të dhënat trekëndëzuese dëshmojnë në mënyrë të plotë se në ora 14:54:52, T.R ishte regjistruar tashmë në zonën e antenës menza_3. Brenda pesë minutave, mobili i E.S. ishte regjistruar të jetë përdorur në ora 15:00:03 pikërisht në të njëjtën zonë të antenës të menza_3 kur i pandehuri kishte pranuar një thirrje prej 28 sekondave nga numri 044XXXXX. Kjo është edhe një provë tjetër se E.S. nuk ka qenë në shtëpi në Vranjevc duke pushuar në shtëpinë e familjes. Një referencë duhet të jetë mendimi i dëshmitarit ekspert të teknikut B.D. i cili shpjegoi se si antena të ndryshme BTS dhe antenat e tyre kishin funksionuar¹⁶⁹ dhe ai deklaroi se territori i një antene ishte nga qendra diku me sipërfaqe 100-150 metër ose rreze me një mbulim prej 65 dhe 90 shkallëve, shumica e tyre duke pasur mbulimin prej 65 shkallëve (f. 33). Kur u pyetën në mënyrë specifike në lidhje me përdorimin në ora 15:00:03, ai deklaroi se telefoni me siguri ka qenë duke operuar brenda zonës së njëjtë. Duke marrë parasysh dëshminë e B.D. ishte e pamundur që E.S. të kishte qenë në shtëpi në ora 15:00:03.

Në ora 15:09:55, T.R mori një telefonatë të dytë prej 35 sekondave nga telefoni fiks 038XXXX, thirrja e tij ishte regjistruar në antenën ulpiana2_2. Deri tani T.R.i ishte pa dyshim në kafenenë AM / PM pasi që dëshmitarë të ndryshëm e kishin konfirmuar. Në ora 15:10:44, R.A. (duke

¹⁶⁹ Shqyrtimi gjyqësor, 03.12.2015

përdorur numrin 044XXXXX) ia bëri një telefonatë të shkurtër prej vetëm 8 sekondave A.B.. Kur A.B. e pranoi atë thirrje ai tani **gjendej saktësisht në të njëjtën antenë** me T.R, ulpiana2_2. A.B. ishte duke pritur dhe shikuar, ndërsa u ul me pamje nga parkingu. Në ora 15:13:12, numri mobil i I. ishte regjistruar në antenën cannon_2. Antena BTS cannon ishte e vendosur në anën tjetër të Bulevardit Bill Klinton në zonën e katedrales dhe në një distancë shumë të shkurtër nga skena e vrasjes. Në ora 15:20:53, I. e kishte përdorur celularin e tij në një bisedë që zgjati 1 minutë e 15 sekonda dhe kjo ishte regjistruar në antenën ptk2_2, një zonë gjithashtu shumë afër me skenën e vrasjes. Në ora 15:37:21, I. e thirri R. për vetëm 4 sekonda, numri i tij ishte regjistruar në antenën cannon_2.

Në ora 15:28:04, T.R e kishte përdorur numrin e tij për herë të fundit për 56 sekonda pak para se të vritej. Ajo thirrje e fundit ishte regjistruar edhe në antenën ulpiana2_2. Në ora 15:39:12, I.A. ishte tashmë duke u larguar nga zona e përgjithshme e vrasjes, sinjali i tij ishte kap nga antena Victoria_1 (zona e kryqëzimit të rrugës në Hotel Victoria), kur ai ishte në kontakt me numrin e R.. Të dhënat trekëndëzuese treguan se ai u zhvendos në jug, pastaj në lindje dhe më pas në veri të qendrës së qytetit.

Ky trup gjykues mori parasysh diferencën kohore prej një ore në regjistrimin e SMS-ve siç shpjegohet nga operatori GSM. Vetëm tani, duke e korrigjuar kohën e serverit të SMS, SMS-at janë vënë si duhet në rend me provat e tjera dhe lëvizjet e kryerësve të krimit dhe viktimës. Sekuenca e mëposhtme e komunikimeve pas vrasjes pastaj ndodhi mes R.A. dhe A.B..

<u>30.08.2007</u> 16:04:53	044 XXXX R.A.	044 XXXX A.B.	00:00:18 (18 sek)	(A.) emshiri_3	
<u>30.08.2007</u> 16:05:00	044 XXXX R.A.	044 XXXX A.B.		(A.) lakrishtja_3	<i>Rri aty ku je, hyn brenda, të thërras më vonë</i>

Kontakti i fundit që A.B. e kishte me R.A. para vrasjes ishte në ora 15:11:31. Që nga ajo kohë, nuk është regjistruar asnjë aktivitet nga celulari i A.B. deri në ora 16:04:53. Në ora 16:04:53, R. e thirri A. dhe ata folën për vetëm 18 sekonda. A. ishte në zonën e antenës emshir_3. Emshiri është një lagje në afërsi të stacionit të autobusëve. Ky kontakt është shumë i rëndësishëm për vlerësimin e deklaratave të A.B.. Sikur të ishte e vërtetë që A. filloi papritmas të zihej me T.R dhe e kishte vrarë atë në një moment të çmendurisë pa përfshirjen e ndonjë personi tjetër, një njeri racional me siguri do të kishte pritur që A. të kishte qenë ai i cili do t'a kishte thirrur I. ose R. shumë shpejt pas vrasjes për të kërkuar ndihmë për të ikur. Por kjo nuk ndodhi. Vrasja ndodhi pak para orës 15:40. A. nuk ka qenë në kontakt me asnjë për rreth 25 minuta e cila është shumë e çuditshme në qoftë se e marrim seriozisht versionin e tij të ngjarjeve. Ishte R. ai i cili e thirri A.B. në ora 16:04 e jo anasjelltas dhe ata folën vetëm për 18 sekonda. Ekziston vetëm një konkluzion i qartë që të nxjerret nga kjo. A.B. nuk ka pasur nevojë që të kontaktojë dikë menjëherë pas vrasje së T.R.it pasi që çdo gjë ishte tashmë e planifikuar, çfarë do të bënte dhe ku do të fshihej. R. në atë telefonatë të shkurtër ishte duke e kontrolluar atë. Pastaj pasoi SMS-i i orës 16:05:00 prej R. për A. kur ai i tha atij që të qëndrojë aty dhe të hyjë brenda. A. tani ishte në zonën e antenës lakrishja_3 e cila është pjesë e antenës afër kafenesë S. dhe stacionit të autobusit. Gjatë gjithë kësaj kohe, ai me siguri ishte në zonën midis kafenesë dhe stacionit të autobusëve. Ky shkëmbim i informacionit ndërmjet R.A.t dhe A.B. i vendosur në rend të komunikimeve të tjera çon vetëm deri në një përfundim logjik se A. ishte duke e ndjekur një plan të parapërgatitur të arratisjes. Ai ishte duke marrë udhëzime për arratisje nga bashkë-kryerësi R.A..

Kontakti i ardhshëm me telefon mobil që A. e kishte pasur me R. nuk kishte qenë para orës 22:18:55 atë mbrëmje kur R. e thirri A.. A. ishte ende në zonën lakrishtja_3. Thirrja zgjati vetëm 50 sekonda. Menjëherë pas kësaj A. u thirr nga K.B. (e dashura e R.) dy herë në ora 22:36:55 (41 sekonda) dhe në ora 22:46:54 (28 sekonda). Kur të gjitha këto thirrje janë pranuar nga A., ai ishte ende në zonën lakrishtja_3.

Prova të tjera rrethanore të involvimit të R.A. në vrasjen e planifikuar vijnë nga mesazhet në vijim të cilat ai i shkëmbeu me të dashurën e tij të atëhershme K.B. menjëherë pas vrasjes vonë gjatë asaj pasdite.

<u>30.08.2007</u> 17:49:35	044 XXXX K.B.	044 XXXX R.A.	<i>Zemër, kush e vrau T.R.</i>
<u>30.08.2007</u> 17:56	044 XXXX R.A.	044 XXXX K.B.	<i>Nuk të intereson ty, kshyre punën tënde, ok</i>
<u>30.08.2007</u> 17:57:39	044 XXXX K.B.	044 XXXX R.A.	<i>Po, është, është, ti mundesh me u lidhë me ta e të burgosesh e çka do të bëj unë pa ty</i>
<u>30.08.2007</u> 18:00:58	044 XXXX R.A.	044 XXXX K.B.	<i>Zemër të thashë që kam qenë duke fjetur dhe më le rehat, a po më dëgjon</i>
<u>30.08.2007</u> 18:02:21	044 XXXX K.B.	044 XXXX R.A.	<i>Më fal i dashur, kjo është për shkak se po frikohem</i>

Vlerësimi logjik i këtij shkëmbimi të SMS-ve, i konsideruar së bashku me provat e tjera për R.A., të çojnë në përfundimin se R.A. ishte i përfshirë në vrasjen e T.R..

Ky trup gjykues e ka pa të nevojshme për të paraqitur një përmbledhje të deklaratave të E.S. të fazës paraprake dhe shqyrtimit gjyqësor për të treguar se si vija e tij mbrojtëse ishte përpunuar dhe iu kishte përshtatur provave me të cilat ai ishte ballafaquar. Kjo përmbledhje është e rëndësishme për ta përballur deklaratën e tij me provat e mbledhura, për të kuptuar marrëdhënien e tij të vështirë me A.I., konfliktet e mëtejshme që ai i kishte me T.R që çuan në vdekjen tragjike të këtij të fundit.

Gjatë fazës paraprake ai dëshmoi:

Deklarata nga marrja në pyetje në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me datën 28 shtator 2012

Ai ka qenë i gatshëm të dorëzohet për një vit rresht por ai kërkonte garanci që EULEX-i do merrej me këtë rast. Ai nuk ka asgjë të bëjë me vrasjen e T.R.. A.I. nuk i kishte dhënë atij para sepse ajo nuk kishte para as për vete. Përkundrazi, ai i kishte dhënë asaj para herë pas here dhe ai gjithashtu ia kishte dhënë asaj një qafore në vlerë prej 5 000 Eurosh.

Pjesën më të madhe të kohës ai kishte qenë jashtë Kosovës që nga lëshimi i urdhrit kundër tij më 14 shkurt 200. Ai ka pasaportë serbe dhe çeke në emër të tij dhe gjithmonë udhëton me këto dokumente dhe nën emrin e tij të vërtetë.

Ai është plotësisht i vetëdijshëm se ai është dënuar me dy vite burgim me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 27 tetor 2006. Megjithatë, ai ishte i bindur se ekzekutimi i këtij aktgjykimi ishte anuluar sepse shoku i tij A.By. i cili gjithashtu ishte gjetur fajtor dhe dënuar me tre vite burgim, nuk është dërguar në burg.

Ai frikësohet për jetën e tij sepse ka marrë shumë kërcënime dhe kishte pasur disa tentime për vrasjen e tij.

Dëshmia e E.S. në procedurën paraprake më 28 mars 2014

Ai ishte pronar dhe e udhëhiqte kafenenë S. së bashku me vëllain e tij N.S. në gusht të vitit 2007. Ai ishte një biznes i përbashkët me vëllain e tij N.S.. Vëllai i tij përkujdesej për lokalin dhe i paguante punëtorët. Ai vet asnjëherë nuk i paguante punëtorët dhe as nuk merrte paratë nga kafeneja apo rrogë. Ai as nuk e furnizonte kafenenë. Kafeneja S. ishte hapur më 18 nëntor 2005 për ditëlindjen e tij. Qarkullimi ditor i biznesit të tij ishte 200-250 EUR në ditë. Por kjo nuk ishte fitim. Kishte raste që ai fitonte 400 EUR në ditë.

Personat vijues kanë punuar në kafenenë S.: F.A. (punëtor), S.Ru. (punëtor), G.A. i cili është djali i motrës së tij, A.Ab. i cili gjithashtu është djali i motrës së tij dhe A.Se. i cili është djali i xhaxhait të tij. A.B. kurrë nuk kishte punuar për të. Ai mund të jetë marrë me veturë nga S. pasi që S. nuk ka pasur ndonjë listë të njerëzve të cilët ka mundur t'i marrë me veturë ose cilët nuk ka mundur t'i marrë. A.B. asnjëherë nuk ishte takuar me të dhe ai asnjëherë nuk ishte ulur në të njëjtën tavolinë me të apo të ketë pirë kafe me të. Ai as nuk ka qenë në asnjë ngjarje shoqërore me të asnjëherë. Ai nuk e din se sa herë A. kishte ardhur në kafenenë e tij sepse ai ishte në burg një kohë të gjatë dhe pastaj në arrest shtëpiak gjatë asaj kohe.

Ai ishte i fokusuar për sigurinë e tij. Ai kishte vetura të blinduara që nga viti 2003. Ndoshta ai kishte pasur shok apo kushëri afër kur ishte jashtë veturës së tij por asnjëherë nuk kishte pasur një truproje. Ai dilte pak në rrugë.

Ai nuk punonte me I.A. sepse ai e parapëlqente të punonte me njerëz më të pjekur. Ai merrej me vetura më të shtrenjta dhe me shitblerjen e banesave. R.A. kurrë nuk kishte punuar në kafenenë S.. Përveç personave të përmendur më lartë askush tjetër asnjëherë nuk kishte punuar për të dhe vëllain e tij. Personat e njëjtë kishin punuar nga dita e parë deri në të fundit dhe askush tjetër nuk ka punuar aty. I. dhe R.A. janë të afërm të afërt të tij.

Përveç se ishte pronar i kafenesë ai merrej edhe me shitblerjen e veturave. Ai gjithashtu jepte para hua por vetëm për miqtë me të cilët kishte biznes të ndërsjellë.

B. Café ishte një biznes i përbashkët me vëllain e tij N.S... Ajo gjendej në lokalet e ndarë nga kafeneja S., ku ishte depoja, por i ishte bashkangjitur kafenesë. Kjo pronë i takon atij dhe vëllait të tij. Që të dy ata udhëhiqnin kafenenë S. dhe B. Café. Ata ishin përfaqësuesit e B. kafesë dhe B. Café ishte depo nga e cila ata furnizonin kafenetë e tjera me kafe. Ai dhe vëllai i tij ishin marr me atë biznes gjatë asaj kohe. Një bashkëpunëtor i tyre i quajtur S. bënte transportimin. Ai përdorte një kamionçinë Opel të kuqe për transportimin e kafesë. Vetura kishte shenjat e “B. Coffee”. Ai gjithashtu më vonë kishte dy kamionçina Renault.

Ai kishte një Golf të zi të blinduar dhe një xhip Cherokee ngjyrë të gjelbër të mbylltë, i cili kryesisht vozitej nga vëllai i tij. Ai kurrë nuk kishte pasur një VW Passat të kuq. Ai kishte paguar 19 000 euro për Cherokee. Ishte reklamuar në Koha Ditore dhe ai e kishte blerë atë në ankand.

Ai nuk kishte kurrfarë marrëdhënie me T.R. T.R kishte qenë pjesëmarrës kur ai ishte sulmuar në Swiss Casino në vitin 2005. Ishte ky kontakti i parë që ai kishte pasur me T.R. A.S. ishte shkaktari i incidentit në Swiss Casino. Para vitit 2005 në Swiss Casino ai nuk kishte pasur asnjë kontakt me T.R. As si polic dhe as privatisht. Kishte disa djem dhe vajza atë natë në Swiss Casino: S., bashkëpronari i B. A.By., S.Se. dhe R.A.. A.Se. dhe N.S. ishin gjithashtu aty. Ai ishte masakruar gjatë incidentit dhe ishte lënë pavetëdije. A.S. kishte filluar incidentin kur ata po largoheshin. Ai kishte qenë përballë me A. në dalje. Ai qëllloi i pari dhe e rrahu atë. Pasi që N. dhe R.A. u larguan, rojet e sigurimit e mbyllën derën dhe i nxorën armët. Ata filluan t'i rrihnin ata. Ishte shtënë nga 5 – 6 armë. T.R ishte pjesëmarrës aty. Procesmbajtësit e shënuan se ai ishte i pranishëm. Ai nuk mund ta pohoj se T.R gjithashtu e rrahu atë. Ai nuk e kishte parë atë duke e goditur. Ajo që i kishin thënë personat e pranishëm atëherë, edhe rojet e sigurimit e kishin rrahur atë.

Ai është i bindur se incidenti i komunikacionit rrugor në Ferizaj nuk kishte asgjë të bënte me T.R. Atij i kishte thënë S.Q., (polic nga Ferizaj i cili kishte marr pjesë në gjithë atë që kishte ndodh në Ferizaj në vitin 2006) se çdo gjë vinte nga I.R.. Prandaj, ai nuk mund ta ndërlihd këtë incident me T.R.

Për herë të parë ai e kishte takuar A.I. në fillim të vitit 2003. Ai kishte një marrëdhënie me të. Ishte ndërprerë disa herë kur ai ishte dërguar në burg. Marrëdhënia kishte mbaruar në mesin e vitit 2004. Ai e mohon se gjatë kohës sa A.I. ishte me të në vitet 2003 dhe 2004 ai kishte zhvatur para nga ajo në shuma të ndryshme nga 100 deri në 9 000 euro. Gjatë viteve 2004/2005 ai nuk kishte dijeni për faktin se A.I. kishte filluar marrëdhënien me T.R. gjatë asaj kohe. Ai as nuk ishte i interesuar lidhur me atë se kush ishte me të. A.I. një muaj apo dy pas ndarjes kishte kërkuar nga ai që të pajtoheshin dhe të ishin përsëri bashkë por ai nuk kishte pranuar dhe aty kishte marrë fund. Ai nuk ishte në gjendje të ndiqte askënd. Për të ecja nëpër rrugët e Prishtinës ishte me rrezik të lartë. Ata kishin orkestruar gjëra pa bërë ai asgjë. Ata kishin ardhur ta merrnin atë në pyetje lidhur me bombat e hedhura përreth ndërsa ai gjatë asaj kohe ishte në spital.

Ai nuk mund të thotë me saktësi se çfarë kishte bërë ai më 30 gusht 2007. Ai mund të garantoj një gjë dhe ajo është se ai nuk kishte pirë alkool atë ditë. Ai kishte shkuar në lokalet e kafenesë S.. Ai kishte shkuar atje në mëngjes. Mbase ai kishte shkuar atje me veturën Golf 3 të blinduar. Ai kishte qëndruar në lokal. Ai ishte ulur afër banakut si zakonisht. Aty ishte ky personi Y. nga Mazgiti. Ai donte të blinte një ngastër toke. Kjo ngastër toke ishte te tregu i bagëtive në periferi të Prishtinës përtej Vranjevcit dhe ata kishin folur për këtë tokë. Rreth mesditës ai kishte shkuar në shtëpi por së pari ai e kishte lënë këtë personin Y. me veturë afër semaforëve. Në shtëpi ai kishte ngrënë drekë dhe kishte pushuar pak. Gruaja e vëllait të tij A. ishte gjithashtu aty. Ajo përgatiti drekën dhe pastaj babai i tij u kthye nga puna. Deri në mbrëmje ai kishte ndenjur në shtëpi. Nëna e tij nuk ishte aty kur ai kishte shkuar në shtëpi dhe më vonë ai e mori vesh se ajo kishte qenë te shtëpia e dajës N.S.. Kur ishte bërë terr nëna e tij u kthye. Ajo u kthye dhe i tregoi atyre se ishin vizituar nga policia dhe se ata kishin qenë rreth 20 apo 30 policë te dajallarët e tij. Ata ishin të maskuar dhe kishin hyrë me forcë në shtëpi gjersa gratë ishin duke pirë çaj. Policia kishte ardhur, i kishin ngacmuan dhe ofenduar ato.

Pasi që ai ishte larguar policia kishte ardhur në shtëpinë e tij. Ai kishte shkuar ta takonte N.. N. nuk dinte asgjë. Ai qëndroi me të për pak kohë dhe ata diskutuan planin e N. për të shkuar në

Gjermani. Pastaj ai pa policët kur u fut në oborret e romëve. Ishte në rrugën kryesore afër Albi Commerce. Aty kishte shumë vetura të policisë në atë rrugë dhe e tërë lagjja ishte rrethuar. Kur policia u largua ai u kthye në shtëpi. Ishte ora rreth 22:00 ose 22:30. Ai ende nuk e kishte idenë se çfarë kishte ndodhur gjatë kësaj dite. Më vonë ai dëgjoji se një polic ishte plagosur. Ishte në lajme në TV21. Familja e tij i kishte parë lajmet dhe ata i treguan se një polic ishte plagosur. Kur policia kishin shkuar në shtëpinë e tij ata e kishin rrahur babanë e tij dhe kërcënuar të ëmën dhe e kishin bërë shtëpinë lëmsh. Policia i kishte thënë nënës së tij se ata e kishin arrestuar N.S. dhe se E.S.i do të vdiste. Ata i kishin thënë nënës së tij që t'i tregoi atij se ata ishin B.O. dhe B.H.. Ai nuk e din saktë se sa kohë kishte qëndruar ai në shtëpi. Ai nuk kishte fjetur në shtëpi. Rreth orës 23:30 ai kishte shkuar në shtëpinë e motrës së tij rrugës për në Podujevë. Distanca në mes të shtëpisë së tij dhe shtëpisë së saj është gjysmë kilometri ndërsa hekurudha është përtej shtëpisë së saj. Ai nuk kishte shkuar atje nëpër hekurudhë. Ai kishte shkuar atje këmbë. Ekziston një rrugë e shkurtër e cila nuk është e asfaltuar dhe nuk ka as drita. Ai qëndroi në shtëpinë e motrës së tij disa ditë. Gjatë këtyre ditëve ai nuk ishte larguar aspak nga shtëpia. Disa ditë më vonë ai kishte shkuar në shtëpinë e tij dhe në lokal për të parë se si ishin gjërat në shtëpi. Më pas, ai kishte kaluar ca kohë në shtëpinë e njërit prej djemve të xhaxhait. Kjo kishte zgjatur tre muaj dhe pasi që N.S. ishte liruar ai ishte larguar nga Kosova.

Në mëngjesin e 30 gushtit 2007 ai ishte ulur me Y. në një tavolinë në kafenenë S.. Me ta nuk kishte persona të tjerë të ulur. Ai zakonisht e pinte kafën larg nga dera e hyrjes për t'iu shmangur ndonjë gjëje. Prandaj, ishte e pamundur që ai të shihte njerëzit që hynin dhe dilnin nga lokali.

E.Z. takohej me dajën e tij I.A.. Incidenti i supozuar i tetorit të vitit 2004 nuk kishte ndodhur asnjëherë. Ishte e pamundur, pasi që ai ishte në qendrën e paraburgimit në tetor të vitit 2004. Ai ishte plagosur dhe ishte në spital për 1 muaj, me roje policore 24 orë në ditë dhe pastaj ishte transferuar në një qendër të paraburgimit për 5 muaj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor E.S. ka deklaruar si vijon:

Procesverbali i dëshmisë së shqyrtimit gjyqësor e dhënë nga E.S. më 3 mars 2016.

Ai as nuk ka biseduar me A.B. në ditën kritike më 30 gusht 2007 dhe as nuk është shoqëruar ndonjëherë me të. Asgjë në jetë nuk e kishte lidhur me A.B.. Ai as nuk ka qenë në gjeneratën e tij

pasi që ka qenë shumë më i ri se ai, e as nuk ka pasur ndonjë lidhje familjare, biznesi apo ndonjë punë tjetër.

Ai nuk di asgjë në lidhje me ngjarjet në ditën kritike të datës 30 gusht 2007, siç përshkruhet në aktakuzë. Në lidhje me akuzat kundër tij, ai kurrë nuk e ka bërë këtë apo ndonjë lloj tjetër të bisedës as me A.B. e as me F.A. Kur është fjala për I.A. ata kishin lidhje familjare, ai ishte djali i dajës së tij. R.A. ishte kushëriri i tij dhe ka mundur të ketë qenë ndonjë bisedë familjare por asgjë më shumë se kaq dhe ato biseda kanë mund të ketë qenë shumë të rralla pasi që ata ishin shumë më të ri se ai në aspektin e gjeneratës që u përkisnin. Ata merreshin me disa vetura të lira, me 2000 dhe 3000 euro dhe kjo nuk ishte interesante për të.

Ai kurrë ndonjëherë në jetën e tij nuk ka orkestruar, organizuar e as nuk i ka interesuar atij që ta gjurmtojë T.R. Nëse ai do të donte që ta gjurmonte, a do të kishte kuptim që ta ndiqte atë me një veturë që është mbuluar tërësisht me reklamat e B. Café, një veturë që ishte e njohur në të gjithë qytetin pasi që ai ishte pronari i saj? Një veturë që T.R. e kishte parë çdo ditë, çdo të dytën apo të tretë ditë për shkak se ai banonte 200 deri 300 metra larg nga kafeneja. Kjo nuk do të kishte kuptim që T.R. dhe A.I. të ndiqen nga I.A. të cilin A.I. tashmë e kishte parë disa herë në shtëpinë e tij.

Dëshmitari D2 nuk është i besueshëm dhe ai nuk e ka thënë të vërtetën. Në ditën kritike ai nuk ka qenë në kafene në ora 6:00 siç e ka përshkruar D2. Ai kurrë nuk kishte dalë që të sorolletej atje në parking sepse dhjetë metra larg nga kafeneja S. mbrapa në vitin 2002 ka qenë e parkuar një veturë bombë nga e cila ai ishte plagosur rëndë. Edhe në qoftë se ai ka dashur që të sorolletej ai nuk e ka pasur sigurinë minimale për ta bërë këtë. Vend parkimi në fjalë nuk ka pasur asnjë kamerë të sigurisë e as ndonjë send tjetër. Çdokush në çdo kohë ka mundur të ketë parkuar çfarëdo lloji të veturës aty.

Ai nuk ka pasur asnjë punë me para. N.S.i nuk i kishte thënë asgjë atij kur ishte në kafene atë ditë. Ai as e kishte parë R. atë ditë, as nuk e kishte parë atë për vite dhe muaj para kësaj, por ai e njihte atë nga pamja. Ai gjithashtu e njihte babain e tij. Ai nuk e mban mend të ketë marrë ndonjë mesazh nga N.S.i në lidhje me paratë.

Numri 044 / XXXXX i përkiste N.Se.. N. rrinte në kafene çdo ditë, por kur ai ishte atje ai e përdorte atë herë pas here, por shumicën e kohës ai numër i telefonit ishte në kafene, edhe në qoftë se N. nuk ishte aty.

Numrin tjetër 044 / XXXXX ai ia dha një A. nga Ferizaj. Ai nuk e di mbiemrin e tij por ai ka punuar me të për një periudhë të gjatë kohore. Ata kishin bashkëpunim për dritare dhe dyer. Ky person nuk ishte i njohur për asnjë nga familjarët e tij, përveç N.S. dhe A.By., të cilët e kishin takuar atë nëpërmjet tij dhe kishte blerë shumë dritare dhe dyer prej tij.

A. e kishte lutur që t'ia shiste telefonin atij dhe i kishte thënë atij se ai do t'i jepte atij, si një dhuratë. Ai gjithashtu donte që ta largonte atë numër, sepse ai ishte i ngjashëm me zyrën qendrore postare dhe kishte pranuar shumë telefonata.

Ai kurrë nuk kishte marrë ndonjë telefonatë e as nuk i ka bërë kurrë një telefonatë A.B., i cili e kishte vrarë T.R. Ai kurrë nuk kishte pranuar ndonjë mesazh me tekst, as nuk i kishte dërguar atij e as nuk ia dinte numrin atij.

A.B. kurrë nuk kishte punuar me të apo me N.S.; ose me dikë tjetër që ishte i afërt me të. Askush nuk kishte shkëmbyer telefonata me A.B., as unë, as N.S., dhe askush nga anëtarët e mi të ngushtë të familjes. Edhe ai nuk ka mund të ketë qenë duke punuar në B. Cafe pasi që ai nuk kishte leje për vozitje, siç tha ai. Përveç lejes për vozitje për të punuar në kafenenë B. ju duhet të keni njohuri për të rregulluar makina për kafe ekspres, për të vendosur mullinj që e përgatisin kafe, pompa të makinave, të dini shumë për ujin dhe energjinë elektrike, për të montuar dhe çmontuar makinat në kafene të ndryshme; gjërat që ai nuk e di fare, e as N.S.i. Këto çështje janë kryer nga S., partneri i tyre, dhe një tjetër djalë që vinte me të i cili quhej S. dhe i cili kishte punuar me S. për një kohë të gjatë, në kohën kur ata nuk ishin duke punuar me të. Ata hynë në atë kompani si partnerë dy ose tre muaj para rastit. Në aktakuzë është përshkruar se ata i kishin ndjekur me muaj dhe vite me vetura të B. Cafés, T.R.in dhe A.I.. Ajo veturë nuk kishte asgjë të bënte me të apo me familjen e tij. Anëtarët e tij të familjes kurrë nuk e vozitën atë veturë, edhe kur ata punonin kohëve të fundit. S. ishte përgjegjës për veturën, për të dhe S., ata kanë mund të kenë shkuar kudo dhe t'ia japin kujt të dëshirojnë, kjo nuk ishte prona e tij.

Ai garanton se A.B. nuk ishte shoqëruar me të apo N.S.in. Dhe se ai nuk ka punuar më parë me të apo me S. në B. Café. Ai gjithashtu garanton se A.B. nuk ishte truproja e tij dhe se ai nuk ka

punuar në kafenenë "S.", as edhe për një orë, e lëre më për një ditë. Ai as nuk ka qenë truproja e I.A.; Ai ka dëgjuar se ata nuk ishin shoqëruar por I.A. nuk e kishte atë lloj të buxhetit për të paguar truproje dhe ai kurrë nuk ka qenë i rrezikuar nga askush.

Në ditën kritike ai shkoi në kafene si çdo ditë ose pjesën më të madhe të ditëve. Ai nuk kishte parë asgjë të dyshimtë kur shkoi në kafene dhe ai qëndroi atje deri në mesditë deri në ora 13:00 përafërsisht. Ai qëndroi atje me Y. me të cilin ai ishte ulur në të njëjtën tryezë. Ata diskutuan në lidhje me një ngastër që ai kishte për qëllim t'ia shes. Pastaj ai u largua nga kafeneja dhe mori automjetin Golf III dhe filloi të shkojë drejt shtëpisë së tij në Vranjevc; së bashku me Y. i cili u largua nga kafeneja së bashku me të. Ai u nda me Y. në skaj të lokaleve afariste në semafor. Më pas, krejt i vetëm, ai vazhdoi më tej në shtëpinë e tij në Vranjevc. Atje, në shtëpi, ai mundi të gjej vetëm bashkëshorten e vëllait të tij. Ai u ul, qëndroi në shtëpi gjersa ajo ishte duke përgatitur drekën. Babai i tij u kthye në shtëpi 10 minuta pas orës 16:00; kjo ishte zakonisht koha kur ai kthehej nga puna. Dhe kur kishte trafik të dyndur atëherë ai arrinte rreth 20 minuta pas orës katër. Bashkëshortja e vëllait e shërbeu drekën, ata hëngrën drekë, pinën çaj, u ulën atje dhe si zakonisht ata biseduan për pak kohë. Pak më vonë, nëna e tij u kthye nga dajhtë e tij, vëllezërit e saj; dhe pas pak kohe e ëma i tha se policia hyri atje. Ata i kishin ofenduar ata dhe ishin sjellur shumë keq dhe i kishin thyer dritaret dhe dyert. Pas një farë kohe, ai doli në rrugë ku u takua me N.Se., djalin e axhës së tij. Ai nuk tha asgjë të veçantë apo të çuditshme, ai nuk kishte asnjë ide. Dhe me siguri ai ishte larguar nga kafeneja më herët sesa që policia kishte arritur atje rreth orës 17:30. Ai e mban mend se N. kishte për të shkuar në Gjermani tek motra e tij, dhe nëse ai nuk e kishte gabim ai kishte udhëtuar për në Shkup atë natë. Dhe ai e di me siguri se ai kishte qëndruar atje një muaj apo një muaj e gjysmë dhe ishte kthyer.

Menjëherë pasi u nda nga N., disa vetura të policisë erdhën atje dhe e rrethuan lagjen. Ai nuk e dinte se ku shkuan, sepse nga pamja e rrugës nuk mund të shihej hyrja e shtëpisë së tij. Ai qëndroi në anën e kundërt të shtëpisë së tij, përballë rrugë në pjesën e sipërme, derisa policia u largua, dhe më pas u kthye në shtëpi. Atje, ai mori vesh se ata kishin qenë në shtëpinë e tij, dhe se e kishin rrahur babain e tij dhe e kishin kërcënuar nënën e tij, duke i thënë asaj se ata do ta vrisnin djalin e saj E.S..

Pasi që B.H. i kishte thënë nënës së tij para 20 policëve se ai do ta vriste djalin e saj dhe pas incidentit në Ferizaj ai ishte i sigurt se ata nuk do të ngurrnin ta vrisnin atë. Për të gjitha këto arsye ai u largua nga shtëpia e tij.

Ai qëndroi dy deri në tre netë tek shtëpia e motrës së tij dhe më pas u kthye në shtëpi. Ai qëndroi për disa ditë tek djali i dajës së tij, tek njëri prej tyre dhe pas disa muajve N.S.i u lirua nga burgu dhe u kthye në shtëpi. Pastaj ai shkoi në Republikën Çeke pasi që ai tashmë kishte dokumente të rregullta të republikës Çeke.

Motra e tij S.S. kontaktoi me pjesëtarët e KFOR-it me kombësi suedeze dhe kërkoi prej tyre garanci për jetën e tij, por ata nuk mund të garantonin për jetën e tij dhe e gjithë kjo ka zgjatur për disa muaj. Për këtë arsye ai u dashtë që të largohet për të siguruar jetën e tij.

Ka ndodhur që ai të ketë takuar T.R disa herë në qytet, por ai asnjëherë kurrë nuk ka pasur as edhe incidentin më të vogël.

Procesverbali i dëshmisë së shqyrtimit gjyqësor të dhënë nga E.S. me 7 mars 2016.

Ai kurrë nuk ka pasur ndonjë incident të drejtpërdrejtë me T.R. Lidhur me rastin e "Swiss Casinos" edhe T.R ishte pjesëmarrës por ai incident ishte iniciuar nga A.Is..

Para "Swiss Casinos", ai nuk ka pasur asnjë kontakt personal me T.R. Kjo do të thotë se ai kurrë nuk ka hasur në të dhe kurrë nuk i ka folur atij; as si polic kurrë nuk e kishte ndaluar atë. - Ka pasur një rast kur T.R.i kishte provokuar vëllain e tij N.S.in në lagjen e quajtur Vranjevc, dhe pas atij incidenti vëllai i tij e raportoi T.R.in në Stacionin Policor numër 3. Por, kjo nuk ishte asgjë serioze, vëllai i tij ishte në veturën e tij dhe ai vetëm e shikoi T.R.in nga vetura tjetër dhe e pyeti: "Pse po më shikon "? Ai vet nuk ka qenë aty kur kjo ka ndodhur, por sipas N.S.it në atë kohë T.R ishte me veturën e tij private, ishte në rroba civile dhe i vetëm në veturë.

T.R kurrë nuk e kishte ndaluar atë dhe ata kurrë nuk kanë pasur ndonjë incident në mes veti as gjatë vitit 2000-2001 e as pas kësaj. Deri në fund të vitit 2000, ai u arrestua dhe u lirua diku në vitin 2001, kështu që ai nuk do të mund të kishte qenë i përfshirë në një incident, i cili dyshohet se ka ndodhur në vitet 2000-2001 në rrethin afër spitalit në Prishtinë, kur ai ishte brenda.

Ai nuk di asgjë në lidhje me pritën e pretenduar për T.R në Stagovë dhe ai nuk e di se ku gjendet Stagova. Hera e parë që ai kishte dëgjuar për këtë ishte gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kur dëshmitarët u shfaqën këtu në podium dhe folën në lidhje me këtë ngjarje.

Ai kurrë nuk kishte dëgjuar se veturës së T.R. iu kishte vënë zjarri ose që dikush kishte folur në lidhje me këtë ngjarje. Ai kurrë nuk kishte pasur ndonjë bandë dhe T.R. kurrë nuk ishte ndjekur ndonjëherë nga ndonjë anëtar i familjes së tij. Ata nuk kishin kurrfarë arsye për të ndjekur atë që të flasim për kohën para rastit të Swiss Casinos: ai atëherë as nuk e njihnte T.R.. Dhe ai nuk e njihnte atë edhe pas incidentit në Swiss Casino pasi që nuk ishte ai që e kishte filluar atë incident. Ai i akuzoi ata para policisë / prokurorisë kështu që i mbetej drejtësisë që të merrej me ta.

Është një rast kur ai e kishte raportuar një person me emrin F.V. dhe gjithashtu e kishte raportuar T.R dhe kjo kishte ndodhur diku në vitin 2006. Është një rast, kur F.V. ishte përpjekur që ta godasë atë me veturë por nuk ia kishte dalur dhe në vend të kësaj ai e kishte goditur veturën e T.R.. Dhe që nga ai rast ata shkuan menjëherë në polici dhe e raportuan rastin. Policia i mbajti ata pak më gjatë rreth gjysmë ore, kur ata e kuptuan se për çfarë ishte kjo dhe për kë. Pastaj ai kërkoi nga policia që të shkoi në vendin e ngjarjes dhe të shihnin xhamat e thyer si dhe dëmet e veturës por ata nuk u pajtuan me këtë.

Në ditën e incidentit në Swiss Casino ai ishte në kafenenë "S.", ishte festa e Krishtlindjeve, disa nga mikeshat erdhën në kafene për të pirë dhe ato i thanë se ishte duke ndodhur një festë në Swiss Casino dhe kështu ata shkuan atje. Më vonë në kohën kur duhej të mbyllej puna në kafene ata shkuan në Swiss Casino. Ata qëndruan në kafenenë "Queen's" dhe më pas hynë në Swiss Casino. Aty ishte një turmë e madhe e njerëzve për festë. Kjo ishte hera e parë që ai ishte brenda asaj kafeneje. Para hyrjes ishin disa roje të sigurisë të cilët i kontrolluan ata me duar. Kështu, ata vazhduan në katin e poshtëm në bodrum dhe morrën pije. Së bashku me të ishte A.By., në hyrje ata takuan S.Se. dhe S.Su., i cili në atë kohë ishin duke e menaxhuar restorantin në afërsi të kafenesë "S." dhe gjithashtu edhe përfaqësues i "B. Cafe", por në atë kohë ata nuk kishin asnjë lloj bashkëpunimi . Ata qëndruan aty për rreth 15 minuta, gjatë kësaj kohe ato vajza erdhën dhe u përshëndetën me ata, përkatësisht F.M. dhe miqtë e saj. Pra, ata janë përpjekur që të largohen nga mjediset e kafenesë. Në këtë kohë R.A. dhe N.Se. tashmë kishin dalë nga kafeneja. Kur ata dolën nëpër dyer djemtë e sigurisë i mbyllën dyert. Kjo ka ndodhur në hyrje nga shkallët. Pastaj papritmas ai e gjeti veten ballë për ballë me A.S., i cili ishte i pari dhe më pas pjesa tjetër ishte

rreshtuar pas tij. Ishte një turmë e madhe, dhe në mesin e tyre ai e njohu edhe T.R. Nga ajo turmë e madhe ai e njohu T.R. Ai e njihte vetëm A.S.n dhe përveç tij ai e njihte edhe T.R. Sa i përket tre apo katër personave të tjerë ai nuk i njohu atëherë dhe nuk i njeh as sot. Në këtë kohë A.S. e kishte goditur atë me shpatullat e tij, me fuqi të lartë. Ai e shtyu atë prapa dhe pastaj ata e shtynë përsëri në kafene ku ishte më parë. Në fillim aty kishte shumë njerëz dhe ata nuk mund të shihnin se çfarë po ndodhte, në pjesën e prapme të hyrjes ata filluan të ziheshin me N.Se. dhe A.By., ata ishin rrahur. T.R mbeti prapa tij në kafene; atëherë armët filluan të shtënat. Në këtë moment T.R e kapi atë për shpatulla dhe u përpoq ta shtyjë atë në drejtim të vendit ku kjo trazirë ishte në vazhdim e sipër. Pastaj dora e T.R.it rrëshqiti nga shpatullat e tij dhe e goditi atë në fytyrë, jo aq shumë sa ishte në shpatullat e tij. Pastaj A.S. erdhi dhe e goditi atë prapa kokës me një pistoletë, dhe më pas ishin qëlluar edhe disa të shtëna, dhe ai nuk e di çfarë ka ndodhur më vonë për shkak se ai ishte pa ndjenja. Ai u zgjua në spital. - Vetë, në çdo kohë, madje edhe me policinë ai e mbante përgjegjës A.S.n, sepse ai ishte i vetmi që kishte filluar gjithçka.

Në lidhje me rastin e Ferizajit, në ditën kritike ai shkoi në Ferizaj për të shikuar inventar për ballkonin e kafenesë "S.". Pas kthimit të tij nga Vitia, ai kishte biseduar me ish të dashurën e tij A.A., dhe pastaj ata e kishin caktuar për tu takuar shkurtimisht për 5 minuta. Gjatë kohës kur ai priste për ta takuar atë, erdhi policia me 3, 4 apo 5 vetura. B.H. ishte aty me një veturë private dhe në rroba civile, vetura ishte një Mercedes me ngjyrë gri. Ai iu afrua veturës së tij dhe e goditi dritaren me një pistoletë. Kur ai e pa atë me një pistoletë ai mendonte se ishte një anëtar i bandës dhe deshi që të shtiej në të. Dhe ai nuk e hapi derën e veturës derisa erdhën zyrtarët e uniformuar të policisë. Aty kanë qenë më shumë se 20 policë dhe në minutën që ai e hapi derën ata e kapën për shpatulla dhe e hodhën në tokë dhe ata vepruan kështu edhe me personat që ishin me të në veturë, X.D.n dhe një person që quhej P. nga Vitia. Ai e mori atë me vete, sepse ai e njihte atë zonë të qytetit dhe e dinte se ku ishin punëtoritë me inventar. Pipi ishte mik me X., ai nuk ishte mik i tij, dhe policët filluan që ti rrahin ata duke i shkelmuar dhe i goditur. Ata i mbajtën të shtrirë për tokë për 20-30 minuta, dhe pastaj i futën në bagazhin e veturës dhe i dërguan në stacionin policor. Ai ishte në bagazhin e veturës dhe nuk mund t'i shihte të tjerët, pastaj ata e sollën veturën e tij Golf në stacionin e policisë. Kur ai i pa sjelljet e tyre ai i kërkoi çelësat e veturës të tij për të siguruar që vetura ishte mbyllur. Ata iu përgjigjën atij që çelësat e veturës kishin humbur, ku me këtë ai e kuptoi se ata donin që të vendosnin diçka në veturën e tij. Pas një kohe ata sollën disa gjëra që ishin në veturën tij, por jo çelësat, atëherë erdhi avokati dhe pas një

farë kohe, kur ata iu afruan veturës ata vërejtën se bagazhi i veturës nuk ishte mbyllur si duhet. Pastaj ai e kuptoi se bagazhi i veturës së tij ishte hapur. Ai iu drejtua avokatit të tij dhe tha se ndoshta ata kanë vendosur mina, bomba, droga apo gjëra të tjera në bagazhin e tij dhe avokati tha se nuk ma merr mendja. Kur policia hapi bagazhin dhe bëheshin sikur po kontrollonin para tij, edhe pse ata e kishin kontrolluar atë më parë dhe kishin sjellur disa artikuj të tij në stacionin e policisë, ata u drejtuan për në bagazhin e veturës dhe e morën pistoletën që e kishin vendosur aty. Kjo ishte një pistoletë shumë e vjetër, shumë e keqe. Ata i çuan në spital, ku ai qëndroi për 3-4 ditë, dhe më pas e çuan në qendrën e parburgimit.

Këto akuza në pikën 2 të aktakuzës nuk janë të vërteta. Ai kurrë në tërë jetën e tij nuk kishte pasur ndonjë bisedë me A.I. në lidhje me të hollat, ose se sa ajo kishte fituar në koncerte apo kush i kishte marrë ato para, kurrfarë bisede. E vetmja gjë që ka qenë lidhur me paratë ishte një dhuratë që ai ia kishte dhënë asaj. Kjo ishte një qafore e cili kushtonte më shumë se 4000 euro. Ishte një komplet i byzylykut dhe qafores dhe ishte një si luan apo mace që ishte e kapur në qafore. Në një rast ai gjithashtu i kishte dërguar asaj një kartelë telefoni. Në atë kohë ato ishin shumë të shtrenjta, më shumë se 100 euro.

Ai ka qenë në marrëdhënie me A.I. për dy vjet. Kjo marrëdhënie filloi që nga fillimi i vitit 2003 dhe përfundoi në fund të vitit 2004. Më 18 nëntor 2004, A.I. e vizitoi atë në spital dhe i solli atij një dhuratë, një portret foto me nënshkrimin e saj dhe dorëshkrimin e saj. Mbishkrimi thoshte " Urime ditëlindjen, Eni im. Të uroj shumë përshëndetje për shumë vite që do të vijmë. Me respekt, e jotja AI "- Ai kurrë nuk ka qenë në shtëpinë e saj, ndërsa ajo ka ardhur tek ai shpesh. Sigurisht ajo ka ardhur me vullnetin e saj të lirë.

Ai kurrë nuk kishte pasur ndonjë problem me ndonjërin nga femrat në jetën e tij. Ai kurrë nuk e ka vërejtur as shqetësimin më të vogël me A.I.. Në një rast, ai i tha asaj se do të donte që të shkonin në pushime verore në breg të detit, por ajo u përpoq që të mos e lejonte atë që të shkonte në bregdet për pushime, sepse ajo donte që ai të qëndrojë me të gjatë gjithë kohës.

Ai kurrë në jetën e tij nuk ka kërkuar para nga A.I., sepse kjo do të ishte një veprim shumë çnjerëzor dhe shumë i ulët. Kjo nuk ishte kurrë një pjesë e natyrës së tij, apo në natyrën e familjes së tij që ta frikësonte apo shantazhonte një femër. Përveç kësaj, ai qëndronte shumë mirë

në kuptimin ekonomik, dhe kjo mund të vërtetohet me atë që ai ka thënë më parë se ai i kishte dhënë asaj dhurata me vlerë prej mija eurove.

Kur marrëdhënia e tyre u ndërpre në fund të vitit 2004, disa muaj më vonë ajo e takua këtë personin A.C.n, të cilin ajo e kishte caktuar për t'i thënë se ajo do të donte që të më shihte përsëri. Ai nuk e kishte dëshmuar këtë bisedë mes tyre, por kjo është mënyra se si mesazhi i ishte përcjellë atij nga A.C.. Ai erdhi dhe ia tregoi këtë atij në kafene. Ai nuk kishte asnjë lloj interesi që ta takonte prapë atë, sepse ai kishte dëgjuar nga mediat se pasi që ajo ishte ndarë nga ai ajo kishte filluar të takohej me një person të quajtur R.B.. Ai ishte më i interesuar që ta menaxhonte biznesin e tij dhe të merrej me çështjet e tij financiare në vend se të takohej me të. Nga dita që ai u nda me A.I., ai nuk ishte i interesuar ta dinte vendndodhjen e saj, kënd ajo ishte duke e takuar apo se çfarë po bënte. Dhe ky nuk ishte rast specifik vetëm me A.I.; kjo ishte edhe me të gjitha vajzat e tjera të cilat ai i kishte takuar.

Ai e kuptoi më vonë marrëdhënien në mes të A.I. dhe T.R. , sepse në fillim ai e dinte se ajo ishte duke u takuar vetëm me këtë R.B., por ai kuptoi për këtë marrëdhënie pas incidentit në Swiss Casino, gjersa ai ishte në spital duke u trajtuar . Dikush erdhi për vizitë, dikush që e njihte atë. Dhe ky person i tha atij se në ditën kritike ka pasur mundësi që A.I. ta kishte vozitur atë deri në Swiss Casino dhe se ata ishin në një marrëdhënie.

Pasi ai e kishte ndërprerë marrëdhënien e tij me A.I. ai nuk e kishte kontaktuar atë, as me telefon e as fizikisht. Ai as nuk e ka parë atë.

Në lidhje me dhunimin e supozuar, as dhunim e as ndonjë lloj i marrëdhënieve seksuale në mes të tij dhe E.Z. nuk ka ndodhur ndonjëherë. Ai kurrë nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie, apo ndonjë marrëdhënie seksuale me E.Z. në atë kohë. Ajo ishte e dashura e djalit të dajës tim, I.. Që ky rast nuk ka ndodhur kurrë, që do të thotë mes meje dhe saj, u konfirmua nga mjeku i cili dëshmoi në këtë sallë gjykimi, dhe kjo është vërtetuar edhe nga dëshmia e drejtorit të spitalit. Prova më e mirë që i vërteton këto janë ato dokumentet konfidenciale që unë ia kam dorëzuar trupit gjykues, dokument i cili i është paraqitur edhe prokurorit para fillimit të këtij shqyrtimi gjyqësor.

Ai nuk ka pasur asnjë lidhje me E.Z., ai nuk e di kur ajo ka mbetur shtatzënë ose nëse ajo ka mbetur shtatzënë, ai nuk është shoqëruar me të. Si dëshmi shtesë që e konfirmon këtë dhe në

lidhje me shtatzëninë e pretenduar ekziston një dokument i cili është tashmë në shkresat e lëndës në lidhje me një operacion shumë të veçantë të cilin ai e kishte pasur në klinikën "Medicus".

Deklarata e E.S. e dhënë më 8 mars 2016

Ai kishte një marrëdhënie shumë normale me A.I.. Sikur mos të kishin qenë të lumtur me njëri-tjetrin, ata nuk do të ishin së bashku për gati dy vjet. Ai nuk është një lloj i tipit që zihet. Deri në kohën sa funksionon një marrëdhënie, kjo është në rregull, nëse jo ata ndahen.

Ai nuk e ka bërë asnjë veprim që ta vë në siklet atë. Ata ndaluan së takuari në fund të vitit 2004. Ai ka qenë larg nga jeta normale civile për rreth 5 muaj më pas, ose në spital ose në burg. Nga spitali ai shkoi në burg dhe kjo është arsyeja pse ata u ndanë. Kur ata u ndanë secili e vazhdoi rrugën e vet pa probleme. Ata të dy vazhduan në rrugë të ndara. Ai kurrë nuk kishte pasur / mbajtur në posedim ndonjë foto lakurige / eksplicite të A.I. për ndonjë arsye.

A.I. nuk ka pasur asnjë obligim ndaj tij. Ajo me siguri e ka llogaritur se ai mund të jetë në burg me muaj. Atij i kishin thënë se disa javë më vonë A.I. ishte parë me R.B. në një motoçikletë.

Ai kurrë nuk kishte ndenjtur me motrat e A.I. dhe nënën. Ai e kishte takuar vetëm një herë M.I. dhe kurrë ishte takuar me Z.I.. Ai kurrë nuk e kishte ofenduar ndonjërin prej tyre dhe kurrë nuk i kishte thirrur në telefonin e tyre fiks.

Ai kurrë nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie ose lidhje me A.I. që nga koha kur ata janë ndarë dhe as edhe një mesazh të vetëm nuk ia kishte dërguar.

Deklarata e E.S. e datës 9 mars 2016

Ai nuk e di se si ndodhi që T.R u vra. Ai beson se ka një konspiracion kundër tij që ka për qëllim ta dënoj atë. Ai personalisht kurrë nuk ka pasur ndonjë argument ose problem me T.R.

Ai është marrë për më shumë se 25 vite me tregtinë e veturave. Në dy ose tre vitet e fundit ai ka shitur më shumë se 50 vetura. Statusi i tij financiar ishte i mesëm gjatë vitit 1990, në vitin 2000 si dhe në vitin 2007. Ata punonin si një familje dhe të gjitha pronat që ata i kishin ishin trashëgimi e babait të tij i cili kishte punuar më shumë se 40 vjet.

Ai ishte shoqëruar me Dr. F.M., G.G. dhe me E.S.. Ai gjithashtu ishte shoqëruar me Y. nga Mazgiti, D., M.T., me S.Se. dhe të tjerët. Ai kryesisht rrinte me njerëz më të moshuar se ai. Ai kurrë nuk kishte ndenjur me Z.D. dhe nipin e tij. E njëjta gjë vlen për I.A.n, i cili është i biri i dajës së tij dhe R.A., i cili është daja i tij. D.S. ishte kushëriri i tij, por ai nuk ka ndenjur me të. Me N.S. ai ka jetuar në të njëjtën shtëpi ndërsa me N.Se. ata i kishin shtëpitë në të njëjtin oborr.

Ai ka ndenjur më shumë me N.S. se A.By., pasi ata ishin në të njëjtën gjeneratë. Ai kurrë nuk ka ndenjur me F.A.. Ai nuk është shoqëruar as me A.E., i cili është djali i hallës së tij. A.S. është vëllai i D. dhe djali i axhës së tij, por ai nuk ishte shoqëruar me të. Ai kurrë nuk ka pasur truprojë.

Në lidhje me regjistrimin që e tregon mbledhjen në kopsht në shtëpinë e tij ai ka deklaruar si më poshtë. Ai ishte i vetmi pronar i shtëpisë dhe kjo ishte arsyeja që ai iu kishte dhënë njerëzve të mbledhur atje pije dhe i kishte shoqëruar. D. dhe A.B. nuk ishin miqtë e tyre dhe ata nuk qenë të ftuar, por vetëm kanë kaluar rastësisht atje.

Sipas mendimit të këtij trupi gjykues, deklaratat e E.S. nuk mund të konsiderohet si e besueshme, duke filluar nga marrëdhënia që kishte me A.I.n, së bashku me marrëveshjet që ka pasur me A.B. dhe për të përfunduar me motivet që kishte për të orkestruar vrasjen e T.R. dhe alibia e tij për ditën e vrasjes.

Është përtej çdo dyshimi se E.S. kishte marrëdhënie të vullshme me A.I. dhe kur ata u ndanë dhe A.I. filloi të takohej së pari me R.B. dhe më pas me T.R., ai nuk mund ta duronte këtë dhe filloi ta përcjellë ish-të dashurën e tij. E.S. u ndje i ofenduar personalisht nga fakti se ai ishte ai që e la A.I. dhe e urrente T.R. gjithnjë e më shumë. Ky emocion i fortë u rrit dhe u rrit deri në fundin e hidhur që shpërtheu me incidentet në Swiss Casino dhe në Ferizaj, kur S.,sipas mendimit të tij, u poshtërua rëndë. Në këtë drejtim, prova është e qartë dhe nuk lë asnjë dyshim që askush tjetër nuk mund të ketë pasur ndjenja të tilla të forta të urrejtjes kundër T.R. për ta vrarë atë.

Mbrojtja ka provuar në mënyrë joefektive për të paraqitur një dëshmitar, gjegjësisht kryerësin kryesor të vrasjes, A.B., si personi që e vrau T.R., ekskluzivisht duke qenë i motivuar nga arsyet e veta të hakmarrjes dhe jo duke qenë i udhëhequr në këtë akt nga E.S.. Sipas mendimit të këtij

kolegji, kjo përpjekje dështoi krejtësisht, duke e lënë linjën e mbrojtjes krejtësisht të pabesueshme.

A.B., tani person i dënuar, duke e vuajtur dënimin për vrasjen e T.R., është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, pasi ishte paralajmëruar në lidhje me detyrat dhe privilegjet e dëshmitarit, në pajtim me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale. Ky Kolegj ka qenë i mendimit se, pasi që A.B. më në fund është dënuar për vrasje, si dëshmitar në këto procedura është i detyruar të dëshmojë të vërtetën dhe i vetmi kufizim është se ai nuk është i detyruar të inkriminojë vetveten.

Dëshmia e A.B. provoi të kundërtën. Deri në frymën e fundit, A.B. dëshmoi të jetë një ushtar besnik i E.S. dhe jo vetëm që ai nuk e tha të vërtetën, por ai e inkriminoi vetëm veten e tij për vrasjen, duke mbështetur në këtë mënyrë vijën e mbrojtjes së udhëheqësit të tij E.S..

A.B. dëshmoi si në vijim. Në vitin 2007 ai punoi si një tregtar i automjeteve. Në atë kohë ai ishte shok me R.A.. Ai gjithashtu kishte edhe disa shokë të tjerë në lagjen ku ai jetonte në atë kohë. Ai u njoh me R.A., pasi që ai ishte një tregtar i automjeteve si ai vetë. Kohë pas kohe ai dilte për kafe me R.A.. Shoku tjetër i tij ishte Aha., i cili ishte fqinji i tij. Ata e thërrisnin atë "A..".

Sa për I.A., ai e njohte atë nga pamja, pasi që e kishte parë atë në shoqëri me R.A..

Nganjëherë ai e vizitonte Kafenenë S., por jo shumë shpesh. Ata nuk kishin ndonjë kafene të veçantë për të shkuar; kryesisht ata shkonin në vendet ku rrinin të rinjt. Ai kishte pirë kafe me R.A. në Kafenenë S. një herë, vetëm një herë. Atëherë ai nuk e dinte se kush ishte pronari i kësaj kafeneje. Ai shkoi atje vetëm për të pirë një kafe si qytetar i rëndomtë. Ai e njohte E.S. vetëm nga pamja. Ai nuk kishte pasur asnjë lidhje me të dhe ai vetëm e kishte parë atë në kafene kur kishte shkuar për të pirë kafe së bashku me shokët e tij të lagjes ku ai jetonte. Ai ishte një herë në kafenenë S. me shokët e tij. Një shok i tij, F.D. e ftoi E.S.in në tavolinën e tyre. E.S.i u afrua te tavolina dhe shkëmbyen përzemërsinë me ta. Dhe pastaj F. ia kishte lëshuar karrigen e vet E.S.. Pasi E.S.i u ul në atë karrige, F. e pyeti, nëse ishte e mundur që të bënin një fotografi së bashku dhe E.S.i tha: "Po, mund ta bëni". Përveç këtij rasti, ai nuk kishte ndenjur me E.S. askund tjetër. Sa për N.S., ai e njohte atë vetëm nga pamja. Ai nuk kishte pasur asnjë bisedë me të apo çfarëdo qoftë tjetër. D.S. ishte shok i tij. Ata u njohën me njëri-tjetrin, sepse edhe ai gjithashtu ishte një

tregtar i automjeteve dhe nga kjo ata shoqëroheshin nganjëherë. Ata dilnin në kafene, aty ku zakonisht të rinjtë rrinin për të pirë kafe.

Kishte ndodhur vetëm një herë që ai kishte qenë në shtëpinë e familjes S.. Ai shkoi atje rastësisht dhe ai nuk shoqërohej nga askush. Kjo ndodhi në vitin 2006 dhe në një të diele. Ai shkoi atje për ta thirrur D.S. dhe e luti që të shkonin në tregun e veturave. D. tha se ai nuk munt të shkonte me të, për shkak se një kushëri i tij ishte duke u martuar. D. i ofroi që të hynte brenda dhe të pinte një pije në këtë dasmë, edhe pse ai nuk fliste me ata persona. Pastaj ai dhe D. hynë në oborr dhe zunë vend të një tavolinë atje dhe dëgjuan këngët që i këndonin këngëtarët. Ishte vetëm rastësi, që ai ndodhi të jetë atje, pasi që ishte e diel dhe ai nuk e dinte se aty kishte dasmë.

Gjendja e tij financiare në vitin 2007 ishte e dobët. Ai merrej me vetura, që do të thotë se ai i blinte ato më lirë dhe i shiste ato me një çmim më të lartë. Ai kurrë nuk ka punuar as për E.S. dhe as për N.S.. Ai kurrë nuk e pa, nuk e ka ngarë apo të jetë bartur me një 'pickup' të kuq me mbishkrimin "B. Café" në të.

Ai e njihte T.R nga pamja. A u njoh me të gjashtë muaj para ngjarjes kritike, kur ai ishte duke dalë nga dyqani "Max". T.R. e ndaloi atë dhe ia kërkoi letrat. Ai ishte në rroba civile, nuk e kishte veshur uniformën e zyrtarit policor, kjo është arsyeja pse ai iu drejtua atij, duke i thënë: - "kush je ti të m'i kërkosh dokumentet /". T.R.i iu përgjigj, duke thënë: - "vetëm m'i jep dokumentet, përndryshe do t'çoj në polici dhe do t'rrah". Dhe ai e tha këtë pa treguar ndonjë dokument që do të vërtetonte se ai ishte një oficer i policisë. Ai pastaj ia dha dokumentet e tij dhe T.R. i tha - "ju dukeni si fytyrë negative (...) mbaje mend, sa herë që ne do të takohemi, do të ndodhë kështu dhe mos u paraiqit në këtë anë përsëri".

Ai nuk e di arsyen se pse ai ishte ndalur nga T.R. apo pse T.R. sillej ashtu. Ai shkoi në këtë dyqan për të blerë diçka dhe kur doli atij ju kërkuan dokumentet. Për shkak se T.R.i ishte në rroba civile, ai e pyeti se kush ishte ai.

Një tjetër takim me T.R kishte ndodhur rreth tre muaj para ditës kritike. Ai ishte duke ecur në zonën e quajtur "Kafet e vogla" në rrugën Fehmi Agani në Prishtinë. Ai u takua me T.R.in rastësisht. T.R. po e ngiste një SUV të bardhë dhe, kur e pa atë, ai e ndaloi makinën dhe i tha: - "çfarë të kam thënë". Pastaj T.R.i e goditi atë dy herë me pëllëmbë në fytyrë. Ai e pyeti T.R.in se

cila ishte arsyeja për ndalimin e tij dhe ai tha: - "largohu nga këtu, kurdoherë që do të takoj, do të kesh të njëjtin trajtim".

Herën tjetër ai u takua me të në ditën kritike, ditën kur ndodhi vrasja.

Më datën 30.08.2007 në orën 11.00 ai doli nga shtëpia e tij nga lagjja *Kodra e Trimave* në Prishtinë dhe ai ishte duke ecur nëpër lagjen *Hanit i Dilit, Bahollt, Qafa*. Ai shkoi në *Quince Bar* dhe ndejti aty vet. Ai pui një kafe atje vetëm, ndejti aty rreth dy orë e gjysmë. Pastaj nga kjo kafene ai shkoi në një kafene afër parkingut. Ai hyri brenda dhe u ul në një karrige, e cila ishte afër tarracës. Ai ndejti në këtë kafene për rreth një orë. Pastaj u largua nga kjo kafene dhe shkoi në drejtim të kafenesë "Intermex". Gjatë rrugës, gjersa ishte duke ecur në drejtim të kësaj kafeneje, i ndjeri T.R e thirri dhe i fërshëlleu nga prapa. T.R.i iu afrua dhe e kapi për këmishë dhe i tha: - "Ku je ti, do ta qij nanën, ti haj; nuk dua të ta shoh fytyrën këndejpri; je i neveritshëm; ose do të largohesh ti nga Kosova ose do të flakësh nga ky vend". Pastaj ai gjithashtu i tha - "pse po sillesh këndejpri dhe rreth veturës sime". Ai iu drejtua T.R., duke e pyetur - "pse po më keqtrajtoni kështu sa herë që po takohem me ju", dhe pastaj ai e shtyu dhe i tha: - "çohu dhe shporru ose unë do ta qij nënën dhe do të të vras si qen". Pas kësaj T.R. filloi të shkonte në drejtim të SUV-it dhe kur ai iu afrua nga prapa, ai u ndal dhe shikoi atë duke thënë - "shporru, përndryshe unë do të ta qij nënën dhe do të të vras". Pastaj T.R.i e ngriti dorën e djathtë në anën e majtë të belit. Ai mendoi se T.R.i donte ta nxirrte pistoletën nga çanta që e kishte të ngjitur për beli dhe pastaj në atë moment, për shkak të frikës ai e nxori pistoletën e tij, e mbushi dhe shtiu dy herë në drejtim të tij dhe 11 plumba u gjuajtën nga pistoletë e tij, prej të cilave tre plumba e arritën T.R.. Qëllimi i tij nuk ishte për ta vrarë T.R.in, pasi që ai vetëm u përpoq për ta trembur atë, sepse ai e ndjeu veten të rrezikuar dhe për këtë ka vepruar në vetëmbrojtje. Distanca në mes tij dhe T.R.it ishte 7 deri në 8 metra, sapo gjuajti ai u largua nga vendi i ngjarjes. Arma me të cilën ai shtiu në T.R ishte një pistoletë Glock që ai e kishte blerë katër muaj para vrasjes. Qëllimi i blerjes së kësaj pistolette ishte për të fituar nga ajo, për ta shitur atë me një çmim më të lartë. Në atë ditë kritike, ai e mori pistoletën me vete në mënyrë që t'ia shiste ndokujt. E.S. nuk kishte të bënte asgjë me blerjen e kësaj pistolette. Ai i mori parate nga biznesi për të blerë pistoletën, pasi që ai ishte tregtar i automjeteve. A.Kr. i ofroi atij për ta blerë pistoletën dhe ai e bleu atë, por askush nuk dinte gjë në lidhje me të. Askush nuk e kishte nxitur atë për ta vrarë T.R apo e kishte kërkuar atë në emër të E.S.. Ishte T.R, ai i cili filloi të kishte probleme me të dhe kjo

është arsyeja pse ndodhi kjo vrasje. Ai nuk e di se çfarë ishin raportet në mes T.R. dhe E.S.. Ai kurrë nuk ka dëgjuar për ndonjë problem ose çështje në mes këtyre dyve.

Në ditën kritike para se të ndodhte vrasja, ai ishte në Kafenenë S. dhe ai qëndroi atje me R.A. dhe me I.A.n. Ai nuk iu tregoi në lidhje me atë më parë, për shkak se R.A. është një djalë i dëlirë dhe nuk kishte nevojë që ta përzierte atë në të.

Ai kurrë nuk do të shkonte aq larg sa të rrezikonte 35 vjet burg për vrasjen e dikujt në emër të dikujt tjetër. As për një shtëpi ose për çfarëdo shpërblimi tjetër.

Ky trup gjykues erdhi në përfundim se deklarata e A.B. nuk është aspak e besueshme. Arsyeja është se ky dëshmitar dëshiron ta mbrojë E.S. nga përgjegjësia penale, duke e marrë të gjithë përgjegjësinë për vrasjen. Dëshmia e tij madje nuk është edhe koherente dhe ai bie në kundërshtim me provat e veta. Ai prerazi ka mohuar në përgjigje ndaj pyetjes së avokatit, se ai kishte qenë ndonjëherë në Kafenenë S. atë ditë (f. 15). Megjithatë, ndërsa ende ishte duke dhënë dëshmi të drejtpërdrejtë dhe duke iu përgjigjur avokatit të dytë mbrojtës, ai krejtësisht e ka ndryshuar deklaratën e tij në mënyrë thelbësore dhe i tha gjykatës, edhe pa u vënë nën ndonjë presion nga pyetjet, se ai në fakt kishte qenë në Kafenenë S. megjithatë dhe se ai kishte qëndruar atje me R. dhe I. (f. 18). Justifikim i tij për atë që kishte gënjyer, nuk ishte i besueshëm, se ai ishte duke u përpjekur për të mbrojtur R.. Është dëshmi e qartë se ky dëshmitar nuk ka ndonjë problem që të gënjejë, pavarësisht dëshmisë nën betim.

Një tjetër shembull se si ky dëshmitar e shuan të vërtetën ishte një video (Prova materiale # 3) që përshkruan ahengun në kopsht. Pas shikimit të videos, ishte jashtëzakonisht e qartë se ai ishte në atë aheng ku A.B. ishte duke punuar për E.S. si korier dhe person, i cili i shikonte makinat në portën e përparme. Ky dëshmitar shpjegoi se ai kishte pasur një numër të bisedave me E.S. gjatë asaj ngjarjeje në lidhje me dasmën dhe muzikën, siç pretendonte ai, se kjo ngjarje në fakt ishte një aheng dasme, ai u ftua rastësisht nga D.S.. Ky trup gjykues e kuptoi se A. madje as nuk fliste me E.S., por në fakt ai merrte urdhra prej tij. Ai është parë duke u kthyer në vendin e tij, i ulur në shkallë mbi hyrje. Trupi gjykues e gjeti të pamundur të besohej se kjo ngjarje ishte një aheng dasme, pasi nuk kishte as nuse apo dhëndër, e as nuk i morën vesh emrat e tyre, shumë pak të ftuar dhe askush nuk ishte veshur solemnisht, siç shihen normalisht në dasma shqiptare. Madje edhe i pandehuri kur dëshmoi, ai mohoi se ishte një dasmë. Kjo ishte e gjitha mjaft e

palogjikshme, akt i palidhur i mohimit, pasi që A.B. dhe E.S. u përballën me prova të pamohueshme të marrëdhënies punëdhënës/ punonjës që ekzistonte midis E.S. dhe ushtarit të tij besnik. Pjesa më e madhe e dëshmisë së A.B. e dhënë më 29.10.2015 iu përkushtua justifikimeve të tij absurde.

Shpjegimi që A.B. i dha në lidhje me arsyet që ai vendosi për ta vrarë T.R gjithashtu u konstatuan si jo të besueshme. Një histori e supozuar e dhunshme mes tij dhe T.R. sa që të shkaktojë që A.B. në mënyrë aq drastike dhe të egër të gjuajë në T.R.in njëmbëdhjetë herë nga mbrapa, nuk mbështetet nga asnjë dëshmi. Ai tregoi për dy incidente të supozuara, që ai thotë se kishin ndodhur tre dhe gjashtë muaj para vrasjes, nuk janë konfirmuar nga, për shembull, një kallëzim penal apo ndonjë ankesë zyrtare drejtuar mbikëqyrësve të T.R.. Nuk ka dëshmitarë të besueshëm për këto përpjekje të pretenduara, pasi që dëshmia tërësisht jo e besueshme e R.B., sipas mendimit të këtij trupi gjykues, e orkestruar. Ky trup gjykues erdhi në përfundim se A.B. nuk kishte asnjë motiv personal për ta vrarë T.R, historia e dhunshme e supozuar nuk është asgjë më shumë se një gënjeshtër, që ka për qëllim për të mbrojtur E.S..

Rrëfimi i A.B. për armën u konsiderua nga trupi gjykues si i fabrikuar krejtësisht. A.B. ishte një i ri i varfër, që fitonte para me shitjen e makinave me vlerë të ulët për të jetuar, por mohoi të ketë punuar për S.. Megjithatë, pavarësisht nga të qëniet me të ardhura të ulëta, nga të cilat ai duhej të kontribuonte financiarisht për familjen e tij prej gjashtë anëtarëve, ai tha se ai ishte në gjendje për të blerë një pistoletë të modifikuar, normalisht vetëm ligjërish në dispozicion të njësive të specializuara ushtarake dhe policore për shumën prej 450 eurove tre muaj para vrasjes. Ai tregon: «*i kam marrë paratë nga biznesi*” (fq 17.). Aspak nuk ka gjasa që ai ishte të ishte në gjendje të ketë shumë të tillë të parave. 450 euro në atë kohë ishin shumë më tepër se paga mesatare mujore në Kosovë. Arsyeja pse ai gjoja e bleu atë armë, gjithashtu nuk është e besueshme. Që ta shes për fitim, tha ai. Sipas mendimit të këtij trupi gjykues, kjo histori është bërë për qëllime të kësaj procedure, për të mohuar pretendimin se E.S. e kishte nxitur atë për të kryer një vrasje të rëndë dhe për ta bërë atë të dukej se vrasja ishte kryer në mënyrë spontane nga A.B.. Ky trup gjykues nuk beson se një pistoletë e modifikuar, e përdorur zakonisht nga agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit, ishte blerë për të bërë një fitim. Tregtia e armëve është një biznes i rrezikshëm dhe i paligjshëm dhe nuk gjen një blerës potencial në vende publike. A.B. pohoi, se ai madje nuk e kishte shikuar armën për të parë nëse ajo funksiononte.

Ai deklaroi se pas tre muajsh, ai ende nuk kishte arritur për ta shitur atë. Në fund, ai dëshmoi se ai rrallë e nxirrte atë nga magazina në mënyrë që të gjente një blerës. Kjo nuk është një mënyrë se si sillet një tregtar i arsyeshëm. A.B. nuk e kontrolloi nëse pistoleta ishte funksionale, ai e la atë në magazinë dhe nuk arriti ta shesë atë. Nga një rastësi e pabesueshme, pikërisht atë ditë, ditën e vrasjes, ndodhi rastëshit që ai ta vënte armën në bel. Megjithatë, një tjetër rastësi e pabesueshme, në zinxhirin e ngjarjeve të pamundshme, që ai duhet ta takojë T.R në atë parking të veturave. Ai nuk e ka blerë armën për ta shitur atë. Ajo iu dha atij për një qëllim shumë të veçantë nga ata që kishin mjetet financiare dhe kontaktet për të ardhë në posedim të një arme të tillë vdekjeprurëse dhe specialiste, që do të thotë E.S. dhe banda e tij. Eksperti i armëve të zjarrit deklaroi se kjo ishte një pistoletë Glock e modifikuar specialiste, që kërkon një leje të veçantë për përdorim, pasi që ajo nuk është e lejuar për përdorim civil¹⁷⁰. Vetëm policia e specializuar dhe njësitë ushtarake marrin licencën me ligj për të përdorur një armë të tillë të modifikuar specialiste. Duke u konvertuar nga e zjarrit në plotësisht automatike, ajo e rrit shumë fuqinë e zjarrit të pistoletës dhe shpejtësinë e shkallës së zjarrit. Për një person të rëndomtë që ta ketë atë, rastësisht të ketë ardhë në posedim të saj dhe që në mënyrë të rëndomtë t'ia ketë shitur atë A.B. për 450 euro, është thjesht e pabesueshme. Megjithatë, ai tha se ai e mori pistoletën me vete atë ditë *"në mënyrë që rastësisht ta shiste atë "* (f. 26).

Është vërtetuar gjatë këtij gjykimi se grupi S. kishte qasje në armët e zjarrit dhe se ata ishin mjaft të përgatitur për t'i përdorur ato edhe në publik. Një referencë i është bërë R.A.t që ka gjuajtur me pistoletë në dorën e SwissCasino's ku pjesëtarë të publikut ishin të pranishëm. Edhe përkundër mbrojtjes së tij se ai e ka pasur vetëm një Telefon në dorën e tij, e njëjta video tregon N. duke e mbajtur një pistoletë. Pjesëtarët e tjerë të grupit po ashtu kanë përdorur armë zjarri brenda kur A.By. ka gjuajtur dhe e ka plagosur A.S.. E.S. i është referuar një TT në njëSMS në ora 22:40 me datë 25.08.2007 dhe I.A. i referohet një 15-shiqëeshtë blerë për 500 euro në një SMS të orës 20:53 me datë 27.08.2007. Një TT është një armë tjetër se ajo që është përdorur për ta vlarë T.R., por SMS-itregon prova për qasjen e tyre të lehtë tek armët. E.S. u sigurua që ekzekutori i tij të jetë mirë i pajisur për ekzekutimin e armikut të tij të urryer T.R.

Plani për ta vlarë T.R. që bërë dhe rolet ishin ndarë me A.B. në rolin kryesor të ekzekutorit. T.R. ishte ndjekur nga anëtarët e bandës të cilët e dinin se kafeneja AM/PM ishte vendi ku

¹⁷⁰ Procesverbali nga shqyrtimi gjyqesor , 04. 11. 2015

T.R.irregullisht e kalonte kohën. Ky fakt qe konfirmuar nga barmeni i kafenesë AM/PM S.Ho.¹⁷¹i cili deklaroi se T.R.i vinte në kafenenë AM/PM çdo ditë. Posa makina e tij ështëvërejtur tek hoteli Grand, ishte thjeshtështje e vetëm tëtransportuarit të A.B. në vendin ku ndodhej AM/PM afër parkingut, duke zënë një vend me pamje nga zona e përgjithshme dhe Parkingu të cilën gjëai e pranoi see bëri, dhe duke pritur që T.R.i të dilte. Ai ka theksuar “*unë shkova tek një bar tjetër[nga Quinns] qëështë ngjitur me vend parkingun. Unë nuk e mbaj mend emrin e atij lokali-bari, por unë jam ulur në tavolinën e cila ishte afër terrasës...është ngjitur me parkingun e Flamurtarit .unë mund të shihja një pjesë të parkingut para meje*” (fq. 10-11)¹⁷².

T.R u shfaq. Ai doli nga kafeneja AM/PM dhe ka ecur për në parkingun në drejtim të makinës së tij të parkuar. A.B. vendosi mu në atë moment që të ngrihej dhe të shkoj po ashtu në pjesën e hapur të parkingut. Nuk është një koincident që ka qenëekzekutim i një plani vdekjeprurës. Në ndërkohë I.A. ishte duke pritur përreth dhe afër parkingut në pjesën e antenave të ptk2_2 (në ora 15:20).

Dëshmia e A.B.se ai ka vepruar në vetë-mbrojtje dhe se vetëm ka dëshiruar që ta frikësojëT.R.është krejtësisht e pabesueshme.

Së pari, argumenti i A.B. se ka pasur një fjalosje është tërësisht e kontradiktuar nga dëshmitari S.K., një person i zakonshëm i cili ishte duke punuar në afërsi të vendit të ngjarjes, i cili dha dëshmi duke thënë se ai "dëgjoi tre tështënat automatike" (fq. 4). Në përgjigje të pyetjes se nëse para ose në kohën kur i dëgjoi të shtënat, nëse ai kishte dëgjuar ndonjë bisedë apo bërtitmë apo ndonjë gjë të kësaj natyre, ai u përgjigj: "Jo, vetëm fëmijët ishin duke luajtur" (fq. 5). Prandaj, kjo dëshmi e besueshme tregon se nuk kishte pasur asnjë zënkë me zë të lartë para vrasjes siç pretendohet nga B..

Së dyti, deklarata e A.B.se ai e ka kryer krimin në mbrojtje të nevojshme bie në kundërshtim me provat balistike dhe mjekësore. Në mënyrë për të shtëne me pistoletë, nuk ishte thjeshtë çështje e vetëm të nxjerrit nga brezi dhe tërheqjes së këmbëzës. Ai është dashur që ta nxjerri nga pantallonat e tij; pastaj ai është dashur që ta mbushi atë duke e kthyer mekanizmin prapa në mënyrë që plumbi të dilte nga karikatori dhe të futej në dhomëzën e cilindrit; pastaj ai është

¹⁷¹Procesverbali i gjykimit, 06.11.2014

¹⁷²Procesverbali i gjykimit, 30.10.2015

dashur që ta ketë manipuluar me dorë selektorin duke e shtyre përpara për ta ndërruar funksionin nga gjuajtja e një të shtëne të vetme (semi-automatike) për të shpërthyer ose plotësisht automatike. Të gjitha këto lëvizje A.B. është dashur që ti ketë bërë shumë shpejt. Duhet që të theksohet se çfarë ka thënë ky dëshmitar në lidhje me mungesën e tij të mëparshme të përvojës me armë. Ai duhet të mos ketë gjuajtur kurrë me armë më parë dhe prandaj nuk do të kishte qenë një reagim automatik i tij për ta përdorur armën shpejtë. Rrjedha e ngjarjeve është e çartë për panelin e në fakt ai tashmë e kishte bërë gati armën dhe e kishte zgjedhur opsionin “automatik” para se ti afrohej T.R. nga prapa. T.R u ekzekutua nga prapa dhe në mes të shpinës së tij. Nuk ka asnjë mënyrë që kjo ishte një vetëmbrojtje e tepruar, sepse T.R. u qëllua dy herë në mes të shpinës dhe në vithe të tij, një minimum prej tre plumbash duke hyrë në të. A.B. deklaroi se ai u ndal 8-9 metra larg, kur qëllloi. Asnjë nga plumbat që e goditën T.R. nuk kanë mbetur brenda trupit të tij. Të gjitha kanë dalë dhe ju i keni parë tashmë fotografitë e plagëve të daljes; plumbat fatal kanë kaluar tej përtej trupit të tij. Në deklaratën e tij të dhënë me datë 25.09.2007 tek prokurori, ai ka thënë se largësia ka qenë 2 deri në 3 hapa larg.

A.B. ka deklaruar se T.R nuk është qëlluar nga prapa. Ky panel nuk e konsideron deklaratën si të besueshme meqë është tërësisht e hedhur poshtë nga raporti i autopsisë zyrtare që është bërë mbi T.R e që është provë reale. Në lidhje me këtë, raporti konkludon: “I ndjeri ka marrë minimum tre të qëlluara me armë zjarri të gjitha nga prapa (mbas). Dy të qëlluarat (5/1 & 7/6) në gjoks ishin fatale dhe të qëlluarit (5/1) që ka kaluar nëpër aortë, venën cava, zemrës dhe mushkërive ishte domosdoshmërisht fatale dhe mund të ketë shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Të dy të shtënat në gjoks ishin drejtuar sipër dhe të qëlluarit e domosdoshëm fatal (5/1) në gjoks është më shumë ose më pak i drejtë, ndërsa e shtëna tjetër (7/6) është e pjerrët në të majtë. Të gjitha plumbat kanë dalur nga trupi.” T.R është qëlluar nga prapa, dy nga plumbat duke kaluar tej-përtej trupit të tij. Të gjithaprovat tregojnë që nuk ka pasur një fjalosje që ka shkuar keq. Ishte një ekzekutim i planifikuar më parë, pastër dhe thjeshtë. Çfarëdo shpjegimi tjetër nuk ka kuptim dhe nuk është në përputhje me ndonjë send tjetër të provave dhe ç’ është më e rëndësishmja provat shkencore. Raporti i autopsisë është prova kryesore në të cilën ju mund të mbështeteni plotësisht dhe kjo tregon se A.B. e ka ekzekutuar T.R nga prapa, gjersa T.R. i ishte kthyer larg nga ai. Prova të tjera që A.B. e ka planifikuar vrasjen ishte fakti se ai ishte i veshur me një kapelë gjatë vrasjes. Sapo ai kishte ekzekutuar T.R, ai dëshmoi: “unë e hoqa atë kur jam larguar pak më tej nga vendi i ngjarjes... Unë vetëm e hoqa atë dhe e mbaja në dorë. Unë e kam mbajtur kapelën vetëm se kam

dashur dhe unë kam mbajtur kapelë edhe më parë” (fq. 16) .ai me qëllim e ka hequr nga koka e tij gjersa largohet nga vendi i krimit dhe kjo është për shkak se ai e ka mbajtur atë kapelë para vrasjes në mënyrë që të mos njihej nga T.R.i. Ai e ka hequr atë në mënyrë që të largohet nga vendi i krimit.

Së treti, pretendimi i ngritur nga mbrojtja duke pretenduar se T.R ishte i dehur në ditën kritike ishte diskredituar nga opiniononi i Institutit të Mjekësisë Ligjore nga Zagrebi. Ky mendim i besueshëm nuk lë hije dyshimi se viktima në ditën e vdekjes ishte i kthjellët. Mbrojtja ka provuar që tëdëshmojë se T.R ka provokuar një fjalosje me fjalë me A.B.në përpjekje për të lënë një impresion se ishte vetëm një konflikt në mes të A.B. dhe T.R. pa përfshirjen e klientit të tyre. Mendimi i institutit mjeko-ligjor është konsideruar si plotësisht i besueshëm meqë ajo është hartuar në mënyrë profesionale, në mënyrë të detajuar në përputhje me zbulimet shkencore. Mendimi i S.G.N.’s nuk u konsiderua edhe aq i besueshëm meqë ishte i bazuar në llogaritje të pasakta.

Së fundi, A.B. u dënua më në fund dhe u shpall fajtor për vrasje të rëndë nga Gjykata e Lartë në Aktgjykimin AP.Nr 336/2010 me 35 vite burgim. Rrethanat e reja që ai ka ngritur mund të përdoren si argument për të iniciuar mjetet juridike në rastin e tij.

Më në fund, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive relevante, Paneli konstaton se A.B. e ka vrarë T.R duke u nxitur nga E.S..

Pika 3

Pika 3 e aktakuzës bazohet në deklaratën e palës së dëmtuar Dëshmitares A e cila ka dëshmuar si në vijim. Rrjedha e ngjarjeve që i është dhënë Prokurorit Reshat Millaku në tetor të vitit 2007, dhe që ishte edhe në deklaratën e datës 8 shtator 2007, është tërësisht e pavërtetë. Ajo nuk kishte të bëjë asgjë me atë deklaratë meqë ishte përpiluar nga të tjerët.

Ajo ka qenë në lidhje me I.A. nnga viti 2003 dhe ata e kanë dashur njëri tjetrin dhe e kanë ruajtur lidhjen e tyre. (sa i përket virgjërisë së saj të cilën ajo e kishte humbur kur ishte 18 vjeçe).

Ajo nuk e njeh dhe nuk kishte kontakte me E.S.. Ajo vetëm e ka ditur dhe kishte dëgjuar se E.S. ishte djali i tezës së I.A.. E.S. nuk e kishte dhunuar atë asnjëherë. Ajo nuk ka pasur kontakt me E.S.meqë ishte e dashura e I.A.. As atëherë e as tani ajo nuk ka frikë nga ai.

Në vitin 2007 policia filloi që ta kërcënojë atë. Nga viti 2007 e deri në vitin 2013 ajo qe ndjekur nga policia gjatë tërë kohës, por asnjë zyrtar policor nuk i ishte afruar asaj që ta kërcënojë apo ta frikësojë. Ajo ka qenë e tmerruar gjatë gjithë kohës, ka pasur vizione dhe është zgjuar duke ulëritur. Dhe të gjitha këto për shkak të keqtrajtimit që i kishte pësuar në stacionin e policisë në vitin 2007. Ajo ishte keqtrajtuar psikologjikisht deri në atë masë sa që kishte rënë në depresion të thellë dhe është dashur që të kërkojë ndihmën e psikiatrit. Kërcënimet kanë zgjatur gjer në vitin 2013. Ajo e ka informuar gjykatën në lidhje me kërcënimet e vazhdueshme në dy raste të ndryshme në vitin 2009 dhe 2010. Kur policia filloi që ta kërcënojë atë në vitin 2007 ajo u ndie nën presion dhe ra në kolaps. Ajo filloi që të marrë sedativë, por pas një kohe ajo e kuptoi që nuk mund ta drejtonte situatën vetë dhe shkoi që ta takojë një psikiatër. Mjeku i shkroi asaj disa ilaçe. Ajo i mori të gjitha ilaçet të cilat mjeku ia përshkroi sepse ishte në një gjendje kritike. Herën e fundit kur ajo e takoi psikiatrin ishte në vitin 2013. Ajo mund ti mbaj në mend dy ose tre vizita. Nuk është e vërtetë që ajo tentoi që të bëjë vetëvrasje. Dimrin e vitit 2013 ajo ishte në spital për shkak se ajo ishte e dehur. Të gjitha këto ndodhën për shkak të kërcënimeve të zyrtarëve policorë B. dhe B.. Aksidentalisht ajo mori një dozë më të lartë të medikamenteve të cilat është dashur që ti merrte, por ajo nuk ka tentuar që të bëjë vetëvrasje.

Ajo asnjëherë nuk ishte detyruar që të ketë marrëdhënie intime. Nëse kjo gjë do të i ndodhte asaj ajo do e kishte raportuar këtë gjë tek autoritetet. Ajo nuk ishte asnjëherësh tatzënë e as që kishte patur abort.

Ajo nuk i mban në mend mirë numrat dhe kjo është arsyeja se ajo e ka një numër që është shumë lehtë për ta mbajtur në mendje. Të gjitha numrat e telefonit të të afërmeve të saj dhe miqve janë të ruajtura në telefonin e saj mobil. E njëjta gjë vlen edhe për tabelat e regjistrimit.

Kjo dëshmitare gjatë dëshmisë së saj në gjykatë ka rënë në kontradikta serioze dhe në thelb e ka ndryshuar dëshminë e saj paraprake. Ajo ka përshkruar po ashtu edhe çrregullime psikiatrike me të cilat ajo u përball duke e imponuar mbi panelin detyrimin për të ushtruar kujdesin e duhur.

Dëshmitarja A deklaroi gjatë procedurës paraprake se si rezultat i dhunimit ajo mbeti shtatzënë dhe vendosi të abortojë fetusin, por të dhënat e procedurës mjekësore u zhdukën.

Paneli vendosi që ta marrë në pyetje ex officio Dëshmitaren Dr M.P. e cila është pronare e Klinikës Private Mjeksore G./Shefe e Paviljonit të Gjinekologjisë me që dëshmitarja A në vitin

2004 kur dhunimi i pretenduar kishte ndodhur kishte kërkuar këshillën e saj. Dëshmitarja ka deklaruar:

Në fund të vitit 2004 kanë qenë dy mjekë dhe një infermiere që punonin në klinikë. Ajo ishte në thelb Klinikë e grave. ishte e hapur vetëm për katër orë në ditë dhe vetëm ofronte egzaminime. Ajo ka punuar katër orë pasdite, nga katër deri në tetë të mbrëmjes. Rreth 800-900 egzaminime në vit janë kryer, që do të thotë se ajo do të kontrollonte në mes të 50 dhe 80 paciente në çdo muaj. Klinika është shumë e vogël dhe nuk ka sallë operacioni. Asnjë pushim i shtatzënive ose aborteve artificiale nuk janë kryer në klinikë. Në atë kohë, në vitin 2004 nuk ka pasur të dhëna në letër për pacientët. Ata i mbanin të dhënat në kompjuter, por tani ato mbahen në libra. Kjo për shkak se klinika ishte thyer disa herë dhe kompjuterët që i kishin këto të dhëna ishin vjedhur. Kanë qenë tre vjedhje në klinikë dhe rastet janë raportuar në polici.

Edhe pse në atë kohë, në vitin 2004 nuk ka pasur të dhëna në letër për pacientët, cdo herë që një pacient është egzaminuar janë marrë shënime duke i shkruar. Ata ishin të detyruar të ia japin këto raporte me shkrim pacientit në mënyrë që ai ose ajo të shkojë në farmaci për t'i blerë ilaçet. Ata kanë filluar me mbajtjen e librave të protokollit në vitin 2007 ose 2008. (në vitin 2007 ose 2008 ata filluan të i mbajnë të dhënat në librat e protokollit). Ajo u ka dhënë këshilla pacientëve në klinikë për pasojat e ndërprerjes. Asnjë abort nuk është kryer në klinikë. Ajo i ka performuar abortet në spital, sepse ky ishte profesioni i saj.

Ajo nuk kishte punuar me dëshmitaren A, por ajo e di që dëshmitarja është një motër medicinale në pavijonin e kirurgjisë në spital. Dëshmitarja erdhi në klinikën publike/spitalin e përgjithshëm që të egzaminohet. Kjo ka qenë hera e parë që ajo u takua me të. Ajo nuk e di datën e saktë. Dëshmitarja ishte sjellë nga krye-infermierja e cila tha: “ kjo është një kolege e re dhe ajo dëshiron që ta bëjë një egzaminim”. Ajo nuk e mban në mend emrin e motrës së vjetër. Ajo vetëm e mban në mend se ajo e ka egzaminuar dëshmitaren dhe se ajo e kishte marrë një mostër shtupe në mënyrë që të përcaktojë nëse ka pasur ndonjë infeskion. Ajo beson se arsyeja se përse ajo kishte ardhur për ta takuar atë ishte se ajo nuk mund të ngelte shtatzënë. Dëshmitarja e mori mostrën e shtupës dhe e dërgoi vetë në laborator. Testet e analizave janë kthyer me rezultat pozitiv për infeksion. Nuk ka pasur asnjë diskutim mbi ndërprerje meqë ata nuk e marrin një mostër shtupe deri në javën e 12 të shtatzënisë. Ajo nuk e ka bërë asnjëherë një abort apo një ndërprerje të shtatzënisë për këtë dëshmitare në asnjë kohë.

Vizita duhet të jetë mbajtur në procesverbal, sepse analizat ishin kryer në laboratorin shtetëror në Klinikën Universitare të Prishtinës. Sidoqoftë mundësia është se dëshmitarja ka mundur që ti dërgojë ato mostra tek një klinikë private por nuk ka pasur nevojë për një gjë të tillë meqë testet kanë mundur që të bëhen në laboratorin e institutit të mikrobiologjisë dhe atë falas.

Dëshmitarja M.P. ka konfirmuar se ajo ia ka kryer ekzaminim mjekësor dëshmitares A, por arsyeja e vizitës së saj ishte për të përcaktuar se pse ajo nuk mund të mbese shtatzënë. Ndërprerja e shtatzënisë nuk është kryer në një klinikë private, por në një spital publik, ku të dhënat mjekësore janë mbajtur. Dëshmia e dëshmitares së besueshme M.P. ka lënë edhe më shumë dyshime për besueshmërinë e dëshmitares A, pasi ajo nuk ka kërkuar këshilla mjekësore për ndërprerjen e shtatzënisë. Kur ia shtojmë edhe trajtimet psikiatrike që ajo i ndërmori, ky panel ka gjithnjë e më shumë dyshime nëse kjo dëshmitare mund të konsiderohet si e besueshme. Kjo gjë nuk i shpëtoi vëmendjes së këtij paneli që dëshmitarja A ishte në marrëdhënie me I.A. që nga viti 2003 deri në vitin 2007 dhe ata e donin njëri-tjetrin dhe e kanë ruajtur lidhjen e tyre. Pyetja është se poqese ajo ishte dhunuar nga E.S. në vitin 2004, përse ajo nuk ishte ankuar tek i dashuri i saj. Dëshmitarja A ka punuar si motër medicinale në Klinikën Universitare në Prishtinë ku i plagosuri T.R ishte dërguar, ajo kishte shkuar në pjesën ku ishte vendosur Riza dhe një përlëshje kishte ndodhur. Dëshmitarja A ka mundur që të jetë frikësuar se ajo do lidhej me vrasjen e T.R. kështu që ajo e sajoi një tregim dhe e prezantoi veten e saj si një viktimë tjetër e E.S..

Duke pasur parasysh deklaratën e dëshmitares A, që është kontradiktore, nuk përputhet plotësisht me provat objektive përkatësisht deklaratën e M.P., trajtimet psikiatrike të cilave ajo iu nënshtrua, ky panel erdhi në të vetmin përfundim të mundshëm që dëshmitarja nuk mund të konsiderohet si dëshmitare e besueshme.

Andaj, nuk është provuar përtej cdo dyshimi të arsyeshëm se E.S. e ka kryer veprën penale sipas pikës 3 të akuzës. Dyshimet në lidhje me egzistimin e faktit relevant për pikën 3, janë të pranishme, andaj paneli që i obliguar nga dispozita e nenit 3, pika 2, e Kodit të Procedurës Penale, që ti interpretojë ato në favor të të pandehurit.

Dënimi

Pas shqyrtimit të të gjitha provave relevante në këtë rast, ky trup gjykues erdhi në përfundim se E.S. ka kryer dy vepra penale siç është akuzuar në

Pikën 1, nxitje për të kryer vrasje të rëndë, në shkelje të nenit 24 dhe nenit 147 (3) dhe (9) të KPK-së

Pikën 2 detyrim, në shkelje të nenit 267 paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së.

Vepra penale në pikën 1 ishte kryer më 30 gusht 2007 dhe vepra penale e përshkruar në pikën 2 ishte kryer nga fillimi i vitit 2003 deri në fund të vitit 2004.

Ky trup gjykues mori parasysh dispozitat e nenit 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, që lexon si më poshtë:

1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. 2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

Kodi i tanishëm penal tashmë ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, kështu që ky trup gjykues ishte i detyruar që të krahasojë dënimet e parapara për të njëjtat vepra në kodin e vjetër dhe në kodin e ri penal. KPK-ja parasheh për veprën penale të vrasjes së rëndë dënimin me burgim prej së paku dhjetë viteve ose me burgim afatgjatë. Sipas nenit 38 (1) të KPK-së dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se njëzet vjet. Neni 37 (2) i kodit të njëjtë parasheh që burgimi afatgjatë është burgim për një periudhë prej njëzet e një viteve deri në 40 vite.

Kodi i ri penal në nenin 179 për vrasjen e rëndë parasheh burgimin prej jo më shumë se 10 vjet ose me burgim të afatgjatë. Neni 45 thotë si vijon: "dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë ose më shumë se 25 vjet.

Krahasimi i këtyre dy kodeve penale çon në përfundimin se kodi i vjetër është më i butë për këtë të pandehur.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave përkatëse trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi me burgim duke filluar nga 10 deri në 20 vjet nuk e pasqyron shkallën e përgjegjësisë penale dhe motivet për kryerjen e aktit. Në rrethanat në fjalë vetëm burgimi afatgjatë do të marrë parasysh qëllimin e dënimit.

Gjatë shqiptimit të dënimit për krimin e përshkruar në pikën 1, ky trup gjykues ka marrë parasysh nenin 37 (1) të KPK-së që thotë: " Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda. "

Kjo vrasje ishte e pashembullt, një i ri, një polic në ngritje u vra brutalisht në kryeqytet, në një vend publik, në dritë të ndritshme, në praninë e kalimtarëve. Kjo nuk ishte vdekje e shkaktuar nga aksidenti tragjik; ai u ekzekutua brutalisht nga një shpërthim i armës automatike të zjarrit në mënyrë të pabesë, duke shtënë në të nga prapa. Të vrarët as nuk kanë pasur guxim të mjaftueshëm për ta shikuar në sy viktimën dhe kanë përdorur armë vdekjeprurëse që zakonisht përdoren nga njësitet speciale ushtarake / policore. Viktima në minimum ka marrë tri të shtëna zjarri; dy të shtënat në gjoks ishin fatale. Në të vërtetë A.B. nuk e kishte përdorur këtë armë vdekjeprurëse as ta trembë e as ta lëndojë T.R. Qëllimi ishte i qartë, për ta privuar nga jeta T.R. Ky trup gjykues kishte përcaktuar përtej çdo dyshimi, se A.B. kishte tërhequr këmbëzën, por ai nuk e ka bërë këtë për shkak të arsyeve personale por ai ka qenë i nxitur nga bos i tij / udhëheqësi E.S. i cili jo vetëm që ka planifikuar e ka organizuar por edhe ka nxitur dhe ishte afër vendit të vrasjes me siguri duke vëzhguar nga një distancë se si ishte duke u ekzekutuar plani i tij për hakmarrje. Trupi gjykues erdhi në përfundimin se E.S. kishte disa motive për të eliminuar T.R dhe arsyeja e parë dhe më kryesorja ishte se A.I. ishte një ish-e dashur e E.S. e cila kishte guxuar që ta braktisë atë dhe të krijuar marrëdhënie të re personale me T.R. Është e panevojshme të thuhet se A.I. ka qenë një çështje e diskutueshme dhe konfliktuoze e cila kishte arritur nivelin më të lartë të urrejtjes dhe hakmarrjes që E.S. kishte vendosur ta bëj mbi armikun e tij më të urrer. E.S. nuk e ka vrarë T.R personalisht, sepse si udhëheqës i grupit të tij duke u respektuar nga anëtarët e saj ka pasur privilegjin dhe burimet materiale për të urdhëruar këtë ekzekutim që të kryhet nga një prej ushtarëve/punëtorëve të tij të bindur, A.B., i cili në fakt ka dëshmuar se është besnik pasi që ai e vrau T.R me gjakftohtësi dhe më vonë u përpoq që ta mbroj E.S. duke i treguar gjykatës histori false në lidhje me konfliktin që ai e ka pasur me T.R.

Me këtë vrasje të kryer në rrethanat e përshkruara më lart, E.S. ka dëshmuar se ai është i paskrupullt, një kriminel i cili ka organizuar një "ekzekutim publik" të policit duke treguar se ai nuk e respekton rendin publik duke e dëmtuar sundimin e rendit dhe ligjit që i mban qytetarët e Kosovës të sigurt dhe të siguruar nga kriminelët. Ky trup gjykues është i vetëdijshëm se kjo vrasje brutale ka shkaktuar në public protesta dhe marshime të protestave.

Në bazë të nenit 64 (1) të KPK-së, gjykata, gjatë marrjes së aktgjykimit duhet të marrë në konsideratë qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat që janë të rëndësishme për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit-- në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprës, intensitetin e rrezikut të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryesit, rrethanat personale dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.

E.S. është një kriminel i rrezikshëm që duhet të eliminohet nga shoqëria për aq kohë sa të jetë e mundur dhe për këtë arsye edhe burgosja prej 20 viteve nuk do të ishte në proporcion me të gjitha rrethanat rënduese.

I pandehuri ka një dosje penale për veprat penale të dhunës dhe kërcënimeve të cilat janë të rëndësishme pasi që ato tregojnë se ai ka një prirje për të kryer vepra të dhunshme dhe për këtë arsye këto dëshmojnë se ka më shumë gjasa se ai i ka kryer veprat penale të renditura në këtë aktakuzë. Informatat e mëposhtme mbi të dhënat penale tregojnë gjithashtu se E.S. thuhet se është përfshirë në vepra të shumta të rënda, së bashku me anëtarët e tjerë të bandës së tij.

Në sjelljen e mëparshme të këtij të pandehuri ky trup gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë lehtësuese. Duhet të theksohet se dënimi prej 35 viteve që i ishte shqiptuar A.B. nuk ka pasur asnjë ndikim në dënimin prej 37 viteve që iu kishte shqiptuar E.S.. Trupi gjykues ishte i mendimit se proporcionaliteti i caktuar duhet të ruhet dhe E.S. si person i cili ka planifikuar, organizuar dhe nxitur planin e vrasjes nuk mund të trajtohet më butë se sa kryesi kryesor.

Gjykata në rastin e pikës 2 vendosi për të kufizuar përgjegjësinë penale të E.S. me nenin 267 (1) të KPP-së që parasheh dënimin me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet. Kodi i tanishëm penal në nenin 340 parasheh saktësisht të njëjtin dënim. Nën këto rrethana trupi gjykues ka përdorur ligjin që ishte në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale. Arsyeja pse ky trup gjykues ka vendosur që të përjashtojë një formë të cilësuar të veprës penale të detyrimit siç përcaktohet në paragrafin (2) të KPP-së është për shkak se është vërtetuar se E.S. e ka kryer këtë vepër penale duke përdorur një mjet të rrezikshëm. A.I. nuk e ka përmendur kurrë se ajo ishte kërcënuar me një mjet të rrezikshëm; ajo ka qenë një objekt i kërcënimeve serioze, por jo me një mjet të rrezikshëm. Përveç kësaj nuk ka dëshmi se detyrimi ka rezultuar në dobi të madhe pasurore, pasi që një përkufizim ligjor i dëmit të madh pasuror nuk është paraparë në KPP në kundërshtim me kodin e ri penal që në paragrafin 2 parashihet në lidhje me shumën që tejkalon shumën prej 10.000 eurove, por kjo dispozitë si më pak e favorshme për të pandehurin nuk mund të përdoret.

Trupi gjykues në bazë të dispozitës së nenit 71 (2) ka shqiptuar dënimin afatgjatë si dënim unik të cilin ai do ta vuajë.

Baza e të dhënave e SIPK-së të Policisë së Kosovës ka paraqitur të dhënat vijuese nga dosja penale lidhur me të pandehurin:

a. Rasti 2001-PA-3 i hapur më 27.01.200,1 ku E.S. dyshohet për Ngacmim/Frikësim. Një viktimë ishte ankuar se gjersa luante lojëra të fatit, i dyshuari i kishte hedhur një hap gjumi në

pije pa e ditur ai gjë që i shkaktoi atij humbje të vetëdijes. Kur ishte zgjuar, i dyshuari i kishte thënë atij se ai kishte humbur shumë para dhe se nëse nuk paguante do të vritej. Gjithashtu, raportohet se i dyshuari e kishte goditur atë me shishe në kokë. Statusi: i liruar nga akuzat.

b. Rasti 2001-PA-4754 i hapur më 25.11.2001 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës penale të Vrasjes në Tentativë. Në këtë incident, ishte raportuar një shkëmbim zjarri në të cilin ishte i përfshirë E.S., S.S. dhe N.Da., pas një mosmarrëveshjeje. Statusi: paraqitur në prokurori;

c. Rasti 2003-TA1-130 i hapur më 11.01.2003 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës penale të Sulmit. Në këtë incident, ishte raportuar se E.S. së bashku me afërsisht 10-13 bashkëkryerës të tjerë kishin sulmuar viktimën A.Bu. në hapësirat e Café “Boom Boom Room”. Një viktimë tjetër K.C. raportohet se kishte marrë lëndime serioze. Statusi: është shpallur fajtor;

d. Rasti 2003-TA3-94 i hapur më 22.01.2003 ku E.S. dyshohej për veprën Moszbatim i urdhrave të policit. Ishte raportuar se një veturë BMW që vozitej nga E.S. nuk ishte ndalur në pikën kontrolluese të policisë dhe kishte ikur duke rrezikuar këmbësorët dhe veturat. Kur më në fund ishte arrestuar, policia konstatoi se E.S. kishte vozitur pa patentë shoferi. Statusi: paraqitur në prokurori;

e. Rasti 2003-AH-1483 i hapur më 12.11.2003 ku E.S. dyshohej për Zjarr vënie. Në datën e cekur, policia ishin njoftuar se i burgosuri E.S. dhe të tjerët i kishin vënë zjarrin qelisë së tyre të burgut në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Statusi: nën hetim;

f. Rasti 2004-AB-2931 i hapur më 31.10.2004 ku E.S. dyshohej për kryerjen e Vrasjes dhe Mbajtje në posedim të paautorizuar të armëve. Në këtë incident, katër persona ishin plagosur gjatë një shkëmbimi të zjarrit, pra E.S., A.Al., P.G. dhe R.A., ndërsa A.Al. kishte marrë plagë vdekjeprurëse. Statusi: i liruar nga akuzat;

g. Rasti 2005-AD-1281 i hapur më 02.05.2005 ku E.S. dyshohej për veprën Sulm kundër paraqitëses së ankesës A.I.. Statusi: nën hetim;

h. Rasti 2005-AD-1416 i hapur më 12.05.2005 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës penale të Sulmit të rëndë, Sulmit dhe Ngacmimit. Ishte raportuar se një patrullë e Njësisë ROSU e kishte ndaluar një veturë Peugeot me regjistrim XXX-KS-XXX që vozitej nga E.S.. Kur kishin dashur të kontrollonin veturën dhe pasagjerët, E.S. i kishte kërcënuar policët se ai do t'i vriste ata

nëse nuk do të lejohej të shkonte, ndërsa N.Se. i cili e shoqëronte atë, i kishte sulmuar dy nga pjesëtarët e PK-së. Statusi: paraqitur në prokurori;

i. Rasti 2005-AB-3670 i hapur më 10.09.2005 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprave të Sulmit dhe Dëmtimit. Viktima ishte J.Th., menaxher i café bar “Publicum”. Ai ishte kërcënuar dhe sulmuar nga një grup i madh i njerëzve përfshirë edhe E.S. sepse kishte refuzuar ta mbante lokalin hapur për ta pas orarit të mbylljes. Statusi: paraqitur në prokurori;

j. Rasti 2005-AD-2949 i hapur më 17.09.2005 në të cilin E.S. dyshohej në një sulm me granatë/minë/eksploziv. I dyshuari, duke vozitur një Volkswagen Golf të zi, ishte raportuar se kishte qenë i përfshirë në një shkëmbim zjarri. Statusi: nën hetim;

k. Rasti 2005-AT-557 i hapur më 02.10.2005, ku E.S. dyshohej për Shkaktim të Rrezikut të Përgjithshëm. Viktima R.G. kishte raportuar se derisa ishte i ulur në kafenenë “Night” me shokët e tij, E.S. u ishte afruar atyre dhe kishte filluar të shtinte nga arma, pa shkaktuar lëndime Statusi: s’ka informacion;

l. Rasti 2005-AB-4189 i hapur më 18.10.2005 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës penale të Posedimit të paautorizuar të municionit. Ishte raportuar se, gjatë një kontrole nga policia e trafikut, ishte ndaluar dhe kontrolluar një xhip Cherokee që vozitej nga E.S.. Gjatë këtij rasti, policia kishte gjetur një gëzhgjë plumbi. Statusi: paraqitur në prokurori;

m. Rasti 2005-AB-4528 i hapur më 09.11.2005 në të cilin E.S. dyshohej në një incident të mjeteve të pashpërthyer në të cilin një veturë, Audi A4, pronë e F.Mu., kishte shpërthyer. Statusi: paraqitur në prokurori;

n. Rasti 2005-AB-5113 i hapur më 25.12.2005 në të cilin E.S. ishte hetuar për kryerjen e veprës penale të Vrasjes. Gjatë një përlëshjeje që kishte rezultuar në shkëmbim zjarri, disa persona ishin plagosur, përfshirë një pjesëtar të PK-së që ishte jashtë detyrës, në lokalet e diskotekës Swiss Casino. Pjesëtari i PK-së T.R gjithashtu ishte sulmuar. Rasti është paraqitur në detaje më lartë në pjesën e njohur si Rasti “Swiss Casino”. Statusi: paraqitur në prokurori;

o. Rasti 2006-AB-1458 i hapur më 04.05.2006 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës së Ngacimit/Frikësimit. Viktima T.R, ishte ankuar se E.S., së bashku me A.By.n dhe N.Se. ishin

munduar që qëllimisht të përplaseshin në veturën e tij. Pala e dëmtuar kishte theksuar se ai ishte kërcënuar seriozisht nga të dyshuarit. Statusi: paraqitur në prokurori;

p. Rasti 2006-CF-1007 i hapur më 22.05.2006 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës së Ngacmimit/Frikësimit. Një viktimë femër kishte raportuar se, derisa ishte e ulur në një kafene, ajo ishte kërcënuar përmes telefonit nga E.S.. Rasti është përshkruar në detaje më lartë si rasti i “Ferizajt”. Statusi: paraqitur në prokurori;

q. Rasti 2006-CF-1009 i hapur më 22.05.2006 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprave penale të Pengimit të Drejtësisë, Ngacmimit dhe Posedim i paautorizuar i armëve. Njësia ROSU e SHPK-së kishte raportuar se disa pjesëtarë të saj kishin marrë lëndime pasi që ishin sulmuar nga E.S. dhe dy të dyshuar të tjerë gjatë një operacioni për arrestimin e tyre. Hetimet lidhur me këtë rast janë paraqitur më lartë në detaje në Rastin “Ferizajt”. Statusi: është shpallur fajtor;

r. Rasti 2006-AB-3570 i hapur më 27.10.2006 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprave penale të Ngacmimit/Frikësimit. Në këtë rast, E.S. ishte arrestuar pas sulmit ndaj disa policëve të PK-së gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas urdhrin të gjykatës. Statusi: i arrestuar 27.10.2006;

s. Rasti 2007-AB-2728 i hapur më 16.08.2007 ku E.S. dyshohej për kryerjen e veprës së Prishjes së rendit publik. Viktima, H.Bla. ishte ankuar se E.S. kishte shkaktuar një skandal duke pretenduar se djali i tij i kishte atij para borxh. Statusi: paraqitur në prokurori;

Në përputhje me nenin 365 paragrafin 1.5 të KPP-së, koha të cilën i pandehuri E.S. e ka kaluar në paraburgim prej datës 03.01.2014 deri më 17 maj 2016 ishte llogaritur në dënim.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Lënda nr.: PKR.Nr.218 / 14

Kryetari i trupit gjykues

Arkadiusz Sedek

Procesmbajtësi

Mjeti juridik: Në bazë të nenit 380 të KPP-së, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit tek palët. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës.